

LULJETA PROGNI

Media shqiptare,
rrugëtimi i vështirë drejt lirisë

Tiranë, 2021

Titulli: Media shqiptare, rrugëtimi i vështirë drejt lirisë

Autore: Luljeta Progni

Recensues: Prof. Dr. Afrim Krasniqi

Redaktore: Ornela Mici

Puna kërkimore: Diona Çeço

Kopertina: Pandeli Çeço

© Fondacioni Konrad Adenauer Shqipëri

Të gjitha të drejtat e rezervuara

ISBN:

Ky punim u financua për publikim nga Fondacioni Konrad Adenauer Shqipëri.

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e organizatës mbështetëse.

Përmbajtja

Parathënie	7
I. LINDJA E MEDIAS SHQIPTARE	11
1.1 Përpyqjet për të botuar në gjuhën shqipe	11
1.2 Çelja e shkollës së parë shqipe.....	15
1.3 Revista “Albania”	17
1.4 Botimi i kalendarëve vjetorë me përmbledhjet e ngjarjeve historike.....	21
II. ZHVILLIMI I MEDIAS DHE NDIKIMI I SAJ NE ARRITJEN E PAVARESISE (1901-1912)	25
2.1 Media në prag të pavarësisë	25
2.2 Kongresi i Manastirit dhe ndikimi tek mediat në gjuhën shqip	27
2.3 Shtypshkronjat e para në Shqipëri	29
2.4 Mediat jashtë kufijve të Shqipërisë.....	32
III. ZHVILLIMI I ORGANEVE TE SHTYPIT DERI NE SHPALLJEN E MONARKISE (1913-1928)	37
3.1 Organet e shtypit pas shpalljes së pavarësisë	37
3.2 Kontributi i motrave Qiriazi në media	42
3.3 Rubrikat informative si standard i ri i medias	46
3.4 Organet e shtypit përballë akuzave në gjyq	53

IV. MEDIA NE KOHEN E MONARKISE (1928-1939)	57
4.1 Media midis lirisë dhe censurës	57
4.2 Shtypi i përdorur nga pushteti.....	62
4.3 Ashpërsimi i censurës pas vitit 1936	64
4.4 Kritika dhe përplasjet mes organeve të shtypit	69
4.5 Marrëdhëniet mes redaksive dhe komunikimi me lexuesin	72
4.6 Psuedonimet e disa autorëve në median e shkruar	74
4.7 Stacioni i parë radiofonik në Shqipëri, Radio Tirana	76
4.8 Studimi i parë për median shqiptare.....	78
V. MEDIA SHQIPTARE GJATE PUSHTIMIT (1939-1944)	81
5.1 Reduktimi i numrit të gazetave e revistave pas pushtimit fashist	81
5.2 Idetë komuniste në media	85
VI. MEDIA NE DIKTATURE (1944-1990)	91
6.1 Media gjatë periudhës së instalimit të diktaturës komuniste	91
6.2 Disa nga gazetarët e ekzekutuar dhe burgosur gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri	100
6.3 Dhuna e diktaturës ndaj elitës shqiptare.....	101
6.4 Roli i medias si vegël propogande e diktaturës.....	107
6.5 Fillimi i transmetimeve televizive dhe ndikimi i tyre në shoqëri	112

VII. MEDIA NE TRANZICIONIN POSTKOMUNIST (1990-2020)	114
7.1 Liria e medias pas 45 viteve diktaturë	114
7.2 Ristrukturimi i medias pas krizës së vitit 1997.....	120
7.3 Tkurrrja e shtypit të shkruar dhe ngritja e medias audiovizive	121
7.4 Media përballë politikës	124
7.5 Problematika me kontrollin e medias.....	126
7.6 Dhuna ndaj gazetarëve	130
7.7 Etika në media, gjithçka për klikime.....	131
7.8 Media dhe përballja me të shkuarën	133
 Përfundime	135
 Aneks 1: Shkrime të përzgjedhura nga shtypi shqiptar	138
Aneks 2: Dokumente me informacione të vlefshme për gazetarët, botuesit dhe median shqiptare	175
Aneks 3: Lista me disa prej autorëve që kanë shkruar në më tepër organe shtypi	188
Aneks 4: Lista e disa prej shtypshkronjave kryesore që shtypnin gazeta e revista në Shqipëri deri në vitin 1944.....	189
Aneks 5: Reklamat e para në shtypin shqiptar	190
Aneks 6. Lista e organeve të shtypit gjatë viteve 1848-1944	194
Aneks 7: Lista e autorëve shqiptarë të medias së shkruar gjatë viteve 1848-1944	211
 Referenca.....	224

Parathënie

Sikur Mit'hat Frashëri të mos kishte lajmëruar në faqet e fundit të revistës “Diturija” shënimin “Dëshërojmë të blejmë çdo libër të vjetër që i përket Shqipërisë”, ndoshta shumë patriotë dhe dijetarë shqiptarë nuk do të kishin mundur të ndihmonin për të krijuar një prej bibliotekave më të mëdha në Shqipëri. Kjo bibliotekë arriti të mbushë raftet e saj me më shumë se 40000 vëllime të botimeve për Shqipërinë dhe, pas sekuestrimit në vitin 1945, u bë pjesë e Bibliotekës Kombëtare.

Sot, kontributi i atyre atdhetarëve gjendet në raftet e bibliotekës, bashkë me shumë libra, gazeta e revista në gjuhën shqipe, duke na trashëguar një pasuri të madhe kombëtare. Bibliotekat shqiptare janë të mbushura me përpjekjet e jashtëzakonshme të njerëzve të shquar, me sakrificat e tyre të pakursyera për të mbajtur në këmbë një prej kombeve më të lashta në Evropë. Dhe të mendosh, që në kohën kur filloi kjo iniciativë e guximshme, rreth një shekull më parë, nëse shkruaje apo lexoje shqip, mund të dënoheshe me burgim a syrgjynosje në fund të botës.

Studimi që ndërmora për rolin që kishte media shqiptare në historinë e Shqipërisë dhe rrugëtimin e vështirë të saj nga lindja deri sot, sigurisht që do të më krijonte mundësinë të hulumtoja një prej fushave ku kontributi i patriotëve shqiptarë ka qenë vendimtar, krijimi i medias shqiptare. Në kohën kur dukej se shpirti i shqiptarëve ishte venitur nën robëri, një dritë shprese, një dritë diturie, vjen nga përtej detit, atje ku ishte vendosur një pjesë e madhe shqiptarësh disa shekuj më parë. Arbëreshët e trashëguan brez pas brezi gjuhën shqipe, aty ku zë rrënjë dëshira për liri dhe shpresa për rimëkëmbje. Ata krijuan organet e para periodike, që shkruanin mbi zakonet, traditat dhe historinë e Shqipërisë.

Dhe drita u përhap. Shumë patriotë shqiptarë u zgjuan dhe ndezën rreth e rrotull trojeve shqiptare pishtarët e diturisë, hapën revista e gazeta që iu thërrisnin, ose sipas Mit'hat Frashërit, iu bërtisnin shqiptarëve të çoheshin dhe të merrnin në dorë fatet e kombit. Po krijohej dalëngadalë një traditë e raportimit të ngjarjeve dhe shkrimit të tyre, ashtu si në vendet e tjera. Nga faqja në faqe, nga numri në numër, nga revista në revistë, po krijohej media e strukturuar shqiptare, që do të luante një rol vendimtar në momentet më jetike të vendit.

Metodologjia e përdorur në këtë studim për katër kapitujt e tij të parë, që përfshijnë periudhën prej revistës së parë “L’albanese d’Italia”, e botuar në vitin 1848 nga arbëreshët e Italisë e deri në vitin 1944, është mbështetur në punën kërkimore, kryesisht në arkivin e Bibliotekës Kombëtare. Janë përzgjedhur shkrime të ndryshme të botuara në gazeta dhe revista, për të treguar se sa e vështirë ishte të krijoje një organ shtypi në kohën kur shtypshkronjat ishin të rralla, financat mungonin, përndjekja nga armiqtë e Shqipërisë të rrezikonte jetën dhe infrastruktura e bënte pothuajse të pamundur takimin apo letërkëmbimin e autorëve. Po ashtu, janë përzgjedhur pjesë nga artikuj, që tregonin raportin e medias me pushtetin, me lexuesin dhe mes vetë organeve të shtypit. Replikat e shumta mes autorëve nuk mungonin, as kritikrat e ashpra, që ndonjëherë shkonin deri në akuza të ndërsjella, por në përgjithësi brenda etikës profesionale.

Të bëjnë përshtypje reagimet e disa mediave që, me guxim, kundërshtuan hapur censurën dhe për hir të fjalës së lirë nuk heshtën, por iu kundërvunë pushtetit, pavarësisht pasojave. Cilësia e artikujve në disa prej organeve, që kemi zgjedhur për t’i ribotuar pjesërisht, është e një modeli inspirues edhe sot. Me një gjuhë të pasur, mbështetur mbi fakte dhe me një logjikë analitike të rrallë, autorë si Faik Konica, Mit’hat Frashëri, Ismet Toto, Fan Noli, Kristo Dako, Parashqevi Qiriazi, Luigj Gurakuqi, Lef Nosi, Branko Merxhani, Nebil Çika, Don Lazër Shantoja,

Ernest Koliqi, Petro Marko e dhjetëra të tjerë, na kanë dhënë leksionet e para mbi median e shkruar.

Studimi vazhdon me tre kapitujt e tjerë, që nga koha e vendosjes së diktaturës komuniste, rrëzimi i saj dhe tranzicioni deri në ditët e sotme, i bazuar në burime arkivore dhe studime të tjera. Një prej gjetjeve të këtij punimi, është fakti se gazetarët dhe publicistët ishin në listat e para të ekzekutimit nga regjimi komunist. Mendimi dhe fjala e lirë u burgosën për 45 vjet dhe media shqiptare pushoi së ekzistuari, duke u zëvendësuar me makinën propagandistike të regjimit diktatorial.

Pas vitit 1990 media u ringjall, u hapën një numër i madh gazetash e revistash dhe qindra stacione radio-televizive. Ndonëse aktualisht Shqipëria ka numrin më të madh të gazetarëve në raport me numrin e banorëve, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për cilësinë, dhe për këtë nuk janë përgjegjës vetëm gazetarët dhe botuesit. Gjatë këtyre viteve pushtetarët kanë treguar se kanë koncepte të gabuara për lirinë e medias dhe ende nuk kanë demonstruar se janë të gatshëm të pranojnë median në rolin e saj. Përpjekjet e vazhdueshme për ta kthyer median në vegël të pushtetit, presionet dhe kërcënimet ndaj punonjësve të medias nga ana e zyrtarëve të veshur me pushtet, kanë qënë pengesë kryesore për zhvillimin e medias sipas standardeve të vendeve evropiane.

Gjatë këtij studimi kam pasur fatin të lexoj për herë të parë disa prej shkrimeve që më kanë lënë vërtet mbresa. Kam gjetur artikuj dhe botime që fshihen vetëm në raftet e arkivave dhe mendoj se vlejnë edhe për kohën e sotme, pavarësisht se janë shkruar një shekull më parë. Besoj se edhe lexuesi i këtij studimi do të ketë mundësi të vlerësojë më mirë misionin historik të medias shqiptare në zhvillimin e shoqërisë sonë.

Një falënderim i veçantë për realizimin e këtij studimi i takon fondacionit Konrad Adenauer Shqipëri, i cili besoi në projektin për

studimin “Media shqiptare, rrugëtimi i vështirë drejt lirisë” , duke mundësuar financiarisht realizimin e tij.

Sfida për të përfunduar studimin nuk do të ishte e lehtë pa ndihmën e dy institucioneve shqiptare dhe stafit të tyre të cilët meritojnë falënderime të veçanta, si Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, e cila vuri në dispozicion arkivin e saj për pjesën kërkimore mbi shtypin shqiptar deri në vitin 1944 dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, që ndihmoi me dosjet për gazetarët e vrarë dhe të dënuar me burg gjatë dikturës komuniste.

Ky punim është realizuar me qëllim për t’i shërbyer studiuesve, gazetarëve dhe veçanërisht studentëve të gazetarisë.

Luljeta Progni

I.

LINDJA E MEDIAS SHQIPTARE

1.1 Përpyjekjet për të botuar në gjuhën shqipe

Gazetat e para me lajme ishin botuar për herë të parë në Gjermani në vitin 1609, pothuajse 150 vite pas shpikjes së shtypshkronjës nga *Johannes Gutenberg*. Ndërsa gazeta e parë franceze daton në vitin 1631, e më pas, me lehtësimin e censurës, edhe në Londër filluan të shtypen gazetat e para në vitin 1695, pasuar nga qytete të tjera në SHBA, përfshirë Bostonin dhe Filadelfian. Deri në fillim të viteve 1800 shtypshkronjat mund të arrinin shumëfishimin e jo më shumë se disa mijëra kopjeve në ditë.

Në këtë periudhë Shqipëria ishte ende nën sundimin Osman, si vendi më i prapambetur i perandorisë. Vetëm disa qytete, si Berati, Shkodra e Voskopoja, kishin një farë zhvillimi nën mbikëqyrjen e Portës së Lartë. Në vitin 1714, Grigor Deda solli në Voskopoje një shtypshkronjë nga Venediku me pajisjet e nevojshme për botimin e librave. Kjo shtypshkronjë, e quajtur “Shën Lluka”, ishte e dyta që funksiononte në të gjithë perandorinë Osmane, pas asaj të Kostandinopojës. Aty u shtypën disa libra me përmbajtje fetare në shqip nga Teodor Kavaljoti, i cili përgatiti edhe të parin alfabet shqip.¹

Do të kalonte më shumë se një shekull, që në Shqipëri të rishfaqeshin shkëndijat e shpresës për përhapjen e gjuhës shqipe. Në këtë kontekst

1 Dhimitër S. Shuteriqi, “Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800”, Akademia e Shkencave, 2005, Tiranë, fq. 190.

lindja e medias shqiptare do të ishte një dukuri e jashtëzakonshme. Ndryshe nga shumë vende të tjera, ku media u krijua pasi ishte konsoliduar gjuha dhe institucionet shtetërore, shqiptarët hodhën bazat e medias pa u shpallur ende pavarësia e vendit, madje pa u hapur shkolla e parë në gjuhën amtare.

Në shekullin XIX filluan përpjekje serioze për të dokumentuar zhvillimet që ndodhnin brenda trojeve shqiptare dhe për të ringjallur një ndjenjë kombëtare të venitur prej shekujsh në robëri. Këto përpjekje u konkretizuan me krijimin e disa revistave pjesërisht në gjuhën shqipe, fillimisht nga arbëreshët e vendosur në Jug të Italisë, e më pas edhe në qytete të tjera evropiane, ku jetonin e punonin shqiptarët prej vitesh.

Në Shqipëri mungonin rrugët automobilistike, rrjetet telefonike apo ndonjë mjet tjetër për komunikim ndërmjet qendrave të banuara dhe kjo e bënte pothuajse të pamundur shkëmbimin e informacionit në kohë të shpejtë, apo krijimin e një organi të medias.

Shumë patriotë vunë në dispozicion të ardhurat, ambientet dhe përkushtimin e tyre për të shkruar rreth historisë dhe ngjarjeve të një kombi, që ishte nën kërcënimin e asimilimit. Për më tepër, këtë iniciativë e ndërmorën në gjuhën amtare shqipe, edhe pse nuk ishte standardizuar për t'u shkruar sipas rregullave gjuhësore. Kështu, botimet e para periodike i gjejmë me gërma nga më të ndryshmet: latine, sllave dhe greke. Në disa prej organeve të shtypur në atë kohë gjenden edhe fjalorë të vegjël, apo rregulla të thjeshta mbi drejtshkrimin, të përcaktuara nga botuesit për të bërë të mundur leximin.

Pas shumë përpjekjesh, u arrit në krijimin e Abetares së parë, e cila u përdor pothuajse nga shumica e organeve të medias më pas. Patrioti i shquar Naum Veqilharxhi botoi në prill 1844, abetaren e parë në gjuhën shqipe, të emërtuar “Fort i shkurtër e i përdorshëm *EVETAR* shqip”. Abetarja e vogël përmbante një alfabet të posaçëm për mësimin e gjuhës shqipe. *Evetar*-i i Veqilharxhit mbështetej tek alfabeti me 33 shkronja i Dhaskal Todrit, i thuajse një shekulli më herët. Më 22 prill 1844, Naum Veqilharxhi shkroi një letër dedikuar këtij momenti historik, ku thekson se “vlera më e epërme e njeriut, është të mësuarit”.

“Fare lehtë mund që secili të njohë lehtësimin që ka çdo farë njerëzore të mësojë diturinë mbi gjuhë të vet. Djali, sado i vogël të jetë, gjithë mundimin dhe vështirësinë do ta ketë sa të mësojë shenjat e të folurit, d.m.th. shkronjat... dhe çdo libër që të marrë në dorë e këndon dhe e kupton; dhe kur të arrijë në mësimet e larta përsëri në gjuhë të tij, shpejt merr përpara; pastaj po të njohë gjuhën e tij, mirë, shpejt e lehtë, mëson çdo gjuhë të huaj”, shkruan Veqilharxhi në letrën drejtuar shqiptarëve”².

Ai shpjegon më hollësisht në po këtë letër edhe arsyet pse e kishte nisur këtë sipërmarrje, gati të pamundur për kohën:

“Se vetëm këtë të vini re gjer sot, në 500 shtëpi ja gjenden ja s’gjenden 50 veta mbarë e prapë që diç dinë të shënojnë, dhe ata mbë gjuhë të huaj. E shpresoj se më të shkuar pak vjet, në 500 shtëpi, s’them të gjenden 100 njerëz që të mos dinë në gjuhë të tyre mësim dhe ata nga kushedi nga ç’pakujdesi”³.

Ishte koha kur Shqipëria vuante nën sundimin e Perandorisë Osmane dhe kur ndalohej rreptësisht mësimi i gjuhës shqipe. Gjithashtu, arsimi në gjuhën amtare, ndalohej edhe nga kisha fanariote greke.

Një vit pas botimit të abetares së vogël, Naum Veqilharxhi nxori në dritë një ribotim të saj më të plotë, i mbështetur nga bashkatdhetarë të tjerë nga vende të ndryshme të botës.

Në vitin 1848, nga arbëreshët e Italisë do të botohej në italisht organi i parë periodic, që ka shkruar për Shqipërinë dhe shqiptarët, Gazeta “*L’albanese d’Italia*”, me drejtues Jeronim De Rada (Girolamo de Rada). Kjo gazetë politiko-kulturore-letrare, botohej dy herë në javë dhe në faqet e saj shkruanin Girolamo De Rada, V. Gilberti, Nicolo Leno de’Coronei dhe Papacortas Izamalas.

Por, përpjekja e parë do të ndalej vetëm pas pak kohësh, për shkak se De Rada nuk e gjeti mbështetjen e duhur për të vazhduar. Gazeta “*L’albanese d’Italia*” e ndërpreu botimin pas 27 numrave. Kështu,

2 Naum Veqilharxhi, Letra për Abetaren e parë shqipe Evetar, 22 prill 1844.

3 Po aty.

vendosi të qëndrojë në pritje për të gjetur një tjetër moment për vazhdimin e botimit të revistës.

Do të kalonin shumë vite për të mbërritur në momentin e dytë, kur gjeti dritën e botimit revista e parë e shkruar në gjuhën shqipe, përsëri jashtë trojeve shqiptare. Ajo titullohej “Zëri i Shqipërisë” dhe doli për here të parë në gjuhën shqipe e greke, në vitin 1882 në Athinë. Themeluesi i këtij periodiku ishte Anastas I. Kullurioti, shkrimtar, gazetar, poet dhe mbledhës i folklorit të shqiptarëve të Greqisë. Gazeta “Zëri i Shqipërisë” kishte si qëllim, nxitjen e dashurisë për gjuhën shqipe, njëherësh ndjenjën kombëtare. Kullurioti u përdoq nga qeveria greke dhe u akuzua si përhapës i gjuhës shqipe. Për këtë arsye, ai e transferoi gazetën e tij në Bukuresht.⁴

Në vitin 1883, rishfaqen përpjekjet e arbëreshëve me Jeronim de Radën, i cili botoi revistën mujore në italisht dhe shqip: “Flamuri i Arbërit”. Numri i parë i kësaj reviste u botua më 20 korrik 1883 dhe vazhdoi deri më 15 nëntor 1887. Revista botohej një herë në muaj dhe kishte 8 faqe. Ky botim merr rëndësi të veçantë, pasi për herë të parë pasqyroi të përmbledhur çështje mbi të kaluarën historike të popullit shqiptar dhe përpjekjet për autonomi. Është e para media ku gjejmë të pasqyruara pikëpamjet politike të Rilindësve. Revista e përmuajshme e De Radës, ia doli të shpërndahej në Itali, Ballkan dhe mbërriti deri në SHBA.⁵

Përgjatë kësaj kohe të avancimit të revistës së De Radës, në vitin 1884, u botua në Kostandinopojë revista e parë shqiptare shkencore “Drita”, e cila drejtohej nga Pietro Poga, me bashkëpunëtorë Naim Frashërin dhe Jani Vreton.

Një tjetër revistë mujore me përmbajtje kulturore e letrare, që titullohej “Arbri i Ri”, pa dritën e botimit në vitin 1887 në Palermo, drejtuar nga Franc Stassi Petta dhe Giuseppe Schiro, në gjuhën shqipe dhe italisht.

4 Zihni Reso, Anastas Kullurioti dhe gazeta “Zëri i Shqipërisë”, 1879-1880, Shtëpia botuese 8 nëntori, 1981, Tiranë, fq. 125.

5 Ahmet Kondo, Flamuri i Arbërit: Çështja kombëtare, Tiranë: Naim Frashëri, 1967.

1.2 Çelja e shkollës së parë shqipe

Gjatë fundit të shekullit XIX po intensifikoheshin përpjekjet e patriotëve shqiptarë me qëllim zgjimin e ndërgjegjes kombëtare. Një ndër arritjet më të rëndësishme në vitin 1885, ishte ajo e patriotëve korçarë Jovan Çiço Kosturi, Thimi Marko e Orhan Pojani, të cilët nisën organizimin e një shoqërie kulturore shqiptare.

Për shkak të përndjekjes nga Perandoria Osmane, por edhe nga Kisha Ortodokse Greke, patriotët nuk ia dolën dot ta konsolidojnë këtë shoqëri, megjithatë mundën të organizohen në një komitet të fshehtë. Për gati dy vite ata punuan në ilegalitet derisa, më 7 mars 1887, u çel shkolla e parë shqipe në Korçë. Për të arritur në këtë moment historik për Shqipërinë, kontributi i vëllezërve Frashëri ishte vendimtar. Asokohe, Naim Frashëri ishte nëpunës i ministrisë së Arsimit në Stamboll, dhe bashkë me të vëllanë, Sami Frashërin dhe shqiptarë të tjerë, pjesëtarë të “Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip”, siguruan lejen e sulltanit për hapjen e një shkolle private shqiptare për djem në Korçë.

Për të finalizuar këtë projekt me rëndësi kombëtare, edhe kontributi i mërgatës shqiptare të Rumanisë ishte gjithashtu vendimtar. Anëtarët e Shoqërisë “Drita” të Bukureshtit dhanë mbështetjen financiare për realizimin e hapjes së shkollës së parë shqipe.

Drejtor i shkollës u emërua Pandeli Sotiri, ndërsa pas tij shkollën do ta drejtonin Petro Nini Luarasi dhe Thanas Sina. Hapja e shkollës së parë shqipe i dha një hov të rëndësishëm avancimit të përpjekjeve për arsim në të gjitha trevat shqiptare. Në këtë kontekst do të merrte një zhvillim me shumë rëndësi edhe media e sapolindur shqiptare.⁶

Një ndër ngjarjet e shënuara është hapja e shtypshkronjës “Tipografia e Zojës së Papërlyeme” në Shkodër, në vitin 1870, e cila ishte edhe shtëpia e parë botuese shqiptare. Duke qenë se çfarëdo lloj botimi në gjuhën shqipe ishte i ndaluar në atë kohë prej Perandorisë

6 Hamit Boriçi, Mark Marku, “Histori e shtypit shqiptar”, Ufo University Press, Tiranë, 2007.

Osmane, kjo shtëpi botuese filloi të botonte revista fetare si organe të Seminarit Papnor me emrin “*Scamp i Koleges*”, duke e fshehur rolin e saj atdhetar.

Kështu, në vitin 1891 filloi botimi i së përkohshmes mujore fetare nën titullin “*Elcija e Zemers s’Jezu Krishtit*” nga Kolegji i Jezuitëve Shkodër, e cila fillimisht kishte vetëm katër faqe.

Jezuitët shkodranë guxuan të finalizojnë projektin e tyre të rëndësishëm, duke u përballur me Perandorinë Osmane. Editoriali i numrit të parë të kësaj reviste shpjegon qëllimin e botimit, gjithashtu dhe emrin e revistës. Editoriali titullohet: “*Merami i puns*” dhe thekson se qëllimi i botimit është përhapja e dashurisë për Krishtin ndër besimtarët e krishterë.

Kjo revistë fetare e vazhdoi botimin për 23 vite rresht deri në vitin 1913, kur e ndërroi titullin në “*Zâni i Shna Ndout*”, me të cilin vazhdoi deri në vitin 1944. Gjatë 53 viteve, në këtë organ periodik të Kishës Katolike, shkruan edhe shumë klerikë patriotë, që i shërbyen çështjes shqiptare deri në fund të jetës si: Marjan Prela, Andon Harapi e Vinçenc Prenushi. Deri në vitin 1900, në territorin e Shqipërisë kishte vetëm dy shtypshkronja funksionale, që të dyja në Shkodër.


Pas disa zhvillimeve të rëndësishme në drejtim të përhapjes së gjuhës shqipe brenda dhe jashtë kufijve, në vitin 1895 një tjetër ngjarje do të hynte në kalendarin e fundshekullit XIX. Jeronim de Rada drejtoi kongresin e parë të gjuhës shqipe, i cili u mbajt në Corigliano Calabro në Itali. Kongresi arriti të mblidhej me kontributin e patriotëve shqiptarë arbëreshë, por edhe të tjerë, që jetonin dhe punonin në vende të ndryshme të botës. Në atë kongres u vendos edhe krijimi i periodikut “*Ylli i Arbëreshve*”, që do të drejtohej nga prifti Antonio Argondizza.

1.3 Revista “Albania”

Më 25 mars 1897 u botua në Bruksel numri i parë i revistës “Albania” në gjuhën shqipe dhe frëngjisht, me botues Faik Konicën. Që në numrat e parë, “Albania” shfaqti një cilësi të lartë krahasuar me organet e tjera që kishin dalë deri në ato vite dhe u bë e njohur në mbarë diasporën. Revista që kishte fillimisht 24 faqe dhe botohej 2 herë në muaj, u bë organi më i njohur për kohën dhe është vlerësuar nga studiuesit si një prej revistave më të rëndësishme kushtuar çështjes shqiptare.

Në këtë sipërmarrje të jashtëzakonshme për atë kohë, Konicës do t’i bashkohej një tjetër personalitet i letrave shqipe, Mit’hat Frashëri (me pseudonimin Skënder Frashëri). Në faqet e para të revistës “Albania” u botuan kryesisht kritikak e ashpra kundër krahut të pashallarëve shqiptarë, që mbrojtën interesat turke në trojet shqiptare.

Në numrin e parë të revistës “Albania” u botua kryeartikulli me titull: “Armiqtë e Shqipërisë”, me autor Faik Konicën, nënshkruar me inicialet e pseudonimit të tij T.C. (Tranc Spiro Beg). Në këtë artikull,



Kopertina të revistës “Albania”, viti i parë I botimit dhe viti XI i botimit (Foto: BKSH)

ai nuk i kursen kritikën për mentalitetin e shoqërisë shqiptare, e cila kishte humbur traditat e zakonet e veta, duke i zëvendësuar me ato të osmanëve. Konica shkruan për mungesën e konceptit të lirisë dhe për pasojat që sillte ajo tek formimi i njeriut, apo formimi i kombit.

Konica shigjeton disa kategori të atyre që, sipas tij, “i janë shmangur rolit për të kontribuar në lirinë e atdheut”. Në fillim trajton pjesën e mërgimtarëve shqiptarë, të cilët punojnë dhe jetojnë prej vitesh jashtë atdheut:

“Të donin shqipëtarët lirinë e Shqipërisë, lehtazi e bënin; por rrinë të patundur edhe andej dëftojnë që s’e duan Shqipërinë, dëftojnë që janë armiq të saj. Dëgjoni mirë në mos e dini: s’janë armiq vetëm duke ndenjur me duart në gji, por ditë për ditë edhe ndryshe punojnë kundër mëmëdheut. Sa të fëlliqura shkruhen në Greqi, a tjetërkund kundër të mjerëve shqiptarë, kundër Paloarvanitëve, sa kanune lindën në Stamboll për të therur Shqipërinë (Pis-arnautllëk), të tëra shqipëtarët i nxjerrin”.⁷

Ai argumenton, se shkak kryesor për atë që ndodhte me shqipëtarët ishte pikërisht, se ata nuk e deshën lirinë dhe se ishin mësuar të jetonin nën lëkurën e turkut apo grekut. Konica evidenton ritet fetare që vinin nga të huajt që kishin ndjekur një politikë të ashpër për tjetërsimin e traditave shqiptare, për ndryshimin e rrënjëve të kombit, duke asimiluar doke e zakone fisnike ndër shekuj.

Menjëherë pas botimit të numrave të pare, Konicës iu adresuan kritika të ashpra, por ai lutet që të mos keqkuptohet në këto mendime të drejtpërdrejta, duke kujtuar që gjithkush është i lirë të bëjë zgjedhjen e tij.

“Mos e mirrni shtrembër mendimin tim, u lutem; unë s’kuvendonj kundër këtyre punërave; të mirat e të ligat, çdo njeri është i lirë t’i besojë edhe t’i mbajë. Vetëm një pyetje kam për të kërkuar, duke falur nderës: a kuptoni se si mund t’i ndërrohet rreza një njeriu sepse-kur qe djalë-i këputnë një copë mish a e vunë brenda në një magje? Mua sma pret mëndja”.⁸

7 Faik Konica, Armiaqët e Shqipërisë, revista “Albania”, 25 mars 1897, Bruksel, A. 1, fq. 8.

8 Po aty.

Në numrin e tretë të revistës, Faik Konica do të përforconte edhe më shumë gjuhën kritike ndaj shoqërisë dhe parisë së shqiptarëve të atyre viteve. Në një artikull me titull “Ç’është Liria?!” , Konica shpreh gjithë zhgënjimin e tij për reagimet, që kishin mbërritur në dy muajt e parë të botimit në redaksinë e revistës. Ai shfaq pendesën për këtë sipërmarrje të madhe, botimin e revistës, që sipas tij kishte qëllim të informonte e të ndriçonte sadopak mendjet e shqiptarëve të robëruar nga zgjedha turke.

“Pasi të shtyp 12 numra pas fjalës që thashë, a e dini se çfarë kam për të bërë? Qibaret le të mbyllin veshët: kam vendosur të shes mut në vënd që të mbaj këtë të përkohëshme (revistën Albania), më mirë të shes mut se sa të shkruaj për shqiptarët. Gomerëve pra, le të përpiqem edhe një herrë që tiu mbush kokën me këtë: ç’është liria?” Liria është që njeriu të mundet që: 1-të besojë çfarë i do zemra; 2-të thotë çfarë i do zemra; 3-të shkruaj çfarë i do zemra; 4-të bëjë çfarë i do zemra por jo ato që janë kundër lirisë së tjetrit.”⁹

Përgjatë artikullit vërejmë të gjitha tiparet që e karakterizuan si publicist deri në fund të veprimtarisë letrare dhe jetës së tij. Nuk ishte kritikë e thjeshtë, por shumë më shumë se kaq: ishte ironi, sarkazëm deri në përbuzje ndaj *vulgut*, që siç e përshkruan ai, ishte shumica absolute e shqiptarëve të asaj kohe.

Një tjetër artikull i veçantë, që lidhet me situatën e Shqipërisë në fundin e shekullit XIX, është botuar në numrin e katërt të kësaj reviste. Titullohet “Bërtim!”. Ka kuptimin e një britme, një thirrje dëshpëruese për reflektim, një piskamë, që duket se vjen nga thellësia e shpirtit, që kërkon të ndërrojë shoqërinë e fjetur shqiptare për gati pesë shekuj nën zgjedhën osmane.

“Më duket ndonjëherë që do të vijë një fuqi nga qielli e tu qaset shqiptarëve e ti shkundë e ti thërrasë: zgjohuni nga gjumi! Jeni buzë varrit! Gjër kur robër, gjër kur si kafshë? Është çudi, shqipëtarët nën zgjedhën e turqve!¹⁰

9 Faik Konica (T.S, Tranc Spiro Beng), Ç’është Liria?!, revista “Albania”, 25 qershor 1897, Bruksel, fq. 4.

10 Skëndo Frashëri, Bërtim!, revista “Albania”, 30 korrik 1897, Bruksel, fq.5.

Ky artikull i drejtohet pikërisht asaj pjese të parisë shqiptare, që garantoj politikën e vazhdimësisë me Portën e Lartë në një moment delikat për ekzistencën e një prej kombeve më të vjetra në botë, duke e lënë vendin nën zgjedhën turke.

“Ore vëllezër, orë shpirtra, ore burra, ne jemi shqipëtarë, djemt e pellazgëve, më të vjetrit e kombeve që erdhën në Evropë. Kemi qënë të mëdhenj, të fortë, me fuqi, mbretëri, qytetari e çdo gjë, kemi mundur gjithë botën thuajse, dhe e gjithë historia jonë e vjetër është e ndritur. Pastaj nja 4.00 vjet më parë erdhi një komb i vjetër në Evropë i cili, o faqëzinj, na mundi e na mori nën zgjedhë ku jemi edhe sot. Ky komb barbar është Turqia. Njeri sna ka mundur në jetë e ky turku të na mundë! Oh e keqe mynxyrë!”¹¹

Në revistën “Albania”, shpërfaqet një Shqipëri e zyrtë, e varfër, analfabete, e sunduar nga një grusht shqiptarësh të konvertuar në turq, që më shumë se sa atdheun, donin ofiqet që përfituan prej osmanëve.

Përsa i takon strukturës së revistës, numrat e parë ajo u botua me 16 faqe dhe dilte dy here në muaj, por më pas vazhdoi me 32 faqe një herë në muaj, sepse siç sqaron botuesi, me 16 faqe nuk mund të botoheshin artikuj të gjatë. Duke shfletuar faqet e kësaj reviste shohim se kopertina, apo korja, siç e quante në atë kohë Konica, është pothuajse e njëjtë për një periudhë disa vjeçare, duke ruajtur identitetin me grafikën dalluese të revistës “Albania” dhe logon e saj.

Fajta e dytë zakonisht ka përmbajtjen dhe informacione që lidhen me pajtimtarët, ndërsa më pas vazhdojnë editorialet apo kryeartikujt, që kryesisht janë politiko-socialë. Në më tepër se gjysmën e hapësirës botoheshin artikuj politikë, ku shprehen hapur opinionet dhe qëndrimet atdhetare të lidhura më historinë e Shqipërisë, gjuhën dhe zhvillimet politike të kohës. Shpesh botoheshin edhe artikuj letrarë, poezi e pjesë nga libra autorësh të huaj ose shqiptarë, që kanë shkruar për Shqipërinë. Nuk mungonin edhe reportazhe për vende të bukura të Shqipërisë, artikuj që lidhen me ekonominë e vendit, arsimin dhe kulturën, apo rubrika me tema shoqërore si ajo që lidhej me të drejtat e grave dhe rubrika satirike “Tej e këtej”.

11 Skëndo Frashëri, Bërtim!, revista “Albania”, 30 korrik 1897, Bruksel, fq.5.

1.4 Botimi i kalendarëve vjetorë me përmbledhjet e ngjarjeve historike

Në fund të shekullit XIX një botim mjaft i rëndësishëm doli në gjuhën shqipe, periodiku vjetor “Ditërrëfenjës”, i drejtuar nga Lumo Skëndo (Mit’hat Frashëri).

Mit’hat Frashëri e kishte nisur karrierën si gazetar në revistën “Albania”, rreth një vit më herët. Ishte në moshën 17 vjeçare kur shkroi te “Albania” artikullin e rëndësishëm, “Fe ç’është, komb ç’është?”, si një ndër bashkëpunëtorët kryesorë të Konicës. Një vit më pas, në vjeshtën e vitit 1897, Mit’hat Frashëri botoi numrin e parë të periodikut vjetor “Ditërrëfenjës”, që do të quhej më vonë “Kalendari Kombiar”. Ky periodik pati një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimet e medias të asaj periudhe.


“Ditërrëfenjës” u publikua në fillim me 56 faqe, ku pasqyroheshin ngjarjet kryesore në trevat shqiptare gjatë gjithë vitit. Numri i parë doli në vitin 1898 dhe pasqyronte ngjarjet më të rëndësishme të para atij viti. Artikujt me temë atdhetare e politike zënë peshën kryesore, ndërsa disa faqe i kushtohen letërsisë, arsimit e kulturës. Një pjesë tjetër e zënë reportazhet dhe *almanaku* i ngjarjeve historike shqiptare e ndërkombëtare, por roli parësor i këtij periodiku është përpjekja për të ndriçuar mendjen e shqiptarëve në kërkim të lirisë dhe pavarësisë.

Në botimin e vitit 1898 do të shkëpusim një paragraf ku evidentohet sërish thirrja për zgjim kombëtar dhe për avancimin e gjuhës shqipe.

“Koha na tregon dhe s’na pret. Në krye të vitit 1898 na shtypën serbët dhe bullgarët, bënë komitete të mëdha, ku thuhej se Kosovën e do Serbia dhe Bullgaria. Ne shqiptarët, që duhet të jemi të zotët e Shqipërisë, rrimë të hutuar e vështrjëmë së largu sikur jemi të huaj. Sa turp!”¹²

Në këtë format “Ditërrëfenjës”-i vazhdoi të botohej çdo vit, si një përmbledhje e ngjarjeve që ndodhnin në Shqipëri dhe rreth saj,

12 Mit’hat Frashëri, “Ditërrëfenjës”, 1898, Sofje, fq.11.



Kopertina e numrit I të “Dritëshkronjës”, botim i vitit 1897 dhe numrit XIII emërtuar “Kalendari Kombiar”, botim i vitit 1909 (Foto: BKSH)

i shtypur prej shoqërisë “Dëshirë” në Sofje, kryeqytetin e Bullgarisë. Një tjetër botim i përvitshëm, i titulluar “Kalendari i Maleve”, u botua për herë të parë në vitin 1900 në Bruksel nga Faik Konica. Kalendari përmbante festat fetare, lëndë kulturore, kronika, këshilla bujqësore, etj., në gjuhën shqip. Në numrin e parë të këtij kalendari gjejmë artikullin “Kalendari i Shqyponëtorëve”, që i dedikohet fillimeve të Albanologjisë dhe Kostandin Kristoforidhit, si themelues i Albanologjisë. Në artikull tregohet rëndësia që po merrte gjuha shqipe përtej kufijve.

*“Kristoforidhi ka përdorë fjalën shqypon për: flas shqip. Pra shqyponëtoe u thomi gjuhëtarëve që dinë shqypen e përpiqen me qit në dritë kanunet e saja. Vit për vit kena me shpall jetën e fytyrën e disa shqyponëtorëve e ma fort në daçin me na ndihmue pak ligjëruesit e “kalendarit” tui na çue shka munen me dit e me pas në dorë përmbi ata burra, shqyptar a të huaj që u banë shkak me e shty përpara mësimin e gjuhës kombëtare, me Kristoforidhin”.*¹³

13 Faik Konica, “Kalendari i maleve”, 1900, Bruksel, fq. 46.

“Kalendari i Maleve” i viteve të mëvonshme e ruan këtë rubrikë duke pasqyruar veprimtarinë e albanologëve të kohës, si Emile Legrand, Gustav Meyer, Holger Pedersen etj.

Gjatë periudhës 1897-1900 evidentohet një zbehje e lëvizjes shqiptare për pavarësi. Kjo situatë, disi apatike, vinte për shkak të frymës jo favorizuese për Shqipërinë në arenën ndërkombëtare, e cila kishte sjellë një valë të re të ndërhyrjeve shtypëse të ushtrisë otomane. Një rol negativ me mjaft peshë, luajti në këtë situatë edhe qëndrimi i shumicës së feudalëve shqiptarë, të cilët nuk ishin në linjën e interesit kombëtar, por të pozicionuar në mbështetje të Portës së Lartë.

Megjithatë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, vazhduan përpjekjet e patriotëve shqiptarë për të avancuar në përhapjen e dijes, kryesisht përmes organeve të reja të medias, që kishin lindur. Kështu, në vitet 1897-1908, përmes përpjekjesh të shumta, u mundësua botimi i disa periodikëve.

Sipas studimit të botuar nga “Revista e Universitetit të Shkencave të Shtypit të Parisit” në vitin 1939, në këtë kohë gjetën dritën e botimit disa organe shtypi në Itali, si “*L’Albania letteraria*” në vitin 1897, gazetë dymujore e redaktuar nga një grup të rinjsh italo-shqiptarë të Corigliano Calabro-s dhe “*La Nuova Albania*” (Zëri i Shqipërisë) në vitet 1898-1904, organ dyjavor i komitetit politik shqiptar të Napolit.¹⁴

Në Rumani u botua periodiku “Shqipëria”, çdo dy javë nga 1897 deri në 1899 në shqip, greqisht dhe rumanisht dhe drejtohej nga R. Chapari. Dervish Hima do të botonte gjithashtu periodikun “*L’indépendance Albanaise*”, e themeluar në Bukuresht në vitin 1898 dhe më pas e transferuar një vit më vonë në Romë, me emrin “Zani i Shqipënisë”.

Në përfundim të këtij kapitulli, mund të thuhet se kjo periudhë e parë e historisë së medias ishte me rëndësi të veçantë, sepse u hodhën

14. André Ravry “La presse Albanaisse”, Revista e Universitetit të Shkencave të Shtypit të Parisit, korrik-shtator 1939, përkthyer nga Aurenc Bebja, botuar në: www.darsiani.com/la-gazette/nje-studim-i-ralle-francez-per-shtypin-shqiptar-te-viteve-1848-1939.

rrënjët e medias shqiptare, por ishte gjithashtu vendimtare për të ardhmen e kombit.

Në rrethanat e sundimit Osman dhe masave të rrepta, që ishin marrë ndaj botimeve në shqip, përpjekjet për themelimin e medias apo edhe lëvizjet që lidheshin me çështjen kombëtare, ishin më të konsoliduara jashtë vendit. Në këtë pjesë të parë të historisë së medias, një ndër revistat më me peshë përse i përket cilësisë, por edhe kontributit konkret në çështjen kombëtare, vlerësohet revista “Albania”, e botuar për herë të parë në Bruksel më 25 mars të vitit 1897. Përpjekjet për zgjimin e ndjenjës kombëtare do t’i vijonte paralelisht Mit’hat Frashëri me botimin e një kalendari vjetor në shqip të quajtur “Dritërrëfenjës”, i cili më pas do të emërtohej në “Kalendari Kombiar”. Ky kalendar me ngjarje historike shënon një nga momentet kyçe të zhvillimit mediatic, pasi artikujt përshkruanin shoqërinë shqiptare në shumë dimensione. Aty pasqyroheshin jo vetëm ngjarje me rëndësi dhe artikuj me tema atdhetare e politike, por edhe reportazhe për vende të bukura të Shqipërisë apo problematika të shoqërisë shqiptare të asaj kohe.

Gjatë viteve 1848 deri në vitin 1900 u botuan 6 organe shtypi: një në Itali, dy në Shkodër dhe tre në Bruksel, të cilët luajtën një rol të dyfishtë, si për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare, ashtu edhe pasqyrimin për herë të parë të ngjarjeve në trojet shqiptare.

II. ZHVILLIMI I MEDIAS DHE NDIKIMI I SAJ NE ARRITJEN E PAVARESISE (1901-1912)

2.1 Media në prag të pavarësisë

Vitet e para të shekullit të XX ishin gjithashtu vendimtare për të ardhmen e Shqipërisë dhe kjo u reflektua edhe në përpjekjet e medias. Në këtë kohë, Shqipëria vazhdonte të ishte në një situatë të pafavorshme ndërkombëtare. E sunduar për një periudhë të gjatë prej Perandorisë Osmane, e sulmuar nga fqinjët dhe e braktisur nga feudalët, trojet shqiptare ishin të kërcënuara. Në këto kushte, ishte më e nevojshme se kurrë përhapja e dijes dhe një kontribut me shumë rëndësi në këtë drejtim do të luante edhe shtypi.

Referuar arkivës që gjendet në Biblotekën Kombëtare, rezulton se prej vitit 1900 deri në vitin 1912, kur u shpall pavarësia e Shqipërisë, u botuan më shumë se 25 organe shtypi, prej të cilave pjesa kryesore jashtë kufijve shqiptarë, ndërsa 2 gazeta botoheshin në Shkodër dhe 2 në Korçë.

Në fillimet e shekullit të ri, “Flamuri i Shqipërisë” (*La Bandiera Albanese*), ishte një tjetër revistë mujore italo-shqiptare, e themeluar më 1 janar 1904 në Napoli, nga Profesor Giuseppe Schiro. Po atë vit u botua “*Gazzetta Albanese*” që drejtohej nga Terenc Toçi dhe një vit më vonë “Lajmtari i Shqypenis” në Romë, e drejtuar nga Gaspër Jakova si

dhe “Shpnesa e Shqypenis” në Raguzë, që drejtohej nga Nikollë Ivanaj.¹⁵

Në këtë grup periodikësh kemi veçuar kryeartikullin “Mbi Abetaren” të revistës “Flamuri i Shqipërisë”¹⁶, përmes të cilit përcillet situata aktuale që po kalonte Shqipëria. Shkrimi nis me vështirësitë e jashtëzakonshme për të siguruar shkronjat shqipe të derdhura në plumb, të cilat do të mundësonin botimin e revistës.

“Ki numër i Flamurit nuk del me shkronjat që përdoren sot për sot ndë Shqipëri e të cilat atje këndojnë më të shumtët, përse këtu nuk gjenden fare. U shtrënguan të këmbëjmë, për një a dy herë, ca të pakta, e kemi porositur ndë një fabrikë ato që na duhen, ndonëse besojmë se s’do ti mbeten shqiptarëvet kur ata të jenë të zotët të kenë liri për mësim si dhe për të tjera gjëra.”¹⁷

Revista “Flamuri i Shqipërisë”, ishte e përmuajshme dhe fillimisht u botua me 12 faqe, ku përfshiheshin rubrika politike, letrare, kulturore dhe kronika ngjarjesh të ndryshme. Me kalimin e muajve, u shtua numri i faqeve në 28 dhe në numrat e fundit mbërriti në 40 faqe.

Më 10 korrik 1908 u shpall konstitucioni, që iu lejonte vendeve të pushtuara nga Turqia të përdornin gjuhën e tyre. Kjo ngjarje u pasqyrua gjerësisht në “Kalendarin Kombiar” të vitit 1909.

“Më 10 korrik natën, vjen tejshkrimi nga sadrazami dyke thënë se sulltani e dha konstitucionin. Gjithë këto ngjarje dhe më tepër mbledhje e katërmbëdhjetëmijë shqiptarëve në Ferizoviç, e bëri qeverinë e vjetër që të mejtohetë: veç kësaj dhe ushtarët që kishin ardhur nga Anadoli në Selanik për tu dërguar kundërë “ të përndërkryervet”, s’deshnë të vënë të luftonjë kundërë vëllezërve të tyre. Kur kuptuan anëtarët e lirisë se ishin mjaft të fortë e shpallnë vetë lirinë: më 10 të korrikut në Manastir,

15 André Ravry “La presse Albanaisse”, Revista e Universitetit të Shkencave të Shtypit të Parisit, korrik-shtator 1939, përkthyer nga Aurenc Bebja, botuar në: www.darsiani.com/la-gazette/nje-studim-i-ralle-francez-per-shtypin-shqiptar-te-viteve-1848-1939.

16 G.Schiro, Mbi Abetaren, “Flamuri i Shqipërisë”, Janar 1904, Itali, fq. 1.

17 Po aty.

në Seres, në Selanik dhe gjetkë bota zuri të dridhet nënë frymë të lirisë; atë mbrëmje erdhi urdhër nga Stambolli dhe thosh se mbreti e dha përsëri konstitucionin q'ish ngriturë tridhjet e një vjet më parë. Kjo ngjarje e madhe e ndërroj menjëherë punët e Tyrqisë. Evropa e tërë që kish një mëri kaqë të madhe dhe të vjetër kundër Tyrqisë, q'atë çast zuri të tregojë një miqësi dhe një çudi të madhe për ngjarjen e madhe që u bë kaq lehtë dhe me kaq urtësi, pa derdhur asnjë pikë gjak... Si një pemë e konstitucionit më 4 të qershorit të Shënëdreut u çel dhe mbledhja e kombit, kuku depytë të zgjedhur prej kombit nisë të kqyrin punët e mbretërisë.”¹⁸

Shpallja e konstitucionit u pasua menjëherë me hapjen e disa gazetave dhe revistave të reja në Shqipëri dhe jashtë kufijve të saj. Për të avancuar në këtë proces të përhapjes së mediave në gjuhën shqipe, do të duhej që faktori shqiptar brenda dhe jashtë kufijve të ndërmerre disa hapa të domosdoshëm për unifikimin e alfabetit dhe rregullave të përdorimit të gjuhës shqipe.

2.2 Kongresi i Manastirit dhe ndikimi tek mediat në gjuhën shqip

Unifikimi i abetares u konsiderua emergjencë nga atdhetarët e viteve të para të shekullit të XX. Çështja e ABC-së ishte problematikë me të cilën ndeshje edhe shtypi i kohës, sepse gazetave apo revistat e para në shqip përdorën shkronjat të ndryshme. Më lart kemi pasqyruar disa prej artikujve, të cilët shfaqin këtë problematikë si dhe vështirësitë për të siguruar shkronjat.

Në këto kushte, në vitin 1908 u mbledh Kongresi i Manastirit, një ndër ngjarjet më të rëndësishme të historisë së Shqipërisë. Në faqen 34 të “Kalendarit Kombiar” të vitit 1909 gjejmë artikullin për rëndësinë e Kongresit të Manastirit:

“Është një nga ngjarjet e mëdha për kombin shqiptarë, kjo mbledhje

¹⁸ Ngjarjet e motit 1908, “Kalendari Kombiar”, 1909, Sofje, fq.32.

që u mbajt që me 1 gjër me 10 të vjeshtës së tretë. Ky kongres u mbledh për t'i dhënë fund çështjes së "ABC"-së, për të vendosur që të shkruhet gjuha shqipe me një palë shkronja e jo si deri tani që çdo njeri e ngrehte abc-në siç i donte qefi.

Në kongresin e Manastirit morën pjesë 32 delegatë të nderuar, nga 22 qytete, klube dhe shoqëri të Shqipërisë dhe jashtë saj (Amerikë, Bukuresht, Kostancë, Sofje, Egjypt etj).

32 delegatët zgjodhën 11 prej tyre dhe ngritën një komision. Ky komision i dha fund diskutimit për abc-në duke zgjedhur abetaren e Stambollit me pak ndryshime (ë, e, p, x). Bashkë me këto shkronja, kongresi vendosi të përdorte edhe një abetare tjetër latine, dmth me 25 letra duke bashkuar dy letra bashkë për ata zëra që mungojnë në abc-të latine."¹⁹

Pas Kongresit të Manastirit, në mbarë trevat shqiptare dhe jashtë tyre, u përhapën me ritme të shpejta klubet kulturore. Paralelisht po avanconte edhe hapja e shkollave shqipe. Në "Kalendarin Kombiar" të vitit 1909 është botuar edhe një artikull që informon pikërisht për iniciativat që po merrnin atdhetarët e shquar në organizimin e shoqërive të ndryshme kulturore.

"Me tu shfaqur konstitucioni, (leja për gjuhën shqipe), shqiptarët me të dy duart zunë të punojnë për gjuhën e tyre duke çelur shkolla dhe klube. E para shkollë u çel në Elbasan një javë pas shpalljes së konstitucionit. Pas saj, erdhi hapja e shkollës së Tiranës, pastaj erdhën me rradhë ato të Korçës, Beratit, Kolonjës etj. U çelën pesë klube të mëdhenj në Stamboll, Selanik, Egjipt, Manastir dhe Janinë. U hapën edhe 10 të vegjël në Elbasan, Tiranë, Korçë, Berat, Vlorë, Delvinë, Gjirokastrë, Filat etj."²⁰

Pas përcaktimit të alfabetit shqip dhe hapjes së shkollave të para, në vitin 1909 u hodhën hapa të rëndësishëm edhe në zhvillimin e medias. Në artikullin me titull "Gazeta Shqip", pasqyrohen titujt e gazetave që u botuan menjëherë pas Kongresit të Manastirit si: "Liria", "Bashkimi",

19 Kongresi i Manastirit, "Kalendari Kombiar", 1909, Sofje, fq. 34.

20 Shkolla dhe klube shqip, "Kalendari Kombiar", 1909, Sofje, fq. 25.

“Korça” e gazeta “Rrufeja”, të gjitha të përjavshme në gjuhën shqipe.²¹

Pavarësisht lejitimit të gjuhës shqipe, përndjekja ndaj atdhetarëve shqiptarë ishte shtuar, edhe pse Perandoria Osmane ishte në grahamat e fundit. Pikërisht në këtë kohë kishte nisur të botohej gazeta “Drita” në Sofje, e drejtuar nga Petro Nini Luarasi. Në artikullin e botuar në maj të vitit 1908, duket optimizmi që kishte kapluar faktorin shqiptar në të gjitha dimensionet.

“Hop’ i dimërit që hoqi shqipëtari në katërqind vjet e tehu që i ftohtë, i hidhur, fatkeq e prishës... Dimëri është në të përcjellë dhe pranvera afroi për gjithë shqiptarët. Lum’ ata që nuk e flakëritnë shpresën po muarnë kurajën të këqijat e dimërit, se pranverën do ta shohën me shijen më t’ëmbëlë. Gjethi fletë-njomë i diturisë u çel, pemët zemër shqipëtare lulëzuan dhe shqipëtari i tartarosur prej dimërit të shkuar u tunt, u shkunt, u shëndosh dhe njohu në ç’hon që hedhur e dënuar për vdekje. i zgjuar po vrapon me çape trimi në rrugën që e kren në shesh të pranverës... Komiteti shqiptar për shpëtimin e mëmëdheut po na thërret. Le të sulemi për qëllim të shenjtëruar... Atëqëna ndihmon nëhallin tënë le ta kemi për nder për jetë, po atëqëna ndalon ta shkelmojmë.”²²

2.3 Shtypshkronjat e para në Shqipëri

Gjatë kësaj periudhe një numër i madh shtypshkronjash po instaloheshin në qytetet kryesore të vendit. Kërkesa gjithnjë më e madhe për të shtypur libra, gazeta e revista në gjuhën shqipe bëri që numri i makinave të shkrimit, mjeteve të kancelarisë dhe shtypshkronjave, të rritej nga viti në vit. Në vitin 1909 u instalua shtypshkronja “Drejtësia” në Korçë, më pas shtypshkronja “Korça” në vitin 1910, shtypshkronja “Bashkimi i Kombit” në Manastir në vitin 1910 si dhe shtypshkronja e “Zojës së Papërlyeme”, në Shkodër në 1915.

21 Gazeta shqip, “Drita”, prill 1908, Sofje, fq. 5.

22 Petro Nini Luarasi, “Drita”, Nr. 100, 15 Maj 1908, Sofje, fq. 5.

Gazeta “Korça” është një ndër gazetatat e para, që filloi botimin brenda kufijve të Shqipërisë në janar të vitit 1909, me drejtor Sami Bej Pojanin. Duke patur parasysh vështirësitë në sigurimin e makinerive dhe pajisjeve të shtypit, si dhe personelin e kualifikuar, sipërmarrjet për botimin e organeve të shtypit kërkonin sakrificat të mëdha. Në një prej numrave të parë të saj, më 12 shkurt 1909, gazeta “Korça” botoi një njoftim punësimi për dy radhitës, që i nevojiteshin për procesin e parapërgatitjes së shtypit:

“Për shtypshkronjën “Drejtësia” në Korçë, na lipsen dy radhonjës që njëri prej tyre lipset të dijë dhe të përdorurit e maqinës. Si kushdo që ka dituri në vehten e tij është i lutur të na bëjë zë që të merremi vesh me pagesën. Drejtonjës i gazetës “Korça”, Sami Pojani.”²³

Dy njoftime të tjera në faqet e kësaj gazete tregojnë vështirësitë, por edhe solidaritetin ndër patriotë, për botimin e gazetave në gjuhën shqipe.

“Ndihma për gazetën “Korça”: Shahin bej Kolonja (deputet) 93 grosh, Musa bej Goça 50, Qemal bej Frashëri 50, Rifat ej 30, Eshref bej 50, Nexhar effendi Gjinokastra 50, Dr Mishe Rupishti (deputet) 113, Koço Pazali 25, Qemal bej Leskoviku 50, Abaz Zihni Kanina 50.”²⁴

Pas disa numrave të botuar, në vjeshtën e po atij viti, gazeta “Korça” investoi për blerjen e një shtypshkronje, por kishte mangësi në shkronjat e plumbit, që i nevojiteshin për radhitjen e faqeve të gazetës.

“Shtypshkronja e gazetës “Korça” ardhi në Korçë, por për fat të keq shkronjat s’kanë ardhur të gjitha, kështu pra, simotra tonë vonojti të botohet. Shumë shumëpër një javë besohet të arrijnë shkronjat e të dalë me rregull.”²⁵

Pas këtij njoftimi, intelektualë dhe tregtarë korçarë ndihmuan financiarisht redaksinë e gazetës “Korça” dhe plotësuan kërkesat për të

23 Njoftim, Gazeta “Korça”, 12 shkurt 1909, Korçë, fq. 14.

24 Ndihma për gazetën “Korça”, Gazeta “Korça”, 12 shkurt 1909, Korçë, fq. 15.

25 Po aty.

gjitha shkronjat dhe bazën materiale, që gazeta të botohej pa vështirësi.

*Shtypshkronja e Korçës u pasurua me çdo lloj shkronje. Që sot pra, marrim përsipër të bëjmë çdo porosi që na jepet në çdo gjuhë që të jetë shkrojtur. Shtypim zëdhënie, kart-vizita, pliko dhe kartë tregtije me çdo firmë, polca, fletë shqip dhe të përkohshme, libra, ftime (ftesa) për dasmë dhe çdo gjë tjetër që të na jepet. Provoni të gjithë shkronjat tona, të rejat. Punojmë me çmime të njerëzija. Në qoftë se e provoni njëherë punën tonë, jemi të siguruar (të sigurtë) se do të na nderoni përhera me porosinë e z. suaj.*²⁶

Përshkrimi i njoftimeve në gazetën “Korça” dëshmon për vështirësitë serioze me të cilat ndeshesh shtypi në atë kohë, për kushtet e jashtëzakonshme në të cilat ata mundën të botojnë gazeta e revista, edhe pse me mungesë të theksuar mjetesh, por edhe profesionistësh. Siç kuptohet në këtë thirrje, mungonin punonjësit e kualifikuar për përdorimin e atyre pak makinerive që kishin mbërritur në Shqipëri.

Por nuk ishte vetëm mungesa e parave dhe infrastruktura që e bënte të pamundur botimin e një gazete. Ata, që vendosën të sakrifikojnë duke marrë përsipër të botojnë një gazetë, shpesh ndesheshin me sulme armiqësore nga qarqe të ndryshme, siç i gjejmë të përshkruara në letrën e Petro Nini Luarasit drejtuar gazetës “Korça”.

Petro Nini Luarasi përgëzonte drejtorin e gazetës, Sami Pojani, për nismën që kishte ndërmarrë. Njëherësh ai pasqyronte situatën e vështirë në të cilën ndodhej në atë kohë Shqipëria. Letra e Luarasit ishte një mbështetje ndaj botuesve të gazetës “Korça”, të cilët kishin kërkuar ndihmë nëpërmjet gazetës dhe gjithashtu në një editorial të titulluar “Grekomanët kundër gazetës “Korça”, shkruanin hapur edhe për sulmet e disa shqiptarëve, që sipas tyre nxiteshin nga qarqe antishqiptare.²⁷

“Fort i ndërcim zoti Direktor i gazetës Korça!

U lutem të më dhuroni pak vent në të ndërcimen gazetë të zotërisë suaj

²⁶ Shtypshkronja “Korça”, Gazeta “Korça”, 22 tetor 1909, Korçë, fq. 8.

²⁷ Sami Pojani, Grekomanët kundër gazetës “Korça”, gazeta “Korça”, shkurt 1909, fq. 1.

të çpall dy fjalë vëllazërisht në të dashurit shqiptarë. Me qenë që shumë shqiptarë pandehin se kanë shprehje, duke patur fatin që t'u epetë pak liri për të kënduarë dhe nxënë gjuhën' e tyre, pa vënë re fjalën e urtë që thotë: "Kush ra poshtë të kujdeset të ngrihetë, dhe kush qendron ngrehetë të vërë re se mos bjerë.

Të tillë shqiptarë janë si shqerat që s'kanë provuar nonjëherë thonjt' e ujkut, as kanë dëgjuar për laqet dhe dinakëritë e dhelprës dhe me qenë që shumë Shqiptarë e dëshirojnë përparimin e gjuhës së tyre po e kërkojnë si manushaqe, ta mbjellin të tjerë e ta përgëzojnë ata, pa kur e shohin që fishket ajo manushaqe e bukur, tek duhetë t'i apëmë krahun e shërimit, ata, pa turp kthejnë sytë mënjanë dhe bëjnë sikur s'e njohinë, andaj për ta, të thjeshtë mëmëdhetarë që kanë shpresë të vdesën si Shqiptarë, u themi që të dini se në fshatrat e Kolonjës një propagandë greke me intriga të hidhura është ngrehur kundër shqiptarisë dhe me vërtik e kuxim po përhapet e po dërmon zemrat e Shqiptarëve, po më shumë të krishterëve të tillë... .”²⁸

2.4 Mediat jashtë kufijve të Shqipërisë

Jashtë kufijve të Shqipërisë, pati një vrull të botimit të mediave në gjuhën shqipe, që lidhej edhe me aktivizimin e shoqërive shqiptare.

Më 15 mars të vitit 1909 u botua në Boston të SHBA-së gazeta “Dielli”, e cila drejtohej nga Fan Noli, organ i shoqërisë “Vatra” të shqiptarëve të Amerikës. Nga viti 1909 deri në vitin 1913, gazeta “Dielli” botohej një herë në javë, në vitin 1914 botohej dy herë në javë dhe më pas, në vitin 1915, botohej tri herë në javë. Fan Noli e drejtoi gazetën “Dielli” për një kohë të shkurtër, nga 15 shkurti 1909 deri më 15 tetori 1909 për t'ia pasuar Konicës, i cili e drejtoi këtë gazetë për disa muaj të tjerë, nga tetori 1909 deri në mars 1910. Dy muajt më pas u drejtua nga komisioni drejtues i “Vatrës” dhe nga maji deri në korrik, u drejtua sërish nga Konica.

²⁸ Petro Nini Luarasi, Gazeta “Korça”, 8 qershor 1909, fq. 12.

Nga korriku 1910 deri në tetor të atij viti, botimi i “Diellit” u ndalua. Fan Noli u rikthye në drejtimin e gazetës në tetor 1910 deri në korrik 1911, e më pas gazeta u drejtua nga Efthim Nasti, Kristo Floqi, Faik Konica dhe në periudha të shkurtra nga Paskal Aleks, Denis Kumbari, Kostë Çekrezi, Bahri Omari, Kristo Kirka, Llambi Çikozi, Hamit Lumi, Vangjel Gjika, Loni Kristo, Mukë Përmeti, Aqif Përmeti, Llambi Çikozi, Gjergj Konda Gjoleka etj.

Në vitin 1909 doli për herë të parë edhe gazeta periodike “Diturija” e Mit’hat Frashërit, një ndër mediat më të rëndësishme të fillimit të shekullit të XX dhe gjithë historisë së shtypit shqiptar. “Diturija” ishte revistë letrare, kulturore, shkencore dhe politike. U botua për njëzet vite rresht, prej vitit 1909, vit në të cilin u mbyll revista “Albania” e Faik Konicës, deri në vitin 1929.

Koha kur “Diturija” po konsolidohej si një media e rëndësishme, përkon me periudhën kur Perandoria Osmane po largohej nga trojet shqiptare. Ky largim pas pothuajse 5 shekujsh, përshkruhet në një artikull në formë reportazhi, në vitin 1913 tek “Diturija”.



Kopertina e gazetës “Dielli” organ i shoqërisë “Vatra” të shqiptarëve të Amerikës (Arkiv BKSH)

MOT I PARË 1 JANAR 1909. N. 1.

DITURIA


E perkohesme sip literare Ëe diturake

DEL HE HERE NE MUAJ

Drejtoges: LUMO SKËNDO

MBAN:

Istori e gërmim sip: Lumo Skëndo. — Andre: Gypitari.
Tingime: Fënik. — Vëll. — Këngët prej popullit.
Mishat poet. — Andej-Këllë. — Pjesa etepiAKE. — Bibliografi.



SELANIK
ÇARCI BAÇI, MYQIR SOKAK

Kemi në stok të libravet gjithë vepratë shqipe, literare dhe shkollore. Libra frëngjisht, anglisht, gjermanisht, italisht, tyqisht.

Përmëndim këtu nga libratë shqip:

	Fr. ar		Fr. ar
Fjalori i Kristoforidhit	12,—	Istori e Shqiptarvet t'Italis	8,—
" Buseti	4,—	Letratyra shqype	2,40
E drejta ndeshkimore,		Naim Frashëri	2,—
Terenc Toçi	10,—	Sërbët dhe Shqiptarët	1,50
Administrata, Kr. Floqi	5,—	Lulja e Kujtimit Foqioni	1,50
Malaria, Dr. Simonidhi	3,50	Fabiola I, II, III,	7,20
Prisi i Gjykatësit, E Kokona	3,80	Hi dhe Shpuz. L. Skëndo	1,50
Lulet e Prenverës H. Mosi	2,—	Qerbelaja, Naim i Rashëri	2,40
Erashja e Lady Windermere	2,40	Skënderbeu	2,40
Mprojjta e Atdeut. Foqioni	2,50	Lulet e Verësë	0,40
Liga e Prizrendit		Bagëti e Bujqësi	0,40
Mehdi Frashëri	1,—	Psikologji e edukatësë,	
Nevruzi	1,—	G. Le Bon	0,40
Tufë Lule	1,—	Pedagogji, A. Xhuvani	2,—
Kalendari Kombiar 1926	1,20	Roza e Taunenburgut	1,40
Diturija 1909	4,—	Gjenovefa	1,20
Kryengritja, Mihal Grameno	1,50	Pritmi i Shqipërisë, Lu-	
Epopeja Kombëtare	2,20	mo Skëndo	0,40
Skënderbeu	1,—	Plagët Tona, Lumo Skëndo	0,40
Skënderbeu mas gojëdhana-		Zemra	1,—
nash	3,50		

Kemi në stok të libravet gjithë vepratë shqipe, literare dhe shkollore. Libra frëngjisht, anglisht, gjermanisht, italisht, tyqisht.

Përmëndim këtu nga libratë shqip:

	Fr. ar		Fr. ar
E trathumja, roman, Prenushi	5	Histori e re Europës, K. Çekrezi	5
Melodram, Gjergj Fishta	5	Mësime Ushtriye I. II. III. IV. V,	
Fë e Kombësi, teatro, K. Floqi	6	Major Qamil Elbasani 2 lek copa	
Ndjenja për Atdhe, S. Butka	13	Për natë Kazanash, Shaltonja	4
H. Jonja, D. Nikaj	7 ^{1/2}	Nastradin Hoxha, Dhoçi Koti	4
Tingëllimet e Zembrës, Floqi	8	Libër Leximi për Shkollat e	
Bukurusha, D. Nikaj	7	Mjesme, K. Letrare	9
Historija e Shqypnis, D. Nikaj	12	Zoologjija, Arsimi	10
Lulet në Thes Nikaj	7	Advokati Patelin, V. Babatasi	4
Trathitja, dramë, Mehdi Frashëri	5	Doktori pa Dashka, Molière	4
Karilo Topija, dramë, Kr. Floqi	8	Dhematje, e Jezuitve	9
Pirro Neoptolemi, " Kr. Floqi	8	Algjebër,	7 ^{1/2}
Edukata,	10	Arithmetikë Theorike e Praktike	6
Napolon Bonaparti, Ilo Qafëzezi	8	Fati me numra, Dhori Koti	2
Qysh u gjënt Amerika, Ilo Qafëzezi	9	Ushtrime Frëngjishte, Metodë Ahn	13
Ali Pashë Tepelena, Ilo Qafëzezi	17	Bijat me nanën, roman, Prenushi	4
Letra, Shkresa, Fjalëtore, K. Çekrezi	10	Mrizi i Zënave, Gjergj Fishta	10
Punët e Dorës, N. Çika	10	Ushtrime Italishte I II, Jezuit	5
Detyrat e trimit, Gj. Shiroko	4	Bisedime Shqyp—Italisht, Nikaj	6
Pushka e Trathtarit, Zef Harapi	4	Sh. Luigji Gonzaga, Gjergj Fishta	3
Fluturimet e Shpirtit, Fer. Vokopola	3	Muziktari i verbët, roman, Pijore	4
E vorina e i Verbtit, D. N. Kimza	3	Prisi i Letratyrës,	4
Dy Pasqyra,	4	Ligjërotë mi gjuhët klanike,	3
Joana D' Ark, K. Gjeçov	4	Fille të Historis Natyre, Arsimi	10
Shpërblesa e përplotë, K. Çekrezi	10	Njoftime gjeografije I. II. III., Jezuit	6
Histori e Shqipëris, K. Çekrezi	6	Atlanti i vogël, Jezuit	5
Histori e Vietër, K. Çekrezi	5	Vallja e Parrizit, Gjergj Fishta	12
" Mjesjatiare, K. Çekrezi	5	Këndime, K. Çekrezi	5

Kopertina e numrit I të gazetës "Diturija" dhe njoftimet në faqet e fundit për titujt e librave, që shiteshin në librarinë "Lumo Skëndo"

“Në Ipek puna ka marrë një fytyrë tragjedi makabre. Qyteti është mbushur me ushtarë të thyer, të prishur, të demoralizuar, pa vleftë morale, as fizike. Rrugatë nxijnë syresh; dyqanet, kafente; hanet janë mbushur. Është një kope e madhe njerzish pa bari që ecin nëndërr, pa ndërgjegje të realitetit. Janë nizamët dhe redifët e prishur në Berarrë, të mbledhur këtu si në spital të gjërë.”²⁹

Artikulli është i gjatë 6 faqe të gazetës dhe përshkruhet hollësisht çdo lëvizje e faktorit shqiptar në largimin e ushtarëve turq. Në fund të artikullit përshkruhen detaje nga dita e pavarësisë më 28 nëntor 1912.

“Dalë nga Stambolli me Luigj Gurakuqin, Ismail Qemali kishte vajtur në Bukuresht ku gjashtë përfaqësues e kishin shoqëruar në Vjenë. Përpara katastrofës pa shëmbull që po e gjente Turqinë, shpresat për respektimin e integritetit tokësor të saj ishin pothuajse fare në zhdukje dhe fitimet e aleatëve ballkanikë dukeshin të bëheshin definitive. Mbi ndërtimin radikal që po priste hartën e Ballkanasve, trilidhja: Austri-Itali-Gjermani dhe më tepër fuqia e një lëvizje nga ana e shqiptare për të shpëtuar sa të mundin, makar një pjesë të vëndit të tyre.

Delegatët që kishin telegrafuar arritjen e tyre në Durrës dhe dëshirën e një mbledhje në Vlorë, kishin një premtim dhe një shpresë. Po vëndi vetë ishte po në një ngushtim të tillë. Hapat e parë ishin bërë bash për të gjetur një dritare shprese. Delegatët e zgjedhur në vënd, tani shtoheshin edhe me numrin e atyre të ardhurve nga viset e veriut dhe lindjes së tokave shqiptare, të cilët të gjithë së bashku 47 veta formojnë kongresin e 28 nëntorit 1912.”³⁰

Me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë zbehet ndjeshëm edhe agresiviteti i qarqeve antishqiptare ndaj gjuhës dhe medias shqipe. Kjo periudhë i lë vëndin një epoke të artë për median shqiptare, ku dhjetëra organe panë dritën e botimit, ç’ka ndikoi edhe në rritjen e cilësisë dhe konsolidimin e medias.

29 Mit’hat Frashëri, Javët e fundit të sundimit turk në Shqipëri, Gazeta “Diturija”, 1913, Selanik, fq. 5.

30 Mit’hat Frashëri, Javët e fundit të sundimit turk në Shqipëri, Gazeta “Diturija”, 1913, Selanik, fq. 5.

Në përmbyllje të kësaj periudhe, kemi zgjedhur të ribotojmë dy vjersha të shkruara nga Thanas V. Mborja në “Kalendarin e Korçës”, të cilat e pasqyrojnë më së miri atmosferën optimiste në trojet shqiptare e me gjerë për zhvillimin e mediave në gjuhën shqipe.

Gazetat shqip në Shqipëri³¹

*Që ditët, që u dha liria
Çeli lule Shqipëria.
Lulet janë gazetat
Degët janë shtypshkronjat
Rrënja vetë Shqipëria
Megjithë bij edhe bija.
Në çdo rrugë që të shkosh
Gazeta shqip do dëgjosh
Çunat gazetat kur shesin
Me zë të fortë thërresin:
Dielli, Liria, Bashkimi
Korça, Lidhja, Shqypja, Zgjimi!*

Shtypi shqip³²

*...Nga çdo anë që të shkosh,
Gazeta shqip do vështrosh.
Shtypshkronja të mëdha
Ngritur në çdo kasaba
Që punojnë natë e ditë
Për ti dhënë kombit dritë
Se gjendet në errësirë...*

31 Thanas V. Mborja, Gazetat shqip në Shqipëri, Kalendarin e Korçës”, 1910. fq. 95.

32 Thanas V. Mbroja, Shtypi shqip, “Kalendarin e Korçës”, 1910, fq. 99.

III.

ZHVILLIMI I ORGANEVE TE SHTYPIT DERI NE SHPALLJEN E MONARKISE (1913–1928)

3.1 Organet e shtypit pas shpalljes së pavarësisë

Ndërmjet viteve 1913–1924, në gjuhën shqipe botoheshin më shumë se 50 organe të shkruara, prej të cilave 5 në Tiranë, 11 në Shkodër, 5 në Korçë, 3 në Vlorë, 3 në Elbasan, nga 1 në Durrës, Pogradec e Gjirokastrë dhe pjesa tjetër jashtë kufijve. Përdorimi i gjuhës shqipe nuk kishte më kufizime dhe me qindra libra, gazeta e revista u përhapën anembanë vendit, sidomos pas përfundimit të Luftës I Botërore. Qytetet shqiptare, si Shkodra, Korça, Elbasani, Tirana e Vlora, filluan të gjallëroheshin dhe jeta kulturore po ashtu. Infrastruktura rrugore po përmirësohej. Kishte filluar shërbimi i telegrafisë dhe arsimi po hynte në fazat e para të zhvillimit. Shumë emigrantë u kthyen në qytetet e tyre dhe themeluan klube kulturore, shoqata, kinema, librari, gazeta e revista periodike.

*“Një mot e mbushi Shqipëria më vehte në këtë ditë! Në këtë ditë është ngritur flamuri i shënjtë i Skënderbeut në Vlorë për të dëftyer se ka dhe rron në botë një Shqipëri dhe një komb shqipëtar... Andaj kjo ditë e shënjtë nuk do harruar kurrë në jetë të jetëve, por do festuar mirë ashtu siç duhet. Po dhe sivjet mbetmë mbrapa, duke festuar gjithë Shqipërinë e lirë, se për fat të keq viset shqiptare në jug nuk janë çliruar ende, dhe më tepër në Vlorë ku është kryeqyteti i hëpërhëshëm i Shqipërisë”.*³³

33 Vjesht' e III-të, Revista “Xgjimi”, Nëntor 1913, Korçë, fq. 3. (131)


Kështu nis kryeartikulli i revistës “Xgjimi”, e cila nisi të botohet në tetor të vitit 1913, rreth një vit pas shpalljes së pavarësisë. Është një reportazh i titulluar “Vjesht’ e III-të”, që përshkruan se si është zbuluar Vlora me flamuj dhe të gjitha trevat shqiptare po festojnë një-vjetorin e shpalljes së pavarësisë. Kryeartikulli tregon gjithashtu edhe situatën kaotike në jug të vendit, ku kishin hyrë forca të armatosura greke, ndërsa në veri serbët. Shqipëria ishte njohur si shtet i pavarur, por ende nuk ishte në gjendje të ruante kufijtë e saj territorialë.

Revista “Xgjimi”, është një ndër mediat e para politike-shoqërore dhe reflektonte zhvillimet intensive të asaj periudhe dramatike për Shqipërinë, Ballkanin por edhe Evropën. Revista dilte çdo muaj me një volum prej 68 faqesh, me përmbajtje politike, letrare dhe kulturore. Drejtori i revistës ishte Dhori Koti, ndërsa përgjegjës Mihal Xoxe. Revista u publikua tetori 1913 deri në mars 1914.

Në këtë periudhë, Shqipëria po vuante represionin serb dhe grek. Mediat e kohës raportojnë se krahas faktorëve të tjerë, në këtë situatë kishin rol negativ qarqe shqiptare që sipas tyre, kishin tradhëtuar interesat kombëtare.

Në revistën “Biblioteka, Zëri i Shqipërisë” një artikull i shkruar nga Themistokli Gërmenji në numrin e tretë të revistës, evidenton si armiq të Shqipërisë shumë prej pashallarëve dhe bejlerëve shqiptarë. Revista drejtohet nga Kristo Dako dhe Themistokli Gërmenji. Numri i saj i parë doli më 1 mars 1915. Revista përmbante artikuj politikë, shoqërorë, kulturorë, si dhe kronika të kohës.

Dy drejtuesit e revistës, Dako dhe Gërmenji, tregojnë se ishin larguar nga atdheu për të vazhduar veprimtarinë e tyre patriotike jashtë vendit, pikërisht për shkak të sulmeve nga armiqtë e Shqipërisë. Bashkë me një grup patriotësh, ata ngritën komitetin e tyre në kryeqytetin e Bullgarisë, Sofie, prej nga botuan revistën “Biblioteka, Zëri i Shqipërisë” në gjuhët shqip, anglisht dhe frëngjisht. Themistokli Gërmenji i drejtohet lexuesve, duke raportuar për situatat që kishte ndeshur në kuvendime të ndryshme, ku vëren se shoqëria shqiptare vuante ende nga mendësia orientale dhe e kishte të vështirë t’i hapte rrugën zhvillimeve të reja politike e sociale.




Kopertina e revistës “Biblioteka, Zëri i Shqipërisë” (Foto: BKSH)



Kopertina e numrit të parë të revistës “Xgjimi” (Foto: BKSH)



Kopertina e revistës “Zana” (Foto: BKSH)



Numri I i gazetës “Yll’ i Mëngjezit”, botuar nga Parashqevi Qiriazi, Boston (Foto: BKSH)

“Pashallarët dhe bejlerët kujtuan se Shqipëria do të bëhet vetëm për ta, dhe se ata do të kishin atë influencë dhe fuqi që kishin në kohën e Turqisë, por kur kuptuan se Shqipëria nuk u bë vetëm për ta, por u bë për të gjithë shqipëtarët, atëherë, ç’thanë: një takëm prej ata që kanë qënë më të liqtë e më të liqve në Shqipëri. ‘Shqipëria s’qënka tona, neve që kemi qënë oxhakët e Shqipërisë, sot me këtë Shqipëri që na u bë–ne s’na shkon fjala; po o burra të përpiqemi ta rrëzojmë këtë princ dhe të sjellim një mysliman me të cilin mund të punojmë si të duam se ndryshe do të na humbasë oxhaku.’ Kam dëgjuar me veshët e mi një bej nacionalist, i cili ka thënë në mes të kafenesë që: ai nuk është bej por është vetëm shqipëtar etj etj.. por një tjetër bej duke u ngritur në këmbë u ngrit dhe i thotë: ske turp ore kur flet kështu?! Bejllëku është një titull të cilin na e ka dhënë Turqia dhe neve duhet ta mbajmë se jemi oxhak.”³⁴

Në të njëjtën revistë, Kristo Dako shkruan për përpjekjet e grekëve dhe serbëve për të copëtuar trojet shqiptare dhe për rëndësinë që kishte “Çështja e Adriatikut” në atë situatë kaotike në Ballkan e Evropë.

“Sot, pothuajse e tërë Evropa gjendet në luftë, por megjithëkëtë çështja e Adriatikut edhe e Shqipërisë nuk kanë humbur rëndësinë e tyre. Më shumë mund të themi se çështja e Shqipërisë është jo vetëm një nga çështjet që shkaktoi luftën evropiane, por edhe një nga ato që mund të sjellë edhe një ndryshim sjelljeje midis aleatëve që gjenden sot në luftë, si atë që përsuan shtetet e Ballkanit prapë nga shkaku i Shqipërisë. Polemika që u bë dhe po bëhet midis shtypit evropian për çështjen e Stambollit, të Bosforit, të Dardaneleve edhe të Adriatikut është një nga shënjat, një nga hijet që po hedhin përpara ndodhitë e mëdha edhe të hidhura të cilat nuk është çudi të ngjasin midis fuqive të trikuptimit, dhe në të cilat ngjarje doemos do të marrë pjesë edhe Italia”³⁵

Qëndrojmë sërish tek kjo revistë, për të veçuar një reportazh të shkruar nga Themistokli Gërmenji, i cili përshkruan udhëtimin e tij

34 Themistokli Gërmenji, Bejlerët dhe pashallarët në Shqipëri, revista “Biblioteka, Zëri i Shqipërisë”, 1915. Sofje, fq. 8.

35 Kristo Dako, Revista “Biblioteka, Zëri i Shqipërisë”, prill 1915, Sofje, fq. 7.

nëpër disa treva ku jetonin shqiptarë dhe konstaton se një kohë e re kishte ardhur për shqiptarët, përse i përket përhapjes së dijes përmes hapjes së shkollave e shoqërive kulturore.

*“Sikundër e kanë marrë vesh lexonjësit tanë nga gazetat shqip, redaktori ynë vizitoi pothuajse tërë kolonitë shqiptare dhe mund t’u sigurojë se përgjithësisht shqipëtarët kanë përparuar nga çdo pikëpamje. Bashkëatdhetarët tanë me gjithë që janë përhapur, me gjithë që lipset të punojnë rëndë për rrojtjen e tyre, mentojnë edhe sa munden përpiqen t’i shërbejnë çështjes kombëtare. Më të gjitha anët shqipëtarët po hapin klube dhe shkolla të natës; po organizojnë shoqëri muzikale, teatrale dhe trupa vullnetare, për të ndriçuar mëndjen, përtëforcuar ndjenjat, përtëstërvitur trupin dhe përtëmbjellëdhe forcuar ndjenjat kombëtare në zemrat e vëllezërve të tyre të arratisur dhe kështu, të gjithë të bëhen më të dobishëm për vehten e tyre edhe për Shqipërinë”.*³⁶

Në vitin 1914 u botua për herë të parë në Durrës revista “Zana”, e drejtuar nga Milo Duçi me pseudonimin Zonja Lulo Malësori dhe përgjegjës Jan Kremo. Revista ishte letrare e argëtuese dhe trajtonte çështje politike të kohës, por i kushtonte një vëmendje të veçantë zhvillimit të gruas në Shqipërinë e asaj kohe. Në një lajmërim të botuar në numrin 2, revista jep një informacion për formatin e saj:

*“Lajmërim. Në numrin 2 “Zana” ka me dalë me 24 faqe edhe shumë fytyra³⁷ midis luftëtarëve e kryengritësve të Shijakut, Kavajës e Tiranës si dhe artikuj e vjersha të shkruara nga më të mirët shkrimtarë shqiptarë dhe të huaj.”*³⁸

Në revistën “Zana” tërheq vëmendjen një artikull me titull: Rregulla për bashkëpunëtorët! Janë disa pika që tregojnë marrëdhëniet që ndërtonin botuesit me autorë të ndryshëm, të cilët nuk ishin pjesë e stafit të revistës.

³⁶ Mihal Grameno, Revista “Biblioteka, Zëri i Shqipërisë”, korrik 1913, fq. 15.

³⁷ Ka kuptimin “fotografi”.

³⁸ Lajmërim, Revista “Zana”, nr. 2, 15 korrik 1914, Durrës, fq. 3.

“Rregullat për Bashkëpunëtorët.

Të gjithë ata zotërinj që do të kenë mirësinë të dërgojnë shkrime duhet të marrin në sy këto kondita:

- *Dorëshkrimet të jenë të shkruara mirë dhe vetëm në një anë të letrës*
- *Çështja të mos jetë politike se e përkohëshmjia jonë nuk e ka programin politik, por vetëm letrat, as që të merret me çështje personale*
- *Ato shkrime që pasi të aprovohen, do botohen e do paguhen*
- *Fotografira që kanë marrëdhënie me zhvillimin dhe çështjen tonë botohen*
- *Pagesa asht 5 franga për çdo faqe me shkronja 8 puntësh!”³⁹*

Duket si një përpjekje e botuesit Milo Duçi, për të përfshirë sa më shumë autorë në faqet e revistës, ndoshta edhe në mungesë të stafit, sepse në katër numrat e arkivuar të kësaj reviste gjen shumë pak autorë. Lulo Malësori, që është pseudonimi i Milo Duçit, është autor në shumicën e artikujve, ndërsa gjenden edhe pseudonime të tjera si “Mushkonja” e “Lumi”. Përgjithësisht artikujt janë pa autorë. Numri i parë i revistës “Zana” u botua më 15 qershor 1914.

3.2 Kontributi i motrave Qiriazi në media

Në këtë periudhë veçojmë gjithashtu revistën “Yll’ i Mëngjesit”, e drejtuar nga Parashqevi Qiriazi. Revista u botua për herë të parë në janar 1917 në Boston të ShBA-së, si një organ i shoqërisë me të njëjtin emër “Yll’ i Mëngjesit”, e themeluar nga Parashqevi Qiriazi dhe motra e saj Sevasti Qiriazi që prej 16 janarit 1909. Parashqevi Qiriazi ishte kthyer në një figurë të njohur e të dashur për shqiptarët pas hartimit dhe botimit të abetares në vitin 1909 me titullin “Abetare për shkollat e para”. Më herët, Parashqevi dhe Sevasti Qiriazi kishin qenë pjesëmarrëse edhe në Kongresin e Manastirit. Dy motrat Qiriazi, përveç kontributit të jashtëzakonshëm për përhapjen e gjuhës shqipe dhe zhvillimin e hapave të parë në arsim, do të hynin në histori edhe si gratë e para drejtuese të

39 Rregullat për Bashkëpunëtorët, Revista “Zana”, 13 maj 1923, Durrës, fq. 20.

një organi të medias në gjuhën shqipe.

“Yll’ i Mëngjesit” ishte një revistë e përdyjavshme politike, shoqërore, historike, gjuhësore, letrare, pedagogjike, folkloristike, në gjuhët shqip dhe anglisht. Parashqevi Qiriazi kishte rubrikën e saj që titullohej “Fleta e editorit”, ku publikoheshin artikuj, kryesisht për arsimin. Sevasti Qiriazi ishte gjithashtu e angazhuar në këtë revistë, ku shkruante për problematika në ndryshme të Shqipërisë së asaj kohe. Bashkëpunëtor shumë i rëndësishëm ishte edhe Kristo Dako, bashkëshorti i Sevasti Qiriazit. Në faqet e kësaj reviste gjejmë edhe autorë të tjerë të sprovuar në publicistikë si, Mihal Grameno, Terenc Toçi, Sotir Dhosi Treska, D.J Tushemishti, H.Gjebrea, Rafail Dhimitri, Qerim Panariti etj.

Një ndër materialet e përzgjedhura për t’u trajtuar në këtë punim është artikulli me titull “Thirrje këndonjësve!”.

“Yll’ i Mëngjesit po afron të gjashtin muaj që kur se filloi të dalë në dritë. Të gjithë këndonjësve u është dërguar me rregull dhe gëzohemi se dyke e kënduar e kanë shijuar lëndën e saj të vyer edhe mendimet e saj të nalta.

Të gjithë shqiptarët kishin ndjerë nevojën e madhe për një të përkohëshme si “Yll’ i Mëngjesit” edhe letrat e shuma që kemi marrë me urime dhe falenderime nga Shqipëtarët e Amerikës si dhe nga të jashtmit na kanë dhënë kurajo e tregojnëçiltazi se shërbimi që i bën çështjes kombëtare e përkohëshmjajonë, çmohet ashtu si duhet. “Yll’ i Mëngjesit” mbush dy detyra, më një anë u jep shqiptarvet lëndë të zgjedhur për të ndritur mëndjen, më tjetër anë me artikullat anglisht familjarizon të huajt me çështjen shqiptare, edhe kështu shton miqtë e Shqipërisë. “Yll’ i Mëngjesit” u dërgohet të gjithë shqiptarëve në Amerikë edhe në Evropë si dhe tërë diplomatëve. Të gjithë këtyre u dërgohet pa të holla.

Prandaj u lutemi të gjithë pajtimtarëve të kenë mirësinë të na dërgojnë pajtimet që të mundim ta mbajmë këtë vepër ashtu si i ka hije: dy dollar në mot për 24 numra nga 34 faqe!”⁴⁰

⁴⁰ Parashqevi Qiriazi, Thirrje këndonjësve!, “Yll’ i Mëngjesit”, 31 mars 1917, Boston, fq. 18.

Siç shpjegohet në artikull, revista ka dy funksione: informues dhe edukativ për lexuesit shqiptarë si dhe informues për anglisht-folësit me qëllim për t'i njohur me çështjen shqiptare, që në ato vite ishte shumë e rëndësishme duke patur parasysh se Shqipëria ndodhej në një rajon të trazuar nën ethet e Luftës I Botërore dhe kërcënimi për ta copëtuar Shqipërinë ishte real.

Kemi përzgjedhur gjithashtu, një artikull në rubrikën “Fleta e editorit”, ku shkruan Parashqevi Qiriazi, e cila në këtë numër ia kushton editorialin e saj arsimit në gjuhën shqipe.

“Shumë herë është folur edhe shkrojtur se fatkeqësia më e madhe që i ka ardhur edhe po i vjen edhe sot të mjerës Shqipëri, shkaktohet nga se i ka mënnguar arësimi. Në ato kohëra kur Shqipëtarët munt të gjenin kohë për të u arësimuar e dimë se hekurat e tiranisë tëqeverisë Turke i ndalonin ; në këto kohëra kur Shqipëtarët munt të përfitojnë nga ky bekim qiellor, gjejnë si shkak, të mos paturit kohë, lipset të punojmë edhe kështu s’u mbetet kohë për të kënduar edhe për tu ndritur mëndjen edhe shpirtin. Po janë shumë gjëra të cilat ngjasin edhe na vërtetojnë se ky shkak nuku është i mjaftë; se as sytë munt të mbullim që të mos shohim, as veshët që të mos dëgjojmë, për ato gjëra që fliten edhe punohen për prishjen e karakterit të njeriut.”⁴¹

Në rubrikën e Sevasti Qiriazit “Kujtime të paharruara” përshkruheshin ngjarje të rëndësishme, të ndodhura në Shqipëri që i kishin mbetur në mendje Sevastisë, nga koha kur bashkë me të motrën përpiqeshin për përhapjen e gjuhës shqipe. Një prej tyre, i kushtohet sulmeve të klerikëve grekë, kundër shqiptarëve që ishin angazhuar në përhapjen e shkollës shqipe në Korçë.

“Ishte dyke ngrysur kur një foshnje, engjell i perendisë u dërgua të na lajmërojë se Sulua, kavazi i dhespotit dhe andar e katil nga vjetët e para bashkë me dy shokë hynë në eqim Polena, të mërkurë mbrëma më një të prillit. Këjo na vuri në dyshim të madh meqënë që flitej se pas ca ditësh do të hyjnë andarët të marrin Korçën etj...Meqënë që zoti Dako edhe nuku kishte ardhur ndë shtëpi u ngrita vetë dhe vajta në Majori edhe i dhashë raportin

⁴¹ Parashqevi Qiriazi, Fleta e editorit, “Yll’I Mëngjesit”, 17 qershor 1919, Boston, fq 7.

për ato që dëgjova. Fuqia e xhandarmarisë ishte e pakët dhe e përhapur rreth qytetit prandaj vetëm një fuqi fort e vogël u dërgua të rrethonjë shtëpinë e Ecim Polenës por nuku bënë zë duke pritur andartët të dalin. Sulua e kuptopi rrezikun edhe pa fjalë se nuku deshte të binte në duart e qeverisë. Bëri si bëri dhe i dërgoi raport dhespotit dhe i kërkoi urdhër çtë bënë. Në ora 2 të mesnatës i vjen përgjigja të nisnjë “luftën e shenjtë” edhe pushka filloi...!”⁴²

Është interesante një letër me vlerësime të larta, që Ismail Qemali i dërgonte revistës “Yll’ i Mëngjesit”, ku i drejtohej Kristo Dakos për veprimtarinë e tij patriotike dhe të dy motrave Qiriazi, duke veçuar shërbimin më të fundit që po i bënin kombit me revistën “Yll’ i Mëngjesit”.

“I nderçmë bashkëatdhetar Z. Dako,

Kurdo herë kam patur ndjenja nderi edhe dashurie për Z-t’uaj duke njojtur gjithë shërbimet patriotike që kini dëftyer gjithë jetën, si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë atdheut. Nuk harroj kurrë hidhërimin që ndjeva kur tyrqit ju burgosnë në Shkodër, edhe gëzimin që pata, pas ca ditësh, arrdhtë e më gjettë nëÇetinjë. Por shërbimi i sotmë që Z-j’uaj edhe e nderçmjja Parashqevi Qiriazi me të motrën të nderçmen zonjën Dako, dëfteni duke çkëlqyer shpirtin dhe mëndjen e atdhetarvet, kapër xen shërbimet e vjetra, për të cilat atdheu ska për të harruar emrat t’uaj dhe unë si plaku i Shqipërisë u nderoj edhe u përgëztoj me gjithë zemër. U lutem të më epni lejen e t’u përgjigjem me falënderje, fjalëve tëëmblla që “Yll’ i mëngjesit” shkruan për artikllën t’im. i lutem zotit të më japë fuqi të përpiqem gjër në funt të jetës me ju bashkë për lirinë e plotë të së dashurës Shqipëri.

Ju përshëndes atdhetarisht,

Juaji me besë Ismail Qemali

Paris, 27 të vjeshtës së tretë 1917.”⁴³

Në revistën “Yll’ i Mëngjesit”, ishte bashkëpunëtore edhe gazetarja Ikbal Çika, një ndër gratë e para gazetare në historinë e medias shqiptare.

42 Sevasti Qiriazi (Dako), Kujtime të paharruara, “Yll’ i Mëngjesit”, 16 qershor 1917, Boston, fq. 13.

43 Letra e Ismail Qemalit drejtuar Kristo Dakos, Parshqevi Qiriazi dhe Sevasti Qiriazi Dakos, “Yll’ i Mëngjesit”, 31 janar 1918, Boston, fq. 15.

Ajo ishte kryeredaktorja dhe administratorja e parë e gazetës “Arbënija”, që botohej nga i vëllai, Nebil Çika. Ishte gjithashtu gazetare dhe administratore e gazetës “Minerva”. Në vitin 1937 Ikbal Çika ishte botuese e gazetës “Java”, ku ishte gazetar edhe bashkëshorti i saj Aleks Mavraqi.

3.3 Rubrikat informative si standard i ri i medias

Me kalimin e viteve, shohim se pas botimeve të gazetave apo revistave të përmuajshme e të përjavshme, do të lindin gazetatat, të cilat botohen më shumë se një herë në javë.

Vlen të veçohet gazeta “Përlindja e Shqipënisë”, një gazetë dyjavore e shkruar në gjuhën shqipe dhe frëngjisht. Numri i parë i saj u botua në Bukuresht më 15 Maj 1913. Është një ndër gazetatat më të rëndësishme të asaj kohe, edhe për shkak se ishte gazeta e parë që publikohej dy herë në javë, çdo të mërkurë e të shtunë. Në faqen e parë publikohet emri i drejtuesit D. Berati, ndërsa nëpër faqet e gazetës gjejmë emrat e autorëve: Mihal Grameno, Haki Glina, Kristo Floqi, Pjetër Kakarriqi, Kostë Çekrezi, Emin Matragjiu, Ferid Vokopola, Gj. Kosta si dhe disa pseudonime, si “Shkëmbi i Mbletës”, Sazani” etj.

Në faqet e saj i gjejmë pothuajse të gjitha rubrikat e një gazete me strukturë të plotë, me informacion nga të gjitha fushat. Deri atëherë, artikujt e publikuar në revista e gazeta ishin më shumë analiza dhe opinione, ndërsa gazeta “Përlindja Shqipënisë”, solli për herë të parë lajmet telegrafike të ndara me rubrika specifike. Më poshtë po shohim ndërtimin e faqes 5, me lajme të ndara në dy pjesë: “lajme të brendme” dhe “lajme të jashtme”.

“Lajme të brendme

Dje arriti në qytetin t'onë Z. Myfid Beu, ministri i punëve të jashtme, bashkë më Z. Eqrem Bej Vlora, një nga anëtarët e komisiës së dërguar n' Evropë për punën e viseve që gjenden në dyshim.

Sikunder thamë edhe tjetër herë, Zotënia e tyne u-priten fort mirë kudo

që vajtën. Delegatët e ministriës, sikunder dhe delegatia e popullit, u-kthyen në Vlonë me shpirtin e forcuën prej fjalëve që degjuen ndër vise ku vajtën. Premtimet e atyne q'e kanë në dorë fatin e Gjinokastrës s'onë dhe viseve perqarj, thonë Z- nia e tynë, duke n'a siguruar se e drejta mbetet e drejtë dhe kurr nuk humbet, n'a mbushin me shpres e gëzim.

Lajme të jashtme

Telegrama

Romë, 30/12. Venizelos vajti dhe u- poq me ambasadorin frënk t'Atinës. Fitet se kryeministri i Grëqisë, ka ndër ment të vejë edhe ay në Paris me regjin e kraliut Konstantin.

Vienë- Ay lajmërohet, se Franca ma në fund emënoi edhe ajo përfaqësonjës in e vet në komisiën e kufinjve të jugës. Njani delegateështë kolloneli Allerman, krej i shërbimit geodhetik dhe i dyti Z. Graillet Voio.”⁴⁴

Një artikull mjaft interesant, me autor Mihal Gramenon publikohet në numrin e “vjeshtës së tretë” të vitit 1913, pra në nëntor të atij viti. Titullohet “Kritika!” Artikulli ka në thelb përballjen me një tjetër gazetë që titullohej “Shqipnia e re”. Ky debat mbi kritikën, pasqyron detaje të rëndësishme të këndvështrimeve të ndryshme që kishin gazetarët apo botuesit e asaj kohe për konceptet e tyre mbi shtypin.

“Simotra t'onë “Shqipnia e re” në No.14 në një kryeartikull fort të goditurë bën fjalë për mi kritikën. Vërtet këjo sëmundje është fort e përhapurë nër Shqipëtarët dhe në më të voglën çeshtje dhe bisedim, kritika është në krye. Nuku kemi kupëtuar as na që ku e kemi trashëguar këtë dhurëti po, siç duket, me qënë që kritika është ajo m'e lehtë punë, e bëmë veglën t'ënë”.⁴⁵

Gazeta “Ora e Maleve” është gjithashtu një gazetë e rëndësishme, e cila u botua nga Ernest Koliqi dhe Padër Anton Aarapi, ndonëse në faqet e saj shkruan edhe personalitete të tjera të kohës, si Luigj Gurakuqi. Kjo gazetë e përjavshme u botua në Shkodër që prej 15 prillit 1923 deri në dhjetor 1924.

44 Gazeta “Përlindja e Shqipnies”, nëntor 2013, Vlorë, fq. 5.

45 Mihal Grameno, Kritika, Gazeta “Përlindja e Shqipnies”, 23 Gusht 1913, Vlorë, fq. 8.

Tek “Ora e Maleve”, vihen re qartë elementet e një gazetarie, që tenton të shkojë drejt raportimit të lajmit. Në numrin e javës së fundit të gushtit 1923, në faqen e parë të gazetës gjejmë kronikën e vrasjes së gjeneral Enriko Tellinit, i cili ishte caktuar në krye të një komisioni ndërkombëtar për ndarjen e kufijve.

“Zyra e shtypit na telegrafon më 29 të muajit që u sos:

Me dorë greke, në tokë greke, delegacioni ushtarak Italian i kufinjve ra viktimë e një krimi të ligisht papritur. Gjeneral Tellini, Major Corti, Toger Bonacini, një marshall bashkë me dragomanin e shërbëtorin shqyphtar, afër Delvinaçit, qenë vrarë nga tufa grekësh. Qeveria e populli shqiptar mësuen ndodhinë me hidhërim të madh dhe do të bahet kudo ceremoni zyrtare e popullore për të ç’faq hidhërimin. Drejtoria e fletores, ka për të shkruar në numrin tjetër mbi këtë çështje. Për sot u paraqet familjeve të të vdekunve ngushëllimet e veta ma t’përzemërta.”⁴⁶

Gazeta botoi njoftimin e zyrës së shtypit pranë qeverisë, për vrasjen e gjeneralit si dhe të anëtarëve të tjerë të komisionit që e shoqëronin, pa e shoqëruar me ndonjë koment apo analizë rreth ngjarjes siç ndodhte zakonisht. Në numrat pasues, u publikuan disa artikuj që përshkruanin veprimtarinë e gjeneralit të vrarë, i cili ishte caktuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit të Kufijve në zbatim të vendimeve të konferencës së Londrës së vitit 1913, si dhe akuzat që i adresoheshin palës greke si autorë të vrasjes.

Në një tjetër artikull të disa muajve më vonë, gjejmë më të dukshëm elementet e raportimit të lajmit për një ngjarje të bujshme në godinën e Asamblesë Parlamentare. Gazeta “Ora e Maleve” e datës 24 shkurt 1924, përshkruan me detaje plagosjen e kryeministrit Ahmet Zogu.

“Atentati kundër kryeministrit

Tiranë më 24.II. 1924

Kuvendi Kushtetues u mblodh dje, më 23 për me zgjedhë parinë definitive, n’orën 2.30 mb dr. Si u këndue lista e miqvet dhe u gjet pranë shumica, kryetari i përkohshëm z. Poga hapi mledhjen dhe me një herë u ndanë biletat

⁴⁶ Vrasja e Gjeneral Tellinit, “Ora e maleve”, gusht 1923, Shkodër, fq. 1.

e secilit: nis për votimin e kryetarit. Ishte ora 2:40 kur u ndigjuen jashtë dy të shtijme revolveri, krisma e të cilave bani një përshtypje të madhe të gjithë asamblistavet dhe ndigjuesve qi gjindeshin mbrenda sallës.

Mas pak sekundash hapet dera e sallës dhe hyn z. Kryeministër me një fytyrë të zbet dhe porsa hyn mbrenda, nxjerr revolen nga brezi. Ndalet një sekund te dera, hedh sytë rreth asamblistave, dhe mbrapa vijon të xanë vendin e vet. U muer vesh me një herë se ishte plagosun e kjo punë shkaktoj një trazim të madh nder zemrën e të gjithve. Aq ma i madh kje trazimi kurse, për një copë herë, nuk muejt me u marrë vesht se kush ishte dorasi i këtij atentati. Mas pushkvet të para, u ndigjuen dhe disa të shtijme të tjera perjshta tue shtuem tmeren në mes të gjithëve pa dijtun se kunder kuej dhe pse shprazeshin.

S'vonoj shum dhe arritën ushtarët qi janë të shënjuem për roje t'asamblesë dhe si diktuen se guximtari ishte ndrye në një dhomë mueren me një herë masat kundër tij.

Në këtë kohë kryetari i Asamblesë kishte zbritë nga froni tue lëshuem kryesin, dhe kështu s;kish se kush t'i drejtonte asamblistat, të cilët të hutuem nga ndodhja e papritur, pritshin me pa durim një lajm mbi këtë ngjarje. Në mes të këtij grubullimi ngrihet z. Iljaz Vrioni dhe me gjakftoftësi merr përkohsisht kryesin me pranimin e të gjith asamblistavet. Zemrat e asemblistave u qetësuen dhi si shkëmbyenë disa mendime e u mueren vesh me komandatin e rojes, u shënjue z. Ali Këlcyra qi t'shkonte n'emën t' Asamblesë me folë me guximtarin për dorëzim. Me këtë ndërmjetësi u muer vesht se guximtari ishte një djalë i ri student nga Mati, i cili mbasi kish krye atë vepër të deplorueshme kundër kryeministrit, ishte ndryem në një dhomë, ku kishte qitun ceken mos me u dhanë për të gjallë pa sigurimin e jetës së vet.

Mbas këtij sigurimi me anën e asambleve, guximtari iu dorzue fuqisë s'aramatosun dhe kështu pothue se mori fund ajo gjendje anormale në të cilën ndodheshin assembleistat me ndigjesat. Mbas fjalvet të doktoravet u muer vesht edhe se plagat e z.kryeministër ishin të lehta dhe të shërueshme në një kohë të shkurtër. Zotnija e tij kishte një plagë në dorën e tij të mëngjër dhe një plagë në ndij.”⁴⁷

⁴⁷ Atentati kundër kryeministrit, “Ora e Maleve”, 24 shkurt 1924, Shkodër, fq. 1.

Ngjarja është raportuar si kronikë e ftohtë, pa komente dhe analizë. Këto janë fillimet e një gazetarie raportuese me ndarjen e qartë ndërmjet rubrikave brenda faqeve të gazetës, ku lajmi raportohet siç ka ndodhur dhe në faqe të tjera që pasojnë gjen komente dhe analiza për ngjarjet e kohës. Një rubrikë e veçantë i kushtohet situatës ekonomike, ku përgjithësisht përshkruhen kushtet e vështira dhe varfëria në Shqipërinë e asaj kohe. Në vitin 1923, gazeta “Ora e Maleve” sjell një artikull ku përshkruhet pikërisht zija e bukës. Qysh në krye të artikullit, sqarohet se kishte qenë një tjetër artikull i planifikuar për t’u botuar, por situata e kishte sjellë domosdoshmërinë e një artikulli aktual që fliste për zinë e bukës.

“E kemi pasë qitë Ceken me fol sod mi rrrizimin e ministrit të punëve botore, kur një çeshtje tjetër ma me shumë randsi na u çfaq kaq e ndershyme, kaq e trishtueshme sa me e tërhjeko plotësisht përkujdesiminj tonë; prandaj, në vënd se me u ndaluemun e me arsyetue mi një çeshtje thjeshtë politike, e shohim ma me udhë me u ndaluemun e me fol mi çeshtjen e dytë, duem me thanë mi çeshtjen e zijes së bukës, që për ditë e ma tepër, me një furi përnjimen mizore, asht ka përhapet ndër shumë vise të atdheut tonë.”⁴⁸

“Posta e Shqypnias” ishte një gazetë e cila u botua për herë të parë në vitin 1916, në Shkodër nga Kuvendi Françeskan. Kjo gazetë politiko-letrare publikohej dy herë në javë, të mërkurë dhe të shtunë, me 4 faqe. Ndër autorët më të spikatur ishin Padër Vinçens Prenushi e Zef Duka.

Megjithëse kishte vetëm katër faqe, gazeta i jep hapësirë informacionit për lajme të brendshme dhe të jashtme. Një ndër artikujt e kësaj gazete në vitin 1917 titullohet: “Italis i ka hije frika”. Artikulli përshkruan me nota ironie situatën në Itali, e cila kërcënohej nga destabiliteti, që kërcënonte mbarë Evropën.

“Fletoret e Italisë nuk bajnë tjetër në këto ditë veç tuj përçapë punën e një t’symes e cilla mundet me ndodhë me anë të fuqive qëndrore, e kaq i ka kap frika ato vise t’mjerueme e popullin e Italisë marë, sa nkto ditë ju desht Cadornës me u sjellë prej Brazilit që asht ministri i hershëm i tokave

⁴⁸ Zija e bukës në Shqypni, “Ora e maleve”, Shkodër, 13 maj 1923, fq. 5.

*të pashpërblyeme, e me i ba do diftime me të cilat Brazili mandej do të mundohej me pajtue sadopak zemrat e pezmatueme te italianave-1914 e me ju hjek sado let at droje deket qi i ka kapë ket popull.*⁴⁹

Do të ndalemi tek revista “Dokumenta Historike”, drejtuar nga Lef Nosi, sepse është një ndër organet e veçanta, që ka një kontribut me rëndësi në dokumentimin e historisë. Numri i parë i kësaj reviste daton më 1 mars të vitit 1924. Për rreth dy vite, në këtë revistë me 36 faqe, u botuan dokumente origjinale të historisë së Shqipërisë me një rëndësi të veçantë për historianët, që përfshinin periudhën gjatë Rilindjes dhe pas shpalljes së pavarësisë, në vitet 1912-1914. Në numrin e parë të revistës, Lef Nosi botoi një parathënie, në të cilën rendiste arsyet, pse vendosi ta botojë këtë revistë.

“Dokumenta Historike. Për ti shërbyer historisë tonë kombëtare.

Parathënie:

Rastet e mira edhe kujdesi që kam pasun, u banë shkak me futë në dorë dal nga dalë, një numër të madh dokumentesh, të cilat janë një visar i pa çmueshën i Rilindjes tonë Kombëtare.

*Nga frika, se po të mos botohen me kohë mund edhe të humbasin, vendosa me i qitë në dritë, me anë të kësaj fletoreje të përmuajshme. Kjo mënyrë mu duk ma e arsyeshme, sepse besoj se kështu mund të dalin në dritë edhe dokumente të tjera, që gjenden ndër duar zotnijsht, të cilëve, edhe mos paçin qënë të interesuem si un-e ka sjellë puna me iu ranë në dorë.”*⁵⁰

Rikthejmë në vëmendje gazetën “Perlindja e Shqipnjes” për të analizuar një ndër elementet e rëndësishëm të gazetarisë, siç është përgënjeshtrimi. Bëhet fjalë për disa artikujt të publikuar në gazetën e revistat e kohës, ku shkruhej për një lëvizje politike të ministrit të luftës në vitin 1914, Izet Pasha, për të cilin ishte shkruar se kishte pretendime për fronin e Shqipërisë. Siç sqarohet në tekstin e përgënjeshtërimit, Izet Pasha kishte dhënë në atë kohë dorëheqje nga posti i ministrit të

49 Italis i ka hije frika , “Posta e Shqipnjes” , 7 prill 1917, Shkodër, fq. 1.

50 Lef Nosi, Parathënie, “Dokumenta Historike” nr. 1, 1 mars 1924, Elbasan, fq. 3.

luftës dhe ky vendim i tij ishte parë si një përpjekje për të nisur lëvizjen politike drejt fronit mbretëror. Gazeta “Perlindja e Shqipnies” ka publikuar përgënjeshttrimin krahas lajmeve të publikuara rreth kësaj çështje në rubrikën “Përgënjeshtime zyrtare”. Kjo rubrikë e posaçme ishte rezervuar për përgënjeshtime të lajmeve që publikoheshin në faqet e kësaj gazete, ose të organeve të tjera të shtypit shqiptar dhe ndërkombëtar.

“Përgënjeshtime zyrtare!

Izet Pasha pregatit të banjë një udhëtim n’Evrop për punërat e tija të veçanta. Izet pasha i ka thanë gazetarëve që kanë nxituar ta pyesin për çëshjtjen e proklamatës së tij si princ i Shqipnies:

Nuk kam kurrë një dëshirë që të përzihem ndër punërat e Shqipnies. Vërtetet kam qëllim të vete në Evropë por skam as ndërmënd të hy në një shqelë të Shqipnies. Tregimet e disa gazetave nuk janë përveçse gjepura qesharake.

Në tjetër anë drejtimi i shtypit i ministrit të punëve të jashtme boton këtë komunikatë:

Lajmet e botuara prej disa gazetave, pas të cilave ish-ministri i luftës Izet pasha nuk është dorëjashtë ndër disa lëvizje politike në Shqipëni, janë plotësisht të çpikura e pa themel.

Ç’thotë Izet Pasha

Izet pasha i ka çpallur korespondentit të gazetës “Neue Freie Press në Stamboll që mbi fjalët e përhapuna të proklamimit të tij për pretendent i fronit shqypnies nuk dinë kurrë-një sendi. Ay asht gjithësisht dorëjashtë në këtë çashtje dhe e ka përgënjeshtuar zyrtarisht lajmin mbi udhëtimin e tij...”⁵¹

51 Përgënjeshtime zyrtare “Perlindja e Shqipnies”, shkurt 1914, Vlorë, fq. 5.

3.4 Organet e shtypit përballë akuzave në gjyq

Përpyekja e mediave për të zgjeruar sa më shumë hapësirën e informacionit duke prekur më shumë problematika të kohës, shoqërohet me rritjen e presioneve nga institucionet qeveritare ndaj gazetarëve.

Në një artikull të gazetës “Perlindja e Shqipnies” vihen re vështirësitë me të cilat ndeshet një gazetar, që zakonisht lidhen me presionet nga eksponentë të ndryshëm të pushtetit të asaj kohe. Artikulli rrëfen udhëtimin e një gazetari drejt Dibrës, i cili ishte nisur me qëllim pasqyrimin e kryengritjes së dibranëve kundër hordhive serbe. Përmes këtij artikulli vërejmë edhe fenomenin e mbulimit më të gjerë të ngjarjeve përmes korrespondentëve. Pavarësisht vështirësive e presioneve, gazeta përpiqet të zgjerojë hartën e pasqyrimin të ngjarjeve edhe në krahinat më të largëta të Shqipërisë. Më poshtë paraqitet ankesa që korrespondenti i drejton botuesit të tij rreth mosmarrëveshjes që kishte me organet e shtetit.

“I ndershëm Drejtar.

Më emëruat korespondent i fletores “Perlindja e Shqipnies” për të vajtur në Dibër. Pa vonuar u nisa nga ana e Durrësit, qyteti ku asht ngehur klika e një diktatori që quhet Esad Pashë Toptani. Me të zbritur prej vaporit, vjen një polic e më thotë se armën duhet ta lë në zyrën e policisë duke më premtuar se kam të drejtë ta marr kur të shkoj. I zura besë atij njeriut dhe ia dhash armën. Dola pastaj të gjej kafshë që të nisem sa ma shpejt për Elbasan. Me të gjetur atë që kërkonja u kthyesh të marr armën. Po, çudi, polici më thotë se pashai bani emër që unë të këthehem prarë nga kam ardhur.”⁵²

Presionet e pushtetit ndaj medias sa vinin e shtoheshin, për të mbërritur në momentin kur media gjendet për herë të parë në përballje ligjore me pushtetin. Gazeta “Ora e Maleve” do të përballej me drejtësinë e kohës, një gjyq që vinte si shkak i reagimit të disa qarqeve fetare, të cilat e shihnin gazetën si një element përçarës për besimet fetare në

⁵² Njerëzit e zotit Esat Pasha dhe gazeta jonë- Odhisea e një korespondenti, “Perlindja e Shqipnies”, 30 tetor 1913, Vlorë, fq. 1.

Shqipëri. Një artikull me titull “Nji gjamë vorresh prej Himaret”, kishte shkaktuar reagim të ashpër të disa qarqeve, që kishin protestuar deri tek nivelet më të larta të qeverisjes së kohës.

*“Ora e malevet e çon zanin e vet e i grish himariotët me hjekë dorë prej atyne venomeve në të cilat, gabimisht kishin ngulë kamë tu i thanë se edhe vllaznit e tjerë të Shqypnisë së epërme kishin hjekë dorë për të mirën e përbashkët t’atdheut”, prej sa e sa venomeve që regjimi Osman i ka pasë njoft. E mirë, grishja e saj interpretohet nji kushtim i katolikve për me përtri dasitë ndërmjet besimeve të ndryshme... Ah ç’kuptim i hollë! Ah c’llogjikë e bindshme! Shpejt për shpejt, nën kryesinë e Shkëlqesës së tij, Sulejman Delvina, mblidhet Këshilli ministrues e vendos që fletorja “Ora e Malevet” të hidhet në gjyq, sikurse një organ i një elementi damprues, i cili mundohet me shkaktue dasinë ndërmjet popullit shqiptar, e me dasinë, turbullomin e qetsis botnore. Shumë Bukur! Të shtunën me 4 në këtë muej rrihet në gjykatore të Shkodrës davaja e “Orës së Malevet”.... Mbas sa padinavet qe i bahen prej prokurorijet përmbi artikullin “Gjamë vorresh prej Himaret” e mas shpjegimeve të dhanme prej avokatit Risto Siliqi, mkamsi i drejtorit të gjegjes, e drejtpërsëdrejti prej artikullshkruesit, gjykatorja vendos pafajninë e fletores “Ora e Malevet” e njiherit kundra katolikve e klerit katolik? Pse me u ndëshkue ligjërisht shkaktarët e dasissë së besimeve fetare? Pse? Pse desht me triumfue e patundshme drejtësia e gjykatës! Të jetë e sigurt qeveria qëndrore se “Ora e Malevet”, jo vec se edhe sot e mrapa, emrena mengjeve të ligjes, ka për ti luftue mballafaque të gjitha paudhësinat qëkudo mund tëndodhin. Por nuk ka për tu friksue fare prej dredhinave me te cillat “ndonje uri e mshefte”, mundohet me i minue ekzistencën e kristianvet e ndoshta ndoshta edhe të shtetit mbarë”.*⁵³

Mbas artikullit botohet një shënim i redaktorit, ku shpjegohen arsyet pse sulmohet gazeta nga qarqe të caktuara, për disa ngjarje kriminale që kishin ndodhur në jug dhe në veri të Shqipërisë, të cilat lidheshin shpesh me konfliktet fetare. Gjithsesi, redaktori i gazetës “Ora e Maleve” sqaron, se këto ngjarje janë mjaft shqetësuese dhe nuk e nderojnë historinë e Shqipërisë, por mbetet i bindur se “kjo është e

⁵³ “Ora e Maleve”, 11 tetor 1924, Shkodër, fq. 2.

vërteta dhe kësaj të vërtete gazeta nuk i shmanget dot”.

“Po na shkruajnë prej Tiranet se ndokuej tuj i ardhë shumë ranë, pse na jemi kah përmendim tepër shpesh ndër shtylla të kësaj fletorje, ndollinat e shëmtueme të Manatisë, Mnelës, të Qafës së Mills etj..

Edhe ne si shyphtar qi nderohena me kenë, na pikon zemra gjak sa herë na duhet me folë përmi kto ndollina të cilat, mjerisht kanë për të mbete të shkrueme me germa të turpshme në historinë komtare, por shka t’i bajmë të vërtetës? Ato shënime nuk duhet ti lamë m’anësh sikurse të ishin punë të vogla pa kurrfarë randsijet, por lypet qi shkaktarët e tyne të hidhen në gjyq. Kur gjyqi ti ketë marrë në gjykim, atherë na skemi për të fol ma, tuj ia lanë kopetencësëtij përgjegjësitëshpirtnore, si në faqe të popullit ashtu edhe në faqe të historisë komtare.

Na, detyrën tonë sikurse fletore, do të mundohena me e krye me një ndërgjegje thjeshtë atdhetare e njerzore, tue u përkujdesë për të shërimit të atyne varrvet që e bajnë me lëngue keqas organizmin shtetnuer. Rrihet mbrenda gjytetit të Shkodrës, prej zyrtarit të xhandarmarisë, një guximtar i dorëzuemun, autoriteteve qeveritare e lidhun duersh, e rrihet kaq fort sa me i shti meren gjithë atyne që ndodhen në atë vënd. Ndoshta nuk kishin dashtë me fol përmi këtë çështje, por shka t’i bajnë popullit, që erdh në protest te redaksioni ynë; atij populli, po thomi, që nuk lyp tjetër veç respektimin e statutit komtar? Edhe një herë triumfoi ideja e “Ora e malevet”.⁵⁴

Artikulli për të cilin gazeta “Ora e Maleve” u përball në gjyq ishte shkruar nga Costantinus, pseudonimi i Luigj Gurakuqit, më 13 shtator 1924.

Është impresionuese mënyra se si Luigj Gurakuqi argumenton mbi pafajësinë e gazetës: *“Edhe ne si shyphtar qi nderohena me kenë, na pikon zemra gjak sa herë na duhet me folë përmi kto ndollina të cilat, mjerisht kanë për të mbete të shkrueme me germa të turpshme në historinë komtare, por shka t’i bajmë të vërtetës?!”*

Pavarësisht fuqisë së pushtetit, gjykata vendosi t’i japë të drejtë medias që ka shkruar artikullin mbi fakte të pakundërshtueshme.

54 Shënim i redaktorit, “Ora e Maleve”, 11 tetor 1924, Shkodër, fq. 3.

Kjo periudhë e historisë së medias, pas shpalljes së pavarësisë, është ndër më produktivet në krahasim me periudhat e mëparshme. Me shtimin e gazetave dhe revistave të reja çdo vit, me rritjen e cilësisë dhe zgjerimin e konsiderueshëm të numrit të hapësirës informative, me shtimin e autorëve, media shqiptare kishte krijuar identitetin e vet. Kjo periudhë bën dallim krahasuar me stilin e mëparshëm të organizimit të faqeve të gazetave, sepse nis të zgjerohet hapësira për informacion. Ky është një stad i ri i organizimit të medias, ku merr formë strukturimi nëpërmjet rubrikave informative. Të mos harrojmë se deri atëherë, artikujt kishin më shumë frymë analize, patriotike e letrare.

IV. MEDIA NE KOHEN E MONARKISE (1928-1939)

4.1 Media midis lirisë dhe censurës

Me shpalljen e Monarkisë, më 1 shtator 1928 dhe kurorëzimit të Ahmet Zogut si Mbret i Shqipërisë, filloi një histori e re e marrëdhënies së shtypit me pushtetin. Zogu shfaqej dashamirës ndaj shtypit, pasi e vlerësonte si një pushtet të ri, me të cilin i duhej të krijonte një marrëdhënie, por zyrtarisht media kontrollohej nga Ministria e Brendshme dhe ligji për shtypin ishte shumë i ashpër.

Në shtyp lejoheshin kritika për nëpunësit e vegjël, por jo për mbretin. Gjithashtu nuk lejohej asnjë opozitarizëm politik. Shumë prej gazetave që shtypeshin jashtë kufijve të Shqipërisë, tashmë u ndalohej të shpërndaheshin në Shqipëri, madje pati raste kur botuesit dhe gazetarët e tyre u shpallën të padëshirueshëm. Shumë botues u përpoqën t'i shpëtojnë censurës duke përdorur një gjuhë më të kujdesshme, më të moderuar dhe duke i kanalizuar konfliktet me Monarkinë më tepër si përplasje e ideve konservatore me ato të reja, gjë që shihej si një debat i parrezikshëm për regjimin.

Një rast interesant e gjejmë tek artikulli “Naltmadhnija e tij, Mbreti dhe Djalëria”, botuar më 15 mars 1933 në revistën “Minerva”, pas një takimi të drejtuesit të kësaj reviste Nebil Çika, me mbretin Ahmet Zog, ku tregohet raporti që kishte botuesi me monarkun. Gazetari dhe drejtuesi i revistës “Minerva”, kishte kërkuar një takim me mbretin, për të folur rreth rolit të rinisë shqiptare në reformat që po planifikoheshin për zhvillimin e Shqipërisë. Në artikullin që ai botoi pas takimit me

mbretin, përshkruhen ndër të tjera edhe vlerësimet shumë të larta për Ahmet Zogun, ndoshta i detyruar edhe nga kushtet në të cilat gjendej media në atë kohë, sepse në janarin e vitit 1931 ishte miratuar një ligj për median, që përmbante disa kushte.

Sipas ligjit, çdo botues duhet të ishte mbi 25 vjeç, të kishte një dëftesë gjimnazi, një depozitë prej 5000 frangash ari etj. Këto kushte nuk mund t'i plotësonin të gjithë në atë kohë. Kështu, dispozitat e këtij ligji me më shumë se 60 artikuj, cënonin të drejtën e lirisë së shtypit dhe shumë gazeta e revista u mbyllën. Nenet që kufizonin lirinë e shtypit përmbledheshin si më poshtë:

“Çensura preventive mbi shtypin vehet:

Kur shpallet shtet-rrethimi:

a) në zonën e shtet-rrethimit;

b) në raste nevojë dhe jashtë asaj zone:

Kur edhe nuk ka edhe shtet-rrethim:

a) në kohë lufte;

b) në kohë mobilizimi;

c) në kohë kryengritjeje;

ç) në kohë të një situatë luftësjetllëse;

d) në kohë të një situatë që parashef një kryengritje;

dh) në kohë të një kalamiteti publik.”⁵⁵

Pak kohë më pas, regjimi do të ndryshonte qasje duke i dhënë një hapësirë lirie medias me miratimin e qeverisë së re. Në njërin prej numrave të revistës “Minerva”, në maj 1935, Ismet Toto shkruan një artikull për disa lëshime që kishte bërë asokohe monarku për shtypin dhe organizimin e klubeve kulturore. Thuajse të gjithë artikujt e Ismet Totos, kanë në thelbin e tyre betejën e vazhdueshme mes “të vjetërve dhe të rinjve”, ndarjen ndërmjet brezave dhe botëkuptimit të tyre për shoqërinë shqiptare e politikën e asaj kohe. Ismet Toto, si një promovues i ideve të të rinjve, nuk ngurron e as nuk tutet të shkruajë atë që mendon se është “e vjetra” apo “të vjetrit”, për të cilët thotë:

⁵⁵ Shih “Aneksi 3”, fq. 186.

“Do t’i respektojmë për aq sa kanë dhënë për kombin, e të tjerë “të vjetër a më pak të vjetër” që nuk lëshojnë udhë, do t’i injorojmë e t’i quajmë se nuk ekzistojnë.”⁵⁶

Toto përshkruan betejën e kohës ndërmjet djalërisë dhe pjesës tjetër, që i etiketon “të vjetër”, dhe bën një analizë entuziaste në kushtet e reja pas lëshimeve nga regjimi. Në vjeshtën e vitit 1935 Zogu emëroi kryeministër Mehdi Frashërin, i cili kishte qenë një ndër zyrtarët shtetërorë që vlerësonte më shumë rolin e shtypit. Ai ishte gjithashtu bashkëpunëtor në disa gazeta e revista, kryesisht përmes artikujve për ekonominë. Dekretimi i tij si kryeministër u përshëndet nga media, që e cilësoi qeverinë e re me frymë liberale.

“Më 21 Tetor Mbreti i Shqiptarëve dekretoi formimin e qeverisë së re. Edhe optimisti më kokëfortë nuk shpresonte aq shumë sa na dha Mbreti. Na u hutuam pakëz nga skena e re, nga realiteti i ri. Të mësuar në errësi, na vrau sytë drita e ditës së re.

Bota që u rrëzua, bota që u nis nga varret, ikën e pështjellë në mantot e saj të mëndafshta duke qeshur e duke qarë, e duke ndriçur dhëmbët e saj të verdhë e të kalbur. Ikën, ikën që të fshihet, ka frikë të duket në mes tonë. Britmat e nxehta të popullit e sëmurën. Dalgadalë do ta vdesin fare.

Na mbetëm pakëz të tronditur. Fitimet dhe humbjet e mëdha të trondisin kur janë të papritura. Do të shkojë pakëz kohë gjersa të fillojmë të puthitemi me realitetin e ri, që me shpejtësi vetëtimtare krijoi Udhëheqësi. Atëhere do të mund t’i japim bashkërisht një impetus të fuqishëm dhe entusiastik jetës sonë në të gjitha shfaqjet e saj.

Thashë kam pasur dhe unë një zell për të shkruar. Dhe kam shkruar disa gjëra të cilat s’guxon t’i thotë kushdo as sot në këtë atmosferë lirie, në këtë klimë të ngrohët e të ndritur, që shpirtëzon për të mbarë e për të mirë edhe katundarin tonë më të fundit. Mbasandaj heshtëm. Ç’që për t’u thënë u tha, ç’që për të bërë u bë. Pritëm. Po s’pritëm shumë. Koha erdh. Erdh koha jonë, ajo kohë për të cilën ne luftuam sipas fuqive tona dhe që aq çmëndurisht dashuruam. Tashti nuk mund veçse të jemi të gëzuar dhe, gjer diku, edhe krenarë. Po krenaria jonë është legjitime dhe e merituar. Është një krenari

⁵⁶ Ismet Toto, revista “Minerva”, maj 1935, Tiranë, fq. 6.

e pastër dhe e kulluar, e ngritur mbi themelin e mermertë të altruizmit dhe të sakrificës më të lartë për të mirën kolektive. Shkurt, është një krenari që s’ka as frikë, as turp të shpallet botërisht; është një krenari për të cilën duhet të mundohemi që dalngadalë ta përvetësojnë të gjithë shqipëtarët, në duam që të mos kemi më qytetarë servilë, të dobët dhe apatikë. Kjo epokë e konstruksionit tonë moral do të ketë pa tjetër për qëllim të rritë qytetarë kryelartë, të fuqishëm dhe përparimtarë. Vetëm të këtillë popuj mund të jetojnë sot e tutje, vetëm të këtillë popuj lënë gjurmë në historinë e botës.

Tashti erdh koha jonë. Tashti mori fund dhe heshtja jonë... Erdh koha jonë.”⁵⁷

Në të njëjtin numër të revistës “Minerva”, botuesi Nebil Çika i përgjigjet Totos duke ia zbehur entuziazmin për ato që priste nga zhvillimet e fundit politike. Në artikullin me titull: “Erdh Koha jonë, por...”, Çika rendit një sërë problematikash që e pengonin zhvillimin e shoqërisë shqiptare dhe sipas tij, përpjekjet e kryeministrit liberal nuk mjaftonin për t’i zgjidhur. Nebil Çika e shënjestron kritikën e tij tek administrata shtetërore, e cila i përkiste një shtrese të shoqërisë që vinte nga kultura osmane.

“Askush nga ministrat e sotëm ose të nesërm, nuk ka akoma një program të elaboruar në bazë të studimeve serioze për ndonjë degë të administratës shtetnore... Shtëpi e re me material të vjetër nuk ka kuptim. Duhet tu jepet kohë ministrave të sotëm sa të kuptojnë gjendjen nga brenda dhe të reformojnë aparatën e tyre sipas nevojave të etapës së re që po fillojmë...

Duhet marrë parasysh se duke thyer hekurat e të tërë një bote të vjetër, do të krijojmë të tërë një botë të re. Nuk është kollaj. Neve na rëndon mbi supe një fatkeqësi e madhe: kemi qënë nën influencën e një bote të vjetër, jemi rritur sipas qefit dhe metodave të asaj bote... Mustafa Mara, një tregtar i zgjuar nacionalist i Tiranës me emër, pasi e pyeta se si i duket kabineti i të rinjve, ma tha përgjigjen: Ay që ka le prej maces s’mund të zaji veçse mi!

Nuk munda ta kem atë që e thonë “presence d’esprit” ose turqe, “hazer xhevapllëk”. Pas nja pak sekondash, kur desha tja kthej mendjen, ai mu

⁵⁷ Ismet Toto, Erdh koha jonë, revista “Minerva”, tetor 1935, Tiranë, fq. 3.

përgjigj prermas: - Unë s'besoj gjë po spashë liri shtypi...!"⁵⁸

Siç duket në artikull, Nebil Çika ishte më pak entuziast, sepse besonte se situata politiko-shoqërore në Shqipëri ishte shumë larg aspiratave të asaj pjesë të intelektualëve të rinj, që quheshin "djalëria shqiptare", ku bënin pjesë shumica e gazetarëve dhe publicistëve. Ndaj, nëpër artikujt e gazetave kryesore të viteve '30-'40, krahas shqetësimeve për problematikat që kalonte vendi, merr vëmendje të konsiderueshme edhe roli i shtypit dhe ndikimi i tij në zhvillimet politiko-shoqërore të kohës.

Në revistën "ABC" me drejtues Petro Markon, në vitin 1936, gjejmë gjithashtu nuanca të pesimizmit për mënyrën se si përhapej informacioni përmes medias. Në numrin e parë të revistës, në editorialin e saj "*Pak fjalë si nisje...*", "ABC"-ja analizon se bota e errët e shtypit shqiptar ishte shumë larg së vërtetës, shumë larg misionit për të cilin ekzistonte një gazetë a revistë.

"Ka shumë njerëz akoma në këtë botë të errët, për të cilët vlerat morale nuk kanë asnjë randësi: drejtësia dhe e vërteta për këta njerëz janë të zbrazta pa kuptim! Të vërbuem nga interesat vulgare të barkut, këta njerëz të vegjël nuk shohin rrezet e agimit të triumfit të drejtësisë. Në revistën tonë, pra o këndonjës shqiptarë, ti do të shohësh rrezet e para të këtij agimi të bukur, të cilat do të ndriçojnë mëndjen tënde të vërbueme nga errësina.

*Ndoshta ndonjë pseudo-intelektuali të mçefun nën xhyben e kulturës do t'i duken dhamët e ndytë nga buzëqeshja cinike kur të këndojë këta rreshta! Ani, ai dhe shokët e tij le të qeshin..."*⁵⁹

"ABC"-ja drejtohej nga Petro Marko, por në këtë revistë shkruante edhe Ismet Toto, Branko Merxhani dhe shumë intelektualë të tjerë që shkruanin me pseudonime. U botuan vetëm disa numra dhe "ABC"-ja u detyrua të ndalonte botimin brenda vitit të parë pas kërcënimeve të shumta.

58 Nebil Çika, Erdh Koha jonë por..., revista "Minerva", tetor 1935, Tiranë, fq. 5.

59 Pak fjalë si nisje..., Gazeta "ABC", 1 mars 1936, Tiranë, fq. 1.

4.2 Shtypi i përdorur nga pushteti

Në faqet e shtypit të viteve 1930–1940 zhvillohet një betejë e vazhdueshme ndërmjet “të vjetërve” dhe “të rinjve”. Drejtuesi i revistës “Minerva” kishte shkëputur një vlerësim domethënës nga revista “Hylli i Dritës” në tetor 1935, që i kushtohej djalërisë shqiptare dhe rolit të tyre përmes shtypit.

“Shtypi është barometri që mat atmosferën e jetës së një vëndi, ai shqyrton e njeh të rrahurat e dejeve të gjallnisë së një populli; prandaj shtypi i jonë thekshëm u prek prej ksaj faze të jetës, edhe, ku sheshas, ku tërthoras çoi zërin, e fuqishëm qiti kushtrimin për krijesën e një atmosfere mendore të shëndoshë, për ngrehjen e një Shqipërie me zakone të shenjta, me vlera njerzore, ndër baza shpirtnore etj.”⁶⁰

Autori përpiket të tregojë se një pjesë e rëndësishme e gazetarëve e publicistëve të kohës ishin angazhuar maksimalisht për të bërë rolin e tyre në zhvillimin e Shqipërisë. Por një pjesë tjetër ishte konformiste me politikën e kohës, që ishte shumë larg aspiratave të brezit të ri. Një vlerësim për rolin e gazetarëve në atë kohë, e gjejmë në një artikull mjaft të rreptë dhe kritik në revistën “Rilindja”, që botohej në Korçë prej vitit 1934, me drejtues Pandi Frashërin.

“Shtypi i shitur.

Kemi pasur rastin të shkruajmë dëndur për shtypin kombëtar dhe jemi ankuar për dallkaukllëkun, gënjeshttrat dhe dobësitë e tyre. Me përjashtimin e disa artikujve me vlerë dhe të guximshëm, të shkrojtur nër gazeta dhe revista, shtypi kombëtar ka qënë dhe qëndron të jetë i papërgjegjshëm. Ky është kufizuar të mbrojë drejt për drejt ose tërthorazi, intereset personale të parazitëve dhe spekulantëve të vëndit tonë, është bërë mercenar i njerëzve në fuqi ose i atyre që përpiqen të zënë përsëri kolltukët. S’kemi gazeta politike independente që të punojnë për të mirën e këtij populli, por vetëm gazeta të shitura që u sigurojnë drejtorëve dhe redaktorëve të tyre të ardhura të majme.”⁶¹

60 Nebil Çika, Erdh Koha jonë por..., revista “Minerva”, tetor 1935, Tiranë, fq. 6.

61 Shtypi i shitur, gazeta “Rilindja”, 7 mars 1936, Korçë, fq. 4.

Nëse i referohemi këtij artikulli, duket se roli i shumë prej gazetave dhe revistave nuk kishte qenë transparent në pasqyrimin e ngjarjeve dhe situatave, por kishte rënë prë e propagandës qeveritare dhe e lakmisë së botuesve për të shtuar të ardhurat, në këmbim të misionit të medias.

Flitet për opinionin publik, po kurrë opinion publik i vërtetë është çfaqur, se ay që çfaqin gazetarët tanë, përgjithësisht është opinion i tyre ose i ndonjë klike që ata mbrojnë. Janë bërë dallaveret më të mëdha, vjedhje turpe dhe shtypi ka heshtur ose, edhe kur ka folur, e ka bërë për të bërë zhurmë, sensacion, i shtytur nga ndjenja jo të pastra, pa i sjellë as një dobi reale popullit, vetëm se e ka egërsuar këtë...⁶²

Do të ndalemi në një tjetër rast, ku shfaqen kontradiktat ndërmjet gazetave, lidhur me klientelizmin e medias dhe lirinë e saj. Gjejmë një përplasje ndërmjet gazetës “Besa” dhe gazetës “Arbënia”. Polemikë ndërmjet dy gazetave ndodhin pikërisht në kohën kur ndryshon qeveria, dhe në vend të një qeverie të cilësuar konservatore ose e “të vjetërve”, siç cilësohej sipas shtypit kabineti i Koço Kotes, vjen një qeveri liberale ose e të “rinjve”, e drejtuar nga Mehdi Frashëri.

Abdurrahman Dibra ishte një prej ministrave të qeverisë së drejtuar nga Koço Kote, që kishte mbajtur postin e ministrit të Financave dhe në këtë detyrë ishte akuzuar për abuzim me fondet publike. Me largimin nga kabineti qeveritar, Abdurrahman Dibra u rizgjodh deputet, por njëkohësisht investoi edhe për botimin e një gazete të quajtur “Besa”. Ajo ishte në opozitë të ashpër me qeverinë e re, të miratuar nga mbreti Zog, e drejtuar nga Mehdi Frashëri. Në një artikull të gazetës “Arbënia” me titull “Sofizmat dhe intrigat e “Besës”, në korrik 1936, përshkruhet “lufta” mes gazetave, si tipar i ri i medias së asaj periudhe.

“Që të bëjë opozitë dhe bile një opozitë të fortë kundra qeverisë organi i politikanëve të Yildizit, që u-rrëzua me aqë rreptësi më 21 Tetor, është një gjë fare e natyrëshme.

Ata njerëz humbën kolltukun definitivisht dhe ata e dijnë së ç’do me thënë “humbje kolltuku”. Bashkë me atë humbje, humbën edhe Arkën

62 Shtypi i shitur, gazeta “Rilindja”, 7 mars 1936, Korçë, fq. 4.

e Shtetit. S' ishte gjë e vogël! Prandaj justifikohet çdo opozitë. Por që të arrijë ky organ dhe të bëhet një organ reaksjonar i shtypit më të verdhë, të katandiset ky organ në dorën e një njeriu që, nga pasjoni dhe nakari kundra qeveritarëve të sotshëm, nuk zmbropset as para llogjikës, as para arsyes më elementare, as para evidences, këtë gjë s' e priste njeriu.

Ne e dinim, dhe bashkë me ne i gjithë populli shqipëtar, se klika e “Besës” është një rrezik publik, por shpresonim se me kalimin e kohës ata njerëz do t'i përshtateshin atmosferës shqipëtare; javash–javash shpresonim se do të orientoheshin dhe do të asimiloheshin me shumicën. Por, si ç' duket, shpresuam në të kotë! Dhe ja, nga një program i thjeshtë që Kryeministri përpiloi me të vetëmin qëllim që t'i shërbejë vëndit, vjen tashti “Besa” dhe, as pak as shumë, i trumbeton botës shqipëtare se Mehdi Frashëri shkel Statutin e Mbretërisë, kërkon krijimin e një pushteti tjetër legjislativ, kërkon krijimin e referendumit ose të plebishitit. Po nga i nxjerr këto gjëra njeriu, i cili kudo është mësuar të shofë “qëllime të errëta?”⁶³

Artikulli do të pasohej me kundërsulme nga gazeta “Besa” dhe debati ndërmjet tyre do të vazhdonte për disa muaj. Në këtë rast shohim qartë se të dy gazetatat duken larg misionit të tyre të shtypit të lirë. “Besa” finançohej nga një deputet, që kishte humbur kolltukun ministror dhe po kërkonte të ndikonte tek opiniononi publik për të rrëzuar rivalët e tij, qeverinë e Mehdi Frashërit, ndërsa “Arbënia” mbronte hapur qeverinë.

4.3 Ashpërsimi i censurës pas vitit 1936

Një artikull i revistës “Rilindja”, e përshkruan saktësisht situatën e shtypit shqiptar pas shpalljes së dekretit, që kishte në thelb censurën dhe kontrollin e organeve të shtypit.

“Këtë artikull e kishim përgatitur për botim në krye të Gushtit të vitit të kaluar, po, mbasi pas botimit të numrit 17 na u komunikua urdhëri që “Rilindja” më parë se sa të shpërndahet, duhet të shkojë në censurë

63 Gazeta “Arbënia”, “Sofizmat dhe intrigat e “Besës”, korrik 1936.

preventive, u nevojit ta lëmë mënjanë se kishim frikë mos rrezikonim jetën e Rilindjes s'onë. Sot po e botojmë pa i bërë as një ndryshim se na duket të ketë vleftë edhe për kohën e sotme, megjithse në kohën e qeverisë së vjetër efekti i tij do t'ish më i madh."⁶⁴

Në vitin 1936 situata me lirinë e shtypit do të përkeqësohej përsëri pas shpalljes së dekretit mbretëror, ku sanksionohej ndër të tjera se:

*"Ato fletore ose revista që me botimet e tyre mund të çënojnë sigurimin e interesit të brendshëm ose të jashtëm të shtetit dhe janë kundër regjimit, përkohësisht pushohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe kur e lyp nevoja, përgjegjësit burgosen apo i dorëzohen gjyqit."*⁶⁵

Pasojat e censurës, por edhe të vështirësive ekonomike me të cilat përballlej media e kohës, i gjejmë të pasqyruara në një tjetër artikull të Ismet Totos me titull: "Të heshtim?!". Artikulli tregon se si ishte reduktuar numri i gazetave e revistave dhe cilat ishin arsyet.

"Disa ditë më parë u shtypën, në këto shtylla, nja tre artikuj me radhë rreth gjëndjes së shtypit shqiptar, rreth kulturës së popullit dhe rreth gjëndjes psikologjike përgjithësisht. Dhe thamë se në gjithë Shqipërinë e 1936-ës kemi vetëm një gazetë të përditshme dhe një tjetër që del tri herë në javë. "Demokratia" është varfëruar dhe del kur i teket. "Gazeta e Korçës" është një azhans për lajmet e huaja. Kështu gazeta në një farë kuptimi janë vetëm dy. Një e përditshme dhe një tri herë në javë. Revista kulture-letrare e ekonomike (!) kemi vetëm një, e cila del një herë në muaj, është "Bota e Re", që shtypet në Korçë.

Pra, e gjithë Shqipëria e 1936-ës nuk ka veç se një gazetë të përditshme, një që del tri herë në javë dhe gjithsej një revistë të përmuajshme.

Pse gjithë kjo varfëri? i kemi dhënë dhe përgjigjet: a) Na ka mbuluar një apati, e cila duket sikur na ka gozhduar dhe s'na lë që të lëvizim e të veprojmë. Duket sikur gjithë ç'qe për të thënë u tha, dhe b) Sepse shtypi

64 Shënimi i redaksisë, revista "Rilindja", mars 1936, Korçë, fq. 4.

65 Dekreti: Cencura preventive mbi shtypin, revista "Rilindja", korrik 1936, Korçë, fq. 5.

nuk mund të qëndrojë mbi këmbët e veta financiarisht. Qarkullimi është i kufizuar dhe për rrjedhje shitja e paktë. Nga këto dy shkaqe edhe ai shtyp që ndihet sot qëndron më këmbë më tepër sepse drejtonjësit e tij s’kanë ç’të bëjnë tjetër veç se të botojnë ndonjë gazetë, sesa ka ndonjë qejf në të botuarit e një gazete sot për sot, ose sepse ka ndonjë leverdi financiare detyronjëse. Me një fjalë, qëndrojmë më këmbë me pahir.⁶⁶

Revista “Përpyekja shqiptare”, e drejtuar nga Branko Merxhani, u botua për herë të parë në tetor 1936. Ishte revistë e përmuajshme kulturore, shoqërore, filozofike, ekonomike, letrare. Përveç Merxhanit, në këtë revistë shkruanin personalitete të kohës si, Lumo Skëndo, Vangjush Nirvana, Aleksandër Xhuvani, Vedat Kokona e të tjerë.

Megjithëse kishte premtuar në editorialin e numrit të parë se “Përpyekja shqiptare” nuk do të merrej asnjëherë me politikë, Merxhani do të gjendej shpejt në mes të një debati tërësisht politik. “Unë nuk jam marksist!” është kryeartikulli i revistës së marsit 1937. Në të, Branko Merxhani i përgjigjet akuzave që vinin ndaj tij si mbështetes i ideve marksiste e komuniste.

“Unë jo vetëm se nuk jam anëtar i parimeve doktrinare të shkollës Marksiste, por jam edhe anti-komunist. Hem si një njeri –mendimtar, hem dhe bile shumë më tepër, si njeri-shqiptar. Jo vetëm në lëmin e shkoqitjeve teorike por edhe në pikëpamjet politiko-shoqërore të zhvillimit ndërkombëtar, unë nuk jam nga ata që pranojnë tezën se gjoja bota e qytetëruar e sotshme është ndarë në dy fronte ideologjike që luftojnë njëri tjetrin gjër në pikën e fundit. Bota e sotshme ashtu siç e shoh unë, është ndarë jo në dy, por në tre fronte ideologjike; pjesa e tretë, pjesa më e madhe, më e shëndoshë, më imponante, mbeti besnike ndaj parimeve të demokracisë përparimtare dhe kapërcen me fuqi dhe me vullnet të gjithë tronditjet dhe tërë nervozitetet që shkaktoi lufta ndërkombëtare e periodës 1914–1918 në strukturat shoqërore të popujve të mëdhenj që muarnë pjesë n’atë ndeshje më të tmerrshme të së gjithë historisë së njerzimit. Dhe jam i bindur se popujt e qytetëruar, popujt e mbrumur e të rritur brenda një tradite

⁶⁶ Ismet Toto, Të heshtim?!, gazeta “Arbënija”, 22 shtator 1936, Tiranë, fq. 5.

*të gjatë zhvillimi kultural, nuk mund ti sakrifikojnë për hir të një aksidenti katastrofal, siç është çdo ndeshje luftarake, liritë e tyre të shtrenjta dhe të shenjta për fitimin e të cilave derdhën pjesën më fisnike të gjakut të tyre bres pas brezi botëra të tëra. Kjo është bindja ime e patundur...”*⁶⁷

Revista “Përpkjka shqiptare” është një ndër mediat më cilësore të kohës, përsa i përket estetikës përmes së cilës i shfaqej lexuesve, rubrikave, por edhe cilësisë së artikujve. Konsiderohej një media me preferencë politike të krahut të majtë për kritikën e ashpra ndaj pushtetit, ndonëse në faqet e saj shkruanin edhe personalitete me bindje të djathta si Lumo Skëndo. Për këtë arsye, revista do të përballlej me një censurë të ashpër. Prej qershorit 1938, revista “Përpkjka shqiptare” u ndalua të botohej për katër muaj, me urdhër të Drejtorisë së Censurës.

“Akti i ndalimit

Dhjetor 1938 Viti i dytë i botimit, numri 18-24

Z. Branko Merxhani

Drejtor i revistës Përpkjka shqiptare

Zoti Drejtor!

Kemi nderin me ju njoftue se këshilli ministrues, me vendimin e tij, nr.711 datë 30.6.1938, ka vendosur ndalimin e botimit për katër muaj të revistës “Përpkjka Shqiptare” që drejtoni zotnija juej, për arsye se, në kundërshtim me deklaratimet në kërkesë dhe të përmbajtjes së lejes, në një artikull të numrit të fundit, ka përdorë fjalë diskredituese dhe asht përzie me çashtje fetare, tue shkel kështu qëllimin që ndiqet me revistat kulturore.

Me nderim

P. drejtor i Shtypit

*Halil Maçi (d.v)”*⁶⁸


Vendimi për ndalimin e botimit zuri vend në faqen e parë të numrit të revistës “Përpkjka shqiptare”, që doli katër muajsh pas dates së ndalimit me urdhër të Këshillit Ministror.

67 Merxhani Branko, Unë nuk jam marksist, revista “Përpkjka Shqiptare”, mars 1937, Tiranë, fq. 6.

68 Akti i ndalimit, revista “Përpkjka shqiptare”, dhjetor 1938, Tiranë. fq. 1.



Akti i ndalimit të botimit të revistës “Përpjekja shqiptare” nga Drejtoria e Shtypit (Foto: BKSH)



Editoriali i botuar tek “Përpjekja shqiptare” në lidhje me aktin e ndalimit të botimit (Foto: BKSH)

Reagimi i revistës tregon se gazetarët dhe drejtuesit e kanë gjykuar të padrejtë vendimin e censurimit. Situata sqarohet përmes një shënimi të redaksisë, ku analizohet akti shtetëror i ndalimit të revistës përmes një njoftimi, i cili botuesve nuk iu plotësonte kriteret zyrtare.

“*Dy fjalë këndonjësvet!*”

Në faqen e mëparshme kënduam tekstin e plotë të shkresës së drejtorisë së shtypit me të cilën na u njoftua ndalimi i revistës për katër muaj, nga shkaku se në një artikull të numrit të fundit paskemi përdorur “fjalë diskredituese” dhe jemi përzier në “çashte fetare”.

Meqënëse vendimi i mësipërm nga shkaku i të cilit u shtrënguar të ndalojmë botimin e revistës për një kohë kaq të gjatë, na dëmtoi ne, ashtu dhe juve, gjejmë veten tonë të detyruar tju themi dy fjalë rreth kësaj ngjarje të hidhur. Literatura zyrtare, ashtu siç përfaqësohet në tekstin origjinal të ndalimit, përbën frazeologji të mbyllur dhe lakonike dhe është e mangët edhe nga pikëpamja thjeshtë teknike. Shkresat zyrtare sidomos ato që kanë

të bëjë me shërbime të interesit publik, ashtu siç janë botime kulturore që i përgjigjen nevojave morale të vëndit, duhet ti respektojnë me një mënyrë shumë të kujdesshme, formalitet ligjore në fuqi, dhe të kenë një kjartësi shprehjeje rreptësisht korrekte. Shkresës sonë i mungojnë thujtjse të gjithë këto elemente:

Cili është ai artikull i numrit të fundit?

Si e ka titullin?

Në çfaqe të revistës është botuar?

Cilat janë ato “fjalë diskretitonjëse” që kemi përdorur?

Pse, ku dhe me çformë jemi përzier në çështje fetare?

Çfarë lloj vërtetimi ligjor i bëhet fajit tonë?”⁶⁹

Përmes këtij qëndrimi, Branko Merxhani dhe bashkëpunëtorët e tij dëshmojnë se nuk ishin vegla të bindura të pushtetit. Rezistenca e tyre përballë censurës është e dukshme në këtë reagim të menjëhershëm, që në numrin e pare, pasi iu rikthye e drejta e botimit.

4.4 Kritika dhe përplasjet mes organeve të shtypit

Në faqet e revistës “Bota e re” u rezervua një hapësirë edhe për kritikën në një rubrikë të veçantë, që titullohej “Gjykime mbi shkrime të botuara, faqja e kritikës”. Autori i artikullit merr shkas nga një rubrikë e gazetës “Illyria”, e cila kishte hapur një faqe të dedikuar si hapësirë për të rinjtë, por nuk e kishte “mbajtur fjalën”.

“Një punë e tillë ish me të vërtetë për t’u lavdëruar dhe “Bota e re”, sikur ta vazhdojë, do të kryej një detyrë të madhe që ka përpara djalërisë prej së cilës drejtohet, e të cilën përfaqëson.

Nuk mundem të them për të rinjtë e “Illyrisë” por për tanët e them pa u gabuar se punët letrare që bëjnë, e bëjnë vetëm se duan të punojnë, se duan ti shërbejnë vëndit. Janë shumë të rrallë ata që drejtohen tek fama e lëndat kur i drejtohen redaksisë tonë... Për këtë, ne vendosëm të flasim për veprat e

⁶⁹ Dy fjalë këndonjësvet!, revista “Përpjekja shqiptare”, dhjetor 1938, Tiranë. fq. 2.

vogla originale që do të botojë revista...”⁷⁰

Përplasjet ndërmjet gazetave e revistave, ose gazetarëve dhe botuesve të tyre bëhen të zakonshme edhe më vonë, si rasti i vitit 1939, kur u botua një artikull në revistën “Hylli i Dritës”, për cilësinë e gazetave e revistave. Në artikullin “Jehona e shtypit”, revista bën analizën e mediave të kohës dhe iu drejtohet me kritika të ashpra shumicës prej tyre. Kritika të shumta i adresohen gazetës “Drita”, për të cilën argumentohet se është gjysmë zyrtare dhe se i jep më shumë hapësirë lajmeve përtej kontinentit, se sa luftës së shqiptarëve ndaj varfërisë.

“Drita” xen vëndin e një fletorje gjysëm zyrtare. Vijon botimin me rregull e përditë. Asht e shtypun me shije. Çashtjet që i interesojnë ma fort e të cilave iu ban vënd ma shumë janë: ngjarjet e jashtme. Jeta e vëndit asht e kufizuese, problemet e vërteta të tokës tonë ndeshen aty këtu e zbërthimi i tyre duket i flashkët. Lexuesat e Shqipnisë interesohen ma fort për luftën e Kinës, se sa për luftën e bukës që përditë shkojnë tuj ba luftëtarët e katuneve tona të vorfnueme. ... Pse një gazetë e qitun në dritë vetëm për me duartrokitë punët e rralla të pëlqyeshme e me mshehë vepra të urryeshme asht një kazëm për vëndin tonë të vorfën për njerëz të mirë, të vorfën për punë të mira. Me qitë në dritë punëtorë të ndershëm, me përhapë vepra të lavdërueshme, me luftue mendsi të kqija, me tregue plagë e me rrfye mënyra shërimi: ky asht, ky duhet të jetë misioni i një gazete që don me bartë me meritim emnin e bukur “fletore parimesh nacionaliste”. Përgjithësisht në ktë muej nuk ndeshet ndonji problem shoqnuer i zgjidhun si duhet. Në vënd të Giordano Brunos e Savonarolës, (të cilët tingëllojnë si parathënie librash) do të kishte qënë mirë me botue heronjt e harresës sonë, aktet e indiferencës kundrejt atyne që kërkojnë kujdes e ndihmë. Krahinat nuk lshojnë ndonjë gja me të tërhjek vëmëndjen. Bjen në sy vetëm korespondenca me randsi: “Vepra produktive të kryeme në prefefekturën e Shkodrës”. Si penda të vlefshme dallohen Z. Shundi e Z. Kokona. ...

Zoti Shundi shkruan mire, pastër e rrjedhshëm. Kërkon e gjen problem. Vizaton me fjalë therëse mendësi e zakone herë me një kujdes të matun,

⁷⁰ Faqja e kritikës, revista “Bota e re”, janar 1937, Korçë, fq. 22.

herë me shpejtësinë e atij që nuk ka vizatim dhe vizatimin duhet ta bëjë.

Z. Kokona asht një penë e re, një vlerë e re. E shumta e refleksive është mresa të një shpirti që ndin...”⁷¹

Një tjetër gazetë, që merr kritika të lehta në këtë artikull është edhe “Cirka”, një gazetë kulturore, shoqërore, letrare, folkloristike e satirike, që botohej nga Gjon Ujka dhe drejtohej nga Cuk Simoni. Sipas kritikës që i bën “Hylli i Dritës”, ajo është një gazetë ku kanë gjetur vend për të shkruar pikëpamjet e tyre disa intelektualë që nuk e kishin këtë mundësi më pare dhe shumica e autorëve të “Cirkës” janë të një niveli jo të kënaqshëm për kohën, por edhe konformistë më pushtetin. Tek “Cirka” shkruhej zakonisht me pseudonime, si: Luvi, Rrencaku, Gimi, Lupi, FA-TI, Dora e harrueme, Sirena, Guri, Shkaba, Lisi, Donisa, Çiklisti i vjetër e me qindra të tjera, ndërsa autorë të përhershëm ishin Lazër Shantoja, Zef Jakini, Injac Ndojaj, Zef Topi, Aleksandër Sirdani, Hashim Koplikaj etj. Në të njëjtin artikull, renditen kritika edhe për “Gazetën e Korçës”, revistën “Diana”, revistën “Kombi” e të tjera, dhe shprehet vlerësim i lartë për gazetën “Demokratia”, e cila drejtohej nga Jorgji Meksi dhe kishte disa bashkëpunëtorë e autorë të shquar, mes tyre Branko Merxhanin e Vangjel Koçën.

“Fletorja “Demokratia”.

Shqipnia e vogël ka një gazetë të vogël. Asht gazeta ma simpatike e vendit tonë. “Demokratia” jeton një kohë e cila po sheh tue u zhvillue përpjekje që synojnë me e ba shqyptarin e lirë në tokën e vet. Kësaj çështje po i kushton papushum ngrohtësinë e zemrës, mjeshtërinë e mendjes, forcën e fjalës.

Ndërsa mbi letrat tona rrrhasin pena, krrusen shpina, vijon e ushqehet tipi i vasalit, i rajes, në “Demokratia”, e largët ndihet kushtrimi trimnuer, zgjidhen probleme te deja për njerëz të lirë.

Na tingëllojnë ende ndër veshë qortimet e forta të “baballarëve të kombit”, kur ata nuk ngurruen me shtue xhepat tue hecë me sy mbyll, me veshë mbyll syprri mjerimeve të një shoqniye, e cilla lypte bukë, vetëm bukë.

Thuaje çdo numër të “Demokraties” e ndjejmë si ahtine thellë të një shpirti të valavitun, si zanin e thekshëm të një dëshire për ndërtim si shfaqjen

⁷¹ Jehona e shtypit, “Hylli i ditës”, shkurt 1939, Shkodër, fq. 4.

ma të qartë të një guximi, që din me mposhtë frikën.

“Demokratia” ka një këndim mbi jetën: “Është turp të jetë njeriu i lumtur kur sheh rreth e rrotull të mjerë”. Ka një mision në jetën shqiptare: me çmure e naltue të mirën, me zbulue e luftue të keqen, me lshue fijen e një lidhnisë vllaznore. Hipokrizija e kohës sonë ka shpesh përballë sinqeritetin e ‘Demokratis’.”⁷²

4.5 Marrëdhëniet mes redaksive dhe komunikimi me lexuesin

Ndonëse disa prej gazetave ishin në rivalitet të vazhdueshëm, shumë të tjera patën marrëdhënie korrekte bashkëpunimi, madje i vijnë në ndihmë njëra-tjetrës në shumë situata të vështira, siç ndodhte shpesh kur mungonte baza materiale apo punonjësit. Një pjesë e madhe e autorëve shkruanin njëkohësisht në më shumë se një organ shtypi dhe ishin inkurajues ndaj botuesve për përhapjen e shtypit në të gjithë territorin.

Në prill të vitit 1936 doli numri i parë i revistës “Bota e re”, e përdyjavshme kulturore, letrare, shoqërore, ekonomike në gjuhën shqipe. Revista që botohej në Korçë, me drejtor Gaqo Evangjelin, u prit me entuziazëm edhe për shkak të një stili të ri, nga forma dhe përmbajtja. Gazeta “Arbënia” i kushtoi një artikull të veçantë revistës së re.

“Mund të themi pa asnjë hezitim se, si numër i parë, revista e re paraqitet mjaft mirë, e shëndetshme dhe e pozuar mirë. Në faqet e saj sundon një frymë serioziteti. Duket se ata që shkruajnë, nuk janë më kalamajtë, që kanë qejf të shkruajnë në revista për qejfin e madh që të duken! Në faqet e “Botës së Re” përgjithësisht gjënden artikuj të shkruar nga “të rinj” plot seriozitet, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje. Për ta thënë më shkurt, duket qartazi se këta që botojnë revistën e re të Korçës, kanë një vullnet të ngulur për një punë serioze. Kjo na gëzon. Aq më tepër sepse kjo revistë del tamëm në Korçë, në

⁷² Jehona e shtypit, “Hylli i ditës”, shkurt 1939, Shkodër, fq. 4.

*këtë qytet me rëndësi të madhe, të cilit i ka hie të ketë organe serioze, organe që të mos i kontribuojnë vetëm ndriçimit të mendimit në Korçë, por duke shikuar çdo punë nga një pikëpamje kryekëput kombëtare, të kontribuojnë për të ndriçuar të gjithë mendimin shqiptar. Dhe na jemi nga ata që besojnë me këmbëngulje se djalëria korçare, përgjithësisht e lirë nga paragjykimet e traditës, mëndjehapët, përparimtare dhe e fuqishme, ka mundësira, qoftë me anën e kësaj reviste, qoftë me aktivitete të tjera, t'i shërbejë tërë shoqërisë shqiptare dhe të mbajë të ndezur me një flakë madhështore idealin e madh të Atdheut”.*⁷³

Ishte një kohë kur po bëheshin përpjekje serioze për të avancuar në zhvillimin e medias së shtypur, qoftë përmes formës, faqosjes më të kujdesshme të gazetave e revistave, qoftë edhe përmes përmbajtjes. Ndër të tjera ka një përpjekje të shtypit për të komunikuar apo bashkëpunuar me lexuesin. Në një prej numrave të saj në korrik 1937, revista “Bota e Re” botoi një artikull ku kërkonte nga lexuesit që, përmes letrave të dërguara në redaksi, të paraqisnin përshtypjet për cilësinë e revistës, temat që trajtoheshin aty dhe cilat prej tyre do të ishin me interes që të vazhdonin më tej botimin, pra të jepeshin më shumë informacione rreth asaj teme.

Por, pavarësisht përpjekjeve të disa botuesve për të sjellë risi në mediat e tyre, censura ishte një prej arsyeve kryesore që e goditi fort rolin e shtypit në kohën e Monarkisë. Në këtë periudhë, sidomos pas vitit 1934 vihet re një zvogëlim i numrit të organeve të shtypit brenda Shqipërisë dhe një rritje e konsiderueshme e gazetave e revistave jashtë kufijve, sidomos në Evropë dhe SHBA, ndër të cilat “Dituria” e Lumo Skëndos në Bruksel, “Dielli”, organi i shoqërisë “Vatra” në SHBA. Deri në vitin 1944 në Itali ishin botuar 13 organe shtypi, ndërsa 11 të tjera në SHBA.

Një pjesë e madhe e gazetave dhe revistave që vazhdonin të botoheshin në Tiranë, ishin organe të ministrive apo institucioneve shtetërore. Vetëm pak revista, kryesisht kulturore, kishin mundësi të

⁷³ Gazeta “Arbënia”, 16 shtator 1936.

botoheshin duke ju shmangur censurës. Ndër to ishin edhe disa revista me përmbajtje fetare dhe letrare “Leka”, e përmuajshme e klerit katolik dhe “Mësuesi” me drejtues Gaspër Mikelin, e cila ishte një revistë që botonte edhe artikuj për arsimin.

Pothuajse të gjitha ministrinë kishin organin e tyre, ku botoheshin artikuj informues, studimorë, shkencorë. Disa prej tyre ishin mjaft voluminoze, me deri 200 faqe dhe me cilësi shumë të mirë shtypi. Për herë të parë u botuan të dhëna kërkimore-shkencore rreth popullsisë si Censuri i vitit 1938, si dhe rreth pasurive natyrore të Shqipërisë, pyjeve, kullotave, tokave bujqësore etj. Në shumë prej tyre përkthehej literaturë e përzgjedhur për profesione të ndryshme, që kishin filluar të ushtroheshin në Shqipëri.

Numrin më të madh të organeve të shtypit, të botuara nga institucionet, e zinte fusha e arsimit me buletinet e ministrisë⁷⁴, por edhe organet e shkollave profesionale si “Normalisti” i shkollës Normale të Elbasanit, apo “Laboremus” i Shkollës Teknike në Tiranë. Në to hodhën hapat e parë në publicistikë dhe letërsi emra shumë të njohur, që do të shkëlqenin vitet e ardhshme si: Sterjo Spasse e Beqir Haçi.

4.6 Psuedonimet e disa autorëve në median e shkruar

Censura ndaj medias solli pasoja në funksionimin e shumë prej redaksive. Dhjetëra revista e gazeta u mbyllën, ndërsa ato që rezistuan duhet t’i përshtateshin klimës që ishte krijuar për të mbijetuar. Gjatë kësaj periudhe u vu re shtimi i pseudonimeve që përdornin autorët për të mos pasur përballje të drejtpërdrejta me organet ligjzbatuese.

Pseudonimet ishin përdorur masivisht që para vitit 1913, fillimisht për t’iu shmangur përndjekjes nga armiqtë që nuk e donin pavarësinë e Shqipërisë. Më pas pseudonimet vazhduan të përdoren për t’iu

74 “Revista Pedagogjike” ku trajtoheshin shkrime rreth pedagogjisë, didaktikës, edukimit; “Edukata e Re”, revistë pedagogjike; “Drini”, buletin i përmuajshëm i turizmit shqiptar etj.

shmangur autoriteteve shqiptare. Përveç autorëve që përndiqeshin, kishte dhe mjaft të tjerë që shkruanin me pseudonym, sipas stilit të mjaft shkrimtarëve dhe gazetarëve në Evropë, duke dashur ta veçojnë emrin real me atë në fushën e krijimtarisë, apo për të mos e bërë publik informacionin rreth jetës private.

Disa prej autorëve të shquar shqiptarë i kishin krijuar pseudonimet e tyre sipas emrave të vendlindjes, apo siç njiheshin nga rrethi i tyre i ngushtë, duke krijuar një *brand* që ishte vështirë ta ndryshonin. Shumë nga autorët që përdorën pseudonime, shpesh i ndryshonin sipas medias ku shkruanin, apo periudhës historike, si Faik Konica (Tepeleni, Trans Spiro Beg, Spiro Beg Konitza, Faik Berga i Konicës, Hasan Aga, Dreqtori, Rrapo Palla), Luigj Gurakuqi (Jakim Shkodra, Lekë Gruda, Hamidi, Pjetri e Pali, Marash Ujka), Fan Noli (Namik Namazi, Theofan Mavromati, Bajram Domosdova, Ali Baba Qyteza, Robo Rrogoshina, Diximus, Pesimisti), Zoi Xoxe (Gjon Muzaka, Ballsha, Alo Bardhi, Gramafoni i prishur, Myzeqari, Pehlivani, Mino Ballsha, Alo Ballsha), Nonda Bulka (Chri-Chri, Na-Na, Sti-Sti, Gër, Qef Gërjepi, Epaminonda), Vangjel Koça (Vangjo Nirvana, Knishta, Bliri, Narcis Vana, Viroi, Tiberius, Nirsha) etj.⁷⁵

Pseudonimet në gazetatat dhe revistat që shtypeshin në Shqipëri, i gjejmë kryesisht në shkrime letrare (organe letrare), te “Cirka”, një revistë kulturore, shoqërore, letrare, folkloristike, satirike, që botohej në Shkodër në vitet 1936-1939, ku autorët kanë shkruar me

75 Disa pseudonime tek gazeta javore “Dielli”, botuar në Boston nga shoqëria shqiptare “Besa-Besën” me drejtor Kristaq E. Floqi, gazetë politiko-kulturore, organ i Shqiptarëve të Amerikës: Një Prevezan, Atdhedashësi, Mal i Ivanit, Shkëmb i Mbletës, Pushka, Pellasgu, Fillonjës i një Shoqërie, çmërshi, Kryengritësi, Shkëmb i Mbletës, Një shqiptar atdhedashës, Kryengritësi, Ujku Plak, Qaf e Thanës, Buni, Shkumbini, Nemërçka, Dhodhona, Vardhari, Akrepi, Qytetari, Stapi, Morava, Gramos, Një nacionalist, Dhuronjësi, Iliriani, Veritas, Tivari, Mustafazi, Atdheu, Brozoveci, Morava, Myzeqari, Shkaba, E Vërteta, Jugori, i bir’ i Guçes, Dodani, Autokefalisti, Vindex, i pakënaquri, Babaliti, Bir Qyteti, X, Vatrani, Toska, Y, Orthodoxi, vezhgonjesi, Vatrani, Udhjetari, Nomegra, i mallëngjyeri, Bostoniani, mushkonja.

më shumë se 200 pseudonime.⁷⁶

Një shëmbull ilustrues është ai i Ismet Totos, që përdori pseudonimet: Borealis, Aurora, Dinamikus, Polifemus, Neo, Arbëreshi, Arbënia, Periskopi, Tomori, Plaku, në revistën “Minerva”, “Illyria”, “Përpyekja shqiptare”, “Ora”, “Hylli i dritës”, “Ora e Maleve” dhe “Arbënia”. Ismet Toto do ta vazhdonte aktivitetin e tij intensiv si publicist deri në fund të vitit 1936, më pas ai do të angazhohej në disa detyra në qeverisjen e kohës për të mbërritur në momentin final, kur do të akuzohej e më pas të dënohej me pushkatim nga mbreti Ahmet Zog.

Et’hem Toto, vëllai i madh i Ismet, Tahsim e Selahudin Totos, ishte pjesë e administratës së Monarkisë, por në rrethanat ku ndodhej ai mendonte se po qeverisej me korrupsion dhe paaftësi dhe kështu vendosi të udhëheqë një kryengritje të armatosur në jug të vendit. Në këtë vendimmarrje Et’hemi u mbështet edhe nga vëllai i tij, Ismet Toto. Kryengritja e Delvinës u shtyp nga xhandarmëria. Menjëherë pas kësaj ngjarjeje, Monarkia vendosi dënimin me vdekje të Et’hem e Tahsim Toto, bashkë me xhaxhanë e tyre Arif Toto. Pak kohë më vonë, në korrik të vitit 1937, u dënua me varje në litar edhe Ismet Toto, i cili u dënua për shkak të aktivizimit të tij politik, por gjithsesi në këtë punim është trajtuar si gazetar për kontributin që ka dhënë në mediat shqiptare. Pavarësisht se u dënua për shkak të aktivizimit të tij në politikë, ai është viktima e parë në rradhët e gazetarëve shqiptarë.

4.7 Stacioni i parë radiofonik në Shqipëri, Radio Tirana

Më 28 nëntor 1938, në përvjetorin e 26-të të pavarësisë së Shqipërisë, filloi transmetimin e para radio në Shqipëri, Radio Tirana. Në ceremoninë e inagurimit ishte i pranishëm edhe mbreti Zog, i cili

76 Pseudonime të përdorura në revistën “Cirka”: Malësori, Mizor, Sadamog, Alkri, Brutus, Minimus, Alauda, Primula, Prometheus, Shkaba, Mazi, Sirena, Andrruesi, Siberius, Sirena, Gjilam, Elsa, Guri, Topija, Donisa, Rita, Pirajka, Largpasi, Beqari, Ag-zot, Firsi, Ignotus, Donica, Silvanus, Olaf, Harbuti, Zaks, Inaruk.

mbajti një fjalim, ku e konsideronte këtë ngjarje shumë të rëndësishme për “Zhvillimin e kulturës dhe vllaznimit e racës shqiptare”. Aktivitetit iu dha një hapësirë e rëndësishme edhe në shtyp.

“Me çeljen e këtijë stacioni u plotësua me sukses një mungesë e dukshme. Shqipëria ishte i vetmi shtet i Evropës pa një stacion të tijën. Është e vërtetë se shërbimin e lajmeve në gjuhën shqipe e kryente me mirëdashje radiostacioni i Barit me shërbimin e tij të përditshëm e gjithashtu me emisione të rralla koncertesh, por këto nuk mjaftonin.”⁷⁷

Drejtori i Radio Tiranës u emërua Gjergj Bubani. Fillimet e Radio Tiranës lidhen me emra të shquar të kulturës e artit shqiptar të asaj kohe, si Marije Kraja (soprano), Tonin Guraziu (pianist), Tefta Tashko Koço (soprano), Merita Sakoli (soprano), Lola Gjoka (soprano), Dhora Leka (redaktorja e parë), Kaliopi Plasari (spikerja e parë), Haki Bejleri (spikeri i parë), Viktori Xhaçka, Kristaq Andoniu, Sterio Spase, Mihal Popi, Besim Lubonja, Gjergj Bubani, Vasfi Samimi, Mihal Ciko, Anton Mazreku etj.

Fillimisht Radio Tirana transmetonte vetëm 3 orë, kryesisht muzikë patriotike e popullore shqiptare nga disqet e gramafonëve të dhuruara prej qytetarëve. Ndërsa një vit më vonë e shtoi programacionin në 11 orë, duke transmetuar muzikë, lajme në gjuhën shqipe dhe 6 gjuhë të huaja. Gazeta “Drita” e datës 30 nëntor 1938 publikoi programacionin e pare të Radio Tiranës.

“Ora 13:00, ora ekzakte, në fjalë me dëgjuesit; 13:10, radiofletore; 13:25, muzike e lehtë; 14:00, mbyllja e emisionit. Në mbrëmje: ora 19:00, ora ekzakte; 19:02, zoti Rrok Gera, ministri i ekonomisë kombëtare çel vargun e konferencave radiofonike; 19.15, muzikë koncertesh; 20;00, radiofletore; 20.15, muzikë vallëzimi; 20.45, mbyllja e emisionit.”⁷⁸

Në vitin 1939 Radio Tirana filloi të botonte edhe një revistë me të njëjtin titull në shqip dhe italisht me përmbajtjen e programacionit. Në

77 Inagurimi i Radiostacionit, “Gazeta e Korçës”, 30 nëntor 1938, Korçë, fq. 5.

78 Programacioni i Radio Tirana, Gazeta “Drita”, 30 nëntor 1938, Tiranë, fq. 8.

fillim titullohej “Radio Tirana”, më pas do të quhej “Vatra Shqiptare”.

Një ndër momentet më të rëndësishme, që u përcoll në mikrofonin e Radio Tiranës, është data 7 prill 1939, kur pushtuesit italianë zbarkuan në Shqipëri. Kryeministri Mehdi Frashëri iu drejtua popullit nga valët e Radio Tiranës, ku i bënte thirrje të ngrihej në luftë për të mbrojtur vendin nga pushtuesit italianë.

4.8 Studimi i parë për median shqiptare

Në vitet ‘30 Shqipëria kishte një popullsi rreth 1,2 milion banorë dhe numri i gazetave në raport me popullsinë ishte i konsiderueshëm. Gjatë viteve 1924-1928 botoheshin rreth 60 gazeta e revista, ndonëse shumica e tyre ishin buletine të institucioneve qeveritare. Padyshim, jo të gjitha organet e medias ishin në standardet e duhura, përse i përket cilësisë së përmbajtjes, informacionit dhe raportimeve të gazetarëve, por shumë prej atyre ku shkruanin intelektualët e kohës, bënë hapa të rëndësishëm përpara.

A kishin fituar lexuesit e tyre këto gazeta dhe revista? A po krijonin një audiencë të përhershme? Studiuesi francez, André Ravry, ka udhëtuar në Shqipëri në vitin 1939 për të hulumtuar historinë e shtypit shqiptar prej fillimeve deri atë vit. Në “Revistën e Shkencave të Shtypit të Parisit”, ai tregon detaje të funksionimit të shtypit. Sipas Ravry, shtypi i shkruar rivalizohej nga një tjetër medium, që ai e cilësoonte si “shtypi i folur”. Bëhej fjalë për bisedat e banorëve nëpër qendrat publike: kafene, pazare, apo organizime të ndryshme shoqërore. Studiuesi francez kishte vënë re se, megjithëse shumë shqiptarë preferonin të informoheshin nga bisedat mes tyre, gazetat mbërrinin deri në fshatrat më të thella malore dhe kjo tregonte një rritje të interesit të shqiptarëve për median, pavarësisht analfabetizmit apo varfërisë.

“Në një vend me 1.2 milionë banorë, gazetat periodike nuk mund të pretendojnë të shiten në masë, sepse ky vend ka ruajtur disa tipare orientale, ku gazetat e botuara kanë përballë tyre një konkurent të fortë,

*“shtypin e folur”, i cili praktikohet në kafene dhe pazare. Gjithsesi, mund të konstatojmë, se gazetat arrijnë shpejt deri në fshatrat më të izoluar dhe shohim shpesh, këto kohët e fundit, fshatarë të rinj, të cilët kishin sjellur prodhimet e tyre në treg dhe marrin gjatë rrugës së kthimit për në malet e tyre gazetat e gjithë javës”.*⁷⁹

Disa statistika rreth të dhënave që janë mbledhur për shtypin e atyre viteve na tregojnë për një farë zhvillimi të arsimit përmes rritjes së numrit të shkollave nga viti në vit.

*“Shohim e dihet se interesat shkollore ndryshojnë prej gegnisë në toskni. Kemi vue re se prej Shkumbinit e teposhte, janë të çiluna 378 shkolla shqipe dhe prej Shkumbinit e përpjete janë të çiluna 124 shkolla; pra 254 shkolla fillore ma tepër janë në Toskni”.*⁸⁰

Në artikullin e gazetës “Ora e Maleve” raportohet, se shkollat po hapen jo vetëm nëpër qytete, por edhe në fshatra më të thella malore. Në një prej zonave më të thella të Shqipërisë, në Nikaj Mërtur, në fshatin Gjonpepaj të kësaj krahine, u hap shkolla e parë shqipe në vitin 1918.⁸¹

Tashmë edhe fshatrat më të largët, kishin disa banorë që dinin shkrim e këndim dhe gazetat e revistat filluan tëmbërrinin në të gjithë vendin. Gjetjet e studimit francez kanë një rëndësi të veçantë, për shkak se është ndër të paktat studime që janë shkruar në atë kohë për historinë e medias shqiptare. Përveç kësaj studimi i André Ravry meriton vlerësime të larta, sepse vjen si njëprodukt i hulumtimit në terren.

79 André Ravry, Historia e shtypit shqiptar, “Revista e Universitetit të Shkencave të Shtypit të Parisit”, korrik – shtator 1939, Paris.

80 Shqynia nëpër shkollë pret dritë, “Ora e Maleve”, nëntor 1924, Shkodër, fq. 5.

81 Bekim e të çelun shkollë në Gjonpepaj”, “Posta e Shqypnisë”, 29 maj 1918, Shkodër, fq. 5

Parashtetja: Për të qenë i aftë të lexosh...
abc... 1 Mars 1938
 E përdorueshme letrare, shoqërore, ekonomike
NË KET NUMER:
 PAK FIALE SI NJISJE...
 Problemet e Djalëris
MORATORIUMI
 Hurra! Mbi Arken e Shtetit
HALLET E DITËS
 Per një Luftë Reale
SHENIME & NGJARJE etj.
 1 Lek. **Copa**

bleta (Drejtues: Ibrahim Lika, redaktor: Adnan Duraku)
 Nr. 116 - 17.000.000 - DREJTORE: BIRAZI, ADMINISTRATOR: DR. ÇABRANOVIÇ, TIRANË 101, VITE 1938
Kush do t'a mbyllë «bletën»?
 Për të shprehur mendimet...
GOMARI
 A...
 Të shprehur mendimet...
 1 Lek.

Bota e Re
 E Përdorueshme Kulturale
PËRMBARTET:
 BOVA E R.E., SHABITI, SHAN DHE, BURE YGJEL, N. ÇEKESIA, SHAN DHE, SHER, FANIS, N. HAKI, D.H. SHETERZI, MERRISIN, S. PARASTI, N. HAKI, VARRI, MERRI, M. S. TOSKA.
 1 Lek. **CRINI I LEK** 30 GJESH 1938

LABORËMUS
 Nr. 1 Vol. VI 1 Novimbar 1938
 Kupa e Artit
 1 Lek.

Perkohemja Sahutë Malsis Vegjë e djelmurisë Çqiptare
 MANASTIR Çiftçiu në shtet, Beshik Kombit
 1 Lek.

RADIOTIRANA
 ADIOPROGRAM
 1 Lek.

SHEKULLI XX
 RIVISTE LETRARE, SHKENCORE E FIDELITZIME
 Nr. 153 TIRANË, 15 SHTATUER 1938 VIII II.
 Kupa e Artit
 1 Lek.

SHQIPTARKA
 N. S. PRINCESHA SENJUE
 1 Lek.

Jeta dhe kultura
 Horonjë e seshëm
 Torrence Çetani i shokëve në luftë të gjatë
 1 Lek.

Kopertinat e disa prej gazetave dhe revistave që shtypeshin në Shqipëri deri në vitin 1939. (Foto: BKSH arkiv)

V. MEDIA SHQIPTARE GJATE PUSHTIMIT (1939–1944)

5.1 Reduktimi i numrit të gazetave e revistave pas pushtimit fashist

Më 7 prill të vitit 1939, Shqipëria u pushtua nga Italia Fashiste, ndërsa mbreti Zog u largua nga Shqipëria. Në këtë kohë, shtypi shqiptar pësoi një tjetër tronditje. U mbyllën disa gazeta dhe revista që atëherë cilësoheshin si të pavarura. Ndërkohë u shfaqën disa gazeta të reja, që kishin mbështetje nga fashistët.

Kështu, gazeta “Drita”, e përditshmja e Tiranës, do të zëvendësohej nga gazeta “Fashizmi”, organ i Partisë Fashiste Shqiptare. Gjatë vitit 1940 e në vazhdim në Shqipëri botoheshin revistat: “Shkëndija”, “Tomori i Vogël”, “Tomori”, “Vatra shqiptare”, “Roja Komtare”, “Fryma”, “Kritika”, “Bleta”, “Njeriu”, “Leka”, “Kultura Islame”, “Lirija e Shqipnisë” etj. Revista “Shkëndija”, ishte e përkohshme letrare dhe artistike në gjuhën shqipe, por edhe me disa faqe në gjuhën italiane dhe drejtohej nga Ernest Koliqi dhe Selahudin Toto. Në numrin e parë të korrikut 1940, shkruanin Lasgush Poradeci, Mustafa Kruja, Pashko Gjeçi, Vangjel Koça, Karl Gurakuqi, Vedat Kokona, Et’hem Haxhiademi e të tjerë. Në parathënie, artikullin e saj të parë, sqarohet se e përditshmja ishte letrare, artistike dhe jo politike.

Vangjel Koça ishte një ndër bashkëpunëtorët e kësaj reviste. Veçojmë një ndër artikujt e tij, i titulluar “Një monument i kulturës

shqiptare, Hylli i Dritës”, ku përmenden disa prej gazetarëve që kishin kontribuar në shtypin e viteve ‘30, duke veçuar sakrificat e tyre.

“Një monument i kulturës shqiptare “Hylli i Dritës”.

...Në një të tillë kohë-kohëçapësh drithmarake në errësi të Shkodër po vetëtinë një kandil shqiptar, kandili i “Hyllit të Dritës”, së fretënvet françeskanë të kuvendit të Teutës. Ç’po bëjnë këta dishepuj të mirë të Asisiatit? Kanë një botkuptim të tyre, botëkuptimin vërtetë katolik por shqiptar dhe oksidental kurse botkuptimi muhamedan e ortodoks bie erë Stamboll e Athinë si frymë kombëtare e qytetërimit.

Shkodra i jepte Shqipërisë dhe po i jep akoma revistën që duhet.

Në krah të “Hyllit të Dritës” mund të qëndrojnë denjësisht e me plot të drejtë, “Albania” e Faik Konicës, “Përpyekja shqiptare”, “Leka”, “Illyria” e Ismet Totos dhe ndonjë revistë tjetër jetëshkurtër.

“Hylli i dritës” nisi të shpërndajë dritën e saj jetëdhënëse në një kohë kur Shqipëria po përpëlitej në mundimet e një shteti të sapolindur dhe në qarkun e ngushtë e të mbyllur të një kulture orjentale e ballkanike, e cila nuk shihte dot më tej nga “Muameleja” e zyrës edhe nuk e kapërcente dot kufirin e një retorike patriotike të bukur, po të zbrazët. Sa për idera, hove, frymëzime-u lamë!”⁸²

“Hylli i Dritës” kishte nisur të botohej qysh në vitin 1913. Ishte një revistë e klerit katolik me lëndë fetare, kulturore, filozofike, juridike, letrare, shoqërore, gjuhësore, folkloristike, por ku pasqyroheshin edhe lajmet e kohës. Revista ishte themeluar nga At Gjergj Fishta dhe në këtë organ shtypi kishin shkruar gjithashtu At Gjon Shllaku, At Benedikt Dema, At Anton Harapi, At Antonin Fishta, Eqerem Çabej etj. Sipas një shënimi të kësaj reviste të vitit 1941, “Hylli i Dritës” është drejtuar prej At Vinçens Prennushi në vitet 1921-1924; prej vitit 1930-1936 e drejtoi At Anton Harapi; prej shkurtit 1937- qershor 1938, e drejtoi Antonin Fishta; prej korrik 1938 - korrik 1939 e drejtoi Gjon Shllaku; prej gusht 1939-1941 e drejtoi Benedikt Dema. Në vitet e para të botimit të kësaj reviste kishte shkruar edhe Luigj Gurakuqi.

82 Vangjel Koça, Një monument i kulturës shqiptare-“Hylli i Dritës”, revista “Shkëndija”, korrik 1940, Tiranë, fq. 4.

Rikthehemi tek revista “Shkëndija” me artikujt kushtuar krizës që po kalonte shtypi në vitin 1940, dhe që do të thellohej vitet në vazhdim. Në numrat e revistës “Shkëndija” iu dha hapësirë e dedikuar sfidave të shtypit, përmes historisë së disa revistave, apo gazetave më të suksesshme.

Një prej tyre ishte artikulli i Nebil Çikës për historinë e revistës “Minerva”, që tashmë ishte e mbyllur. Në disa numra të revistës “Shkëndija” në vitet ‘40, ai do të shkruante mbi betejat e tij për të botuar disa prej organeve, që kishte drejtuar apo kishte punuar për to në rreth 15 vite. Një prej këtyre artikujve në dhjetor të vitit 1944, titullohej “Veprimtaria e Minervës”.

“Më 21 janar 1931, fletorja “Arbënija” që nxirrja, u mbyll prej qeverisë pas artikullit të bujshëm “Ave Parlament”. Ishte e treta herë që mbyllej, e pra sipas fjalës: e treta e vërteta”. Unë kuptova se ndofta për një kohë shumë të gjatë, nuk do të kisha më leje për të botuar një gazetë. Mirpo e kisha pasion gazetarinë dhe smund ta leja. Prandaj, desha s’desha, e lashë të kalojnë nja tre muaj gjër sa të ftoheshin gjakrat, kërkova leje për të botuar një revistë kulturore mujore të ilustruar, pasi ndjehej nevoja e një reviste të këtillë... Kërkova një subvencion mujor prej 300 frangash dhe një paradhënie 900 frangash për të filluar nga puna. Kërkesa m’u pranua pas dy muajsh. Qe vetë Musa efendija, ministri i brendshëm që ma komunikoi pranimin. “Sa për 900 frangat paradhënie, më tha, këto ditë skam të holla, duku një herë pas nja dy javësh.”⁸³

Çika tregon më tej, se do të kalonin 18 muaj përpjekje, mashtrime e zhgënjime deri sa t’i pranohej leja për të botuar “Minervën”. Ndërsa në numrin tjetër do të shkruante për një tjetër etapë të “Minervës” deri tek numri i fundit, që sigurisht kishte pasur një presion për t’u mbyllur, siç kishte qenë historia me gazetën “Arbënija”.

Në një prej numrave të revistës “Shkëndija” gjendet një artikull kortezie, kushtuar ndarjes nga jeta të gazetarit të njohur Vangjel Koça.

⁸³ Nebil Çika, Veprimtaria e “Minervës”, revista “Shkëndija”, dhjetor 1944, Tiranë, fq. 13.

“Një lajm i papritun: Vangjel Koçës iu qep vdkeja papandehun edhe tragjikisht mbaroi midis dallgëve t’Adriatikut!

Tërbimi i njeriut dhe pafundësia e detit i gëlltinë përgjithmonë një nga fytyrat mendore ma të njoftuna të Shqipnisë. Pa u rrëmbye nga klithma e së shoqes edhe të birit të tij, pa u stepun as nga tronditja e vetë-vetishme, që na shkaktoi lajmi i pikëlluem, ne sot na dalin para vetëm e mira të të ndjemit e na bajnë me reflektue tek ato Vangjelin e letrave tona, Vangjelin e gazetarisë, Vangjelin e mendimit shqiptar.

Vangjel Koça ka pjesën e vet në botën mendore shqiptare njëzet-vjeçare, që ka lëvruë herë me hove gati të tulatuna, herë me hove mesatare e herë hove të përhedhuna: e gjejmë te gazeta “Drita”, të Veli Hashrovës, mandej i jep jetë gazetës “Demokratia” të Gjirokastrës edhe gatuen e brumos, kristalizon, lufton, zbulon e shtron mendimin shqiptar në zenitin e vet intelektual të revistës “Illyria”, te “Minerva”, te “Përpyekja shqiptare” e gjetiu.”⁸⁴

“Revista Letrare”, e themeluar nga Mitrush Kuteli me drejtor përgjegjës Vedat Kokonën, filloi botimin e saj dy here në muaj në Tiranën e vitit 1944. Ishte një revistë me përmbajtje letrare, folkloristike e kulturore, që kishte ftuar të shkruanin në faqet e saj autorë të njohur si Nexhat Hakiu, Sterjo Spasse, Ali Asllani, Aleksandër Xhuvani etj. Revista ishte e fokusuar më së shumti tek letërsia, ku zinin hapësirë shkrimtarët shqiptarë dhe ata të huaj, por përmbante edhe artikuj që trajtonin problematikën e shoqërisë shqiptare të kohës. Një rubrikë e dedikuar me titull “Dje dhe Sot” ishte hapësira për kritikën, që autorët e kësaj reviste ia adresonin shoqërisë shqiptare. Në artikullin “E Vërteta!”, të botuar më 1 maj 1944, analizohen arsyet e analfabetizmit në Shqipëri dhe fenomenet që e kishin stimuluar atë në 100 vjet, ndërkohë që vlerësohet figura e mësuesve për sakrificat që bënë, sidomos në kohën e pavarësisë.

“U desh që arësimtari të krijonte nga hiçi një kështjellë, ndërsa injoranca dhe fanatizmi, mendësia prapanike orientale e mbështetur dhe e përkrahur nga axhikatorët dhe intrigantët, të stërvitur në të tjera kohë të historisë së

84 Vangjel Koça, revista “Shkëndija”, gusht 1943, Tiranë, fq. 25.

Shqipërisë, ia pengun shumë veprën e tij heroike për të ringjallur në jetën kolektive cmirën dhe urrejtjen e ndasive të ndryshme antikombëtare, se në këtë mënyrë do të spekulonin më vonë mbi efektet e tyre në kurriz të solidarisë dhe të unitetit kombëtar. Mirpo guximi i pashoq dhe zelli i çeliktë që kanë karakterizuar arsimtarin në vjetët e pavarësisë për një lartësim kombëtar-shoqëror të popullit tonë, mbeten të papërlyera edhe sot tu drejtojmë mirënjohjen tone.”⁸⁵

5.2 Idetë komuniste në media

Gjatë Luftës II Botërore, Shqipëria ishte një vend i rënuar nën regjimin ushtarak të diktuar prej pushtuesve nazi-fashistë. Media do të dëmtohej nga kjo situatë dhe shumë gazetarë të shquar të viteve ‘30 do të largoheshin nga Shqipëria, ndonëse disa prej tyre nuk e ndaluan veprimtarinë e të shkruarit.

Në këto kushte, me ndihmën e emisarëve jugosllavë ishin formuar grupe të ndryshme komuniste në disa qytete. Komunistët e ushtronin veprimtarinë e tyre në ilegalitet dhe në shtypin e kohës mungonte informacioni rreth ideve të tyre. Në vitin 1942 filloi botimin gazeta “Zëri i Popullit”, si organ i Frontit Antifashist Nacional-Çlirimtar. Për rreth dy vite në ilegalitet, kjo gazetë botoi artikuj me përmbajtje propagandistike për përhapjen e ideve komuniste dhe luftën kundër pushtuesve, nën autorësinë e anëtarëve të Partisë Komuniste.

Ndërsa në shtypin e atyre viteve shkruhej shumë rrallë për komunistët dhe veprimtarinë e tyre, si tek gazeta e përjavshme “Java”, e drejtuar nga Aleks Mavraqi, ku u botua një artikull me titullin: “Komunizmi!”

Bëhej fjalë për gjyqin ndaj 70 personave që ishin arrestuar, të akuzuar për propagandë komuniste. Në artikull pasqyrohen rreziqet që mund të vinin nga Komunizmi, argumentuar me faktin se pjesëtarët e kësaj ideologjie vinin nga pjesa më injorante e shoqërisë shqiptare dhe

85 P. Ç., E vërteta! “Revista Letrare”, 1 maj 1944, Tiranë, fq. 1.

synonin ta shfrytëzonin pjesën më injorante të shoqërisë.⁸⁶

Qëndrimet apo artikujt e publicistëve dhe gazetarëve që shkruanin në median e asaj kohe, ishin kryesisht kundër ideve komuniste. Në një artikull të Anton Harapit në revistën “Hylli i dritës” të shkurtit 1944, autori shkruan se shqiptarët nuk po e kuptojnë siç duhet propagandën që vinte përmes ideve komuniste dhe cilat ishin problematikat që sillnin këto ide në dëm të kombit.

“Unë jam i bindun se pak janë ata shqiptarë të cilët vërtetë e kuptojnë doktrinën komuniste por të gjithë tashmë po e njohin e po e shohin veprën komuniste në Shqipni. Kjo asht e vërtetë e kjo don me thanë se të gjithë komunistat veprojnë me krye në thes pa ditë shka bajnë dhe shka veprojnë. Por, po thonë se e kanë për Shqipni e vetëm për Shqipni. Unë due tu besoj por ka dallim midis doktrinës komuniste dhe veprës komuniste me formën kombëtare, sikurse i kam ndigjue unë vetë, tue dëshmue organizatorët komunistat -mue më ban me dyshue për sinqeritetin e kësaj rryme shqiptare. Pse vall komunistat veshen e ngjeshen me zellin atdhetar, kurse atyne mbi të gjitha u intereson doktrina dhe jo atdheu?!”

Masat terroriste, mandje vëllavrasja, lidhja e ngushte deri dipendencë nga dora e huej dhe përdorimi i çdo mjeti për qëllim nuk i lanë vënd dyshimit. More me kobure ne gjoks nuk bahet kush as vlla, as shoq, por ja skllav, ja mizuer apo hipokrit. Gjithmonë tue rrënue nuk ndërtohet.

Porse mbas gjase komunizmi sot ndër ne e kanë lanë manesh doktrinën dhe don të justifikohet me veprën politike atdheu. Kjo për mue asht kontrast. Nuk due të bjerri kohë tue polemizue me komunistat, por thom se ktu në Shqipni palla në thes nuk hyn. Nuk kemi si me andrrue me ngrehë republikën e Platonit kur ne jemi në gjendje primitive. Nuk kemi sot si të kapërcejmë në internacionalizëm kurse ende nuk kemi formue si duhet ndërgjegjen kombëtare. E pse atyne u asht mbushun mëndja se luftën e fitojnë udhëheqësit e së tretës internacionale, nuk asht kjo një arsye që na tash ti nxjerrim syt shoqi shoqit e të krijojmë hekatoma shqiptare...”⁸⁷

86 Aleks Mavraqi, Komunizmi, Gazeta “Java”, nëntor 1939, Tiranë, fq. 1.

87 Anton Harapi, revista “Hylli i dritës”, shkurt 1944, Shkodër, fq. 2.

Përkundrejt këtij qëndrimi, që e gjejmë në shumë prej artikujve të “Hylli i Dritës”, por edhe në gazeta të tjera, një tjetër pikëvështrim vjen për idetë komuniste të viteve '40 nga gazetari i njohur Gjergj Bubani. Ai shkruan në gazetën “Bashkimi i kombit” me vlerësime të larta për rininë e kohës, e përbashkuar rreth ideve komuniste. Madje vlerësimi i tij kapërcen kohët më të vështira e njëherësh më të lavdishme të gazetarëve, që hodhën themelet e shtypit shqiptar.

Sipas Bubanit, kjo rini e viteve 1940-1944, i kapërcen brezat e mëparshëm të djalërisë shqiptare. I entuziazmuar, autori mohon edhe vetë përpjekjet e tij e të paraardhësve që dhanë gjithçka, shumë prej të cilëve edhe jetën, për shkronjat shqipe. Ndonëse djalëria e fundit të shekullit të XIX dhe fillimit të shekullit XX kishin hyrë në histori si brezi që krijoi kombin e forcoi ndërgjegjen kombëtare, Bubani i vlerëson ndryshe.

“Duhet të jemi të ndershëm e ta pranojmë, rinia e ditëve të sotme i kapërceu brezat e tjerë paravajtës në gjallëri veprimi dhe frymë therori e vetmohimi.”⁸⁸

Në të njëjtën gazetë, Vasfi Samimi, me pseudonimin Agim Shkëndija, shkruante një artikull të ngjashëm me lavde madhështore për djalërinë komuniste të Shqipërisë së vitit 1944.

“Djalëria shqiptare sot nderohet më tepër se kurrë nga i gjithë populli, aq sa një gjë e këtillë nuk është parë asnjëherë në historinë tonë. Këto lule të njoma të fisit arbënor, janë në gjëndje shpirtërore e mendore që të kuptojnë thellësisht tingëllimën e melankolisë e të tragjedisë që jehojnë në të katër anët e atdheut, sepse ky brez prej katër vjet me rradhë jeto i lidhur ngushtësisht me popullin, në të gjitha vuajtjet, mjerimet dhe lotët...”⁸⁹

Kasëm Bajrami do të thellohej më tej në argumentin për lartësimin e djalërisë komuniste, kur sqaronte tiparet e kohës së tyre, solidaritetin dhe lidhjen me popullin.

88 Gjergj Bubani, Djalëria e ditëve të sotme!, gazeta “Bashkimi i kombit”, 15 janar 1944, Tiranë, fq. 2.

89 Vasfi Samimi, Misioni historik i djalërisë shqiptare, gazeta “Bashkimi i kombit”, 18 janar 1944, fq. 3.

“Duhet të kuptojmë kohën e shpirtin e rinisë. Duhet të njohim botën që rinia vijëzon përpara vetes. Duhet të ecim me kohën. Rinia kërkon ndërtimin e botës së re të shkëputur nga prangat e fanatizmeve, të nepotizmit, të regjionalizimit, të kapitalizimit të tërbuar, të feudalizmit shekullor. Rinia kërkon të ndërtojë botën e solidaritetit, atë të vllaznimit, botën e socializmit.”⁹⁰

Në fund të vitit 1944, një vjershë e botuar nga Sejfulla Malëshova, nën pseudonimin *Lame Kodra*, do të shkaktonte reagime në gazetatat e kohës. Selahudin Toto i kushton një artikull të gjatë, ku i thur lavde ideve komuniste të *Lame Kodrës* (Sejfulla Malëshova).

“Gjer më sot pakë fjalë është bërë për librin “Vjersha” që botoi Lame Kodra. Vetëm një reçension në “Botën e Re” nga Pashko Gjeçi dhe një artikull i nxituar në “Bashkimi” i paraqitën publikut këto vjersha që kanë ndezur zëmërat e mijëra partizanëve të Lëvizjes sonë Nacional-Çlirimtare.

Që rrethi i ngushtë i letrarëve tanë pothua se ka heshtur, kjo mund të ketë dhe shpjegimet e saj. Vepra krijonjëse e Lame Kodrës është diçka e re në letërsinë tonë. Ajo është pjella e frymës së re që shohëm sot ndër ne. Lame Kodra nuk ka shkruar si pas shijës së rretheve tona të ngushta. Ay jetën e tij ja ka kushtuar popullit dhe ka sakrifikuar çdo gjë që historinë ta bëjë vetë populli dhe jo rrethet e ngushta të “të zgjedhurve”. Kjo përpjekje pasqyrohet si drita e diellit dhe në vjershat e tij. Në këto derdhet me një lirizëm të kulluar e të fuqishme aspirata shekullore për liri e popullit tonë. Nga kjo rrjedh dhe kontradikta që këto u bënë burim frymëzimi për zëmërat e fshatarëve, punëtorëve dhe të rinisë sonë liridashëse, se sa për rrethet e ngushta të intelektualëve të çkëputur nga populli. Mua më duket se s’ka gëzim më të madh për një poet kur shikon se krijimet e tij ndezën zëmëren e një populli për liri.

Me këtë nuk dua të them se vjershat e Lame Kodrës janë popullore në kuptimin e vjershave të një bardi. Përkundrazi, në disa, si në “Bilbilejtë”, “Kremlini”, “Poeti rebel” etj., gjëjmë dorën e një mjeshtëri në artin poetik. Ajo që dua të theksoj është realizma e mprehtë shoqërore e pendës së tij. Kjo duket në vjershën “Si e dua Shqipërinë”.

⁹⁰ Gazeta “Bashkimi i kombit”, Ç’kërkon rinia?!, Kasem Bajrami, 27 janar 1944.

E vërteta është se artisti nuk mund t'i shpëtojë kohës së tij. Për Lame Kodrën idea qendrore e gjithë frymëzimeve është liria e popullit nga i huaji dhe nga forcat feudale dhe obskurantiste të brëndëshme. Është kjo idea qendrore që ndjen thellë, e cila i buçet herë herë me vrullin e një katarakti. Në “Poeti rebel” kemi një ritmë të lehtë e të rrëmbyer, që i përshtatet një rebeli në malet tona.”⁹¹

Për të gjitha këto mendime të shprehura nga këta gazetarë në fund të vitit 1944 në mbështetje të djalërisë dhe ideve komuniste, “Hylli i dritës” tërhoqte vëmendjen, pavarësisht pasojave që mund të kishte. Në një artikull të rubrikës së përhershme: “Jehona e Shtypit”, autori Gjon Shllaku, me pseudonimin Gjin Shpata, argumentonte krejt të kundërtën. Autori shënjestron disa gazetarë që shpallën gatishmërinë për të lënë penën e për të rrokur armët në luftë për çlirimin e atdheut. Me një citim që i referohet një thënieje popullore, autori nis kritikën për propagandën e ideve komuniste në shtypin e kohës.

“Na ktej ka Shkodra kemi një thanie popullore: i urti shka din nuk flet, i marri shka flet nuk din.

E keqja ndër ne asht se çdo njëri e ndien veten shpëtimtar i atdheut. Prandaj shumë nga shkrimtarët tanë hodhën penën e rrokën shpatën. Nga puna e përpjekja e tynë në lamën strategjike e ushtarake, po kemi përfundime ma se tragjike. Gjysmën e Shqipnisë e dogjëm e gjysmën tjetër kemi mbetë me dyshim: ta djegim a mos ta djegim?

Letrarët me parzmore e përkrenare le të bajn punën e vet. Ne kemi guxim të japim këshilla. Por gzim i madh ka me qënë për ne kur ti rrokim për parzëm këta kingja të butë që braktisën grigjën. Kur deri letrarve u kërceu gjaku në krye e nuk mund pritën me ba ata shka banë, shka do të thomi për turmën amorfe shqiptare, për gjithë ata malokë, injoranta, vagabonda që trajtojnë masën e murrme antihistorike shqiptare?⁹²

Në vazhdim të analizës së “Hyllit të Dritës”, gjejmë një parashikim për të ardhmen e shtypit shqiptar nën regjimin komunist.

91 Gazeta “Bota e re”, Selahudin Toto, dhjetor 1944.

92 Gjin Shpata, Jehona e shtypit, revista “Hylli i dritës”, 1944, Shkodër, fq. 3.

“Por le të mendojnë shqiptarët se shka bahet sot ka me pasë pasoja të idhta për ne. Në t’ardhmen na kemi me pas turp të kërkojmë liri shtypi e mendimi. Me kamt tona kemi me shkue drejt robnisë tonë. E shka asht ma zi ka me u zmadhue aq fort mënjia shekullore në mes elementesh sa të huejt mezi kanë me prit me futë hundët në punët tona e na e dime atëbotë se shka na gjen. Intelektualët e njerzit e artë të Shqipnisë le të bijn në fije. Menitë vetjake e kolektive në mos mujshin me i zhdukë, ti lanë për ma vonë se asht në rrezik kombi. Shpresa e kombit, si pat kenë thirrë ndër ne në këto dhjetë vjetët e fundit rinia jonë, asht tu ringjallë e frymëzue edhe të rritunit e deri pleqt, me e kujtue vetin si të jetojshin gjithnji në at moshë: lum, lumi un” vetëm pse nuk kursehen në lavde të teprueme kundrejt kësaj breznije që sot e ka vu aq fort ne mendim kombin e shtetin tonë...

Por rinia aq fort e lavdërueme, aq fort e adhurueme na paraqitet sod e dame ndër llogore të ndryshme, prej kah njiheri me plumba që vringëllojnë, ndihet edhe fjala “trathtarë” me të cillën gjuhen pjesët kundërshtare ndërmyjet vetit. Kush nuk mendon këtë tradhëti në dritën e këtij fakti le të heshtë ma mirë, pse asht i vërbt e nuk mundet me pa, as asht rradhitun shpirtnisht në njenen ndër këto llogore tëçiluna.”⁹³

Ky artikull është një përgjigje, pikërisht për artikujt e shkruar nga katër autorët, Bubani, Toto, Samini e Bajrami. Në vazhdim të studimit, do të shohim se si këta autorë do të ndëshkoheshin nga komunistët e sapoardhur në pushtet. Për ironi të fatit, ata do të kuptonin se profecia e “Hyllit të Dritës” do të përmbushej shumë shpejt.

93 Gjin Shpata, Jehona e shtypit, revista “Hylli i dritës”, 1944, Shkodër, fq. 3.

VI. MEDIA NE DIKTATURE (1944-1990)

6.1 Media gjatë periudhës së instalimit të diktaturës komuniste

Pas çlirimit të Shqipërisë pushtetin e mori fillimisht Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe sekretari i parë i Partisë Komuniste, Enver Hoxha, u emërua kryeministër. Që në ditët e para të qeverisjes, komunistët filluan persekutimin ndaj kundërshtarëve të tyre politikë, përfshirë pjesëtarë të partive të tjera politike, intelektualë, klerikë, tregtarë dhe pjesën dërrmuese të elitës së atëhershme. Gazetarët dhe publicistët gjithashtu u shënjestruan të parët. Të etiketuar prej komunistëve si armiq të popullit, në listat e gjata gjendeshin emra të njohur që kishin dhënë kontribute për Shqipërinë që prej shpalljes së pavarësisë.

Ndër vendimet e para ishte edhe ndalimi i të gjithë gazetave e revistave që botoheshin në Tiranë, Shkodër, Korçë e qytete të tjera. Njëherësh ndalohej edhe hyrja në territorin shqiptar e gazetave apo revistave, që botoheshin jashtë Shqipërisë, siç ishte gazeta “Dielli” që botohej në Boston të SHBA-së, apo edhe “Shëjzat” e Ernest Koliqit, “Koha jonë” e Lec Shllakut etj. Prej nëntorit 1944 në Shqipëri nuk ekzistonte e drejta e pronësisë private mbi shtypin.⁹⁴

Kështu, në këtë klimë ndaluan së botuari gazetat dhe revistat që kishin mbetur ende në treg në prag të përfundimit të Luftës së dytë

⁹⁴ Hamit Boriçi, Mark Marku, Historia e shtypit shqiptar, nga fillimet deri në ditët tona, SHBLUT, 2010, Tiranë, fq. 232.

Botërore, siç ishin “Hylli i Dritës”, “Shkëndija”, “Fryma”, “Kritika” e të tjera. Menjëherë pas këtyre masave, komunistët ngritën strukturat e tyre dhe një ndër to, që kishte në shënjestër kryesisht median, ishte “Sektori i shtypit dhe propagandës”. Kështu u vendos kontrolli i plotë mbi çdo gazetë ose revistë, që do të botohej në vazhdim.⁹⁵

Për të kuptuar më mirë situatën e re dhe ndryshimin radikal të gjendjes në vitet e para pas 1944-s, kam analizuar sjelljet dhe botimet kryesore të dy autorëve të njohur, të cilet u ndodhën në dy anë të ndryshme politike, por që patën të njëjtin fat tragjik, Nebil Çika dhe Selahudin Toto. Shkëpusim disa fragmente nga artikulli i Totos në revistën “Bota e re” të gushtit 1945, të titulluar “Fuqitë krijonjëse dhe Lëvizja Nacional-Çlirimtare”.

Artikulli nis me prezantimin e një personazhi, partizan që kishte pasion vizatimit. Ai përshkruan takimin e tij të paradokohshëm me partizanin artist. “Kam bërë shumë skica në mal”, më tha me një zë të ngadalshëm, “Kur të thyej qafën gjermani, do ta punoj këtë lëndë dhe do bëj një ekspozitë me piktura” i ishte përgjigjur partizani Selahudinit. Pasi e përshkruan me detaje bisedën me partizanin piktor, Selahudini nis e shtjellon tezën e tij:

*“Djem e vajza me talent dhe të etur për art do ketë dhe të tjerë në Lëvizjen Nacional-Çlirimtare, që sa po kanë nisur të shkruajnë vjersha dhe përshkrime të frymëzuara nga eksperiencia e tyre e re, ose që duan të kompozojnë këngë heroike partizane, djem dhe vajza të thjeshtë e të panjohur, që sakrifikuan çdo gjë për lirin e vëndit tonë. S’ka dyshim se nga zjarri i Luftës Nacional-Çlirimtare, që e çliroi popullin jo vetëm nga okupatori, po dhe nga format e ndryshkura të jetës që i mohonin çdo dinjitet njerëzor, do të lindin fuqira tëra krijonjëse. Në këtë çpërthim të madh të energjive popullore, letërsisë sonë do t’i çelen horizonte të ri. Po jo vetëm letërsisë sonë. Në Shqipërinë e re po krijohen kushtet e domosdoshme për një zhvillim më të gjërë dhe të pikturës, të theatrit, të muzikës dhe të skulpturës”.*⁹⁶

95 Hamit Boriçi, Mark Marku, Historia e shtypit shqiptar, nga fillimet deri në ditët tona, SHBLUT, 2010, Tiranë, fq. 232.

96 Selahudin Toto, Gazeta “Bota e re”, gusht 1945, Korçë, fq. 5.

Në vazhdim të artikullit, Toto argumenton se nga radhët e partizanëve do të shpërthejë letërsia dhe arti i ri dhe se po ndërtohej kështu Shqipëria e re demokratike. Në përpjekjen për t'i lartësuar shkrimtarët dhe artistët që pritej të prodhonte LANÇ, autori merr me mend edhe reagimet kundërshtare:

“Letrarët tonë do të pyesën: “Po ç’ka të bëjë letërsia ose zhvillimi artistik me Lëvizjen Nacional-Çlirimtare?”. Që të marën një qëndrim të tillë, këta duhen të nisen me dashje ose pa dashje, nga kjo premisë: arti ose idea e së bukurës është universale, absolute dhe e kapërcen kohën ose vëndin. Arti nuk preket nga çqetësimet shoqërore në të cilat ndodhet artisti. Me pak fjalë, letërsia ose çdo formë tjetër në të cilën shprehet imagjinata njerëzore është një botë më vete, që s’ka aspak të bëjë me përpjekjen dhe konfliktet shoqërore. Në periudhën romantike kësaj i thane “art për hir të artit”, “art per se”.

Për veten time, unë kam qënë kundra kësaj shkolle këtu e dhjet vjet më parë dhe arsyeja nuk është se doja të shisja mënd në çështje të estetikës. Po se në këtë kohë Lasgush Poradeci kish arritur të formonte një pleiadë me pasonjës të njomë, romantikë të sëmurë, që kishin filluar ta shikonin botën nëpër mjegullën e syve të përlotur, dhe numri i tyre kish arritur të bëhej allarmonjës. Haxhiademi, si përfundim i një vullneti të jashtëzakonshëm, sa po që kish mbaruar ciklin me drama e tragjedira të një natyre klasike dhe donte të na sillte kështu edhe një herë kohën e Sofokliut e të Euripidit. Sterjo Spasse hidhej fare në nihilizmë me romanin e tij “Pse? Bota e hiçit, prej Hiçit”.

Kjo qe gjëndja jonë letrare në vitërat e fundit të regjimit të Zogut. Udha që kishin zënë letrarët tonë ish e shtrëmbër dhe shpinte jashtë realitetit shoqëror në të cilin jetonim të gjithë. Ndonjë mund ta shpjegonte këtë shtrembërim duke prurë si arsye mungesën e lirisë së shtypit ose të mendimit. S’ka dyshim se censura dhe Porto Palermua kanë qënë pengime të mëdha për një zhvillim të lirë letrar. Për të kuptuar se sa liri shtypi kish në këtë kohë, mjafton të përmendim faktin se vepra me famë botërore si “Nëna” e Gorkit ose “Armiku i popullit” e Ibsenit merreshin si “subversive”...”⁹⁷

97 Selahudin Toto, Gazeta “Bota e re”, gusht 1945, Korçë, fq. 5.

Në vazhdim të argumentimit, Toto arrin të mohojë kontributin e shkrimtarëve të brezit para LANÇ, duke arritur në përfundime që para vitit 1944 as që i mendonte:

“Me këtë nuk dua të them se shkrimtarët tanë në indiferencën e tyre kundrejt realitetit shqiptar nuk prodhuan asgjë të bukur. Nuk mund të them, fjala vjen, se disa vjersha nga të Lasgushit nuk janë të bukura. Në fund të fundit, një vepër arti, gjer sa shpreh ndjenja dhe pasione njerëzore, gjer sa është shprehja e një procesi subjektiv, ka pa dyshim vlerë për çdo vënd dhe për çdo kohë, ndonëse kjo vlerë ndryshon sipas zhvillimit të ndërgjegjes njerëzore. Po ajo që është për të vënë re te Lasgushi është frymëzimi i tij mistik, përpjekja të çkëputet nga realiteti në të cilin jeton dhe mbyllet në vetvete. Lasgushi është tipik i shkollës “art per se”. Nga kjo rrjedh dhe qëndrimi i tij kontemplonjës dhe melankonik kundrejt botës. Lasgushi nuk e ka kuptuar artin si një funksion shoqëror, si një marrëdhënie dinamike me të gjitha forcat shoqërore. Për të bota e artit është universale dhe absolute dhe mania e mbylljes në vetvete si në një kullë të fildishtë i ka sjellë ndofta dhe shterimin e pandalur në të cilin ndodhet sot. Gjenitë e mbëdhenj që kanë arritur në universalitet kanë patur si burim të pashterur të frymëzimeve të tyre kohën dhe vëndin, çastin historik në të cilin kanë jetuar. Është për të vënë re se dhe vjershat e Lasgushit, ato më të mirat, si “Kënga pleqërishte” ose “Poradeci”, janë pikërisht frymëzime nga vëndi dhe nga jeta e jonë...”

Dhe më në fund vjen dhe argumenti pse Selahudin Toto shpresonte dhe besonte kaq shumë tek arti dhe letërsia që do të prodhonte LANÇ-i.

“Tashti le të vimë te pyetja që shtruam në fillim dhe të vështrojmë këtë ndryshim të madh e rrënjësor që solli me vete Lëvizja Nacional-Çlirimtare. Energjitë e popullit tone të ndrydhura e të shtypura nga regjimet e kaluar çpërthyen si një inondate dhe klasa e “vrasësve” është duke hequr konsenkuencat e veprës së saj. Në këtë klimë të re heroizmi popullor, kemi të bëjmë, pra, me një realitet të ri. Sot as që mund të mendohet se mund të lindën përsëri shkrimtarë që rrinë në bishtin e përpjekjes shoqërore, që kontemplojnë botën me sy të përlotur dhe duan t’i mbajnë “duart e lara”. Shkrimtarët dhe artistët tanë të rij do të jenë ata që kanë përvetsuar këtë eksperiencë të thellë të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, që gëzojnë këtë klimë

të re e të shëndetshme, që i kanë njohur në zjarrin e luftës të mirat, të këqiat dhe fuqinë e popullit tonë. Ata do të marrin pjesë vetvetiu në këtë përpjekje heroike që bën populli ynë për një jetë më të lumtur. Për ta arti do të ketë një funksion thjesht shoqëror....”⁹⁸

Artikulli është shkruar pak muaj pas çlirimit të Shqipërisë dhe autori e vendos veten në rolin e mohuesit për gjithçka kishte kontribuar para vitit 1944, duke u përpjekur t’i thurë lavde komunistëve që po merrnin pushtetin.

Siç shihet në këtë artikull, autori pozicionohet hapur në mbrojtje të regjimit komunist. Ai e kishte njohur Enver Hoxhën prej të vëllait, Ismet Toto, i cili nuk kishte ndier tjetër gjë veç përbuzjes në takimet që kishte patur me të. Selahudini ishte në dijeni të përballjes së Ismetit me Enver Hoxhën, që prej vitit 1935.

“Pas rënies së regjimit komunist zoti Mentor Çoku, pinjoll i familjes të njohur të Iliaz pashë Dibrës, dha një dëshmi që davariti çdo lloj hamendësimi të bërë në mjedisin tonë familjar në dekada. Ngjarja e treguar prej tij kishte ndodhur në mesin e viteve ’30, ndoshta më 1935. Asokohe zoti Mentor, mik shumë i afërt me Ismetin, gjatë një takimi të zhvilluar në një prej lokaleve më në zë të Tiranës, ku merrnin pjesë të rinj intelektualë, përfshihet në një debat të ashpër me Enver Hoxhën. Ky i fundit, duke folur me përçmim për shqiptarët e mbetur jashtë kufijve politikë të shtetit shqiptar, shkakton reagimin e ashpër të zotit Çoku, i cili përpiqet edhe ta godasë. “Pikërisht në atë çast, -kujton zoti Çoku, -miku im i mirë Ismeti ndërhyr dhe më qetëson duke më thënë: Mentor, nuk ia vlen ta qëllosh. Ai është aq maskara, sa edhe nëse ti e pështyn në fytyrë, ngre sytë lart dhe thotë se po bie shi.”

Nuk është e vështirë të merret me mend reagimi i të pranishëmve. Enver Hoxha nuk e harroi kurrë fyerjen dhe u hakmor ndaj gruas e fëmijëve të Ismetit si edhe vajzës së vetme të Mentor Çokut, zonjës së nderuar Valbona Çoku-Miraka.”⁹⁹

98 Selahudin Toto, Gazeta “Bota e re”, gusht 1945, Korçë, fq. 5.

99 Ismet Toto, “Larg dhe afër, saga e një familjeje”, UET Press, 2017, Tiranë.

Ndërsa Selahudin Toto vazhdonte të besonte tek atdhetarizmi i djalërisë së viteve '40, shumë bashkëkohës të tij, po ndëshkoheshin ashpër, shumë më ashpër se sa kishte ndodhur gjatë regjimit të Zogut, apo edhe më herët gjatë pushtimit turk. Në këto vite të para të "lirisë", ishin detyruar të arratiseshin nga Shqipëria shumë shkrimtarë, gazetarë e intelektualë të elitës së asaj kohe. Të tjerë të mbetur në Shqipëri, po përballëshin me akuza të rënda para trupës së gjyqit ushtarak, ose u pushkatuan pa gjyq.

Njëri prej tyre, mik i kohëve të hershme të Selahudinit, ishte edhe gazetari Nebil Çika, një prej personazheve të famshme të shtypit të viteve '30 e në vazhdim. Ai kishte qenë bashkëkohës me dy vëllezërit Toto, por dhe me shumë publicistë të tjerë, që kishin shkruar për dhjetëra gazeta e që do të përmendeshin në historinë e medias shqiptare për vlera të veçanta. Më 14 nëntor 1944, Nebil Çika u pushkatua pa gjyq nga regjimi komunist. Pa kryer asnjë krim, pa u përballur me asnjë akuzë, Nebil Çika, bashkë me të kunatin Aleks Mavraqi, gjithashtu gazetar e botues i viteve '30, u ekzekutuan mes një grupi prej 15 vetësh të shpallur "armiqtë e popullit".

Me sa duket, rrugët e Selahudinit dhe të Nebilit ishin ndarë, sepse Selahudini kishte qenë partizan, ndërsa Nebili kishte vazhduar në udhën e tij si gazetar e botues, madje deri në ditën e pushkatimit, Nebil Çika punonte si korrespondent i agjencisë "Reuters" dhe gazetës së njohur amerikane "New York Times". Ata kishin qëndruar në dy anë të ndryshme të historisë edhe pse pa asnjë dyshim, qoftë Selahudini, qoftë Nebili, gjithë jetën e tyre ia kishin kushtuar gazetarisë. U rreshtuan shpesh përballë regjimeve apo pushtuesve e u ndëshkuan, kush më shumë e kush më pak, nëçdo etapë të historisë.

Ndonëse Nebil Çika zhvilloi aktivitetin më të madh në media gjatë regjimit të mbretit Zog, shpesh ai e kundërshtoi hapur dhe u përball me censurën e regjimit deri sa ia mbyllën gazetën "Arbënia". Më vonë u shënjestrua edhe nga fashistët, si: "*gazetar që ushtron influencë të dëmshme, sidomos mbi rininë studentore, prandaj është e dobishme të ndalohet botimi i një reviste të tillë dhe i botimeve të tilla në përgjithësi*". Për

këtë arsye, më 25 nëntor 1940, Nebil Çikën e internuan në Itali. U rikthye në atdhe pas pak kohësh për t'u përfshirë sërish si bashkëpunëtor në revistën “Bleta”, e më pas si korrespondent i agjencive të huaja të lajmeve.

Për shkak të specifikës dhe aftësisë parashikuese kam zgjedhur t'i përfshij në studim disa pjesë nga artikujt e Nebil Çikës. “Mentarët dhe rrethi shoqëror”, titullohej artikulli, ku ai analizonte rolin që kanë intelektualët në fatet e kombit.

“...Në njëmendësi (realitet) drejtonjësit e vërtetë të një Kombi janë jo administratorët dhe burokratët anonimë, por mendimet dhe besimet (croyances = credenze) që ka ai komb, domethënë janë mentarët që prodhojnë: poetët, oratorët, shkrimtarët, etj. Këta kanë jo autoritetin e xhandarit, jo fuqinë brutale, por ndikimin (influncën) e vazhdueshëm pjellor mbi shpirtërat. Mentarët tanë po i shmangen këtij misioni të lartë të drejtimit. Pse vallë?

Para se t'i përgjigjemi pyetjes, duhet të caktojmë se kujt i themi mentar. Ky është një njeri që punon me idetë dhe mbi idetë (shkencore, letrare, filozofike, etj.), të cilat i grumbullon në arsyetime duke i lidhur me njëra-tjetrën dhe nxjerr prej tyre ide të reja, dhe prozozon, më së fundi, në fushat e veprimtarisë së tij, shikime të përgjithshme dhe hipoteza.”¹⁰⁰

Nebil Çika i referohej politologut francez Henri de Saint-Simon, i cili kishte shkruar për elitën franceze: “Po të qe se Franca humbiste papritmas të pesëdhjetë dijetarët e parë të saj, të pesëdhjetë artistët e parë të saj, të pesëdhjetë industrialistët e parë të saj, të pesëdhjetë lëvruerit e parë të tokës së saj, kombi do të bëhej një trup pa shpirt, do t'i ishte prerë koka. Po të qe, përkundra, se humbiste të gjithë personelin zyrtar të saj, nga kjo gjë nuk do të dilte për vendin veçse një dëm i vogël”.

Për fat të keq, do të ndodhte pikërisht ky skenar. Shqipëria do të mbetej një trup pa shpirt, sepse shumë shpejt diktatori Enver Hoxha, që shfaqej si drejtues i luftës për çlirim, do të tregonte fytyrën e vërtetë të

100 Nebil Çika, Mentarët dhe rrethi shoqëror, revista “Bleta”, 1943, Tiranë, fq. 6.

një ekzekutori të pamëshirshëm. E para lëvizje që ai do të bënte, ishte prerja e kokave të elitës, e *mentarëve*, siç i quante Nebil Çika. Ndër këta *mentarë*, ishin thuajse të gjithë gazetarët e publicistët, që me punën e tyre për pothuajse 50 vjet, me sakrifica dhe këmbëngulje, kishin qenë pjesë e ndërtimit të shtetit të sapolindur shqiptar. Shumë ish-ministra, pjesëtarë të kabineteve qeveritare, veprimtarë të shquar të lëvizjes kombëtare dhe nënshkrues të aktit të pavarësisë, që mbetën në Shqipëri, u dënuan pa gjyq, me masa ekstreme si varja në litar apo pushkatimi.

Siç rezultoi, një pjesë e intelektualëve shqiptarë iu bashkuan ideve komuniste jo vetëm me penë, por edhe me pushkë. Kjo duket në qëndrimet e katër gazetarëve të spikatur në publicistikën e viteve '30, të cilët u rreshtuan apo lartësuan përmes artikujve të tyre, “idetë komuniste të djalërisë”.

Gjergj Bubani, një gazetar i njohur, që shkruante me vlerësime të larta për djalërinë e ideve komuniste, ishte një ndër intelektualët e spikatur qysh në vitet e para pas pavarësisë së Shqipërisë. Ai kishte studiuar në Liceun Francez të Korçës dhe vazhdoi studimet e larta për Kimi, në Athinë. Kishte filluar të shkruante rreth temave politiko-shoqërore në vitin 1920, në të përjavshmen kombëtare “Shqipëri e re”, që botohej në Rumani prej Ilo Mitkë Qafëzezit. Dy vite më vonë, Bubani drejtoi një periodik me emrin “Dodona”, ndërsa në mars 1926, revistën “Zëri Shqipëtar”. Në vitin 1943 u kthye në Shqipëri dhe shkruante për gazetën “Bashkimi i Kombit”, e kur filloi transmetimet Radio Tirana ishte spiker e më vonë drejtues i saj.

Bubani ishte një ndër gazetarët që promovuan fort rininë komuniste, por menjëherë pas çlirimit do të arrestohej nga diktatura dhe do të akuzohej si “kriminel lufte” në “Gjyqin Special” me aktakuzën: *“Është bërë vegël e propagandës armike si agjikator, propagandist dhe publicist me anë të radios dhe fletoreve. Ka shkruar artikuj për okupatorin dhe kondra luftës së popullit si Drejtor i Radioemisionit, Drejtor i Radios dhe redaktor i gazetës “Bashkimi i Kombit”.*¹⁰¹

101 AIDSSH, Dosja e Sigurimit të Shtetit për Gjergj Bubanin.

Në seancat gjyqësore, ai nuk e pranoi asnjëherë akuzën, madje pati dëshmitarë që e mbrojtën, duke dëshmuar se Gjergj Bubani njihej si simpatizant i lëvizjes komuniste qysh në fillimet e saj. Megjithatë, u dënua me 15 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e të drejtave civile e politike.

Një tjetër shkrimtar dhe publicist si Vasfi Samini, i njohur me pseudonimin Agim Shkëndija, u rreshtua gjithashtu në bankën e të akuzuarve përkrah Bubanit. Megjithëse mbështetës i djalërisë komuniste, Samini u arrestua më 15 dhjetor 1944, u gjykua gjithashtu në procesin e “Gjyqit special” dhe u dënua me 3 vjet burg, i akuzuar për veprën e shkruar në vitin 1943 “Nëna Kosovë-Shqipëria e vërtetë”.

Komunikimet në sallën e gjyqit të tij do të botoheshin në gazetën “Bashkimi”, ku ai kishte punuar si gazetar e ku kishte thurur lavde për djalërinë komuniste.

“Kryetari i gjyqit (Koçi Xoxe): -Pse e ke botuar atë librin “Nëna Kosovë” që merret me propagandë?

I pandehuri (dr. Vasfiu): -Unë librin “Nëna Kosovë” e kam shkruar me plot ndërgjegje dhe përgjegjësinë për përmbajtjen e tij e marr vet. Këtë libër e kam shkruar si një shqiptar dhe ka një stil human....

-Keni bërë propagandë ... jeni armik i popullit...”¹⁰²

Edhe Kasëm Bajrami, gjithashtu mbështetës i dikurshëm i lëvizjes së rinisë komuniste, do të burgosej nga diktatura. Në listën e gjyqit special do të përfshiheshin edhe gazetarë e publicistë të njohur si: Fiqiri Llagami apo Lazër Radi. Më pas lista e gazetarëve të vrarë e të burgosur do të shtohet me emra të tjerë të njohur, në procese gjyqësore të sajuara me dëshmitarë të rremë dhe akuza false.

Në shtator të vitit 1947, një tjetër gjyq famëkeq, i njohur si “gjyqi i deputetëve” do të godiste elitën intelektuale, ku u përfshinë edhe shumë gazetarë e publicistë. Si pjesë e këtij “grupi armiqësor” do të

102 Gjyqi Special, gazeta “Bashkimi”, 28 mars 1945, Tiranë, fq. 3.

dënohej me pushkatim edhe Selahudin Toto. Në momentin e arrestimit, Selahudin Toto ishte deputet dhe titullar i Institutit të Shkencave.

6.2 Disa nga gazetarët e ekzekutuar dhe burgosur gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri

Nebil Çika - i pushkatuar

Xhemal Farka - vdekur në tortura

Fiqiri Llagami - dy herë i dënuar, vdekur në burg

Musine Kokalari - e burgosur

Kolë Berisha - i pushkatuar

Aleks Mavraqi - i pushkatuar

Gjon Shllaku - i pushkatuar

Zoi Xoxe - i burgosur

Beqir Ajazi - i burgosur

Koço Semini - i burgosur

Petro Marko - i burgosur

Rrok Kolaj - vdekur në burg

Beqir Haçi - i burgosur

Zhan Gorguzi - i burgosur

Andon Frashëri - i burgosur

Kolë Tromara - i pushkatuar

Mitrush Kuteli - i burgosur

Lazer Radi - i burgosur

Akile Tasi - i burgosur

Lazër Shantoja - i pushkatuar

Guljelm Deda - i burgosur

Kristo Floqi - vdekur në burg

Kristo Krika - i burgosur

Gjergj Bubani - i burgosur

Ihsan Libohova - i burgosur

Pashko Gjeçi - i burgosur

Arshi Pipa - i burgosur

Selfixhe Ciu - e internuar

Marian Skanjeti - i burgosur
Et'hem Haxhiademi - i vdekur në burg
Fadil Kokomani - i pushkatuar
Fatos Lubonja - i burgosur
Vangjel Lezho - i pushkatuar
Niko Kotani - i burgosur

Më poshtë paraqitet një tjetër listë me autorë të organeve të ndryshme në shtyp para vitit 1944, por që u dënuan nga regjimi për funksionet politike që kishin mbajtur:

Mihal Zallari - i burgosur
Vinçens Prenushi - vdekur në burg
Abdurrahman Dibra - i burgosur
Myzafer Pipa - vdekur në hetuesi
Mustafa Greblleshi - i burgosur
Javer Hurshit - i pushkatuar
Hilmi Leka - i pushkatuar
Bedri Pejani - i pushkatuar
Bahri Omari - i pushkatuar
Qazim Kokoshi - vdekur në hetuesi
Hafiz Ibrahim Dalliu - vdekur në burg
Mirash Ivanaj - vdekur në burg
Lef Nosi - i pushkatuar

6.3 Dhuna e diktaturës ndaj elitës shqiptare

Bazuar mbi doktrinën sovjetike, komunistët shqiptarë e shndërruan median në një instrument të rëndësishëm agjitacioni për të propaganduar “arritjet” e sistemit. Prej vitit 1944 deri në vitin 1952, kur nuk ishte miratuar Kushtetuta apo Kodi Penal, shteti diktatorial funksionoi përmes disa ligjeve, ndër të cilët ishte edhe ligji nr.372, datë 12.12.1946 “Mbi fajet penale kontra popullit dhe shtetit”.

“1-Ligji nr.372, datë 12.12.1946 “Mbi fajet penale kontra popullit dhe shtetit”;

Neni 8: Kushdo që bën propagandë ose agjitacion për të rrëzuar me dhunë organizimin shtetëror dënohet me privim të lirisë, me punë të detyruar, jo më pak se 1 vit. Konsiderohen rethane rëndësore kur faji kryhet me anën e shtypit ose të radios.”¹⁰³

Në vitin 1950 Byroja Politike dhe Komiteti Qëndror i PPSH morën një tjetër vendim, i cili urdhëronte sekuestrimin e librave, revistave, gazetave, etj., të publikuara para 29 nëntorit 1944, dhe që përmbanin materiale në kundërshtim me vijën e partisë. Dekretet i Presidiumit të Kuvendit Popullor, i datës 27 nëntor 1950, legjitimonte këtë vendim.

“Dekret Nr. 1180; 27/II/1950 Mbi bllokimin e librave, revistave, gazetave, kartolinave dhe pllakave të gramafonit të tregtarëve.

Neni 1

Të gjitha librat, revistat, gazetat, kartolinat dhe pllakat e gramafonit, të botuara, të incizuara në vend ose të hyra në Shqipëri para 29 Nëntorit 1944, që ndodhen pranë shitësve privatë (ambulantë ose stabël), me hyrjen në fuqi të këtij dekreti, konsiderohen të bllokuara.

Neni 2

Shitësit privatë (ambulantë ose stabël) që mbajnë libra, revista, gazeta, kartolina ose pllaka gramafoni që i shtrohen bllokimit simbas nenit 1, qoftë në emër të vet, qoftë në emër të të tretëve, detyrohen t’ua dorëzojnë këto komiteteve ekzekutive (zyrës së kulturës) menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij dekreti...

AQSH, Fondi 14 /AP, Viti 1950, Dosja 1, fl. 10.”¹⁰⁴

Përmes këtij vendimi ndalohej të lexoheshin librat e autorëve të mirënjohur si: Gjergj Fishta, të cilit iu hoq e gjithë vepra nga qarkullimi, por edhe emrave të tjerë të njohur si Mit’hat Frashëri, Lef Nosi, Kristo Floqi, Faik Konica, Mehdi Frashëri, Terenc Toçi, Ernest Koliqi, Gjon

103 Beqir Meta, Afrim Krasniqi, Hasan Bello, “Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit”, vëllimi I, Tiranë, 2018 fq.194.

104 Po aty.

Shllaku, Anton Harapi, Martin Camaj, Mitrush Kuteli, Mustafa Kruja, Justin Rrota, Tajar Zavalani, Kristo Dako, Fiqiri Llagami, Nebil Çika e të tjerë. Librat e ndaluar u mbyllën në Fondin e Rezervave të Bibliotekës, të vulosura me damkat: “R” - i rezervuar, “ShR” - shumë i rezervuar, “RA” - autor i rezervuar.

Ligji për agjitacionin dhe propagandën u ashpërsua në vitin 1952, kur u miratua Kodi Penal. Ligji numër 1470, datë 23.5.1952, i Kodit Penal të RPSH-së, neni 73, parashikonte:

“Agjitacioni dhe propaganda kundër pushtetit popullor, agjitacioni dhe propaganda që përmbajnë thirrje për të minuar ose dobësuar pushtetin popullor si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja për përhapje e shkrimeve me përmbajtje e tillë, dënohen:

me heqje të lirisë nga 3 gjer në 10 vjet me ose pa konfiskim të pasurisë.

Kur këto vepra janë kryer në kohë luftime ose kanë shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda, dënohen: me heqje të lirisë jo me pak se 10 vjet ose me vdekje, kurdoherë me konfiskim të pasurisë.”

Kështu, shtypi u vu në funksion të plotë të sistemit totalitar, duke e humbur përfundimisht rolin e parë, atë të informimit. Detyra e shtypit gjatë regjimit komunist ishte: mobilizimi i masave në konsolidimin e shtetit diktatorial. Në vitet e para të diktaturës, shtypi përmes gazetës “Bashkimi”, u përqendrua tek lufta kundër “Armiqve të popullit”, ku si pasojë do të vinin ekzekutimet e shumë gazetarëve, shkrimtarëve e profesionistëve të elitës shqiptare.

Do të përcjellim më poshtë disa prej proceseve famëkeqe, ku vendimet arbitrare merreshin pa gjyq, ose gjyqe të sajuara pa asnjë akuzë reale të vërtetuar, përmes të cilave u ekzekutuan gazetarë me kontribut të jashtëzakonshëm në historinë e shtypit shqiptar. Siç e kemi përmendur më herët, ndër gazetarët e parë që u ekzekutuan menjëherë pasi komunistët erdhën në pushtet, ishte Nebil Çika. Më pas vijnë proceset e njëpasnjëshme si ai i “Gjyqit Special”, ku siç u theksua më lart më me detaje, u dënuan disa gazetarë.

Do të pasqyrojmë më poshtë një artikull të gazetës së Frontit

Demokratik në vitin 1945, kur nisi ekzekutimi i gazetarëve dhe intelektualëve shqiptarë, të cilësuar “armiqtë e popullit”. Në artikullin e botuar në gazetën “Bashkimi”, Gjergj Bubani do të konsiderohej si një ndër armiqtë e popullit. Megjithëse kishte dëshmitarë që e mbështetën dhe argumentuan se Bubani kishte ndihmuar Lëvizjen Antifashiste, Gjykata Speciale e dënoi me 15 vjet burg, pas dënimit me pushkatim që kërkoi në fillim prokurori. Një prej tyre ishte Ilia Gjino nga Dardha e Korçës, i cili tregon raportet e tij dhe të familjes me Gjergj Bubanin dhe se si ky i fundit i kishte ndihmuar djemtë e tij partizanë dhe të bijën:

*“Kur të tre djemtë e mi dolën partizanë, unë erdha këtu në Tiranë me çupat, sepse s’kisha çfarë të bëja më në Korçë. Kur kam ardhur këtu, Gjergj Bubani na ka ndihmuar. E mori vajzën në punë në shtypshkronjë dhe ajo ka qëndruar atje deri sa doli në mal. Kur më erdhi djali i plagosur nga mali, pasi u përmirësua, Gjergji e ka ndihmuar me një letërnjoftim fallso për të dalë nga Tirana, pasi ai nuk kishte dokumente”.*¹⁰⁵

Të tilla dëshmi i shpëtuan jetën Gjergj Bubanit, pasi kishte qenë në listën e parë të personave që do të dënoheshin me pushkatim. Në përfundim të gjyqit special, i cili zgjati nga 1 marsi deri më 1 prill 1945, në gazetën “Bashkimi” u botua një artikull rreth kësaj ngjarje.

Për ironi të fatit, ky artikull, shkruhej nga Lame Kodra (pseudonimi i Sejfulla Malëshovës), i cili kishte qenë një ndër miqtë e Gjergj Bubanit dhe kishin shkruar në të njëjtat gazeta para vitit 1944. Pas disa viteve edhe vetë Sejfulla Malëshova do të shpallej gjithashtu armik i popullit. Në artikullin e Malëshovës shkruhej:

“Në gjyqin Special ‘Coram populo’ duallën ballë përballë dy botë: Protagonistët e Shqipërisë së vjetër, që kishin sunduar me të huajt dhe për të huajt mi kurrizin e popullit, dhe protagonistët e luftës së madhe për çlirimin e atdheut, protagonistët e revolucionit popullor që udhëhoqi themelet e Shqipërisë së re.

Të parët qëndronin mi gërmadhat e kompromisit dhe të tradhëtisë, të dytët qëndronin në pjedestalin e një lufte të madhe heroike për çlirimin e

¹⁰⁵ Gazeta “Bashkimi”, 17 mars 1945, Tiranë, fq. 2.

Shqipërisë, mi pjestalin e një revolucioni. Këtu ishte dobësia, hipokrizia, frika dhe qëndrimi i lëkundshëm i të parëve; këtu ishte forca, guximi dhe qëndrimi i prerë dhe i hapët i të dytëve. Këtu ishte sekreti i sofizmave, i mexhelesë, i skolastikës që përdorën në gjyq të akuzuarit dhe avokatët e tyre, këtu ishte sekreti i logjikës së fortë, i dialektikës së prokurorit....

Verdiksi i gjyqit special është një provë e forcës morale e politike të lëvizjes tonë, është një shëmbull i madh historic që përmbys drejtësinë e kalbur të regjimeve të vjetra dhe konsakron triumfin e drejtësisë së vërtetë, drejtësisë së popullit...”.¹⁰⁶

Në gazetën “Bashkimi” të 2 shtatorit të vitit 1945, kryeartikulli me titull: “Gjyqi i Armiqve të Popullit”, shpalli vendimet e gjyqit special për të dënuar ata që u etiketuan “armiqtë e popullit”. Bëhej fjalë për shumë personalite të shquara, që kishin qenë dikur në radhët e komunistëve, por gjithashtu edhe për anëtarë të partive të tjera si Legaliteti dhe Balli Kombëtar.

Në gjyqin special u dënuan gazetarët:

Gjergj Bubani me 15 vjet burg, vdes në burg në 1954;

Akile Tasi me 30 vjet burg;

Fiqiri Llagami me 20 vjet burg, vdes në burg;

Lazër Radi me 30 vjet burg.

Në atë gjyq u dënuan gjithashtu edhe emra të tjerë që ishin akuzuar për veprimtari politike, por që gjenden me kontribute gjatë historisë së medias në vitet ‘20-’30, si:

Terenc Toçi me pushkatim;

Hilmi Leka me pushkatim;

Lef Nosi me pushkatim.

Dy vite më vonë, më 27 shtator 1947, në sallën e kinemasë “17 Nëntori” do të luhej një tjetër akt i shëmtuar që shkaktoi viktima të tjera në radhët e intelektualëve, mes tyre edhe gazetarë: “Gjyqi i deputetëve”.

¹⁰⁶ Lame Kodra, (Sejfulla Malëshova), Verdiksi i Gjyqit Special, gazeta “Bashkimi”, 18 prill 1945, Tiranë, fq. 1.

Një trupë gjykuese, e përbërë nga ushtarakë pa asnjë përvojë në sistemin e drejtësisë, ngriti akuzat mbi një pjesë të deputetëve shqiptarë, që kishin mbajtur qëndrim kritik ndaj qeverisjes bolshevike të instaluar në Shqipëri.

Shtypi i kohës që përcillte propagandën e diktaturës i dha jehonë ngjarjes makabre. Gazeta “Bashkimi” në një prej faqeve të numrit special, pasqyroi seancën hetimore.

“Ndërsa tradhëtarët japin llogari, populli i grumbulluar pranë sallës ku bëhet gjyqi thërret: Kriminelët në litar”, “Populli dënon ashpër tradhëtinë”, etj. janë titujt e artikujve të shkruar nga Fadil Paçrami, ku pasqyrohej seanca e hetimit të “grupit armiqësor”. Në këtë gjyq do të dënohej edhe Musine Kokalari, e cila ishte anëtarësuar në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve pas ftesës që i kishte drejtuar kryetari i saj, Sejfulla Malëshova.

Në gjyqin e deputetëve, mes dhjetëra të tjerëve u dënua me pushkatim Selahudin Toto, gjithashtu u dënua me burgim të përjetshëm (101 vjet burg) Foto Bala, profesor i filozofisë dhe i letërsisë, publicist i njohur i viteve 1930-1944.

Dhuna e diktaturës ndaj gazetarëve e publicistëve nuk do të ndalej tek këto dy gjyqe. Petro Marko ishte një tjetër shkrimtar i njohur dhe publicist që gjithashtu u dënua nga diktatura komuniste në vitet e para të këtij regjimi. Ai u arrestua në vitin 1947 me akuzën se iu gjetën artikuj e tekste, që kishin përmbajtje armiqësore me regjimin komunist.

Petro Marko kishte kontribuar në mbështetje të lëvizjes komuniste qysh në fillim. Më pas u angazhua në shtypin e diktaturës si kryeredaktor i gazetës “Bashkimi”, pikërisht në atë kohë kur kjo gazetë “demaskonte” armiqët e popullit, shumë prej të cilëve kishin qenë miq të tij. Pak kohë pasi ishte ekzekutuar “grupi armiqësor” i deputetëve, do të arrestohej edhe Petro Marko dhe pas rreth dy vitesh në hetuesi, u dënua me tre vite burg. Në dosjen e Petro Markos, të përpiluar nga Sigurimi i Shtetit, veçojmë një dokument të titulluar “Promemorie mbi Petro Markon”:

“Tiranë më 27-X-946

Promemorie mbi Petro Markon

Me ardhjen e Fultzit dhe të Anton Stevens, ky vjen për një herë në kontakt me këta dhe sipas angazhimeve të marruna fillon nga aktiviteti si agjent i amerikanëve. Si kryeradaktor i “Bashkimi”-t, amerikanët me anë të Petro Markos u informuan mbi aktivitetin që kishte treguar kjo fletore deri tani. Petro i furnizonte vazhdimisht me informata të ndryshme, ka dhënë hollësira rreth personelit që punonte aty tue i cilësuar se kush ishin më të besuar dhe kush jo. Ka dhënë biografira të personaliteteve të ndryshme. Në bazë të udhëzimeve të marruna nga Fultz-i Petro Marko desh ta bënte gazetën “Bashkimi” mjet propaganda për Amerikën dhe për këtë disa here mundi të ketë përfundim të mire për ta. Ka nxjerrë fotografi të luftës që bën ushtria amerikane, botuar artikuj nga revista amerikane, të cilat i sillte Stevensi. I ka dhënë Stevensit informata të ndryshme mbi shtypin, numurin e fletoreve që dilnin në Shqipëri, se këta drejtoreshin nga organet e pushtetit, se shtypi privat ishte i ndaluar, mbi sasinë e letrës që dispononte pushteti, çfar mungesa kishte, ç’libra të reja kanë dalë deri aherë në shtyp, mbi libra të ndryshme sovjetike nese silleshin gratis ose me të holla....”¹⁰⁷

Me këto akuza, Petro Marko, pavarësisht rolit që kishte patur gjatë luftës në mbështetje të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, u dënua me tre vite burg, njëherësh iu ndalua edhe e drejta e botimit. Ai vazhdoi të përndiqej e të censurohej për 43 vitet në vazhdim, deri sa ra regjimi komunist në dhjetor të vitit 1990.

Gjuetia ndaj intelektualëve nëpërmjet gjyqeve politike me akuza të sajuara vazhdoi intensivisht deri në fundin e regjimit në vitin 1990, për të ekzekutuar e burgosur thujtse shumicën e elitës shqiptare, ndër të cilët edhe gazetarë.

6.4 Roli i medias si vegël propogande e diktaturës

Vakumi i shkaktuar në media nga eliminimi i penave të famshme që kishin shkruar në faqet e gazetave dhe revistave shqiptare, u

plotësua me aktivistë partiakë dhe informatorë, që sipas një shablloni të paracaktuar mbushnin faqet e mëdha të organeve të partisë-shtet, me shkrime të gjata propagandistike. Qysh në fillimet e diktaturës, në mbledhjen e dytë të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik më datë 7 tetor 1946, theksohet:

“...Shtypi të shpërndahe dhe të lexohet nga të katër anët dhe ky të jetë një shtyp jo vetëm informativ, por sidomos edukativ dhe të pasqyrojë jetën dhe frymën e re...”.¹⁰⁸

“Zëri i Popullit”, organi kryesor i PPSH-së dhe “Bashkimi”, organ i Frontit Demokratik, ishin dy prej gazetave të përditshme, të cilat u bënë mjete kryesor i propagandës së diktaturës komuniste. Përveç këtyre, edhe ministritë apo organizatat satelite që vareshin nga partia, krijuan organet e tyre: “Mësuesi” e Ministrisë së Arsimit, “Luftëtari” e Ministrisë së Mbrojtjes, “Zëri i Rinisë” e Bashkimit të Rinisë, “Puna” e Bashkimeve Profesionale, “Shqiptarja e Re” e Bashkimit të Grave Shqiptare, “Bujqësia Socialiste” e Ministrisë së Bujqësisë etj.

Gjithashtu, u krijuan edhe revista për artin, kulturën e grup moshë të ndryshme, si: “Yllkat” për fëmijët parashkollorë, “Fatosi” e “Pionieri” për nxënësit e shkollave 8 vjeçare, “Horizonti” me tema shkencore të përshtatura për nxënësit etj., ndërsa gazetat “Drita” dhe “Sporti Shqiptar” kishin përkatësisht përmbajtje letrare dhe sportive. Gjithsesi, faqet e para të këtyre gazetave i rezervoheshin propagandas së regjimit.

Nga viti 1960 e më pas, nëpër rrethe botoheshin 27 gazeta lokale, të cilat kishin një numër më të reduktuar faqesh, por përmbajtje pothuajse të njëjtë si ato që botoheshin në kryeqytet. Gazetat lokale ishin nën varësinë e komiteteve të partisë së rretheve dhe redaksitë e tyre zakonisht gjendeshin brenda godinave partiake.

Shkrimet që botoheshin në organet e shtypit ishin kryesisht sulme për çdo kundërshtar politik brenda e jashtë Shqipërisë, thurje e lavdeve

¹⁰⁸ Partia e Punës e Shqipërisë për shtypin, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1980, fq. 47.

për diktatorin e Byronë Politike, përsëritje e sloganeve të nxjerra nga fjalimet e diktatorit dhe informacione të pavërteta nga gjendja tejet e varfër, ku gjendej populli. Edhe disa rubrika rreth artit, kulturës e sportit, që gjendeshin në faqet e fundit të gazetave, ishin tejet të politizuara.

Gazetarët profesionistë u zëvendësuan me militantë, që nuk e kishin gazetarinë profesion ose më vonë me produkte të shkollës së gazetarisë, që në fakt ishin vetëm produkte të indoktrinimit politik. Reportazhet nga vende të ndryshme ndërtoheshin sipas një skeme të caktuar me të njëjtën hyrje dhe mbyllje, që i thurte lavde sistemit diktatorial, duke injoruar çdo pakënaqësi që mund të shfaqej. Media ishte mjeti kryesor për të bërë propagandë dhe gjithë procesi i botimit kontrollohej plotësisht, që nga bocetet, radhitja në shtypshkronjë, shtypja në letër e deri në shpërndarje.

Leximi i shtypit bëhej me detyrim dhe sipas rregullave të caktuara. Në mëngjes, kolektivet e punonjësve ishin të detyruar të dëgjonin leximin e gazetave, si “Zëri i Popullit” apo “Bashkimi”. Çdo ndërmarrje kishte për detyrë të realizonte një numër të caktuar abonimesh në organe të caktuara shtypi. Hezitimi apo kundërshtimi për t’u abonuar nga ndonjë prej punonjësve, sillte pasoja të rënda deri në largim nga puna, madje edhe burgim, duke u akuzuar si kundërshtar i regjimit, sipas nenit famëkeq 55 për agjitacion e propagandë.

Shtypi, radioja dhe televizioni ishin të organizuara sipas një strategjie të mirëpërcaktuar nga drejtuesit e regjimit. Duke iu referuar modelit sovjetik, drejtuesit e diktaturës shpresonin, se përmes propagandës së shtypit, jo vetëm do të arrinin të mbanin nën kontroll informacionin dhe aksesin e qytetarëve tek informacioni, do të kontrollonin mendimet dhe opinionet, do të krijonin një shoqëri të informuar vetëm me burimin zyrtar të PPSH-së.

Me kalimin e viteve u miratuan me mijëra vendime, udhëzime e ligje që shoqëroheshin me strukturat përkatëse, të cilat angazhoheshin për punën politike në forcimin e “ndërgjegjes socialiste”. Një prej tyre ishte udhëzimi i Raportit të Komitetit Qendror mbi krijimin dhe funksionet

e Bibliotekave të Partisë, më 26 dhjetor 1953. Një prej pikave të këtij udhëzimi, ishte puna e bibliotekës me propagandistët. Në këtë material pasqyrohen format përmes të cilave do të përgatiteshin propagandistët e ardhshëm:

“Forma kryesore për të ndihmuar propagandistët është seminari i propagandistëve. Për seminarët punohet në bazë të një plani vjetor dhe mujor. Me propagandistët bëhet punë në mënyrë të diferencuar simbas formave të rrjetit të arsimit në parti...

Agjitorët, një ndihmë kryesore gjejnë në bibliotekën e partisë. Biblioteka e partisë për edukimin e agjitorëve zhvillon me grupe agjitorësh nga qendra pune të ndryshme, leksione politike e ideologjike, duke ia përshtatur problemeve kryesore që ka partia për një periudhë të caktuar, për data përkujtimore etj.

Gjithashtu biblioteka e partisë zhvillon edhe leksione mbi metodën e punës me agjitorët, me qëllim të bëhen më të aftë në këtë drejtim, bën përgjithësimin e eksperiencës së agjitorëve më të mirë, ekspozon planet e bisedave të agjitorëve.

Bibliotekat e partisë, për t’ju ardhur në ndihmë agjitorëve, për (çdo) muaj përgatitin tematikën e bisedave që duhet të bëjnë agjitorët gjatë një muaji. Për çdo temë shënohet plani i temës në formën e tezave të shkurtra dhe poshtë kësaj rekomandohet literatura. (AQSH, Fondi 14 /AP, Viti 1953, Dosja 385, fl. 8-15).”¹⁰⁹

Një ndër pikat më domethënëse të këtij materiali, lidhet me punën politike për “edukimin e masave”, që tregon se e gjithë vëmendja e pushtetit ishte përqëndruar tek propaganda, që synonte formimin e “njeriut të ri socialist”.

“Puna politike dhe kulturele e partisë influencon në forcimin e ndërgjegjes socialiste në masa. Sa më me kualitet të lartë të jetë puna politike, aq më shumë forcohet ndërgjegjja e masave dhe aq më shumë masat mobilizohen për të realizuar detyrat e tyre. Në drejtimin e krijimit të

¹⁰⁹ Beqir Meta, Afrim Krasniqi, Hasan Bello, Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit, vëllimi I, Tiranë, 2018, fq. 247.

masave, të ndërgjegjes në punë, ka rezultate të kënaqshme. Është mbërritur që puna të konsiderohet si një çështje nderi për çdo punonjës dhe secili përpiket të shtojë sa më tepër rendimentin në punë, të përmirësojë teknikën dhe metodën e punës. Nga masat po dalin njerëz të rinj, të pajisur me ndërgjegje të lartë socialiste. Të tillë janë stakanovistët në vendin tonë dhe përfaqësuesit më të mirë si Xhevdet Lazja, Sali Vata etj., të cilët, duke punuar me metoda sovjetike, kanë rritur rendimentet.”¹¹⁰

Spektori i Agjitacionit dhe propagandës, u kthye në organizimin më të rëndësishëm të strukturave të partisë shtet duke dominuar çdo strukturë shoqërore, përfshi këtu edhe median. Në këtë mënyrë, organet e medias u kthyen në një instrument në dorën e shtetit diktatorial për të mbajtur pushtetin sa më gjatë. Në librin “Monolog”, studiuesi Artan Fuga, ka hedhur dritë mbi metodologjinë e regjimit komunist në përdorimin e medias si instrument për ruajtjen e pushtetit. Ai sqaron tri format e detyruara të leximit të shtypit në Shqipërinë komuniste.

“Leximi kolektiv ku për shkak të analfabetizmit të lartë, organizmat e larta Partiake këshillonin që njerëzve t’u lexohej shtypi nga ana e veprimtarëve shoqërorë. Mënyra e dytë e leximit të shtypit ishte: Leximi i shtypit në radio, ku çdo ditë herët në mëngjes në emisionet e mëngjesit ishte rit tradicional leximi i pasqyrës së shtypit të ditës. Mënyra e tretë e leximit të shtypit në komunizëm ishte: Leximi i shtypit në stenda, ku në vende të caktuara të territorit të çdo ndërmarrjeje, kooperativave bujqësore apo institucioneve, si dhe në stacione treni, autobusësh, hyrje spitalesh apo në vende të tjera publike ku gjeje stenda ku ishte i afishuar shtypi i ditës”.¹¹¹

Mund të shtojmë edhe një formë tjetër të leximit të shtypit gjatë diktaturës komuniste, që ishte “e marta e informacionit politik”, e cila ushtrohej në të gjitha institucionet arsimore, që nga cikli 8-vjeçar e deri në universitet, në të gjitha ndërmarrjet, institucionet e organizatat. Çdo të martë, përzgjidheshin kryeartikujt e gazetave kryesore dhe

110 Beqir Meta, Afrim Krasniqi, Hasan Bello, Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit, vëllimi I, Tiranë, 2018, fq. 264.

111 Artan Fuga, Monolog, Dudaj, Tiranë, 2010, fq. 80.

lexoheshin me zë të lartë në klasat e shkollave, kolektive punonjësish, reparte ushtarake etj.

Ushtria e të ashtuquajturve gazetarë, që ishin të bindur verbërisht ndaj ideologjisë së sistemit, kishin për detyrë jo vetëm të botonin porosinë e partisë, por edhe t'i pasqyronin në një formë të tillë, që masat të mund t'i kuptonin më mirë. Komunikimi i ideologjisë së partisë-shtet me popullin realizohej kryesisht nëpërmjet shtypit dhe më vonë edhe radios e televizionit. Çdo informacion që transmetohej nëpërmjet medias kontrollohej rreptësisht nga një piramidë e ngritur posaçërisht për këtë instrument, në krye të së cilës ishte Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, Sekretari për Propagandën, Shefi i Sektorit të Shtypit, Drejtori i Agjitacion Propagandës, kryeredaktorët dhe redaktorët, si dhe një rrjet i tërë informatorësh të Sigurimit të Shtetit, që e ndiqnin procesin paralelisht.

6.5 Fillimi i transmetimeve televizive dhe ndikimi i tyre në shoqëri

Më 29 prill 1960 nisi transmetimi i parë në valë televizive i Televizionit Publik Shqiptar, fillimisht si një qendër eksperimentale vetëm për shikuesit në Tiranë. Në ditët e para, programacioni ishte i reduktuar në pak emisione: një film për fëmijë, pas tij një dokumentar, një koncert dhe në fund një film artistik. Për rreth 3 vite qendra eksperimentale funksiononte vetëm me një studio, ndërsa gjatë viteve në vazhdim u shtuan aparaturat dhe studiot, duke mundur orar më të gjatë transmetimi dhe programacion më të zgjeruar.

Gjithsesi, për shkak të numrit shumë të vogël të shtetasve që kishin mundësi të blinin një televizor dhe kostot e larta të transmetimit, televizioni nuk e zëvendësoi dot rolin e shtypit, si arma kryesore e propagandës në funksion të diktaturës. Por, transmetimi i shpejtë i informacionit dhe risia e një media të re vizuale në atë kohë e bëri akoma më të ashpër kontrollin ndaj televizionit prej regjimit.

Edicioni i lajmeve të TVSH-së ishte i monitoruar rreptësisht nga strukturat partiake, ndërsa punonjësit e televizionit ishin të survejuar deri në detaje nga Sigurimi i Shtetit. Për ta ilustruar më mirë sistemin e survejimit, veçojmë disa detaje të dosjes së Sigurimit të Shtetit për punonjësit e Radio-Televizionit Shqiptar.¹¹²

Survejimi edhe në ambientet e brendshme filloi në vitin 1969 dhe vazhdoi deri në vitin 1990. Në dosjen e vënë në dispozicion nga AIDSSH fillimisht gjendet lista e survejimeve, e shoqëruar me dokumentacionin sipas datave kur është kryer survejimi. Nga kjo listë e gjatë, rezulton se punonjësit e Radio-Televizionit Shqiptar, duke nisur që nga drejtuesit, gazetarët, stafet teknike, stafet mbështetëse e deri tek shoferët dhe rojet, kanë qenë plotësisht të survejuar.

I njëjti proces ka ndodhur edhe në sektorë të tjerë të rëndësishëm të propagandës si Kinostudio “Shqipëria e re”, Teatri i Operas dhe Baletit, Lidhja e Shkrimtarëve etj. Survejimi i gjatë dhe i imtësishëm është shoqëruar me arrestime e dënime gazetarësh, siç është rasti i Koço Prokos, i cili ishte formuar si gazetar gjatë regjimit komunist, por u përndoq dhe u dënua për shkak të bashkëshortes së tij ruse¹¹³. Po ashtu, u dënuan me pushkatim nga akuzat e ngritura nëpërmjet survejimit të agentëve të Sigurimit të Shtetit, Vangjel Lezho e Fadil Kokomani si dhe u dënua me internim gazetari i ekonomisë, Vangjush Gambeta.

112 AIDSSH, Dosja e Sigurimit të Shtetit për Radio-Televizionin Shqiptar.

113 Shumë prej grave ruse që mbetën në Shqipëri pas prishjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik, vuajtën përndjekjen dhe persekutimin e regjimit komunist. Edhe bashkëshortët e tyre shqiptarë dhe familjet e tyre vuajtën burgje dhe internime.

VII. MEDIA NE TRANZICIONIN POSTKOMUNIST (1990-2020)

7.1 Liria e medias pas 45 viteve diktaturë

Pas protestave studentore, që kulmuan me shpalljen e pluralizmit më 11 dhjetor 1990, do t'i hapet rruga themelimit të partive politike dhe njëkohësisht edhe lirisë së shtypit.

Pak orë pas shpalljes së pluralizmit u themelua Partia Demokratike e Shqipërisë, e cila në programin e saj minimal kishte një pikë të veçantë për garantimin e lirisë së medias. Në mbledhjet e para të Komisionit Nismëtar të PD-së, u ngarkua një grup pune për krijimin e gazetës së kësaj partie, e cila do të quhej “Rilindja Demokratike”. Në këtë grup bënë pjesë gazetarë të gazetave “Zëri i Popullit”, “Bashkimi”, “Zëri i Rinisë”, si dhe disa të rinj studentë. Kryeredaktor i parë i RD-së u zgjodh Errok Çupi, i cili gjithashtu vinte nga një përvojë si gazetar në mediat e diktaturës.

Më 5 janar 1991, doli numri i parë i gazetës “Rilindja Demokratike”, e para gazetë opozitare në Shqipëri pas 45 viteve diktaturë. Kështu, historia e medias së lirë pas rënies së sistemit monist, nis me një gazetë partiake, e cila do të pritej me shumë entuziazëm nga publiku.

Ndërkohë, në qytetet kryesore kishin nisur revoltat kundër PPSH-së, e cila vazhdonte të qeveriste. Qysh në numrat e saj të parë, “Rilindja Demokratike” shtypej në një tirazh të jashtëzakonshëm. Numri i parë i gazetës u shtyp në 78 mijë kopje dhe me kalimin e javëve tirazhi kaloi në

mbi 100 mijë kopje. Fillimisht gazeta u botua me 6 dhe 8 faqe në format të madh, dilte nga shtypi dy herë në javë, e më vonë tre herë në javë derisa u bë e përditshme.

Në atë kohë, “Rilindja Demokratike” ishte i vetmi kanal komunikimi i qytetarëve, jashtë shtypit të PPSH-së. Si e tillë u kthye në një simbol shumë të rëndësishëm të lirisë së fjalës në fillimet e pluralizmit. Për të ilustruar ato momente të rëndësishme, rikthejmë artikullin e parë të kësaj gazetë në numrin e parë.

“Fjala e Parë.

Sot “Rilindja Demokratike” flet fjalën e parë të saj. Kjo “Rilindje ...” ka marrë për vete një barrë të rëndë dhe detyrë të ndershme:

Ka marrë një detyrë që të thotë fjalën e vërtetë. Sa shumë e duam këtë fjalë! E dëgjofshim, e gëzofshim të gjithë bashkë të vërtetën!

“Rilindja Demokratike” do ta ketë zërin të dliur dhe fjalën të lirë. E di ajo që më parë një fjalë: vetëm kur e vërteta është e lirë, atëherë liria është e vërtetë. Prandaj do të bëjë të pamundurën të mundur për të thënë dhe për të mbrojtur lirinë e fjalës, lirinë e shprehjes dhe të mendimit. Ajo kurrë nuk do të ruajë sekretin për disa dhe ta lejojë në pa kufi për ca të tjerë. Ajo do ta shprehë dhe do ta mbrojë mendimin e lirë të gazetarëve të saj, të bashkëpunëtorëve, por edhe më gjerë, ose krejt gjerë: të drejtën e ligjshme të mendimit e të shprehjes së lirë në një popull të tërë.

Që në fjalën e parë “Rilindja Demokratike” bën thirrje që askush të mos cenohet, të mos persekutohet, të mos censurohet për shkak të fjalës, të mendimit e të shprehjes.

“Rilindja Demokratike” lind pikërisht për të kryer vepër të madhe demokratike në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Ajo është gazetë demokratike dhe do të ketë në mendjen e saj mendimin dhe fjalën e publicistëve të shquar demokratë e përparimtar shqiptarë, do të ketë guximin e dëshmorëve për demokraci, do të ketë idealin e drejtësisë sociale e të demokracisë.

“Rilindja Demokratike” në çdo fjalë e në çdo germë do të ketë çështjen e kombit e të atdheut. Kombi të ndritet, të vëllazërohet e të përparojë. Kombi shqiptar të ngjitet ku i takon e të zhvillohet! Atdheu të gëzojë liri e independencë, atdheu ynë i lashtë të bëhet çerdhe e dashur dhe kopsht lulësh

për bijtë e vet, që këta të mos ia kthejnë jo shpinën, por as fjalën të mos ia kthejnë kurrë atdheut. Për këtë do të përpiqet “Rilindja Demokratike”.

Në faqet e “Rilindjes Demokratike” do të shihemi e do të kuvendojmë me vëllezërit tanë kosovarë, me të gjithë shqiptarët vëllezër tanë të shpërndarë nëpër botë, që nga brigjet e tejsjme të Adriatikut e gjer në kontinentin amerikan.

“Rilindja Demokratike” i ka faqet të hapura.

Ajo do të interesohet për të gjithë problemet që ka jeta e popullit: Për ekonominë, për kulturën, për historinë për letërsinë e artin, për të drejtën, për mësimin, për mendimin e ndërgjegjen, për zakonet e traditën, për sot e për nesër.

“Rilindja Demokratike” shikon përpara. Ajo ka një dëshirë e vullnet që të hyjë tek të gjithë, te fshatari, te shkollari, te punëtori, te intelektual, te shkrimtari e shkencëtari, tek i riu e fëmija, tek të mëdhenj e të vegjël.

“Rilindja Demokratike”, e cila lindi së bashku me Partinë Demokratike, do të mbështesë e do të pasqyrojë çdo reformë demokratike që i shërben përparimit, pavarësisht se cila forcë politike do të jetë nismëtare dhe zbatuese e saj. Ajo do të kultivojë dialogun, tolerancën, pluralizmin.

Por fjala e “Rilindjes...” nuk do të jetë kurrë lustër e lajkë. Fjala e saj do të jetë e rreptë kundër burokracisë, ndaj autokracisë, ndaj çdo të keqeje që do të përpiqet ta pengojë përparimin e vendit, lirinë e njeriut, forcimin e shtetit juridik shqiptar. Të mos qëndrojmë duarkryq para së keqes shoqërore dhe shtetërore, këtë do ta zbatojë vetë dhe do t’ia kërkojë lexuesit “Rilindja Demokratike”.

“Rilindja Demokratike” do të flasë fjalën shqipe, shqipen gurrë e qelibar, që nuk ngec nëpër gurët e sofizmave, që nuk njëtrajtësohet me enët e ideologjive të caktuara, që nuk flashket nëpër frazat e gjata boshe me pamje zyrtare. Ka një dëshirë “Rilindja Demokratike”: që njerëzit të mos thonë më: mos më fol si në gazetë. Por të thonë: Flasim si “Rilindja...”. Ajo ta ketë fjalën për ta pirë me etje. Gëzuar të gjithëve fjalën e lirë.”¹¹⁴

Në numrin e parë të “Rilindjes Demokratike” u botuan artikuj nga drejtues të Lëvizjes së Dhjetorit: Sali Berisha, Gramoz Pashko e të tjerë.

114 Fjala e Parë, gazeta “Rilindja Demokratike”, 5 janar 1991, fq. 1.

“Fjala e parë” dukej premtuese, ndonëse mes entuziazmit të orëve të para të asaj lirie, mori përsipër shumë më tepër se sa do të mund të arrinte në misionin e saj si gazeta e parë opozitare, në një Shqipëri që sapo kishte dalë nga 45 vite errësirë. Kjo reflektohej edhe në epilogun e editorialit të gazetës së parë, ku shkruhej:

*“Por, fjala e “Rilindjes Demokratike” nuk do të jetë kurrë lustër e lajkë. Fjala e saj do të jetë e rreptë kundër burokracisë, ndaj autokracisë, ndaj çdo të keqeje që do të përpiket ta pengojë përparimin e vendit, lirinë e njeriut, forcimin e shtetit juridik shqiptar. Të mos qëndrojmë duarkryq para së keqes shoqërore dhe shtetërore, këtë do ta zbatojë vetë dhe do t’ia kërkojë lexuesit “Rilindja Demokratike”.*¹¹⁵

Por koha dëshmoi krejt të kundërtën e premtimeve në “Fjalën e parë”. “Rilindja Demokratike” do të kthehej shpejt në një gazetë, që iu shërbente vetëm drejtuesve politikë të PD-së kundër kritikëve të tyre në parti. Nga redaksia e saj do të largoheshin drejtuesit e parë, veprime që të kujtonin elemente të funksionimit të redaksive në periudhën e komunizmit. “Rilindja Demokratike” mbeti një gazetë partiake dhe nuk mundi t’i shmanget rrugës së zhvillimeve politike, që ndodhnin brenda Partisë Demokratike. Qysh në fillim u kuptua, se rruga drejt lirisë ishte shumë më e mundimshme dhe se premtimi i “Fjalës së parë” ishte një mision i vështirë.

Edhe parti të tjera të sapokrijuara themeluan gazetatat e tyre, fill pas PD-së, si gazeta “Republika” e Partisë Republikane dhe “Alternativa-SD” e Partisë Socialdemokrate. Ndërsa më vonë u botuan “Progresi Agrar” e Partisë Agrare, “Kombi” e Partisë së Unitetit Kombëtar, “Balli Kombëtar” e Partisë së Ballit Kombëtar etj. Po ashtu, shumë shoqata dhe organizata të ndryshme, që sapo u krijuan, botuan gazetatat e tyre periodike.

Teksa tituj të rinj gazetash po dilnin çdo javë, teknologjia e vjetër e shtypshkronjave dhe kapaciteti maksimal i kërkesës për të shtypur çdo ditë, ishte i papërballueshëm. Në maj të vitit 1992 u instalua

¹¹⁵ Fjala e Parë, gazeta “Rilindja Demokratike”, 5 janar 1991, fq. 1.

shtypshkronja e re “Demokracia”, një dhuratë e qeverisë amerikane për gazetat opozitare, me teknologji bashkëkohore dhe e aftë të përballonte tirazhe të mëdha shtypi. Fillimisht në shtypshkronjën “Demokracia” shtypeshin gazetat “Rilindja Demokratike” dhe “Republika”, e më pas edhe disa gazeta të tjera të vogla si “Bashkimi”, “Sindikalisti”, “Drita”, “Zëri i Rinisë” etj.

Edhe shpërndarja e gazetave kishte sfidat e veta, pasi i gjithë procesi i centralizuar nga organet partiake në diktaturë, u shpërbë. Abonimet e detyruara nuk funksiononin në kohën e shtypit të pavarur, ndërsa përhapja e gazetave nëpër fshatra, ku ndodhej ende shumica e popullsisë, ishte e pamundur.

Nga 27 gazetat lokale, që kishin qenë nën varësinë e komiteteve të partisë në rrethe deri në fund të vitit 1990, disa u mbyllën, ndërsa të tjerat ndryshuan emrat apo politikën editoriale, me vendimin e strukturave të larta të KQ të PPSH-së. Brenda pak ditësh ato u cilësuan si të pavarura. Megjithatë, këto gazeta trashëguan stafin, zyrat, mjetet, arkivat dhe elementet e tjerë të gazetave partiake të PPSH-së. Vetëm disa prej tyre arritën të mbijetonin në rrethanat e reja.

Një ndër to ishte gazeta “Koha Jonë”, e cila ka lënë gjurmë në historinë e shtypit shqiptar gjatë 10 viteve të para të tranzicionit. Deri në vitin 1990, pra para rënies së diktaturës, gazeta “Koha Jonë” ishte një prej organeve të shtypit komunist, organ i Komitetit të Partisë së Punës së rrethit të Lezhës. Në maj të vitit 1991, kjo gazetë kaloi në administrim privat me botues Nikollë Lesin.¹¹⁶ Në vitin 1992, redaksia e gazetës u shpërngul në Tiranë dhe filloi të botohej dy herë në javë. Në shtator 1993, “Koha jonë” filloi të botohej tri herë në javë dhe në janar 1994 filloi botimin si e përditshme.

Brenda pak kohësh “Koha Jonë” do të kthehej në një prej gazetave më të lexuara në Shqipëri, me një politikë editoriale kritike ndaj qeverisë së demokratëve. “Koha Jonë” e dominoi thujtë plotësisht tregun e shtypit

¹¹⁶ Hamit Boriçi, “Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare”, Enti Botues Poligrafik “Gjergj Fishta”, Lezhë, 1997.

shqiptar në të paktën pesë vitet e saj të para në Tiranë, 1993-1998. Roli i kësaj gazete, me ndikimin që kishte mbi opinionin publik, arriti kulmin në vitin 1997, si një zë i fuqishëm kundër qeverisë së PD-së. Për shkak të këtij pozicionimi hapur kundër pushtetit, më 2 mars 1997 redaksia e gazetës u përfshi nga flakët, ndërsa disa gazetarë të saj u dhunuan dhe u arrestuan. Përplasja e ashpër e qeverisë me median deri në vitin 1997, tregoi se misioni drejt fjalës së lirë ishte i porealizueshëm për ato vite, duke treguar papjekurinë apo mendësinë e vjetër të politikanëve dhe pozicionimin e hapur politik të disa gazetave ndaj një krahu të caktuar.

Në vitin 1993 dolën në skenën e shtypit gazeta të tjera të pavarura, si “Gazeta Shqiptare”, “Dita informacion”, “Populli Po” etj. Në vitin 1995, një emër i njohur do të rishfaqej në tregun e shtypit shqiptar, gazeta “Albania”, e cila mundi të botohej për 15 vite. Do të riktheheshin emra të njohur të gazetave të tjera që ishin botuar para diktaturës, si “Shekulli”, “Java”, “ABC” etj.

Shtimi i organeve të reja të shtypit krijoi një situatë kaotike nga ana ligjore, në mungesë të ligjit për median dhe informimit e publikut, bazuar vetëm në nenet kushtetuese që garantonin lirinë e shprehjes dhe lirinë e shtypit. Sidoqoftë, zgjerimi i medias dhe shumëllojshmëria e titujve nuk solli rritjen e cilësisë së informacionit dhe informim më të saktë për publikun. Në shumë shkrime gazetash vihej re mungesa e etikës profesionale dhe autorët nuk i përmbaheshin asnjë detyrimi ligjor për informacionin që përcillnin te publiku. Po ashtu mungonte respektimi për të drejtën e autorit, për pasojë shumica e faqeve të gazetave mbusheshin me përkthime apo kopjime, pa cituar asnjë burim.

Në aspektin statistikor kjo është periudha me më shumë organe shtypi në historinë e medias shqiptare. Deri në vitin 1997 në tezgat e gazetashitësve gjendeshin më shumë se 270 gazeta e revista¹¹⁷, nga të cilat më shumë se 20 gazeta ishin të përditshme.

117 Hamit Boriçi, “Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare”, Enti Botues Poligrafik “Gjergj Fishta”, Lezhë, 1997.

7.2 Ristrukturimi i medias pas krizës së vitit 1997

Pas trazirave të vitit 1997, edhe shtypi pësoi një shndërrim të thellë. Gjendja e rënduar e ekonomisë pas mbylljes së firmave piramidale, mes shumë pasojave, solli edhe mbylljen e mjaft gazetave. Në vitin 2000 u vu re një rritje cilësore e organeve të shtypit, sidomos e revistave, si në përmbajtje, ashtu edhe në formë. U zgjerua tematika e shtypit të shkruar duke përfshirë kulturën, artin, sociologjinë, filozofinë dhe letërsinë.

Një plejadë e re gazetarësh, të formuar në vitet e para të lirisë së shtypit dhe disa prej tyre me një eksperiencë të shkurtër në mediat perëndimore gjatë viteve 1991-1999, i dhanë tjetër fytyrë medias shqiptare pas vitit 2000. Profesionit i gazetarit zuri përsëri vendin e vet dhe redaksitë filluan të organizoheshin sipas modelit perëndimor, duke shtuar gazetarë për rubrika të ndryshme e korrespondentë nëpër rrethe. Teknologjia ishte përmirësuar ndjeshëm, duke bërë të mundur përcjelljen e lajmeve më shpejt dhe me më shumë cilësi.

Ndërkohë, filluan hapat e parë për liberalizimin e tregut audio-viziv. Televizioni i parë privat, që transmetoi në Shqipëri ishte “Shijak TV” në vitin 1995. Më vonë, me dhjetëra frekuenca të reja ishin gati për transmetim, fillimisht si studio eksperimentale. Në fund të vitit 1998 u miratua ligji për Radion dhe Televizionin publik dhe privat, si dhe ngritja e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), sot Autoriteti i *Mediave* Audiovizive (AMA).¹¹⁸ Në vitin 2000, rreth 30 kanale televizive u shfaqën në ekranet e shqiptarëve, shumica e të cilave kishin vetëm programe në gjuhë të huaja, shpesh të pa përkthyer në shqip, apo transmetime nga logot e televizioneve të huaja. Po këtë vit, KKRT-ja dha dy licenca për televizionet kombëtare, “TV Arbëria” dhe “TV Klan”, si dhe licenoi disa televizione lokale.

118 Ligji nr. 8401, datë 30.9.1998 “Për Radion dhe Televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”.

7.3 Tkurrrja e shtypit të shkruar dhe ngritja e medias audiovizive

Pas vitit 2000 vihet re një tkurrje e shtypit të shkruar. Tirazhet e gazetave dhe revistave u zvogëluan në mënyrë të ndjeshme, ndërsa publiku po shpenzonte gjithmonë e më tepër kohë para ekranit të televizorit. Stacionet e reja televizive po shtoheshin dhe po ashtu, edhe programacioni i tyre.

Kjo periudhë përkon me zhvillimet e vullshme në politikën shqiptare, e cila po e konsideronte televizionin si *mediumin* më të përshtatshëm për shpalosjen e platformave politike. E ndërsa media po zhvillohej me hapa të shpejtë, politika ndryshoi sjellje ndaj saj, duke e përdorur për mesazhe dhe komunikim me publikun.

Në studiot e televizioneve, një pjesë e konsiderueshme e kohës me shikueshmëri të lartë filloi të rezervohej për debatet politike, ndërsa edicionet e lajmeve bazoheshin kryesisht tek ngjarjet politike në vend.

Vetë shtypi i shkruar tashmë varej nga emisionet e mëngjesit në televizionet ku lexoheshin faqet e para të gazetave. I ndikuar nga këto emisione, dizajni i faqeve të para të gazetave ndryshoi duke krijuar një konfuzion me titujt dhe nëntitujt e shumtë. Madje në disa gazeta u shmangën plotësisht shkrimet editoriale apo reklamat, për të shtuar sa më tepër kohën e leximit në televizion.

Ndryshimi i raportit mes shtypit të shkruar dhe medias audiovizive vazhdoi të thellohet, ndërsa pas vitit 2010 filluan të shfaqen edhe mediat e para *online*. Sipas kryetarit të Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë, Aleksandër Çipa, numri i portaleve *online* arriti mbi 800 në fillim të vitit 2019 dhe mendohet se ky numër vazhdon të rritet nga viti në vit. Gjatë dekadës së fundit ky ndryshim radikal ishte në favor të medias *online*.

Zgjerimi i medias dhe përfitimet e mëdha ekonomike në një treg jo konkurrues, me mbështetje financiare edhe nga qeveritë e radhës, e kthyen median në një sektor atraktiv për punësim dhe karrierë. Shqipëria ka aktualisht numrin më të madh të punonjësve të medias,

krahasuar me vendet e tjera. Sipas të dhënave të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë për vitin 2019, në Shqipëri ka 6200 punonjës të regjistruar në fushën e medias, duke mos llogaritur informalitetin e lartë, sidomos në mediat *online*. Kjo shifër përkthehet me 22 të punësuar në media për çdo 1000 banorë, ndërkohë që në vendet e BE është 8. Pavarësisht numrave, Shqipëria ndodhet në vendin e 84-t në “Raportin për lirinë e shtypit”¹¹⁹ të “Reporterë pa Kufij”.

Raportet ndërkombëtare pas vitit 1990 pasqyrojnë thujtë të njëjtën klimë për lirinë e medias, duke e renditur Shqipërinë në listën e vendeve me liri të kufizuar të medias. Në raportin e Freedom House “Kombe në Tranzicion” të vitit 2015, lidhur me seksionin “Media e Pavarur”, për Shqipërinë shkruhet:

“Liria e shprehjes garantohet ligjërisht dhe ushtrohet lirisht në vend, por shpesh mediat shfaqin një qasje të fortë politike dhe raportimi i tyre ndikohet nga interesat ekonomike ose politike të pronarëve të tyre”.

Përsa i përket rolit të sindikatave mediatike për këtë periudhë Freedom House thekson:

“Ato kanë pasur një ndikim të ulët në përmirësimin e kushteve të punës, lirisë editoriale si dhe marrëdhënieve ndërmjet gazetarëve dhe pronarëve të mediave”.

Më tej, trajtohet moskorrektësia e pronarëve në lidhje me pagesat e punonjësve për vitin 2014.

*“Disa media kanë bërë rutinë vonesën e pagave të punonjësve gjatë vitit 2014 dhe disa gazetarë u kërcënuan, apo u sulmuan gjatë punës”.*¹²⁰

Pavarësisht lirisë së shprehjes, ndërthurja e interesave të fuqishme të biznesit, politikës dhe medias pengon zhvillimin e organeve të pavarura të lajmeve. Në raportin “Liria në botë, 2019”, Freedom House thekson:

119 World Press Freedom Index, 2021.

120 Freedom House, Albania: Nations in transit 2015, <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2015>)

“Ndonëse njerëzit janë të lirë të bëjnë zgjedhjet e tyre politike, aktorët e fuqishëm ekonomikë mund të ndikojnë në sferën politike dhe fushatat elektorale, falë mediave që zotërojnë... Shumica e gazetarëve shihen si të njëanshëm ndaj PS-së ose PD-së. Gazetarët kanë pak siguri në punë dhe mbeten subjekt i padive, frikësimeve dhe sulmeve të herëpashershme fizike nga ata që përballen me shqyrtimin e mediave. Mediat e shkruara kanë vazhduar të përjetojnë rënie të të ardhurave, gjë që ka ulur pagat e gazetarëve.”¹²¹

Në kritikën që i bëhen qeverisë shqiptare në lidhje me median vërehet presioni i saj, duke kërcënuar se do të miratonte një ligj të ri për shpifjen, i cili u kundërshtua gjerësisht nga të gjithë faktorët shoqërorë e të medias në Shqipëri. Në raportin “Liria në botë, 2019”, Freedom House i referohet kritikave të OSBE-së dhe organizatave ndërkombëtare të medias, për njoftimin e tetorit të vitit 2018 të deklaruar nga kryeministri Rama, ku theksonte faktin se faqet e lajmeve (portalet) duhet të detyroheshin për t’u regjistruar në autoritetin tatimor.

Ky njoftim u shoqërua me publikimin e një liste të portaleve të paregjistruara nga Autoriteti Rregullator i Komunikimeve, të cilat asokohe i kërcënoi me mbyllje. Mirëpo nga ana tjetër, shumë nga mediat pohuan se ishin të regjistruara si biznese ose organizata joqeveritare (OJQ). Kryeministri Rama pretendoi se kërkesa për regjistrim ishte pjesë e fushatës antishpifje. Raporti vëren gjithashtu, se sjellja e qeverisë ndaj medias inkurajoi biznesmenë dhe zyrtarë pro qeverisë që të padisin gazetarët, ndërsa përdorimi i gjuhës denigruese i ka kthyer gazetarët në objektiva të mundshëm sulmi.

121 Freedom House, Freedom in the World, <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2019>

7.4 Media përballë politikës

Do të përqendrohemi më poshtë tek liria e medias për të pasqyruar një panoramë të përmbledhur të rolit që ka luajtur media në *tranzicionin* e 30 viteve të fundit. Gjatë dhjetëvjeçarit të parë të pluralizimit në Shqipëri, media u censuroa dhe u sulmua hapur nga politika përmes kërcënimeve e burgosjes së gazetarëve. Kjo periudhë karakterizohet nga një marrëdhënie përgjithësisht konfliktuale ndërmjet medias dhe politikës, e cila erdhi si rezultat i mungesës së konceptit për median e lirë në një shoqëri që vinte nga izolimi i thellë prej diktaturës komuniste. Në këtë situatë disi të zymtë, “Zëri i Amerikës” (VOA) dhe seksioni i BBC-së në shqip, ishin dy media që i dhanë frymëmarrje mjedisit mediatik në Shqipëri.

Pas vitit 2000, politika nisi t’i qasej medias me metoda të tjera, gjë që do të finalizohet me një lloj kompromisi mes palëve. Me anë të financimit të medias përmes reklamave të institucioneve qeveritare, e favoreve të ndryshme që qeveritarët iu bënë pronarëve të medias, do të mundësohet një marrëveshje e heshtur, fitimprurëse për të dyja palët.

Gazetarët dhe reporterët e lajmeve, do të ndesheshin me muret që po ngrinte politika, po ashtu edhe me hezitimin apo kundërshtimin e redaksive për të pranuar botimin e lajmeve, që binin ndesh me paktin e pa shkruar. Kështu nga censura zyrtare u kalua tek vetë-censura. Rreth vitit 2008 filloi të shfaqej fenomeni i “kasetave”. Partitë politike ngritën departamente të posaçme pranë zyrave të shtypit, ku punësoheshin ish-gazetarë, të cilët mbulonin aktivitetet politike të partive në mënyrë subjektive, sipas preferencave të drejtuesve të tyre. Këto zyra funksiononin kështu, paralelisht me redaksitë e mediave të pavarura.

Në këto rrethana, gazetarët u përjashtuan nga vendi i ngjarjes dhe, duke u joshur me një pagesë më të mirë, u punësuan për të krijuar “lajmin”, që i shërbente politikës, por jo publikut. Këto studio produksioni pranë partive politike dhe institucioneve qeveritare, arritën të merrnin ekskluzivitetin e deklaratave zyrtare, aktiviteteteve

dhe prononcimin e politikanëve në media, duke i kuruar me kujdes nën vëzhgimin e zyrave të shtypit. Produktin përfundimtar e ofronin në një kasetë, të montuar, gati për të gjitha mediat. Raportimet nga vendi i ngjarjes u zëvendësuan me një regji qëndrore, që në disa institucione përbëhej nga dhjetëra kameramanë, fotografë dhe gazetarë, të cilët përdornin pajisje me teknologji më të avancuar se redaksitë e medias së pavarur.

Edhe pse dukej qartë, se kjo ishte një situatë alarmante për median e pavarur, pasi e shmangte nga misioni për të përcjellë informacionin e pafiltruar te publiku, kasetat e ofruara nga politika u pranuan pa rezistencë nga mediat.

Partia Socialiste dhe kryetari Edi Rama, ishin të parët që “shpikën” *servirjen* e kasetës së gatshme nëpër studio televizive. Ndërkohë, kasetat ishin të rezervuara për transmetim ekskluziv në një televizion të ri *online* të krijuar nga kryeministri Edi Rama, që filloi transmetimin në rrjetet sociale. Vetë inicialet e emrit të kryeministrit ishin logoja e “ERtv”, një kanal televiziv dedikuar veprimtarisë së tij, që po thithte një audiencë të gjerë krahasuar me mediat e pavarura, e cila përbëhej kryesisht nga punonjësit e administratës, simpatizantët e partive dhe të papunët.

Këtij ekrani ishin të detyruara t’i referoheshin dhe vazhdojnë t’i referohen të gjitha mediat shqiptare. Çdo aktivitet që kryen kryeministri dhe qeveria që ai drejton, përcillet për publikun përmes ekranit të “ERtv”-së. Asnjë media nuk mund të ndjekë aktivitetet politike të kryeministrit, (përveç konferencave për shtyp), pasi monopolin e informacionit e ka vetëm “ERtv”-ja.

Askush nuk e di se ku ndodhet fizikisht redaksia e këtij televizioni, çfarë adrese apo kontakte ka, ku është regjistruar dhe cilët janë gazetarët që punojnë atje, kushtet e punës së tyre, si financohet ky kanal, apo ku gjenden të ardhurat për të paguar stafin.

I pajisur me ekranin e tij personal dhe me arrogancën që i jep posti, kryeministri ka treguar një përbuzje të vazhdueshme për komunitetin

e gazetarëve, në përpjekje për ta injoruar tërësisht rolin e tyre. Janë me dhjetëra situata të filmuara, kur kryeministri intimidon dhe sulmon verbalisht gazetarët. Epiteti “kazan”, që kryeministri përdor për median e pavarur, është një ndër rastet, kur ai e përçmon dhe sulmon median për ta zhvlerësuar para publikut. Gjithsesi, as kryeministri Rama e as ndonjë politikan tjetër, nuk mundi të avancojë deri në këtë pikë pa dakordësinë e vetë medias.

Redaksitë e gazetave dhe televizioneve, nuk e kishin më të nevojshme për të çuar reporterin pranë institucioneve që të mbulonte rubrikat e ndryshme, pasi zyrat e shtypit e zgjeruan gamën e produksionit, përveç njoftimeve zyrtare me lajme të gatshme për gazetatat dhe edicionet informative të televizioneve.

Fenomeni u përhap me shpejtësi në të gjitha partitë politike, duke përfshirë edhe ato opozitare, ndërkohë studiot televizive dhe redaksitë e gazetave u kthyen në korrierë të politikës. Kjo nuk ishte thjesht një ide që po eksperimentohej, por ishte një realitet i ri në marrëdhëniet ndërmjet botuesve dhe pronarëve të medias me politikën. Pikat e marrëveshjes së pashkruar shtoheshin dita ditës, e ndërsa liria e medias dhe cilësia e saj profesionale ishin nën kërcënim, pronarët e medias nuk hezituan të kërkonin favore në këmbim të kësaj autocensure.

7.5 Problematika me kontrollin e medias

Në vigjilje të shekullit XX, patriotët shqiptarë sakrifikuan gjithçka për të botuar në gjuhën shqipe libra, revista e gazeta, në kushtet kur ndalohej gjuha shqipe, përballë represionit të pushtuesve e qarqeve antishqiptare. Botuesit e asaj kohe treguan se mbrojtja e interesave shqiptare, zgjimi i ndërgjegjes kombëtare dhe ndriçimi i mendjes së një populli që kishte vuajtur afro 500 vjet në errësirë, ishte i vetmi mision që nuk e tradhtuan kurrë.

Ndonëse media shqiptare atë periudhë ishte në hapat e para, pa ndonjë mbështetje financiare, pa kornizat e një pakete ligjore, në

mungesë të konventave për mbrojtjen e punonjësve të medias dhe në kushtet e një infrastrukture shumë të vështirë, botuesit e parë shqiptarë ia dolën të krijojnë një standard për median e lirë dhe të pavarur.

Sot, pas më shumë se një shekulli, Shqipëria ka krijuar një tjetër standard të medias dhe një tjetër model të botuesve, ose siç quhen ndryshe në zhargonin e përditshëm, “pronarët e medias”, që mund të përkthehet edhe “pronarët e informacionit”, apo “pronarët e fjalës së lirë”. Të gjitha kompanitë e medias në Shqipëri, që shpesh kanë prapashtesën *group*, janë prone e biznesmenëve, të cilët në këndvështrimin e parë e shohin median si një aset për të përfituar ekonomikisht, duke e anashkaluar misionin e medias së pavarur.

Pronarët e medias shqiptare kanë arritur të ndikojnë edhe në ndryshimet e legjislacionit për median. Neni 62/3 i ligjit për mediat audiovizive, i ndalonte çdo pronari të vetëm, që të mbante më shumë se 40 përqind të aksioneve në një media. Por ky nen u hoq me vendim të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2016 dhe me këtë ndryshim ligjor në favor të pronarëve të medias, u zhduk mekanizmi që supozohej se do të garantonte pluralizmin e pronësisë së medias.

Pronarët e mediave kishin lobuar edhe më herët që të hiqej ky nen, por kishin ndeshur në kundërshtimet e organizatave ndërkombëtare si OSBE-ja, pasi konsiderohej si një hap me ndikim në cënimin e mjedisit të medias në Shqipëri. Dhe në fakt, ky ndryshim ligjor ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë në përqendrimin e lirisë së medias dhe cilësinë e saj. Ky përqendrim u bë më i dukshëm kur pronarët e vetëm nuk kishin asnjë lloj pengese në vendimmarrje për ta përdorur median që zotëronin plotësisht në funksion të interesave të bizneseve të tyre.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit i vitit 2018 vëren se, *“shumica e pronarëve të televizioneve private kanë përdorur përmbajtjen e transmetimeve të tyre për të ndikuar në veprimet e qeverisë ndaj bizneseve të tyre të tjera”*.¹²²

122 DASH, Raporti për të Drejtat e Njeriut, 2018, <https://www.medialook.al/wp-content/uploads/2019/03/Albania-2018-Human-Rights-Report.pdf>

Në raportet e përvitshme të Këshillit të Evropës për Shqipërinë, media zë një vend me rëndësi. Në raportin për vitin 2018, Këshilli i Evropës veçoi pikërisht ndryshimet në Ligjin nr. 9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjin nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, e njohur si “Paketa Antishpifje”. Këshilli i Evropës theksoi në raport, se këto ndryshime ndikuan thelbësisht në përkeqësimin e lirisë së medias në Shqipëri.¹²³

Shpesh, pronarët e mediave detyrohen të marrin vendime nën ndikimin e qeverisë. Në vitin 2019 “Focus Group” vendosi të ndërpresë kontratën me gazetarin Ylli Rakipi, për transmetimin e emisionit “Të paeksponuarit” në televizionin “News 24”. Rakipi deklaroi në një intervistë për BIRN Albania, se emisioni i tij ishte mbyllur për shkak të presionit të qeverisë:

*“Emisioni u mbyll nga presioni direkt i qeverisë. Ka pasur gjithmonë presion për ta mbyllur emisionin dhe vetë Edi Rama ka dhënë urdhër që përfaqësues të qeverisë të mos vinin në studion e emisionit. Kisha dhe një vit kontratë dhe nuk m’u dha asnjë arsye për mbylljen. Motivi i mbylljes së emisionit, erdhi pas ekspozimit të disa aferave korruptive të qeverisë”.*¹²⁴

Po atë vit, “News 24” ndërpreu kontratën edhe me gazetarin Adi Krasta, i cili drejtonte emisionin “A show”, gjithashtu një ndër emisionet e pakta kritike ndaj qeverisë. Presidenti i “Focus Group”, Irfan Hysenbelliu, mohoi të ketë patur presion nga qeveria për vendimin e prishjes së kontratave me gazetarët. Rasti i Rakipit dhe Krastës iu shtua rasteve të tjera të raporteve ndërkombëtare, duke dëshmuar se liria e medias në Shqipëri është në përkeqësim.

Gazetarët shqiptarë e ushtrojnë profesionin e tyre në një mjedis

123 Këshilli i Evropës, Raporti i Këshillit të Evropës për Shqipërinë, 2018, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/20180417-albania-report.pdf>

124 Birn Albania (Balkan Investigative Reporting Network), reporter.al, “Mbyllja e emisioneve kritike ngre shqetësime të reja për lirinë e medias në Shqipëri”, 29 gusht 2019, <https://www.reporter.al/mbyllja-e-emisioneve-kritike-ngre-shqetesime-te-reja-per-lirine-e-medias-ne-shqiperi/>

intimidues, nën tryshninë e politikanëve dhe pronarëve të medias ku punojnë. Ky mjedis krijon pasiguri dhe rrjedhimisht cënon profesionalizmin e një gazetari. Pasiguria ekonomike renditet si arsyeja kryesore, sepse në përgjithësi, mungojnë kontratat e punës përmes të cilave garantohet vazhdueshmëria dhe stabiliteti në profesion. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë raporton, se gjatë vitit 2020 një ndër problemet kryesore, me të cilat u përballën gazetarët, ka lidhje me vonesat e pagave.

Raporti për të Drejtat e Njeriut për vitin 2020 nga Departamenti Amerikan i Shtetit iu referua Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, kur përmendte vonesat deri në dhjetë muaj të pagave të gazetarëve, por edhe problemet e intimidimit dhe dhunës ndaj gazetarëve.

“Unioni i Gazetarëve Shqiptarë raportoi pesë raste dhune dhe intimidimi deri në nëntor kundrejt anëtarëve të medias, ndërkohë që politika dhe biznesi ushtroi presion ndaj gazetarëve. Për sa u përket proceseve gjyqësore ndaj gazetarëve. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë shprehu shqetësimin se, deri në gusht, kishte më shumë se 20 padi ndaj gazetarëve, kryesisht për shpifje.”¹²⁵

Është thuar se e pamundur të gjesh gazetarë që deklarojnë me përgjegjësi se nuk janë censuruar të paktën njëherë gjatë profesionit.

Është po kaq e vështirë të gjesh një të tillë, që deklaron me përgjegjësi, se nuk është detyruar të publikojë një lajm apo intervistë të caktuar në funksion të një politikani, qeveritari apo edhe “biznesi” të caktuar. Në zhargonin e gazetarëve, kjo quhet “qokë”. Drejtuesi i Këshillit Shqiptar të Medias, Koloreto Cukali, pohon se vetëcensura krijohet së pari nga presioni i pronarëve për të mbrojtur interesat e tyre.

“Gazetarët nuk janë të lirë të bëjnë punën e tyre, sepse ka një perceptim nga ana e pronarëve, që media ka si funksion së pari mbrojtjen e interesit të tyre. Pa sindikata, e shpesh dhe pa kontrata të rregullta, gazetarët pengohen të bëjnë punën e tyre dhe këtu ndizet çelësi i vetëcensurës”¹²⁶

125 DASH, Raporti për të Drejtat e Njeriut, 2020 <https://www.state.gov/reports/2020-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>

126 Po aty.

7.6 Dhuna ndaj gazetarëve

Që prej krijimit të organeve të para të medias së pavarur në vitin 1991, në Shqipëri janë të shumta rastet edhunës dhe proceseve gjyqësore ndaj gazetarëve. Rastet më të rënda të dhunës u shfaqën prej vitit 1992 deri në vitin 1997, kur u dhunuan fizikisht gazetarë dhe punonjës të medias si: Adi Krasta, moderator i spektaklit “12 vallëzime pa një të shtunë”; Abdurrahim Ashiku, reporter i “Zërit të Popullit”; Gjergj Zefi dhe Alban Kraja, gazetarë dhe botues të “Lajmëtari”; Aleksandër Çipa, korrespondent i gazetës “Koha Jonë”; Zamir Dule, gazetar i gazetës “Koha Jonë”; Bardhok Lala, gazetar i gazetës “Dita Informacion”; Alfred Peza, gazetar i gazetës “Koha Jonë”. Po gjatë kësaj periudhe, ndaj disa gazetarëve u hapën edhe procese gjyqësore për shpifje, të cilat përfunduan me gjobitjen dhe burgosjen e tyre, si Nikollë Lesi, Fatmir Zanaj, Aleksandër Frangaj e Shyqyri Meka.

Por, rastet e dhunës fizike e verbale ndaj gazetarëve vazhduan edhe pas viti 1997, kur Sali Berisha dha dorëheqjen si president dhe pas zgjedhjeve të parakohshme erdhën në pushtet socialistët. Ndër rastet e rënda të dhunës fizike ndaj punonjësve të medias përmendim: Ilir Babaramo, kryeredaktor i televizionit “Vizion Plus”; Mero Baze, gazetar dhe botues i gazetës “Tema”; Dashmir Biçaku, gazetar i gazetës “Shekulli”; Eduard Ilnica, gazetar i televizionit “Telesport”; Besar Likmeta, gazetar i BIRN; Klodiana Lala, gazetare e televizionit “News 24”; Alfred Lela, kryeredaktor i emisionit “Politiko”.

Më 30 gusht 2018, një person i pidentifikuar qëllloi me breshëri plumbash mbi shtëpinë e prindërve të gazetares Klodiana Lala. Në shtator të po atij viti, drejtuesi i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë raportoi se 12 gazetarë kishin kërkuar azil në vendet e Bashkimit Evropian dhe SHBA, pasi kishin qenë objekt i kërcënimeve të ndryshme për shkak të profesionit, ndërsa 34 të tjerë kishin kërkuar strehim në vende të tjera.

Gjatë protestave të zhvilluara në prill 2019, një gazetare dhe një fotograf u plagosën nga përdorimi i gazit lotsjellës dhe shkopinjtë

e gomës nga policia. “Reporterët pa kufij” iu kërkuan autoriteteve shqiptare të mos përdorin “dhunë në mënyrë disproporcionale” gjatë protestave, në veçanti kundrejt gazetarëve dhe fotografëve, të cilët janë duke kryer punën e tyre.

7.7 Etika në media, gjithçka për klikime

Në vitin 1996 u hartua “Kodi i etikës së gazetarit” nga një grup ekspertësh të Institutit Shqiptar të Medias dhe disa vite më vonë ky kod u ndryshua disa herë për t’u plotësuar me sugjerime të reja, që ishin në koherencë me zhvillimet e medias. Varianti i fundit të këtij kodi, ai i vitit 2018, sipas hartuesve, është një instrument vetërregullues që synon të forcojë dhe përmirësojë cilësinë e gazetarisë dhe ndjenjën e përgjegjësisë së gazetarëve në Shqipëri.¹²⁷

Plotësimi i “Kodit të etikës së gazetarit” u bë më se i nevojshëm pas ndryshimeve të shpejta që ndodhën vitet e fundit në median shqiptare, me shtimin e kanaleve televizive, strukturimin e platformave digjitale dhe shpërthimin e mediave *online*, ose portaleve. Sipas studimeve, në ditët e sotme, mbi 80% e publikut e merr informacionin nga mediat digjitale nëpërmjet *smartphone*, ose pajisjeve të tjera kompjuterike.¹²⁸ Gazetarët e mediave tradicionale në Shqipëri, tashmë janë në një terren tjetër. Konkurrenca mes mediave bëri që koha në dispozicion për të përpunuar lajmin të shkurtohej aq shumë, sa që shpesh cënonte cilësinë dhe etikën. Shumë prej gazetave tradicionale janë transferuar nga tezgat e vjetra të gazetashitësve në faqet e tyre *online*, ndërsa televizionet po i kushtojnë më tepër rëndësi krijimit të kanaleve të tyre në platformat që mbartin video. Media digjitale, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve elektronike, është duke e zëvendësuar gradualisht mënyrën tradicionale

127 Kodi i Etikës së Gazetarit <https://kshm.al/wp-content/uploads/2018/04/Kodi-i-Etikës-final-shqip-3.pdf>

128 PEW RESEARCH CENTER <https://www.pewresearch.org/fact-tank/2021/01/12/more-than-eight-in-ten-americans-get-news-from-digital-devices/>

të shpërndarjes së informacionit, sepse ka disa avantazhe të dukshme, siç është *interaktiviteti* i publikut, pra publiku mund të komentojë dhe vlerësojë në kohë reale informacionin e ofruar prej medias.

Përveç medias tradicionale si gazetat, revistat dhe televizionet, që hapën *website*-t dhe kanalet e tyre në botën digjitale, u shfaqën edhe shumë portale të reja që nuk kishin ekzistuar në hapësirën e medias më herët, por investuan direkt në ndërtimin e *website*-ve dhe faqeve të tyre në rrjetet sociale. Gjatë këtij transformimi u shfaqën edhe problematikat e pashmangshme. Duke mos patur një përvojë në media, shumë *portale* i japin rëndësi vetëm sasisë së leximeve, apo klikimeve, duke thyer çdo rregull të medias tradicionale dhe më e keqja, duke shkelur hapur kodin e etikës. Përmbajtja e tyre përfshin lajme të rreme, thashetheme dhe keqinformime të qëllimshme, pa cituar asnjë burim informacioni, për të manipuluar opinionin publik në favor të një interesi të caktuar politik, ekonomik, për të vetmin qëllim, rritjen e audiencës. Profesionalizmi i shumë portaleve lë ende për të dëshiruar, që prej titujve të shkrimeve, ku nuk përmbushet asnjë prej kriteve bazë të gazetarisë.

Retiçenca e pavend, e shumë përdorur nëpër portale, është “gropi” për të kapur sa më tepër klikime, ndërkohë që publiku e ka të vështirë të përzgjedhë mes informacioneve të shumta, se cilat janë të besueshme dhe cilat jo. Rastet kur shfaqen të plotë emrat e personave të mitur në vendin e ngjarjes, fotografi dhe video me përmbajtje të ndjeshme për publikun, abuzimi ndaj femrave dhe gjuha e urrejtjes, janë thyerje e hapur e “Kodit të etikës së gazetarit”, që nuk mungojnë nëpër portalet shqiptare.

Këshilli Shqiptar i Medias (KSHM), publikoi një raport për vitin 2020 mbi etikën në mediat *online*, pasi monitoroi 30 mediat me shikueshmërinë më të lartë.¹²⁹ Gjatë katër muajve u vërejtën mbi 400 shkelje të etikës në media. Sipas raportit, shkelja e etikës vjen nga disa faktorë dhe një ndër kryesorët renditet presioni nga pronarët e mediave,

129 KMSH, Raport mbi etikën në mediat online, 2020, <https://kshm.al/wp-content/uploads/2020/08/Studimi-Layout.pdf>

të cilët kanë marrë rolin e kryeredaktorit, duke dhënë orientime me qëllim që media t'u shërbejë agjendave të tyre ekonomike. Ndodh shpesh që presioni i pronarëve për klikime nga audienca, i detyron gazetarët të abuzojnë me etikën e raportimit. Një faktor tjetër lidhet me kushtet e punës. Shpesh gazetarëve u kërkohet të punojnë me normë dhe të prodhojnë aq shumë lajme, sa që e bën të pamundur raportimin cilësor. Ritmi i prodhimit të lajmeve, sidomos te mediat e reja, nuk u jep mundësinë gazetarëve që të verifikojnë lajmin, ose i detyron të “gjejnë” lajme aty ku nuk ka.

7.8 Media dhe përballja me të shkuarën

Përballja e shoqërisë shqiptare me të shkuarën totalitare gjatë diktaturës komuniste, do të duhej të ishte një reflektim i domosdoshëm i shoqërisë shqiptare dhe organeve vendimmarrëse, qysh në vitet e para të pluralizimit. Ndryshe nga vendet e tjera ish-komuniste të Evropës Jug-lindore, Shqipëria nuk ka bërë hapa të mjaftueshëm në drejtim të përballjes me të shkuarën komuniste. Institucionet shtetërore dhe partitë politike i janë shmangur vazhdimisht kësaj përballjeje ose e kanë përdorur vetëm për interesa elektorale.

Media gjatë këtyre 30 viteve, gjithashtu i është shmangur misionit të saj shumë të rëndësishëm në këtë proces. Madje shpesh ka kryer funksion të kundërt, duke u përpjekur ta paraqesë atë periudhë si një cikël të zakonshëm historik, që kaloi Shqipëria si shumë vende të tjera dhe duke i ushqyer nostalgjikët e komunizmit me historitë rozë të personazheve të diktaturës.

E vërteta, e dokumentuar nga materialet arkivore dhe shumë dëshmi të të mbijetuarve të regjimit komunist nga viti 1944 deri në 1990 është se, u vranë mijëra shqiptarë, u burgosën dhjetëra mijëra të tjerë dhe u torturuan fizikisht e psikologjikisht të gjithë të afërmit e tyre, duke e kthyer Shqipërinë në një nga vendet me nivelin më të lartë të dhunës dhe represionit shtetëror. Megjithatë, një numër i madh i faqeve të gazetave

pas vitit 1990 janë mbushur me historitë e anëtarëve të Byrosë Politike e Komitetit Qendror të PPSH-së, intrigat mes tyre dhe informatorëve të ish-Sigurimit të Shtetit. Në media janë shfaqur vazhdimisht fytyrat e diktaturës me historitë e tyre rozë, ndërsa krimet e tyre, krimet e diktaturës komuniste, nuk e gjetën hapësirën e duhur. Janë shkruar e komentuar gjerësisht intervista me personazhe të diktaturës, siç ishte rasti i Nexhmije Hoxhës, bashkëshortes së diktatorit Enver Hoxha, ku tregonte pa asnjë pendesë vendimet e ekzekutorëve, krahas historisë personale me diktatorin.

Nga ana tjetër, në 30 vitet e historisë së medias pas shpalljes së pluralizmit, janë të pamjaftueshme rastet kur janë bërë përpjekje për të publikuar të vërtetën e krimeve të diktaturës komuniste, apo dëshmitë e viktimave të diktaturës komuniste. Ashtu si disa nga politikanët, institucionet shtetërore dhe ato të drejtësisë, edhe media ka një rol negativ në procesin e drejtësisë tranzitore dhe të përballjes me historinë e krimeve të diktaturës komuniste.

Përfundime

Historia e medias shqiptare është një rrugëtim që tregon përmasën e lirisë së shoqërisë shqiptare gjatë një shekulli e gjysmë. Sfidat e fillimeve të medias shqiptare janë ndër më të vështirat, pasi i përkasin kohës kur Shqipëria ishte nën pushtimin e Perandorisë Osmane. Në një vend ku nuk kishte shkollë në gjuhën amtare, ku thuajse e gjithë popullsia ishte analfabete, përpjekjet e para për të botuar një gazetë shqiptare, ishin në kufijtë e së pamundurës. Megjithatë, në atë kohë të zymtë, arbëreshët e Italisë, e më pas të tjerë patriotë shqiptarë nga vende të ndryshme të botës, do të bashkonin përpjekjet për të nisur historinë e medias shqiptare.

Në kapërcyellin e shekujve, përmes betejash të jashtëzakonshme, do të niste të konsolidohej media shqiptare, e cila do të kthehej në pararendëse të zhvillimeve historike të Shqipërisë. Revistat dhe gazetat e fundit të shekullit të XIX dhe fillimeve të shekullit të XX patën një kontribut shumë të rëndësishëm për fatet e vendit, për momentin historik, pavarësinë e Shqipërisë. Media do të kalonte nëpër disa etapa të rëndësishme zhvillimi, për t'u kthyer në një institucion emancipues të shoqërisë shqiptare, që po dilte e verbuar prej rreth 500 vitesh pushtimi nga Perandoria Osmane.

Sfida e medias në vitet e para pas shpalljes së pavarësisë, ishte përballja me elitën politike qeverisëse, e cila në mungesë të tolerancës për raportimin e paanshëm, kishte tendencën për të krijuar raporte jo miqësore me median. Gjithsesi, në vitet '30 media përjetoi kohët më të lavdishme, ndonëse u deshën sakrifica të mëdha nga gazetarët dhe botuesit, të cilët njëkohësisht ishin edhe elita e intelektualëve shqiptarë. Pas një fanitjeje gjatë Luftës II Botërore, do të vinte një moment i errët në historinë e Shqipërisë, kur kjo elitë të asgjësohej nga diktatura komuniste.

Në vitin 1944 do të fillonte përmbyjsja e elitës, vrasja e intelektualëve ku përfshiheshin edhe gazetarët, për t'u zëvendësuar me të paaftët, që do të viheshin në shërbim të regjimit diktatorial, për ta kthyer propagandën në armë vrasëse për fjalën dhe mendimin e lirë, me qëllim nënshtrimin e shoqërisë shqiptare nën diktaturën komuniste. Kjo është pika e kthesës, që i dha goditjen fatale zhvillimit të medias dhe elitës intelektuale shqiptare. Gjatë 45 viteve të diktaturës komuniste, media u drejtua nga strukturat më të larta të partisë-shtet, duke e humbur tërësisht rolin e saj informues dhe raportin me të vërtetën.

Pas rrëzimit të diktaturës komuniste, në vitin 1990 rikthehen përpjekjet për median e lirë. Padyshim që sfidat do të ishin të vështira pas një periudhe të errët 45-vjeçare, ku media e lirë nuk kishte ekzistuar. Liria e fjalës nuk mundi ta ndryshojë mendësinë e vjetër të pushtetarëve për ta përdorur median. Numri i madh i gazetave, revistave e kanaleve radio-televizive që u shfaqën në vitet e para pas shpalljes së pluralizmit, solli një situatë kaotike në mungesë të ligjit për median dhe informimit mbi publikun. Nëntet 1998-2000 u vu re një rritje cilësore, si në përmbajtje, ashtu edhe në formë, e organeve të shtypit bashkë me zgjerimin e tematikës duke përfshirë kulturën, artin, sociologjinë, filozofinë dhe letërsinë.

Pas vitit 2000, filluan hapat e parë për liberalizimin e tregut audioviziv. E ndërsa shtypi i shkruar sa vinte e tkurrej, publiku po shpenzonte gjithmonë e më tepër kohë para ekranit të televizorit. Në këtë kohë filluan të shfaqen edhe mediat e para *online*. Zgjerimi i medias dhe përfitimet e mëdha ekonomike në një treg jo konkurrues me mbështetje financiare edhe nga qeveritë e radhës, e kthyen median në një sektor atraktiv për punësim dhe karrierë.

Pavarësisht lirisë së shprehjes, ndërthurja e interesave të fuqishme të biznesit dhe politikës po e pengon zhvillimin e medias së pavarur. Në shumë raporte të organizatave vendase dhe të huaja, vihet re se ushtrimi i profesionit të gazetarit në Shqipëri përballet me vështirësi të shumta, si qasja e fortë politike e medias, e ndikuar nga interesat ekonomike ose politike të pronarëve të tyre, moszbatimi i kontratave

të punës, sjellja denigruese e pushtetarëve dhe dhuna ndaj gazetarëve gjatë ushtrimit të profesionit.

Pas ndryshimeve të shpejta që ndodhën vitet e fundit në median shqiptare, me shtimin e kanaleve televizive, strukturimin e platformave digjitale dhe shpërthimin e portaleve, u vunë re disa dukuri të reja. Shumë prej mediave *online* i japin rëndësi vetëm sasisë së leximeve, apo klikimeve, duke shkelur hapur kodin e etikës. Është shtuar përmbajtja me lajme të rreme, thashetheme dhe keqinformime, duke manipuluar opinionin publik në favor të interesave politike apo ekonomike të pronarëve të medias.

Tranzicioni i gjatë, i shoqëruar nga mungesa e kulturës demokratike, si nga politika ashtu edhe shoqëria shqiptare, nuk ka bërë të mundur krijimin e një mjedisi të përshtatshëm, që media të luajë rolin e saj kryesor në informimin transparent të publikut dhe garantimin e standardeve të demokracisë, siç ndodh në të gjitha vendet e zhvilluara. Por, pavarësisht të gjithë problemeve që ka ende media në Shqipëri, shumë gazetarë kanë lënë gjurmë në profesion dhe kanë vazhduar misionin e tyre, ndonëse janë përballur me dhunën e pushtetit, fyerjet e kërcënimet.

Aneks 1: Shkrime të përzgjedhura nga shtypi shqiptar

Në këtë aneks, ribotohen të plota disa prej shkrimeve, që janë marrë si referencë gjatë studimit për vlerat e veçanta dhe ndikimin e tyre në ecurinë e medias shqiptare.

Armiqtë e shqipërisë

Faik Konica (Tranc Spiro Beg)

Revista "Albania", 25 mars 1897

Të gjithë ata qi kanë njohur mirë vendin tonë, shkrojnë se dhe i Shqipërisë munt të japë bukë nizat million shqiptarëve; e dini që jemi tre milion dhe që dy milion prej nesh ngordhim uriye; shkrojnë se shqiptarët janë mjaft të mënçur me punuem, nuk vetem për zbukurimin e tyre, por edhe për mirësinë, edhe për dritën e gjithë njerëzinë; e dini mirë që shqiptarët të mësuar janë me të rrallë se fjalë të vërteta në gojë prifti. Cilët prejtin bukën e barkut cilët prejtin bukën e mëndjes.

Të dojin shqipëtarët lirinë e Shqipërisë, lehtazi e bëjin; por rrinë të patundur edhe andej dëftojnë që s'e duan Shqipërinë, dëftojnë që janë armiqtë e saj.

Dëgjoni mirë në mos e dini: s'janë armiq vetëm duke ndenjtur duart në gj, por ditë për ditë edhe ndryshe punojnë kundër mëmëdheut. Sa të fëlliqura shkruhen në Greqi, a tjatërkund kundër të mjerëve shqiptarë, kundër Paloarvanitëve, sa kanune lindën në Stamboll për të therur Shqipërinë (Pis-arnautlluk), të tëra shqiptarët i nxjerrin.

Shkaku i këtyreave të ligave është se Shqipëtarët s'kanë shpirtin mjaft të lartë për të dashur lirinë; shqiptarët psherëtitin nat e ditë pas orës tek do të mundin të jenë fare fare robër nën turkun e nën grekun, të hidhen në përpara ghorgos, ti qërojnë thonjët me gjuhë. Veç zakonës qi hyri në gjak të shqiptarëve, të veshin gjithnjë lëkurën e turkut e grekut e ndonjë tjetri zotit, është dhe shkaku i gjuhëve e besave.

Ata prej nesh që nuk e kuvendojnë shqipen, arrijnë lehtëzi të besojnë se nuk janë shqiptarë. Çka të bëjë gjuha në këtë punë? Helvecianët, për tregim, kuvendojnë ca frëngjisht, ca gjermanisht por janë një komb. Pse? Se kanë rrzëzë (rrënjë), edhe kombi është punë rrzëzë, jo gjuhe.

Tjetri shkak është që ka ca prej shqiptarëve që janë sunetisur, ca të pagëzuar. Këto të dy punërat mjaft për të qeshur janë, edhe në qoftë se ndonjë këndonjës nuk i njeh-ja, shkurt qysh bëhen. Kur rritet një djalë shtatë a tetë vjeçar, i ati i tij fton miqtë, han e pinë dhe këndojnë; pastaj duke rënë vjolinës, një maskara i qaset të gjorës foshnje- e cila ulurin dhe përpiqet- edhe me një gërshërë në dorë i pret një thelë mish te një vënt që është turp ta emëron. Janë shqiptarë që s'e bëjnë këtë punë; por ata, kur lindet një djalë, ja shpien një prifti mjekërqelburi, i cili e merr edhe e kthen lakuriq brenda në një magje plot më ujë.

Mos e mirrni shtrembër mendimin tim, u lutem; unë s'kuvendonj kundër këtyre punërave; të mirat e të ligat, çdo njeri është i lirë ti besojë edhe ti mbajë. Vetëm një pyetje kam për të kërkuar, duke falur nderës: a kuptoni se si mund ti ndërrohet rreza një njeriu sepse- kur qe djalë- i këputnë një copë mish a e vunë brenda në një magje? Mua sma pret mëndja.

Ç'është liria?!

Faik Konica (Tranc Spiro Beg)

Revista "Albania", prill 1897

Ç'është liria? Në mbetet pak kohë akoma. Dua të marr shpatën t'u caj kokën gomerëve dhe në vënd të trurit të vendos këtë: ç'është liria? Të mos të kisha nisur këtë fletën (vaftë në djall), s'do të humbja kohën time tu mësoja gomerëve ç'është liria. Dy muaj janë bërë qysh kur u nis kjo punë dhe tani jam lodhur nga shkak i gomerëve. Më mirë të shes pleh njeriu se sa të nisja punë për shqiptarët. Janë nja 50 shqiptarë që e kuptojnë ç'është liria. Ata nuk na shkrojtën gomarlleqe sepse e dinë që është i lirë njeriu të thotë se e ka në fund të shpirtit. Por të tjerët janë gomerë. Pasi të shtyp 12 numra pas fjalës që thashë a e dini se çfarë kam për të bërë? Qibaret le të mbyllin veshët: kam vendosur të shes mut në vënd që të mbaj këtë të përkohëshme

(revistën “Albania”). Më mirë të shes mut se sa të shkruaj për shqiptarët. Gomerëve pra, le të përpiqem edhe një herrë që tiu mbush kokën me këtë: ç;është liria?

Liria është që njeriu të mundet që: 1- të besojë çfarë i do zemra; 2- të thotë çfarë i do zemra; 3-të shkruaj çfarë i do zemra; 4- të bëjë çfarë i do zemra, por jo ato që janë kundër lirisë së tjetrit.

Por shqiptarët në shumicë janë shpirtrobëruar. Për dëftim: janë shqiptarët që kanë fe. Unë them: ata janë të lirë të kenë fe, janë të lirë të thonë që kanë fe, janë të lirë të shkruajnë që feja është e mirë, janë të lirë të bëjnë ç’urdhëron feja. Kur më dërgojnë artikuj për të lavdëruar fenë unë i botoj sepse nuk kam të drejtë tiu pres lirinë e fjalës. Por kur unë mendoj dhe do ta shkruaj: më vjen për të vjellë me çdo fe (besim fetar). Pastaj ata shpirtrobërit më thonë: nuk të lejojmë të kesh lirinë të shash fe-rat.

S’më lejoni të shaj fe-rat? Po unë o shpirtrobër pse ju lejoj të lëvdoni fe-rat? A kini sadopak mënd që të kuptoni se fjala juaj është fjalë gomari?

Vëllezër shqiptarë! Mjaft rrojti e gjora Shqipëri jetën e Kurmit, duhet dhe ajo të nisë tani të jetojë jetën e mëndjes (la vie intellectuelle). Jeta e mëndjes është të hapim të gjithë zemrat tona, të flasim vëllazërisht njëri kundër tjetrit të kuvendojmë si njerëz të qytetëruar që mblidhen të luftojnë me fjalë për idetë e tyre. Më besoni se nëse vazhdojmë kështu do të largohemi nga njëri-tjetri. Në të kundërt do të afrohem më shumë, do të njihemi më shumë, nuk do të mbajmë mendime të fshehura dhe do të kuptojmë që të gjithë jemi të lidhur me dy lidhje të arta: dëshira për të vërtetën dhe dëshira për Shqipërinë.

Për të qënë e mirë një gazetë duhet të ekzistojë si Pazar. Një Pazar ku gjenden njerëz të pasur, njerëz të varfër, gra, burra, djem, të gjithë bashkë dhe duke kuvenduar me qëllim që të merren vesh për të ardhmen e tyre.

Bërtim!

Mit’hat Frashëri (Skëndo Frashëri)

Revista “Albania”, qershor 1897

Më duket ndonjëherë që do të vijë një fuqi nga qielli e tu qaset shqiptarëve e ti shkundë e ti thërrasë: zgjohuni nga gjumi! Jeni buzë varrit! Gjër kur robër, gjër kur si kafshë? Është çudi, shqipëtarët nën zgjedhën e turqve!

Orë vëllezër, orë shpritra, ore burra, ne jemi shqipëtarë djemt e

pellazgëve, më të vjetrit e kombeve që erdhën në Evropë. Kemi qënë të mëdhenj, të fortë, me fuqi, mbretëri, qytetari e çdo gjë, kemi mundur gjithë botën thuajse, dhe e gjithë historia jonë e vjetër është e ndritur. Pastaj nga 400 vjet më parë erdhi një komb i vjetër në Evropë i cili, o faqëzinj, na mundi e na mori nën zgjedhë ku jemi edhe sot. Ky komb barbar është Turqia. Njeri nga ka mundur në jetë e ky turku të na mundë! Oh, e keqe mynxyrë!

Nuk e shihni pra vëllezër që turqit janë të huaj, neve na kanë si robër e janë armiq të tanë? Ç'të ngjarë kemi ne me ata? Ata janë nga rraca e mongolëve, ne Pellazgë, ata halldupër, ne shqipëtarë të perendishëm, ata tjetër gjuhë, tjera zakone, tjetër mos e di unë ç'gjë tjetër... në thënçi se më të shumtit e shqiptarëve kanë një fe me turqit (po feja ska ç'të bënë), mund të themi se frengët, italianët, moskovitët dhe grekët, janë vëllezër me qënëse janë të krishterë? Pse ata nuk janë të gjithë bashkë? Sepse nuk janë një komb. Po ne mos jemi kafshë për të qënë vëllezërit e tuqve? Dëgjoni ore shqipëtarë! Ne çtë mirë kemi parë prej halldupëve? Gjithnjë na shajnë, na pështyjnë, na rrahin, na kurvërojnë, na turpërojnë. Kurrë ndonjë të mirë skemi parë prej tyre... kemi qënë zotërinj me nder, të pasur, të lumtur, sot jemi evgjitë.

Turkun ne e kemi mbajtur dhe sot ne po i shërbejmë; po i japim të dhejtat për udhën, për shkollën, e çtë mirë shohim? Pa shkollën, pa udhën, pa siguri, në çdo anë kusarë, në çdo katër çipat të liq. Valiu, mutesarifgi, kajmekami, mydyri, të tërë kusarë, të liq, të ndyrë, pa turp, pa sedër, pa gjë...të gjithë na rrjepin, na vjedhin dhe ndonjë të mirë s'kemi. Në anët tjetër grekët, bullgarët, serbët shohin kaq të mira; ne po derdhim gjak si kafshët për mbretërinë e turqve dhe ai po i jep Beratin Shkijeve. Nuk po e shihni o vëllezër se halldupët po na shesin sikundër shitën Ulqinin, Barin, Nishin dhe Thesalinë.

E harruat se si mbreti i halldupëve dërgoi Dervish Pashën tetëmbëdhjetë vjet më parë me 40,000 ushtarë dhe i dha Ulqinin Malaziut? Ashtu edhe sot Thesalinë që shqipëtarët e morën me gjakun e tyre po ia shet prap Moresë. Po vet të jemi të verbër për të mos parë se sa turqit të trashë janë armiq të tanë dhe sa po vuan Shqipëria prej tyre. Ah o vëllezër! Më s'na mbeti gjak as turp që kur na duron zemra duke parë gjithë këto të këqija. Gjër kur, gjër kur do të jemi nën këmbën e halldupëve?

Halldupët, sikur s'arrijnë të na bëjnë të tjera, po na ndalojmë të këndojmë gjuhën tonë në shkollën, dhe ne ende po durojmë.

Shqipëria ka armiq halldupët por më të tepërtit i ka në gjitë të saj.

Një pjesë e parisë shqiptare janë bashkë me turkun e bëjnë aq të lig sa edhe ata (turqit); rrjepin vegjëlinë, vrasin, vjedhin, çfarë s'bëjnë. Të tillë janë me qindra në toskëri dhe në gegëri; të tillë janë në Fuat Beg e në

Hysen Beg në anë të Prevezës. Këta zotërinj të qelbur ishin pushtetarë pas Veliut, Havzi pashës që është një prej më të mëdhenjve të Turqisë dhe çfarë vidhnin i ndanin në mes. Pra zotërinjtë Fuat e Hysen slinin gjë pa bërë si dhe të tërë të liqt' e tjerë dhe shpresonin se halldupi kish për ti lënë të qetë. Por shikonin sa gënjejshin megjithë ata të dy zotërinjtë treguan shumë trimëri në luftë të fundit të Moresë. Valiu me shokë u ngjiten të pabëra dhe i hodhën në burg, atje janë edhe sot. Duke thanë se i ndihne Moresë.

A e shihni ju o parësi të liq që bëheni një me trukun e bëni njëmijë ligësira. E shihni që të gjiha janë kot e që turku që e kujtoni mik është në të vërtetë armik e jua nxjerr nga hundët atë që keni përfituar. Por mblidhni mëntë e ndahuni prej halldupit se ay ka për tju kallur të gjallë në varr, në mos sot, nesër.

Ah Shqipëri! Ne që shkruajmë këto, ishim takuar me ata dy zotërinjtë që sot janë në të Tralos dhe i kishim dëgjuar që lëvdonin Turqinë, e thoshin se kanë vëllezër turqit. Zoti e faltë këtë vëllazëri kaq të mirë.

Guxojmë të themi se të gjithë atë që janë bërë me halldupët këto kanë për të patur. Por të mbledhin e të mbledhin mëndtë.

Ligësi e Kuvrnës së turqve u hyn nga njëherë me pahir shqiptarëve. Valiu i kërkon të holla parisë në Shqipëri të cilët shpesh shtrëngohen të vjedhin edhe vetë prej vegjëlisë dhe ndajnë plaçkën me valinë dhe me atë Firuanë që e thonë Sulltan. Kështu shkaku i gjithë ligësisë që bëhet në mëmëdhe është turku. Por edhe këtë të mos gënjejshin se në fund turku nga hunda ka për ta nxjerrë. Turqit ne na kanë halë në sy.

Andaj o vëllezër, të bashkohemi të tërë tok dhe në mos përzënçim dot fare halldupët nga Shqipëria, të paktën të përpiqemi të mos na përziejnë kështu fare në Shqipëri, të mos bëjnë ligësira. Të përpiqemi të hapim shkolla në gjuhën shqipe në çdo anë, të marrim autonominë dhe të rrojmë dhe ne si njerëz e jo kështu si kafshë si robër.

Kur të kemi autonominë tonë, dmth që çdo punë ta ketë në dorë vendi e të ketë mbledhje në çdo qytet e që pa pyetur ato të mos bëhet dot gjësendi, që ushtria të rrijë në vënd kur ska luftë e të mos veje andej këndeje e të vdesë urie, të shihni se sa e bukur, e pasur, e lumtur do të jetë Shqipëria; si do të dritohet e do të lulëzonjë, akush nuk ka për të guxuar ta ngasë, por sot, duke parë që duam të rrojmë robër nën turkun që nuk jemi një komb, që se duam lirinë, që skemi gjuhë, që jemi kafshë, të gjithë na vështrojnë si të vdekur dhe duan të na copëtojnë. Kështu janë greku, bullgari, ilatilanët, dhe kanë të drejtë se sna shohin të lëvizim as këmbën as dorë por duam të gjithë të rrimë nën këmbë të turkut.

Erdhi koha të tregojmë që kemi shpirt, që jemi të gjallë e të fortë e jo

kufoma si na pandehin armiqtë. O burrani! Të hidhemi të tërë e të zhdukim hithrat e ferrat që na kanë hipur përsipër e sna lënë të marrim frymë. Të zgjohemi se jemi buzë varrit.

Nuk e shihni se si greku, bullgari, serbi dhe malazezi që i kemi fqinj u zgjuan e tani janë të lirë e të lumtur; edhe ata kanë qënë një herë robër nën halldupët por mblodhën mëntë e u zgjuan e në mos jemi ne më të dobët se ata për të ndenjur kurdoherë shërbëtorë të turqve.

Kemi katërqind vjet që jemi robër nën këpucët e turqve: të zëmë pra tani të marrim frymë e të rrojmë!

Koha s'na pret

Mit'hat Frashëri (Lumo Skëndo)

“Kalendari Kombiar”, 1899

Kurajo dhe shpresë pra! Të mos humbasim kohë! Të shohim e të vemi përpara, të tundemi e të ç'pihemi sepse deri tani kemi qënë në gjumë....

Koha na tregon dhe s'na pret. Në krye të vitit 1898 na shtypën serbët dhe bullgarët, bënë komitete të mëdha, ku thuhej se Kosovën e do Serbia dhe Bullgaria. Ne shqiptarët që duhet të jemi të zotët e Shqipërisë, rrimë të hutuar e vështrojmë së largu sikur jemi të huaj. Sa turp!

Lutje e shqiptarëve. Në vjeshtën e tretë të vitit 1898, një grup shqiptarësh në Bukuresht bënë një lutje për të kërkuar autonominë, dmth vetëqeverinë e Shqipërisë. Kjo lutje u shkrua në gjuhën frënge dhe në atë italiane dhe iu dërgua sulltanit dhe ambasadorëve në Stamboll.

Në emër të kauzës shqiptare! Shoqëritë kombëtare, ligat kombëtare të cilat janë ngritur jashtë Shqipërisë, me mision për të mbrojtur mëmëdhenë, kërkojnë nga mëdhësi e tij Sulltan Abdul Hamit Han i II, zot i madh dhe mbret i otomanëve, të njohë të drejtat e kauzit shqiptar dhe të japë autonominë administrative e cila do të jetë sipas kësaj mënyre:

- Të besuarit e katër vilajeteve: Shkodër, Kosovë, Manastir dhe Janinë në të vetmin vilajet i cili të ketë një qeveri me qendër në Manastir.
- Në të tre vilajetet e tjera në Shkodër, Kosovë dhe Janinë të ketë nënqeveri dhe ata të jenë gjithashtu shqiptarë.
- Gjuha kombëtare shqipe të njihet si gjuhë zyrtare e qeverisë dhe të vihet në kishë e në shkolla
- Të lirohen të gjithë mëmëdhetarët shqiptarë që janë në burg a të dëbuar në dhe të huaj nga shkaqe politike. Kështu do të pajtohet qeveri e

Kostandinopojës me popullin shqiptar.

- Qeveria otomane e Shqipërisë të paguajë çdo vit një pagë madhësisë së tij Sulltanit
- Të mos bëhet fjalë për të marrë armët sepse armët u duhen shqipëtarëve për të treguar se shqiptarët janë kurdoherë gati të mbrojnë atdheun e tyre e të ruajnë mbretërinë të paprekur.

Kalendari i Shqyponëtorëve!

Faik Konica

“Kalendari i Maleve” 1900

Kristoforidhika përdorë fjalën shqypon për: flas shqip. Prashqyponëtorë u thomi gjuhëtarëve që dinë shqypen e përpiqen me qit në dritë kanunet e saja. Vit për vit kena me shpall jetën e fytyrën e disa shqyponëtorëve e ma fort në daçin me na ndihmue pak ligjëruesit e “kalendarit” tu na çue shka munen me dit e me pas në dorë përmbi ata burra, shqyptar a të huaj që u banë shkak me e shty përpara mësimin e gjuhës kombëtare, me Kristoforidhin.

Nelko Kristoforidhi. Kristoforidhi u lind në Elbasan në fund të së parës gjysëm të këtij shekulli. Emrin ia vunë Kostandin në kishë, por mas zakonit e si bie ma mirë në gjuhë shqype e thërrisnin Nelko.

Nelko ndodhej në Janinë kur mbërrini në kryeqytet të Shqypnies së poshtme Gjergji i Hahnit si konsull i perandorisë austriake. Hahni, që kishte me diftuer në një libër të madh e të thellë, i pari i shqyponëtorëve (albanolog), filloi atëbotë me mësu gjuhën shqipe dhe për këtë mori dy mësues shqiptar, Apostolin dhe Nelkon. Apostoli që ishte mjek i plagëve, doli pemë e thatë, do me thanë sbani gja për shqipen. Por Kristoforidhi mori që atëherë shije të madhe për gjuhën kombëtare e iu vu mbrapa me gjithë zemër. Përveç të katër ungjillave që i përktheu toskërisht e gegënisht si dhe historinë e shenjtë e plasterin e Davidit, Kristoforidhi ka shpallur (botuar) edhe dy gramatika shqipe. Por më e rana (rënda) punë e vet është fjalori i madh shqyp greqisht për të cilin punoi për njizet e pesë vite për me mbledh të gjitha fjalët e gjuhës shqipe. Dorëshkrimi i këtij fjalori është sot në duart e birit të vet e na man uzdaj (na jep shpresë) se ka me mbërrit dita kur ta shohë dritën ai thesar i vërtetë i gjuhës shqype.

Kristoforidhi ka dek tash gjashtë vjet e emri i tij ka met i paharrueshëm në zemrat e atdhetarëve. Kristoforidhi është i pari, mjerisht i vetmi ndër shqiptarë që kish nevojë me bashkue gjithë menytrat e foljet e Shqipërisë

e me krijue një gjuhë të shkrimit. Thom të shkrimit se merret vesh që t'flitet shqypja në shumë mënyra si fliten gjithë gjuhët, por atdhetarët e mendueshëm e të dishëm kanë me kuptue sa nevojë kemi me e shkruie gjuhën shqipe të gjithë në një mënyrë. Kristoforidhi duket se ka kenë apostulli ma i parë i këtij bashkimi të gjuhës e prandaj emni i tij smundet me u harrue. S'ish si do shkrimtarë prej nesh që duen me e shkruie gjuhën shqype krejt në gegnisht o krejt ne toskerisht që ta kuptojë gjysma e Shqiptarëve. E ket menim sikur më kish ken i ndihmuem pak, Kristoforidhi kish me marue por iu dorëzue zemra e shpresa prej se shihte se shqiptarët të le për me kenë gjithmotit robër e shërbëtorë, s'dojshin me mësue gjuhën e vet e me krijue shkolla e shoqni mësimesh. Por megjithse nuk mujti me sjell në drit at menim nato libra fejet që shkrojti, duket se ka pasë dëshirën me shkru një gjuhë të përbashkueme që t'munej me u marr vesh edhe prej toskëve edhe prej gegëve.

Mbi Abetaren

Giuseppe Schiro

"Flamuri i Shqiperis", 1 janar 1904

Ki numër i Flamurit nuk del me shkronjat që përdoren sot për sot ndë Shqipëri e të cilat atje këndojnë më të shumtët, përse këtu nuk gjenden fare. U shtrënguam të këmbëjme, për një a dy herë, ca të pakta, e kemi porositur ndë një fabrikë ato që na duhen, ndonëse besojmë se s'do ti mbeten shqiptarëvet kur ata të jenë të zotët të kenë liri për mësim si dhe për të tjera gjëra.

Me të vërtetë ato shkronja që mbledhmë myslimanësh e të krishterësh, për të çpikur të Vaso Pashës, Vali i Livanit, njëri nga më të diturit jo vetëm të Shkodrës, por thuajse të Shqipërisë së tërë, zgjodhi në Stamboll në 1979, pas kongresit të Berlinit e pas lejes që i dha Sulltani, i cili atëherë ishte gjithënjë me dëshirën e Evropës, ato shkronja për të cilat disa njerëz kanë hequr e heqin shumë nëpër burgje e nëpër shkretëtira të Azisë e të Afrikës, na thomi: hapë e pa fshehur mendimin tënë me fjalë të tepëra, nuk na duket të jenë ato që i lipsen gjuhës tënë pas diturisë.

Për këtë punë nuk mundim as duam të flasim këtu gjërë e gjatë. Disa njerëz të lartë e të dishëm u kanë munduar ti ndryshojnë ndë Shqipëri por më kot. Kush i dëgjon? Për fat të keq atje shkolla kombëtare nuk ka, edhe atë të vetme që ishtë e që lulëzonte në Korçë, armiqhtë e gjakut t'ënë e prishën me

të shpifura, me të kallzuara e me të gënjeshtërtë; guverna turke shqiptarët do ti mbajë në të errët e me nape (perde) tek sytë. Të mos guxojmë tui shuajmë atyre edhe këtë dritë të vogël që kanë e që ruajnë burrërisht 24 vjet!

Kush ndodhet ndë dhe të huaj është i zoti të bëjë, të thotë e të shkruaj sipas dëshirës që ka. Edhe ne të themi pak, kemi dy abetare, mos më shumë. Të tjerë e kanë shtypur këtu e këtej nëpër Evropë. Po shqiptarët e Shqipërisë nuk i kanë e as kanë kohë të humbasin duke vatur sa tek njëri tek tjetri ndër të këqijat e ndër rreziqet ndë të cilat jetojnë.

Kur ata të kenë shkollat e tyre si të gjithë kombet e tjera, kur ata të jenë të mësuar ashti si ngjet. Kur mundet që ata të flasin ashtu siç duan e ashtu si duhet mbi të këtilla gjëra, atëherë është koha për të qëruar, për të ndërtuar a për të bërë përsëri abetaren kombëtare. Mos ti vështërojmë këto ditë o burra në shpata që kemi ndë dorë do të ketë meru tartë a në do të ketë të hekurt.

Ngjarjet e motit 1908

“Kalendari i Korçës”, 1909

- Ngjarja e ktij moti ma e madhja është konstitucioni.
- Të dhjetë vjetët e parë të këtij shekulli të njëzetë do të jenë të paharruem për dy gjëra: Luftë e Ruisë me Japoninë dhe shpalljet e konstitucionit në Tyrqi.
- Luftë e Japonisë rrëzoi despotizmën e Ruisë, rrëzoi fuqinë e një mbretërie despotike, shpëtoi dhe Turqinë nga thonjtë e kësaj Rusije.
- Po këta dhjetë vjetë janë vitet e konstitucionit: Rusija, Përsija, Mali i Zi, Çini shpallte konstitucionin në vënd të tyre: më së fundmi na ku dhe Tyrqia mbylli kohën e despotizmit.
- Konstitucioni u shpall më 10 korrik 1908.

Nga këtu histori e këtij konstitucioni:

- Më 1876 Midhat Pasha, sadrazemi patriot, desh të shpëtojë Tyrqinë nga gremina dhe shpalli konstitucionë. Tre muaj më pastaj, në mars 1887 hapet në Stamboll mbledhja e kombit (Meçlis-i-Meb’usan). Mbledhja u çel dhe motin e dytë, pastaj s’u mblodh edhe një herë.
- Jo vetëm mbledhja e kombit më s’u mështoll(mblodh) dhe një herë por konstitucionit ca na ca iu harrua edhe emri. Aherë nisë ata vite të zes, vite të tmerrueme: qeveria e shoi despotizmën, e padreqta mbretëronte

tek-do, punët vanë rrëmujë, spiunët u shtuanë si mushkonjat, njeriu i varfrë rronte në tmerr, se sdintë në do gdhinte në shtëpi, s'dinte në do t'gdhinte në shtrat.

- Kjo jet e zezë, kjo jetë me vdekje përpara syve, mbajti 31 vjet.
- Më këto tridhejte e një vjet kombet e Tyrqisë i kish rrethuarë një gjum i rëndë: gjithë rënkoni, po asnjë s'nxirrte dot zënë, s'nxirrte dot zënë përveç duke nxjerrë tym dhe zjarr: këtu ngjanë punët e pakta t'Ermenistanit, dhe të Maqedonisë.
- Edhe rrojtj'e Tyrqisë ish më sot më nesër! Tyrqit vetë lëngonin, dhe kombet e tjerë përpiqeshin të ndahen nga Tyrqia.
- Por ishin edhe ca njerëz që punonin nën fletë. Në Paris ish një shoqëri "Tyrqit e rinj" që punonte për të përhapur mendimet e lirisë dhe të mëmëdhetarisë. Këta njerëz nxirrnin në Evropë edhe ca fletore që kishnin më shumë rrezik brenda në Tyrqi.
- Megjith këto të punuarët e këtyre s'ishin gjërë me themele, mbase themi se shumë herë bënë edhe më tepër dëm se fitim.
- Nja katër vjet më parë në Selanik u bë një shoqëri prej djelmoshëmëve mëmëdhetarë. Kjo shoqëri nën emër "bashkim dhe mbrojtësi" (Ittihad ve Tereki) më pak kohë mori në gji të saj shumë njerëz, po më tepër u përpoq të marrë oficerë (zabitët) se po fort bukurë kish këputurë që pa marrë Brenda ushtrinë do-me-thënë fuqinë, zbëhet dot gjë.
- Punët vanë të fshehta, disa vjet, po vjet në verë zunë të rrëfejnë vethenë.
- Ushtëritë e Maqedonisë që kishin gjashtë vjet në shi e në baltë panë me sy të tyre gjithë rrezikët, gjithë të këqijat e Tyrqisë; ushtarët dhe oficerët muarën dhe pak mësim nga bullgarët dhe grekërit e Maqedonisë që vriteshin dhe s'kursenin fare vethen e tyre.

Nga këtu disa ngjarje paravajtës të konstitucionit:

- Më 29 të majit i bjenë për të vrarë Nazim Beut në Selanik, që po nisesh në Stamboll për të dhënë emrat e ca oficerëve të shoqërisë.
- Ahmet Niazi effendi Resnja, ikën në mal me ushtarët e tij.
- U vra në Manastir Shemsi Pasha që ish i dërguar për të mbytur lëvizjen e oficerëve.
- 23-27 qershor u plagosnë në Selanik dy spiunë Hari Aqif dhe myftiu i ordhisë së tretë.
- 6 korrik u plagos në Manastir Liva Osman Pasha.
- 9 korrik në vënd të Ferid Pashës u bë sadrazeum Said Pasha.
- 9 korrik në Gjevgjeli afër Selanikut ushtarët shpallin konstitucionin
- 10 korrik në Manastir hodhën 101 topa dhe shpallet konstitucioni

- 10 korrik në Seres dhe Selanik bëhenë mbledhje të mëdha dhe shpallet konstitucioni.
- 10 korrik natën vjen tejshkrimi nga sadrazami dyke thënë se sulltani e dha konstitucionin.

Gjithë këto ngjarje dhe më tepër mbledhje e katërmbëdhjetëmijë shqiptarëve në Ferizoviç, e bëri qeverinë e vjetër që të mejtohet: veç kësaj dhe ushtarët që kishin ardhur nga Anadulli në Selanik për tu dërguar kundër “të përndërkryervet”, s’deshnë të vënë të luftonjë kundër vëllezërve të tyre.

Kur kuptuan anëtarët e lirisë se ishin mjaft të fortë e shpallnë vetë lirinë: më 10 të korrikut në Manastir, në Seres, në Selanik dhe gjetkë bota zuri të dridhet nënë frymë të lirisë; atë mbrëmje erdhi urdhër nga Stambolli dhe thosh se mbreti e dha përsëri konstitucionin q’ish ngriturë tridhjet e një vjet më parë.

Kjo ngjarje e madhe e ndërroj menjëherë punët e Tyrqisë. Evropa e tërë që kish një mëri kaqë të madhe dhe të vjetër kundër Tyrqisë, q’atë çast zuri të tregojë një miqësi dhe një çudi të madhe për ngjarjen e madhe që u bë kaq lehtë dhe me kaq urtësi, pa derdhur asnjë pikë gjak.

Më një çast armiçësi e Evropit u shndërrua në simpati dhe ata që pritnin vdekjen e Tyrqisë e panë se u ngjall dhe u shëndosh.

Është e vërtetë se pas konstitucionit duallnë dy të vështira njëra nga ana e Bullgarisë që deklaroi vethen e saj më vehte dhe tjetra nga ana e Austrisë që deklaroi aneksionin e Bosnje Hercegovinit, po dhe këto është shpres e madhe që të ndreqnë me paqe dhe me urtësi.

Si një pemë e konstitucionit më 4 të qershorit të Shënëdreut u çel dhe mbledhja e kombit, ku ku depytë(deputetë) të zgjedhur prej kombit nisnë të kqyrin punët e mbretërisë.

Gazeta “Korça”

Petro Nini Luarasi

8 qershor 1909

“Fort i ndërçim zoti Direktor i gazetës Korça!

U lutem të më dhuroni pak vent në të ndërçimen gazetë të zotërisë suaj të çpall dy fjalë vëllazërisht në të dashurit shqiptarë. Me qenë që shumë shqiptarë pandehin se kanë shprehje, duke patur fatin që t’u epetë pak liri për të kënduarë dhe nxënë gjuhën’e tyre, pa vënë re fjalën e urtë që thotë:

“Kush ra poshtë të kujdeset të ngrihetë, dhe kush qendron ngrehetë të vërë re se mos bjerë”. Të tillë shqiptarë janë si shqerat që s’kanë provuar nonjëherë thonjt’e ujkut, as kanë dëgjuar për laqet dhe dinakëritë e dhelprës dhe me qenë që shumë Shqiptarë e dëshirojnë përparimin e gjuhës së tyre po e kërkojnë si manushaqe, ta mbjellin të tjerë e ta përgëzojnë ata, pa kur e shohin që fishket ajo manushaqe e bukur, tek duhetë t’i apëmë krahun e shërimit, ata, pa turp kthejnë sytë mënjanë dhe bëjnë sikur s’e njohinë, andaj për ta, të thjeshtë mëmëdhetarë që kanë shpresë të vdesën si Shqiptarë, u themi që të dini se në fshatrat e Kolonjës një propagandë greke me intriga të hidhura është ngrehur kundër shqiptarisë dhe me vërtik e kuxim po përhapet e po dërmon zemrat e Shqiptarëvet, po më shumë të krishterëve të tillë.

Në ato fshatra që kanë marrë pjesë Shqiptarija, epet pagë në priftrinjtë që të ngatërrojnë fshatarët dhe të priren nga an e grekërvet, dhe në pleqt të fshatit (n’ata më të fortët) e këtyre fshatrave, epet dhe me të fitimçime, (pagesa të larta), po të përkrahin anën e grekomanëve.

Veç këtyre armëve (gra dhe snaider) po ngulenë dhëndurë prej Greqie, e po forcojnë qëllimnë e kësaj propagande. Sot nuk do të zë ngoje për qendrat dhe për vetat e kësaj propagande që gjendet në mes të Kolonjës si thëngjill i mbuluar, por dyke ruajtur të gjurmojmë më tepër e më kthjellët paskëtaj, për qëllim të kësaj propagande të armiktë që po çnderon Kolonjën dhe shqiptarët e atjeshën. U lutemi gjithë shqiptarëvet të kthjellët që ta hedhin këtej dy orë gjumë dhe të rrinë zgjuar për fatin e tyre, dhe veçan lutemi, duke patur shpresë se kolonjarët që janë rrëfyer gjer dje mëmëdhetarë të kulluar do të lenë mënjanë zihjet dhe thashethemet, të cilat po trashin dhe forcojnë propagandat e huaja në vatrat e tyre, se gjithnjë, kur zihen macet, bëjnë minjtë dasmë.”

Lajme të brendme e të jashtme

Gazeta “Perlidnja e Shqipërisë”, nëntor 1913

Lajme të brendme

- Dje arriti në qytetin t’onë Z. Myfid Beu, ministri i punëve të jashtme, bashkë më Z. Eqrem Bej Vlora, një nga anëtarët e komisiës së dërguar n’Evropë për punën e viseve që gjenden në dyshim.
- Sindekur thamë edhe tjatër herë, Zotënia e tyne u-priten fort mirë kudo që vajtën. Delegatët e ministriës, sikunder dhe delegatia e popullit, u

kthyen në Vlonë me shpirtin e forcuën prej fjalëve që degjuen ndër vise ku vajtën. Premtimet e atyne q'ë kanë në dorë fatin e Gjinokastrës s'onë dhe viseve perqarj, thonë Z-nia e tynë, duke n'a siguruar se e drejto mbetet e drejtë dhe kurr nuk humbet, n'a mbushin me shpres e gëzim.

- Zotënia e Tij ministry i punëve te jashtme, paska thanë se pas lajmeve që ka, komisia e kufinjve të juges, do t'ia fillojë punën nga ana e Kolonjës, jo nga Stillo sindekur shkruajnë gazetata.
- Delegatët u nisën prej Korfuzit në Manastir dhe s'andejmi do të marrin rrugën e Kolonjës.
- Shqipëria, përsëri, po bahet theatër o Ballkanit. Artikulli i Z. M. Grameno që u botua në numrin e fundit nën titullin "Armikën e Komit të vet" dhe telegramin q'i a çuan Z. Esad Pashë Toptanit të rinjtë intelektualë, telegram që botojmë në numurin e sotmë, mjaftojnë për t'dhanë të kuptojnë kënduesve të gazetës përse themi se Shqipëria munt të bahet persëri theatër. Në numrin tjater do të botonen lajme të plota mbi këtë çështje.
- Këshilli i ministrave bani këtë vendim mbi vleftën e arit në doganë: Që më 1 të Vjeshtës së parë pagesat në doganë do bahen me ar (flori). Lira turke do meret per 100 grosh dhe napoloni me 88.

Lajme prej Elbasani

- Z. Lef Nosi, ministri i Postave arriti këtu. Si rall priti Elbasani njerës ashtu si e prit birin të tij, Lef Nosi. Kalorës, flamure, djem, shkollë as gja nga ato që munt t'a zbukuronin këtë pritje, nuk mungoi.
- Z. Eshref Bej, ingjiner i dërguar prej ministerit të punëve botore per t'a shikuar rrugën që lith Elbasanin me Durresin ariti së bashku me Z. ministër Lef Nosi dhe pa vonuar, a nis per Durrës.
- Mesojme së n'Ohr kanë ngjarje trazyra të mëdha, Kapedan Pera Çaulef, dolli maleve me tridhjetë shpirte. Gjer sot kanë vrarë gjashtë ushtarë sërbe.
- Disa Bullgrarë prej Kerçove të çathesuar prej Sërbiës, erdhën këtu.
- Një sëmundje njerzish u përhap në viset t'onë. Sëmundja quhet Linja. Lumtësisht, masat e mjekësve banë që damet e saj të jenë të vogëla.

Lajme të jashtme

Telegrama

- Romë, 30/12. Venizelos vajti dhe u poq me ambasadorin frënk t'Athinës. Fitet se kryeministri i Grëqisë, ka ndër ment të vejë edhe ay në Paris me regjin e kralliut Konstantin.

- Vienë- Aty lajmërohet, se Franca ma në fund emënoi edhe ajo përfaqësonjësin e vet në komisiën e kufinjve të jugës. Njani delegat është kolloneli Allerman, kreu i shërbimit geodhetik dhe i dyti Z. Graillet Voio.
- Romë 30/12. Delegat i Italisë në komisiën e kufinjve të jugës, Z. Labia ariti në Korfu, ku gjenden që ma parë, delegatet e Gjermanisë, ay i Anglisë dhe i Rusisë. Për-së shpejti pritet të vijë dhe delegatet e Austrisë, Z. Kushull në Balinski.
- Shtypi Italian, i uron komisiës se kufinjve, punë të mbarë, dhe flet gjanas për të drejtat e Shqipëtarëve që t'i shohin një'orë e ma parë të parguëm dyshimet që mbreterojnë sot dhe e pengojnë zhvillimin shtetit ma të ri t'Evropës.
- Kryekatundari që n' Spezzao Albanese i telegrafoi Z. de San Giuliani duke u lutur që qeveria italiane të perpiqet për ta mprojtur tanësin e tokës shqiptare duke bame që Gjinokastra dhe viset e tjera në dyshim, t'i mbesin Shqipëriës.
- Romë, 31/12. Për punën e Shqipërisë, Tribna boton një artikull ku thotë se vetëm pajtimi i plotë midis Austriës dhe Italiës munda ta sigurojë për shumë kohë paqen e pergjithme, sindëkur dhe jetën e shtetit të ri shqipëtar.
- Komisioni e kufinjve jugorë do t'a fillojë punën me 8 të këti muaji. Mesohet se puna do të soset me dy muaj e sipër.
- Delegat i Austrisë, Z. Bilinski arriti në Brindisi, sot. Nesër nisët për Korfu. Bashke me të asht dhe delegatet teknik, Z. Busckberg.
- Në komisiën e dytë që do të hyjë në Shqipërië, ajo që ka barrë cakëtimin e kufinjve nga ana e lindjes, Franca emënoi përfaqësonjësin e vet Z. Fourmier.
- Le Matin lajmohet prej Franchfurtit se Konstantini, regj 'i Greqiës, nisët nesër për Londër duke vizituar të parin kryetarin e republikës.
- Romë, 1/14. Ania italiane Ciclope, u nis nga Bari për në Shqipërië duke pasur brenda një biolog, anëtar i shoqëriës thailosografike edhe disa peshkatarë. Qëllim'i udhëtimit të këtyne asht të studiuarit e organizimit të peshkimit në bregdetin e Shqipëriës, që në Vlonë në Durrës.
- Prej Konstandinopojës lajmohet zyrtarisht se tregtimet midis Turqiës dhe Bullgariës do të marrin funt n'javën që vjen. Në Bari arritën nga Çamëria ma shumë veta prej parësiës dhe disa tregtarë. Të gjithë kanë ikur prej vendit të tyre.

Kritika

Mihal Grameno

Gazeta "Përlindja e Shqipnias", 23 Gusht 1913

Simotrat'onë "Shqipnia e re" në No.14 në një kryeartikull fort të goditurë bën fjalë për mi kritikën. Vërtet këjo sëmundje është fort e përhapurë në Shqipëtarët dhe në më të voglën çeshtje dhe bisëdim, kritika është në krye. Nuku kemi kupëtuar as na që ku e kemi trashëguar këtë dhurëti po, siç duket, me qënë që kritika është ajo m'e lehtë punë, e bëmë veglën t'ënë. Nuku ka më lehtë se të kritikosh veprat e tjetrit, nuku ka më lehtë që mos pëlqesh çdo gjë që bën një tjetër i cili nuku mundi të të mbushë dëshirat e të të kënaqjë. Po në është e keqe kritika është dhe shumë e dobishme dhe e nevojshme, po zemra e kritikantit dhe kritika mburon nga dëshira e vërtetë që të shërbenjë e të dëftenjë gabimet, duke këshilluar të mos përsëriten. Mjërisht, neve Shqipëtarëvet, n'a mungon këjo dëshirë e vërtetë, dhe as mendohemi për të e ndrequr, se po të analizohet mirë as që munt të quhet kritikë po egoizëm dhe kundërshtim pa rënjë, duke patur të vetëmin qëllim që dukë përdorur kritikën për veglë munt të mbushin dëshirat e tyre, pa u menduar që me këtë mënyrë mund t'i sjellim dëme popullit edhe atdheut. (...)

Me këtë mënyrë do të çpojnë kundërshtarët që të punojnë më mirë e të druhen nga çdo padrejtësi që munt të vepërojnë po vetëm siç thamë kontrolli dhe kritika të jenë të drejtë dhe të arësyeshmë. Shprehim që atdhetarët e vërtetë do të druhen nga një rugë të shtrembër e të dëmçme dhe do të kërkojnë të marin shëmbëll partitë të Angliterrës, në të cilat është çporur çpifja dhe gënjeshtria, që vështrojnë si patriotë të kontrollojnë veprat e partisë tjetre me drejtësi, e jo qysh çpifin për me marë vëndet e atyrevet që kanë fuqinë në dorë. Nuku n'a vjen të besojmë për ca Zotërinj atdhetarë, që i kemi njojtur për liberallë, të fshehin prapa maskës të patriotizmës egoizmen duke përdoryr për veglë, që të mbushin qëllimin jo vetëm çpifjet po dhe fenë!!!

Në qoftë që të vërtetohen këto, atëherë i sigurojmë që vetëm patriotë nuku janë edhe përveç që do të humbasën simpathinë dhe dashurinë të popullit as nonjë fitim nuku do të kenë. E drejta është e drejtë dhe sa do që të fshihet do të dalë në shesh për të dërmuar të shtrembërën. Le të kupëtohet një herë për gjithënjë që kombi Shqipëtar zuri të xgjohet dhe nuku do të lihet të hiqet prej hunde nga aventurierët, nga egoistët dhe nga gënjeshtarët, të cilët jo vetëm që s'kanë patur dhembë për atdhe po kanë qënë armiq dhe kanë kërkuar të nxjerrin fitime për vehten e tyre me maskën e patriotizmës!

Po sot falje Zotit Shqipëria u lirua nga Turqia dhe nuku zenë mazi metodat e vjetra, andaj le të dijet që Shqipëtarët kurrë do të mos lihen paskëtaj të hiqen prej hunde nga të këtillë zotërinj.

Njerëzit e zotit Esat Pasha dhe gazeta jonë -
Odhisea e një korespondenti

Gazeta "Përlindja e Shqipnies", 30 tetor 1913

Kur plasi në Dibër kryengritja e shkakëtueme prej ligësisë serbe, na, duke dashur që këndonjësit e Perlidnjes së Shqipënies të kenë lajme sa ma të reja e sa ma të drejta, çuam një korespondent, z. Haki Glina.

I ndershëm Drejtar.

Më emëruat korespondent i fletores "perlindja e Shqipnies" për të vajtur në Dibër. Pa vonuar u nisa nga ana e Durrësit, qyteti ku asht ngehur klika e një diktatori që quhet Esad Pashë Toptani. Me të zbritur prej vavorit vjen një polic e më thotë se armën duhet ta lë në zyrën e policies duke më premtuar se kam të drejtë ta marr kur të shkoj. I zura besë atij njeriut dhe ia dhash armën.

Dola pastaj të gjej kafshë që të nisem sa ma shpejt për Elbasan.

Me të gjetur atë që kërkonja u kthyesh të marr armën. Po, çudi, polici më thotë se pasha bani emër që unë të këthehem prarë nga kam ardhur.

I habitur e i dëshpëruar vajta ta pjek pashën, zotnija e tij n'a ish mbyllur në një odë me z. Bektash Cakrani. Prita gjër sa doli ky i fundit pastaj i çova kartë-vizitën time pashës. Më thirri. Me të hyrë i them se dua të vete në Dibër: s'kuptoj përse urdhëruat të kthehem prapë, mua shqipëtar të më dëboni nga Shqipëria, smë ngjan të jetë këjo një punë e drejtë. Të m'ipni leje të ju them se këjo do t'i vërtetojë fjalët e atyne që ju emnojnë miku i math i serbëve. Aherë zotërija e tij ngrihet e më thotë: Si guxon e më vjen këtu njeriu që tha se unë jam tradhëtor.

Më ndjeni zotëni, i them unë, në telegramën që kisha nënshkruar edhe unë, nuk u emnonim zotnin t'uaj trathëtor, por ata që punojnë kundër atdhesiës.

Me këto fjalë më thotë: Del jashtë e po të dërgonj haber unë.

Pas gjysëm ore vjen komisari e më thotë se pasha bani emën që të vish e të marrësh armën e të shkojsh nga të duash.

I falem nderës pashait, thaç unë: por armën e mora të dytën ditë në mëngjes. Erdh një polic e më përcolli gjër te ura ku fillon rrugë e Kavajës.

Sapo arriva në Kavajë kur kisha dalë të hasem me të njohurit e mi, m'afrohet një polic me pesë shokë të tjerë.

Unë bana sikur nuk e shoh dhe mora rrugën e hanit. Kur isha duke shkrojtur ato që kisha parë në udhtimin tim gjër këtu, më ora tre e gjysëm të natës alla turka, vjen kajmekani i gjytetit, një pijanik i çmendur i quajtur Xhella, prej Mati. Sa njeri i shmëtuar ky kajmekani: ca sy të zgurdulluar, një fytyr të gjelbër që se ka parë kurrë qysh asht uji dhe, aq i shëmtuar sa më vjen randë ta përshkruaj.

Kajmekani që kish pesëmbëdhjet veta me vethe t'aramatosur me bajoneta në grykë të dyfekut, hynë në dhomë e më thotë "teslim".

I rrethuar me xhanderma para e mbrapa më shpien në dhomë të xhandarmariës. Atje më propozuan të ia epë me të shkrojtur për ku jam nisur dhe përse vete.

Sikundër e kisha punën u a dhashë me të shkrojtur shqip ku e përse udhëtoj.

Bejlerët dhe pashallarët në Shqipëri

Themistokli Gërmenji

"Bibloteka Zëri i Shqipërisë", mars 1915

Si shqipëtar dhe si njeri i cili jamë marrë prej vjetësh me çështjen kombëtare, dhe si i njojtur me të shumntit e shqiptarëve nacionalistë, me të cilët kamë bashkëpunuar në të mirë të Shqipërisë, kujtova se nuk do të jetë e tëpërt që të shpall mendimin tim përmbi shkaktarët e prishjes që erdhi mbi kokë të të ngartit popull shqipëtar.

Prishja që na erdhi në Shqipëri, na erdhi vetëm nga pashallarët dhe bejlerët, të cilët për të mos humbur influencën që kanë pasur në Shqipëri, në kohën e Turqisë, u bënë vegla të propagandave të huaja dhe duke marrë disa të holla pa menduar fundit ku do të dalë, bënë në Shqipëri një propagandë për një princ mysliman, për të cilin ata vetë nuk kanë asnjë pikë adhurimi, sepse njerzit që tradhëtojnë kombin e vet, tradhëtojnë edhe zotin vetë.

Pashallarët dhe bejlerët kujtuan se Shqipëria do të bëhet vetëm për ta, dhe se ata do të kiohin atë influencë dhe fuqi që kishin në kohën e Turqisë, por kur kuptuan se Shqipëria nuk u bë vetëm për ta por u bë për të gjithë shqipëtarët, atëherë, ç' thanë një takëm prej ata që kanë qënë më të liqtë e më të liqve në Shqipëri. "Shqipëria s'qënka tona, neve që kemi qën oxhakët e Shqipërisë, sot me këtë Shqipëri që na u bë- ne s'na shkon fjala; po o burra

të përpiqemi ta rrëzojmë këtë princ dhe të sjellim një mysliman me të cilin mund të punojmë sit ë duam se ndryshe do të na humbasë oxhaku”.

Kam dëgjuar me veshët e mi një bej nacionalist i cili ka thënë në mes të kafenesë që: ai nuk është bej por është vetëm shqipëtar etj etj. por një tjetër bej duke u ngritur në këmbë u ngrit dhe i thotë: ske turp ore kur flet kështu?! Bejleku është një titull të cilin na e ka dhënë Turqia dhe neve duhet ta mbajmë se jemi oxhak”. (pa menduar as pak se oxhaku i tyre ka mbyllur shumë shtëpi duke u shojtur farë oxhaknë). Edhe përse? Vetëm për të rrëmbyer mallin! Mashalla oxhakë! Oxhakët e bejlerëve tanë e dimë se çkanë qënë ca vjet më parë. Këto na i tregon historia dhe ata që i gënjen mëndja dhe nuk e dinë se çkanë qënë dhe si janë bërë bejlerë, u liutemi le të na përgjigjen pa do tiua tregojmë neve se ç’kanë qënë, soj pas soji, se më të shumtit e tyre kanë qënë çobanë (barinj).

Në shqipëri kemi shumë soj bejlerësh: Bejlerë prej fisi; bejlerë nga kamja; bejlerë nga të përkëdhelurit e evgjitkave (jevkave); bejlerë nga trimëria dhe bejlerë nga hajdutllëku.

Bejlerë prej fisi quhen ata qënë nëpër punërat zyrtare të Turqisë që në kohërat e vjetra dhe pas shërbimit që i bënë perandorisë osmane duke tradhëtuar combine tyre, u jepte Sulltani kujt një pashallëk, kujt një bejlerllëk, pas tradhëtisë që bënë. Si fitonin titllën e bejlerllëkut ose të pashallëkut rripnin dhe rrëmbenbin mallin e botës pa kursim dhe pa menduar se rripnin vëllezërit e tyre. Ata që u kundërshtonin i vrisnin, dhe ata që trembeshin linin mallin dhe largoheshin nga atdheu për të shpëtuar jetën e tyre. Kësisoj, ata që lindeshin nga ata faqezinj që përmëndëm më lart, quheshin bejlerë dhe oxhakë që den baba den.

Bejlerët nga kamja janë të gjithë ata myslimanë të cilët kanë pasur kamje në Shqipëri dhe kujt i digjte zemra për bejlerllëk, bënte krushqi duke marrë çupë të ndonjë beu, të prishur dmth të rënë nga dynjallëku. Ata fëmijë që lindeshin nga ajo quheshin bejlerë. Për shëmbull një nga këta është edhe Sulejmani i biri i Tafkës nga Mborja (një katund afër Korçës).

Një takëm nga këta të pasurit iu ngjiteshe bejleku që në foshnjëri, nga të përkëdhelurit e jevkave që u thonbin “të keqën o Bej, tu bëftë kurban Nureja” dhe duke u rritur, dajlit i pëlqente ti thonë Bej dhe kësisoj u ngjitet Bejleku, i cili është një mikrob kaq i lig sa nuk shpëton dot prej tij.

Bejlerë nga trimëria quhen ata që kanë vrarë armiqtë e tij ose hasëm e ndonjë beu nga ata që përmëndëm më sipër. Me trimërinë e tyre kanë fituar bejlekun. Se po trë vinte ndonjë prej fshati ose ndonjë mik dhe të thërriste vetëm me emër të tij e të mos i thosh Bej, ay trim jo vetëm që skthente kokën dhe as i përgjigjej por e quante dhe armik. Kësisoj se bota ishte e shtrënguar

ti ngjite bejlllekun me pahir. Kësisoj janë bërë bejlerë edhe ata njerëz që kanë bërë hajdutllëk.

Nga këta që tham më sipër, kuptohet lehtëzi se bejlerët nuk qenkan gatuan prej tjetër balte, siç u pëlqen tu thonë atyre: Bejlerët janë oxhak”, ata sjanë bejlerë por janë hajdutë. Por bejlerët qenkan një soj, një gjak me ata që quhen hajdutë, harbutë dhe bejllëku në Shqipëri qënka një e tillë gjaksore, të cilën ia pat dhënë Turqia për të përfituar interest e saj dhe si u nda Shqipëria nga Turqias, Sulltani ngriti me irade.

Ç’kanë bërë bejlerët për prishjen e Shqipërisë?

Bejlerët vanë dhe u bashkuan me Esadin (Esad Pashë Toptanin) dhe e vunë në udhë të çpallë vetëqeverimin në Shqipërinë e mesme.

Bejlerët qene ata që dolën nëpër fshtra dhe mbanbin në një dorë kuranin dhe në një tjetër kryqin dhe u thoshin fshatarëve për tiu prishur mëndjen: “Kush do kuranin është me pashën dhe kush do kryqin është me princin”, e shumë të tjera që na vjen ligsht rti shkruajmë se qeshin bota me ne.

Bejlerët ishin ata që kishin lidhur nga një çallmë në kokë dhe faleshin nga shtatë herë ditën në sytë e botës, që ata kurrë s’qene falur në jetë të tyre ndonjë herë por gjithë këtë e bënë për ti prishur mëndjen popullit të gjorë.

Pashallarët dhe bejlerët qenë ata që morën të holla nga financa duke i bërë premtime princit se do të bëjnë fuqi dhe do të vënë kundra kryengritësve, por pasi morën të hoillat ikën me fuqinë prej 1 000 vetash që kishin dhe e lanë Lushnjën (si morën të hollat e kasës), në duart e kryengritësve të cilëve u lanë dhe të gjithë xhepanenë që kishin me vete. Kryengritësit nuk qene përveç fshatarë dhe hasan Toptani një katil i Dumresë me 15 shokë.

Bejlerë qenë ata që hynë në Elbasan dhe bënë gjithë ato rezillëke, dogjnë dhe rrojnë sa mundën.

Bej qe ay q ëish dërguar nga ana e Esatit si nënprefekt në Korçë dhe sapo erdhi për të kallur një grindje në mes të nacionalistëve dhe për të fituar simpatinë e myslimanëve fanatikë, vuri tallal dhe thirri që për pesë vjet do të përdoret gjuha turke.

Bej që ay i cili thërriste në Korçë që ka për të mbjell një bejllëk që për njëqind vjet të mos shkulet. E mbolli sa...se i prishi me gjithsej jo vetëm bejlerët por gjithë kazanin e Kolonjës.

Bejlerë janë ata që ishin mbledhur në hyqymet të Korçës më 6 prill shtyll i ri 1914. Dhe kishin vendosur të lëshonin ata katiulet e Starovës në Varosh, që ta prishnin fare dhe të mos merrte masta e duhura Majori holandez zoti Snellen, për të çarmatosurit e Korçës, pa fjalë që Korça do të prisheshe krejt. Dhe si panë që nuk u përmbush dëdhira e tyre satanike, vanë e u bënë me grekomanët.

Bej qe ay që vate në Kolonjë, gënjeu kolonjarët të ngrenë fëmijët dhe bëri teslim Kolonjën.

Bej është ay që kur erdhë të dy topat në Korçë mbajti një fjalim dhe thirri: Rroftë Shqipëria, rroftë ushtria dhe emrin e mbretit se përmëndi fare. Dhe kur vajtën e i thanë pse nuk thirri rroftë mbreti, i mori dhe i nxori jashtë duke iu thënë: s'është puna juaj".

Bejklere ishin nënprefeketi i Starovës dhe kryetarët të cilët na vranë taborë e Kolonjës, dhe bej qe ay që bëri planë për të dërguarit e këtij tabori në Starovë me qëllim ta prishë, se ky tabor ishte një ndër më besnikët e këtij mbreti dhe të Shqipërisë.

Bejlerë qene të gjithë ata ministore të cilët nënshkruan traktatin në Korfuz dhe dërgonin dit për ditë këshilla kryengritësve ctë bëjnë për të fituar qëllimin e tyre etj.

Gjithë këto e shumë të tjera na bënë pashallarët e bejlerët, të cilët po të donin të punonin si shqiptarë të vërtetë, e kishin në dorë ta shuanin atë zjarr që u ndez në Shqipëri. Por ata deshën një Shqipëri vetëm për vete e tyre dhe u bënë shkaktarë që prishën një komb të tërë. Në qafë të tyre qoftë!

Le të mos harrojmë se në mes të këtyre kemi edhe disa të ndershëm dhe shqipëtarë të vërtetë. Për shëmbull do të tregojmë disa emra. Prej Elbasanit kemi Aqif Pashën me shokët e tij, prej Kosovës kemi Bajram Currin, Isa Boletinin me shokë e fisin e tyre etj, prej Kolonje kemi Sali butkën, Izet Zavalanin etj. disa prej Vlore, prej Frashëri, prej Korçë; Xhemal Be Goça, Bejlerët e Dishnicës etj.

Këta zotërinj si shqiptarë të vërtetë dhe besnikë të L.M. së tij, u bashkuan me opingën dhe për të përmbajtur një Shqipëri të lirë, e lanë bejllëkun mënjane. Se e kuptuan që është hiç më hiç. U dogjnë u vranë, u prishnë dhe luftuan me besnikëri dhe jo me djallëzi gjër ditën që M e tij, u largua prej Durrësit për shkaqet e panjohura.

Mos u dëshpëroni o atdhetarë të vërtetë, se së shpejti do të vijë dita kur M e tij Mbreti do të kthehet në Shqipëri dhe bashkë me shqipëtarët e vërtetë do të punojmë për lulëzimin e fatbardhësinë e kombit.

Pashallarëve dhe bejlerëve që u bënë shkak të na prishin Shqipërinë skemi ç'tu thomi tjetër përvec: mos u mbiftë fara! Që të mos u dëgjohet emri...

Kujtime të paharruara

Sevasti Qiriazi Dako

“Yll’i Mëngjesit”, 16 korrik 1917

Gjithë këto kundërshtime po tregonte një udhëheqës edhe një udhëheqës i fesë nga i cili priten punëra të drejta edhe të shenjtëruara. Lodrat e dhespotit edhe të shokëve të tij i kuptonin edhe ata që nuk merreshin farësoj me punërat e politikës; si të mos i kuptonin ata që ishin brenda ndë këto gjëra? Të sjellat e dhespotit, të folurit edhe shpresat e grekomanëve na jepnin të kuptonim kthjellët se kishte një lëvizje të fshehur e cila do të çfaqej shpejt a vonë dhe nuku u gënjyem. Por Shqipëria ndë mos pati përkrahjen e ndonjë fuqie të fortë drejt për drejt, prap ai që urdhëroi të krijuarit e saj e shpëtoi dhe do ta shpëtojë edhe paskëtaj. Po mjerë për ata që i bëhen gur pengimi foshnjes së pafajme!

Ishte dyke ngrysur kur një foshnje, engjell i perendisë u dërgua të na lajmërojë se Sulua, kavazi i dhespotit dhe andar e katil nga vjetët e para bashkë me dy shokë hynë në Eqim Polena, të mërkurë mbrëma më një të prillit. Këjo na vuri në dyshim të madh meqënë që flitej se pas ca ditësh do të hyjnë andarët të marrin Korçën etj...

Meqënë që zoti Dako edhe nuku kishte ardhur ndë shtëpi u ngrita vetë dhe vajta në Majori edhe i dhashë raportin për ato që dëgjova. Fuqia e xhandarmarisë ishte e pakët dhe e përhapur rreth qytetit prandaj vetëm një fuqi fort e vogël u dërgua të rrethonjë shtëpinë e Eqim Polenës por nuku bënë zë duke pritur andartët të dalin. Sulua e kuptopi rrezikun edhe pa fjalë se nuku deshte të binte në duart e qeverisë. Bëri si bëri dhe i dërgoi raport dhespotit dhe i kërkoi urdhër çtë bënë. Në ora 2 të mesnatës i vjen përgjigja të nisnjë “luftën e shenjtë” edhe pushka filloi. Ishtë shënja e parë e kryengritjes që tu jepte aber besnikëve të dhespotit të ngrihen më këmbë dhe të vrasë vëllai të vëllanë. Posa ranë këto dy dyfeqe, grekomanët që ruanin me veshë të ngritur, muarnë pushkët në dorë dhe ngritën pusi nëpër penxheret. Pas pak edhe pas të krisurit e pushkëve, zërat e këmbanave zunë të buçasin.

Ah! Ay zë i ëmëbël, shënja që thërret tërë besnikët të venë të vendi i shenjtëruar për të shërnyer, për të falur edhe për të ardhuruar krietarë, ky zë u bë zë pikëllimi. Zë i cili tronditi edhe të vdekurit nga varri. Zë edhe buçimë që të zgjonjë edhe të nrejë më këmbë ata besnikë të dhespotit që të vrapojnë e të vene në mitropoli për të armatosur edhe për të vrarë të dashurit edhe të afërmit e tyre.

Ngreu o popull i pafjmë,
 Ngreu e vra baban; e vëllanë,
 Ngreu e bëju i pabesë,
 Se kështu i pëlqen Moresë!

O! Ti dhespoti i Korçës, vallë si do të dalësh përpara gjykatësit të math edhe ç'përgjigje ke për të dhënë për atë gjak të pafajmë ato pesë ditë të tmerruara Brenda në qytet? Ah! Gjaku i atyre që ranë dëshmorë po thërret e do t'bërtasë mbi kryet t'at bres pas brezi edhe prehje ske për të gjetur.

Si udhëheqës fetar detyra jote ishte të ligjërosh pajtimin dhe dashurinë, po ndë vënd të kësaj prure mërzitje armiqësi, prishje, vrasje ndë mes të vëllazërisë, aherë kur po ushqenim shpresa të mëdha për ditë të bardha pas një xgjedhë të rëndë prej 500 vjet. Kur zotimet e ëmbla për lirinë e kombit tonë na mbushnin me gëzime atëherë të shohim gjithë këto shpresa të humbasën edhe të fishken me një grimë herë, kjo na pru një dëshpërim.

Pushka e parë më ngriti në këmbë dhe u gëzova, po kur dëgjonjë buçimën e këmbanave na dha të kuptojmë se xheç e pa pandehur po ngjiste.

Qëndruam përpara penxhereve po që errët dhe asgjë nuku ndigjohej përveç të krisurit të pushkëve dhe buçimi. Vërshëllime të plumbavet dhe buçima e këmbanave që po depertonin qetësinë e natës na tronditën shpirtin sepse kujtova katilët që kishin hhrë në shtëpi të Eqim Polenës dhe thashë me vethe: si mjerë ata që të bijën në duart e andarvë! Vërshimi shtonet tepër e më tepër, këmbë në të gjitha anët, të shpunitura rreth e qark po dëgjonen; po nuku çquanim dot gjë, duheshe durim gjër sat ë hapeshë drita. Në të thyerit të mëngjesit çtë shohëm dhe çtë dëgjojmë, “zito, zito o Kostandinos”! U muar vesh për njëherë rreziku i math që na rrethonte; populli i dehur dhe si i marrë po rente poshtë e lart zbrazur pa vënë re e kudo edhe më çdo anë dyke bërtitur: “Zito i Ellas”! Në mëngjes si lindi dielli vatmë të penxherja dhe me kujdes po e ngremë perden të shohëm çbëhet në shesh të aratvet. Kur çtë shohëm! Çdo gjë ka një kufi, po pa njerëzimi, mos përdëllimi edhe tirania kish kapërcyer. Ndjenja njerëzore skishte më. Gjakkpirës më keq se egërsirat që skanë të ngopur tmerr mbi tmerret! Çtë shohç! Shtrirë në mes të sheshit aravet dy trima ndë lulëzim të moshës. Them tmerr i tmerrevet sepse njeriu i cili ka të përgjaturit e perendisë, munt të xbresë të poshtërohet sa të bënet bishë e papërdëlluershme mi atë që ka më të afërm si nga gjaku kështu edhe nga fare e fisi. Njëri prej këta ishte Vasil Trebicka, një trim atdhetar i flaktë i cili nuku e kurseu jetën për shpëtimi të atdheut. Ra në duart e armikut duke luftuar burrërisht edhe pse u plagos rëndë. Kur po hiqte shpirt shkoj një grua zemër-guri, së cilës i kërkoi një lot ujë të lakte majën e gjuhës; po këjo në vënt të ujit i hedh një gur! Një tjetër shoku i kësaj vjen dhe duke dëgjuar

rënkimet e thella të Vasil Trebickës, në vënt të ngushëllimit i afrohet dhe e godet me kodankë e pushkës me tërë fuqinë e tij. Këjo nuku ishte mjaft. Urrejtja kundër Vasilit u shtua kaqë shumë sa edhe fëmija e pafajmë zunë të vjellin vrerë si dhe të mëdhenjtë, dhe duke hypur mbi të i thërrisnin:” thuaj tani se je shqipëtarë!”. Shumë të tjera poshtërime u praktikuan mi trup të dëshmorit Vasil, të cilat penda ime nuku mund ti shënonjë; megjithë këto do të mbeten të paharrura edhe do të ndritin me dritë të zjarrtë.

Shoku i Vasilit, një bej trim i rij nga Pojani u vra përpara derës së Efrem Gjinit në të gdhirë kur po bënte detyrën kundrejt atdheut si devrie. Gjini se desh përpara derës, prandaj i jep ca para një prishuri ta marrë dhe ta shpjerë nga sheshi. Ky i lidh litarnë në qafë dhe e zvarrit ndë araa dhe e lë të shtrirë pranë Vasilit. Beu para se të binte dëshmor ishte veshur shumë bukur. Katilët pasi e vranë e zhveshnë dhe i morën gjithë rrobat dhe këpucët edhe të gjitha paratë që kishte me vete të cilat ishin më teprë se 10 mijë lira, dhe sahatin. Mundimet dhe poshtërimet që u praktikuan mbi trupin e Vasilit u përsëritnë edhe mbi trupine beut, me ndryshim se gurët që iu hodhën beut ishin më të shumta. Të dy trupat e këtyre dëshmorëve të Shqipërisë ndejnë në shesh tri ditë: po u çuditmë që as shpez as qen nuk u afruan ti preknjë. Për gjakune këtyre trimave po vajtonin të gjithë përveçse besnikëte dhespotit.

E dinin edhe prisnin të ktheheshin edhe ti binin shkollës edhe ta bënë plur, se tërë cmirë këtu e kishin por atë që vendos njeriu zoti nuk e vulos. Tërë xbrisnin nga metropolia edhe pazari, edhe kohë nuk u mbet që të mejtonin tashi për tashi për shkollën. Një luftë e rreptë po bëheshe në shesh të Shëngjergjit ku luftuan ballë për ballë shqiptarët me grekomanët. Shqiptarët mundën edhe zaptuan beledien edhe qeverinë, kur grekomanët edhe grekërit kishin policanën edhe anën e Shejt Gjergjit. Sh. Gjergjin e kish zënë dhjakua edhe shokët e tij. Kur e vu re Dervishi trim Dhjaknë ndë ballë të luftës tha: Ay Dhjak unë Dervish, përveç unë asnjeri ska të drejtë që ti bjerë; dyke thënë kështu vë nishanë edhe i bie Dhjakos ndë ballë edhe e vret. Megjith që shqiptarët s’ishin të pregatitur edhe ndonëse nuku ishin as shumicë as oficerë as grekërit prapë këta me trimërinë mund të mposhtnin edhe tu dobësojnë fuqinë. Major Sneller u plagos që të paren ditë me anë të mëngjër, një qime e shpëtoj plumbin nga zemra dhe i zgjati jetën. Major Snellën e mori plumbin prej një mësonjësi grek nga Arta. Si u plagos majori, Themistokliu bashkë me kapedan Doorman edhe Gjillardin mbajtnë komandën në dorë. Të enjten mbrëma pushka pushoj: po bëneshe përgatitje për të dytën ditë.

Nevë ndenjmë mbyllur tërë ditën edhe nuku denim se cbëneshe jashtë përveç ca lajmeve që i sillte fshehurazi fqinja jonë. Jashtë po bëheshin pyetje

për zotin Dako se deshin që ta zënë por ne i thamë se z. dako ishte te major Snelleni që të mërkurë dhe nuku gjendet në shtëpi; po zoti dako në vënt që të qederoset po na flet dhe na jep gajret dyke thënë se shqiptarët si trima do të dalnë faqebardhë edhe se lufta është t'ona. Nuku kuptova dot atëherë profiti ishte apo se na vinte mirë kështu të mësojmë ose që të na mbante me gajret neve e vehten e tij, po pasi u mbarua lufta edhe ushtrua vendi i thashë: Qënke profit!

Fleta e editorit

Parashqevi Qirjazi

“Yll'i Mëngjesit”, 17 qershor 1919

Shumë herë është folur edhe shkrojtur se fatkeqësia më e madhe që i ka ardhur edhe po i vjen edhe sot të mjerës Shqipëri, shkaktohet nga se i ka mënguar arësimi. Në ato kohëra kur Shqipëtarët munt të gjenin kohë për të u arësimitar e dimë se hekurat e tiranisë qeverisë Turke i ndalonin; në këto kohëra kur Shqipëtarët munt të përfitojnë nga ky bekim qiellor, gjejnë si shkak, të mos paturit kohë, lipset të punojmë edhe kështu s'u mbetet kohë për të kënduar edhe për tu ndritur mëndjen edhe shpirtin. Po janë shumë gjëratë cilat ngjasin edhe na vërtetojnë se ky shkak nuku është i mjaftë; se as sytë munt të mbullim që të mos shohim, as veshët që të mos dëgjojmë, për ato gjerra që fliten edhe punohen për prishjen e karakterit të njeriut.

Sa herë që del një veprë e mirë në shesh, në vent që të ndihmohet edhe te përkrahet, vetëm për të mbushur qëllime të dobëta, derdhen të holla, prishet shendet, shkon koha kot, edhe përdoret edhe gjuha më e ashpër, vetëm për të ndalur atë veprë të mirë. Sa herë mentohen nje grup njerës të bëjnë një punë të dobishme, që të mos marin ndonje lavdi bërësit shpejt do të meren masa më të dobëta. Përse thotë, t'a le unë atë të dalë përpara meje? Përse të shohin Shqipëtarët se ay ka sjellë kaq sherbime për Shqipërinë? Përse të botonj unë se ay e ka bërë të parën vepër në këtë ise atë degë etj? Po të rimë t'i nëmerojmë të gjitha nuku sosen dot kurë, këto harijnë për të çpjeguar pikën t'onë. Ay që të ndjekë një punë t'atillë, është i siguruar për veten e tij, se këjo mënyrë është mënyrë e dobët, edhe se një njeri i rethuar me fakte të gjalla të vepravet të dobishme, kurrë nuku munt të bjerë; po hidhërimi i math që lipset të ndjenjë ç' do zemrë Shqipëtarë, është se këto mënyra edhe shumë të tjra kanë prishur karakterin edhe moralin e të rinjve Shqipëtarë. Kur është për tu përdorur fuqi morale edhe lëndare për prishjen e të rinjve,

nuku ka as një kursin, as një bisedim. Kur behet një proponim i mirë do të bisedohet me muaj edhe në funt mund të mos jepet as një përkrahje.

Është për të ardhur keq! Një nga më të shenjta qëllime të Yllit të Mëngjesit, është të ndritonjë edhe të xgjonjë popullin që të mundin të shohën punërat kështu si janë, edhe pastaj të mundit të bëjnë edhe gjykimin e duhur, kështu ndë u bëftë nuku munt të ngjasin ngjarjet e pa njerëzorta, ngatërimet edhe përçarjet të vitevet të fundit, se cilado do të punonjë me ndërgegje.

Ç' do shqipëtar le të pyesë shpirtin e vetë, sa kohë në ditë dyke mentuar edhe dyke fjalosur që t'i bëjnë keq vëllajt? Ç' do Shqipëtar shpirtin e vete, sa net shkon pa gjumë që të çpifnjë dhe të gënjenjë për vëllanë? Mbase për më të afërfimin e ti nga i cili ka parë vetëm mirë edhe kurë ndonjë të keqe.

Po sikur ajo kohë të përdorej për të kënduar ndonjë gjë të dobishme q t'i ndritonte shpirtin, so i math dotë qe fitimi! Njerëzia dotë dëshin si vëllezër dotë mblidheshin të bisedonin për të çvilluar mendjejn e njëri-tjetrit me bisedime arësimi, dotë defrenin duke kënduar këngë kombëtare, edhe dotë mos shikonin këto armiçësi edhe këto sjellje të dobëta.

Yll'i Mëngjesit u lutet të gjithë këndonjësvet të japin vetëm gjysëm ore, në mos më shumë, në ditë, të këndojnë gjëra të dobishme edhe shpejt Shqipëtarët do t'a gejnë shkollën e cila u ka për të pasuruar mëndjen, u ka për të ndrituar shpirtin edhe u ka për të sjellë dashurinë vëllaznore.

Më kujtohet një punëtor që s' munte të shohë njeriu një minut pa punë, i cili nuku kish vajtur në shkollë kurë, po i cili kishte një ditje mjaft të gjërë. Një shok e pyet një ditë se qysh gjën kohë të këndonjë edhe të mësonjë. I përgjigjet dyke thënë:

-Unë nuku këndonjë shumë se nuk kam nge, jam njeri punëtor, perveç asaj këndonjë shumë ngadalë; po, edhe sikur të këndonja më shumë, vallë do t'i mbanja mënt kaqë mirë. Kam vënë re se njerës që këndojnë shumë nuku mabjnë mënt mirë. Mëndjet e tyre janë si sita.

-Mirë po janë disa autorë të shënuar për të cilët kë ditje shumë të mirë.

-Oh, po. Kur më pëlqen një shkrimtar, e këndonj edhe njihem mirë me të. Më pelqen të studionj jetën që ka shkuar edhe e kam mik të ngushtë.

-Do të thuash se kur këndon ndonjë shkrimtar, nuku e le gjer nuku ja mëson jetëshkrimin?

- Jo gjithënjë; po e kam bërë disa herë. Është gjë shumë interesaçmë të vesh re se ritet edhe çvillohen mëndja e një njeriu. Nuku munt të them se përdor ndonjë methodhë të veçantë për të kënduar, po kam bërë këtë rregull, gjithnjë, përpara se të fle këndonj gjysëm ore.

-Po qysh e formove këtë hyq?

Oh, kam nisur kur kam qënë i ri, e shihja se nuku më mbetej asnji minutë për ndonjë gjë mentore edhe e dinja se po mos ta bënja gjë do të mbetesha pas nga të tëra. Është çudi e madhe se ç'ka bërë ajo gjysëm orë në jetën t'ime. Sa do i lodhur të jem, sa do i tubulluar që të jem, me hidhërime etj, dotë rinja të këndonj gjysëm ore edhe bëhesha si tjetër njeri. Më sukej sikur hynja në një botë të re, ku rethimet ishin të kulluara, edhe era e qëruar.

-Lipset t'a kesh kormuar këtë zakon kur ke qënë i ri që të munt t'a mbash pa lajthitur.

-Përveç zakonit është edhe ndjenja që kam në shpirt se në atë kohë shpirti im do të gjenjë prëhje.

-Edhe pas këndimit ndjenje m'i gëzuar? Po këto gjera që po këndon nuku të mbajnë në gjumë?

-O, jo; përkundrazi ato gjëra që të këndonj rinë në mest të atyre gjërave që më mbanin zgjuar edhe më turbullonin mëndjen më kanë qetur shpirtin edhe më kanë bërë njeri.

-Le të mbajmë ment, gjysëm orë këndim përpara se të flemë.

Shtypi i shitur

Gazeta "Rilindja", 7 mars 1936

Kemi pasur rastin të shkruajmë dendur për shtypin kombëtar dhe jemi ankuar për dallkauklëkun, gënjeshttrat dhe dobësitë e tyre.

Me përjashtimin e disa artikujve me vlerë dhe të guximshëm, të shkrojtur në gazeta dhe revista, shtypi kombëtar ka qënë dhe qëndron të jetë i papërgjegjshëm. Ky është kufizuar të mbrojë drejt për drejt ose tërthorazi, intereset poersonale të parazitëve dhe spekulantëve të vëndit tonë, është bërë mercenar i njerëzve në fuqi ose i atyre që përpiqen të zënë përsëri kolltukët.

S'kemi gazeta politike indipendente që të punojnë për të mirën e këtij populli, por vetëm gazeta të shitura që u sigurojnë drejtorëve dhe redaktorëve të tyre të ardhura të majme.

Flitet për opinionin publik, po kurrë opinion publik i vërtetë është çfaqur, se ay që çfaqin gazetarët tanë, përgjithësisht është opinion i tyre ose i ndonjë klike që ata mbrojnë. Janë bërë dallaveret më të mëdha, vjedhje turpe dhe shtypi ka heshtur ose, edhe kur ka folur, e ka bërë për të bërë zhurmë, sensacion, i shtytur nga ndjenja jo të pastra, pa i sjellë as një dobi reale popullit, vetëm se e ka egërsuar këtë...

Po dhe kur ka goditur, rrall e tek, që një revistë ose gazetë të flasë hapur, të numërojë nevojat e popullit shqiptar, të përshkruaj plagët dhe mjerimet e tij, kur ka thirrur se ky vuan për bukë, çnderohet, spekulohet, pra zëri i saj nuk është dëgjuar për arsye se qeveriatarët tanë skanë pasur një ide të qartë mbi nevojat e këtij populli dhe nuk kanë dashur të besojnë se gjendja e tij të ketë arrirë n'atë shkallë që e alarmon gazetarin dhe se shumë herë njerzit në fuqi të këtij shteti kanë qënë t'implikuar (trazuar) në *çështje nga të cilat vuan populli*.

Një popull që ka ndërgjegje se rron në një shtet të lirë, demokrat, ka nevojë të domosdoshme që dëshirat dhe të drejtat e tij të respektohen dhe se shteti që respekton vullnetin e popullit, sovranitetin e tij, ay shtet ka respektuar vehten e tij. Prandaj liria e shtypit është e domosdoshme për sigurimin e të drejtave të popullit dhe për forcimin e shtetit (tjetër hesap kur interesat e shtetit venë në kundërshtim me ato të njerëzve në fuqi).

Po, fatkeqësisht, me gjithë lirinë e gjërë që u është akorduar gazetarëve t'anë, prap populli ynë spekulohet, vuan për bukë, çnderohet, rrihet dhe nuk gjen mënyrën si të flasë, nuk gjen ngushëllim të paktën të dëgjohen botërisht vuajtjet e tij.

Mirpo kazani zjen dhe populli i cili i njuh fort mirë të drejtat q'i përkasin simbas ligjit, ashtu siç i njuh edhe detyrat e tij kur sheh se nuk ka se prej kujt të përfaqësohet, kur ankimet dhe psherëtimet e tij venë humbur, kur shikon se vidhet e spekulohet çdo ditë, astëherë pëllcet dhe nga dëshpërimi i tepërt, vepron në mënyrë që cënon formën e ligjeve. Bëhet posi gjerat e egërsuara që dalin prej kosheres kur një njeri i ngacmon nëpër ato.

Po at'herë ngjet dhe një gjë tjetër me rëndësi. Ata që populli i paguan me djersën e tij që ti ruajnë qetësinë dhe ti mprojnë të drejtat e tij, ata që duhet të jenë si babai i tij, e humbasin torruan kur shikojnë se populli, nga dëshpërimi, bën gjëra që prekin dinjitetin e tyre. Ata duke mos ditur vojtjen e përditshme të popullit që administrojnë, duke mos besuar se gratë dhe burra dalin natën dhe venë e kërkojnë bukë në dyert e botës, duke kujtuar se populli shumë gjëra nuk i di, s'mund ti dijë dhe, më së fundi, duke qënë të bindur se populli ka qënë i mësuar të jetë i urtë dhe i qetë-pa marrë parasysh evolucionin që bën ky në pak vite, ndërgjegjen që ka ky të jetë një qytetar i lirë-ata, themi mbeten me gojë hapur dhe sdinë si të sillen kur shikojnë se ky popull çfaq një dëshirë kolektivisht. U duket se mos populli u marros, mos po bën revolucion, mos "është shtytur me qëllime të errëta prej disa vagabondësh", mos ka qëllim të vrasë, dhe përnjëherësh me mënyrën e tyre orjentalë, marrin masa të rrepta për të sjellë "në din" popullin e dëshpëruar.

Është për tu shënuar se në vëndin tonë sa herë që populli bën ndonjë

demonstratë për të kërkuar një të drejtë që i përket simbas ligjeve në fuqi, sa herë që revoltohet për padrejtësisë që i ngjasin, menjëherë organet e shtypit dallkaur e akuzojnë popullin si të shtytur nga qëllime të errëta prej vagabondësh ose nga propaganda e huaja, tamam ashtu sikur në vëndin tonë punërat të vinin aqë mbarë saqë populli të mos kish asnjë arsye për tu ankuar, pa qënë i shtytur nga të tjerë. Ky pretendim qesharak, mbas mëndjes sonë, është një shkak që vihet përpara për të lehtësuar barrën e atyre që shpien punën që populli të bëjë demonstrata dhe të revoltohet.

Të heshtim?!

Ismet Toto

Gazeta "Arbënia", 22 shtator 1936

Disa ditë më parë u shtypën, në këto shtylla, nja tre artikuj me radhë rreth gjëndjes së shtypit shqiptar, rreth kulturës së popullit dhe rreth gjëndjes psikologjike përgjithësisht.

Dhe thamë se në gjithë Shqipërinë e 1936-ës kemi vetëm një gazetë të përditshme dhe një tjetër që del tri herë në javë. "Demokratia" është varfëruar dhe del kur i teket. Gazeta e Korçës është një azhans për lajmet e huaja. Kështu gazeta në një farë kuptimi janë vetëm dy. Një e përditshme dhe një tri herë në javë.

Revista kulturele-letrare e ekonomike (!) kemi vetëm një, e cila del një herë në muaj. Është "Bota e Re", që shtypet në Korçë.

Pra, e gjithë Shqipëria e 1936-ës nuk ka veç se një gazetë të përditshme, një që del tri herë në javë dhe gjithsej një revistë të përmuajshme.

Pse gjithë kjo varfëri? i kemi dhënë dhe përgjigjet: a) Na ka mbuluar një apati, e cila duket sikur na ka gozhduar dhe s'na lë që të lëvizim e të veprojmë. Duket sikur gjithë ç'që për të thënë u tha, dhe b) Sepse shtypi nuk mund të qëndrojë mbi këmbët e veta financiarisht. Qarkullimi është i kufizuar dhe për rrjedhje shitja e paktë. Nga këto dy shkaqe edhe ai shtyp që ndihet sot qëndron më këmbë më tepër sepse drejtonjësit e tij s'kanë ç'të bëjnë tjetër veç se të botojnë ndonjë gazetë, sesa ka ndonjë qejf në të botuarit e një gazete sot për sot, ose sepse ka ndonjë leverdi financiare detyronjëse. Me një fjalë, qëndrojmë më këmbë me pahir.

"Hesapet e tjetrit bëhen kollaj", thotë një shprehje popullore. Kështu që këndonjësi, kur bën hesap punën e gazetarëve të sotëm, kush e di se ç'parajsë mendon. Ai nuk e di se si qëndrohet më këmbë. Prandaj edhe

pretendon që shtypi të jetë më i shëndoshë edhe më i gjallë, kurse në realitet shtypi i sotëm s'mund të bëjë veçse atë që bën: të agonizojë ditë-ditës. Dhe pikërisht në një kohë kur, po të marësh një leje gazete, nuk është ndonjë punë e zorshme dhe mbasandaj, po të merresh trimërisht edhe me problemet e jetës sonë, nuk është ndonjë punë e rrezikshme.

Me gjithë shpjegimet tona mbi shkaqet e kësaj agonie të shtypit, si në artikujt e mëparshëm, ashtu edhe në përmbledhjen e sipërme, prapë se prapë ka diçka misterioze, diçka të pakuptueshme, kjo agoni e shtypit. "Sepse s'ka qejf njeriu as të këndojë, as të shkruajë!", më thosh një shok aty pardje. Dhe është një shok që ka kënduar dhe ka shkruar shumë. "A e dini se ç'më tha X-i pardje", më thosh po ky shok - "më tha pse s'heshtni fare, mor zot, na lodhtë me zënë tuaj dhe me shpresat tuaja, na lodhtë. Heshtni, heshtni një herë e mirë, mbase në një heshtje të përgjithshme do të jemi më mirë".

Në këtë mënyrë nga këndonjësit vjen një rënkim i thellë: Heshtni! Kurse ne që flasim e shkruajmë, prisnim një inkurajim një "ju lumtë që jini optimistë..."!

Mirëpo në këto bashkëfjalime të këtyre shokëve, në këto dialog të dëshpëruar e të zez, kujtoj, duhet të gjendet dhe e mështa e agonisë së shtypit dhe e agonisë shpirtërore përgjithësisht.

Na vijnë gazetatat dhe revistat turke, frënge, italjane e gjermane si shigjeta, si breshër. Gazetat turke, 16 faqe plot artikuj, plot fotografi, plot gjallëri plot JETË. i marëm dhe i vërejmë me kureshtje. E ndiejmë se vijnë nga një botë ku gjithçka lëviz, ku jeta nuk kuptohet si një heshtje melankolike, po si një zhurmë, si një përpjekje e fortë dhe e vazhdueshme për të arritur forma jetese dhe kulture më të larta e më të përsosura. i hedhëm pastaj një vështrim vetes sonë, shtypit tonë, jetës sonë dhe pa dashur na shpëton nga goja vetëm një fjalë: mizerja. Duket sheshit se jeta jonë, sot për sot, nuk ka një ritëm, një lëvizje, një përpjekje për të arritur formë më të larta e më të përsosura. Është kjo e sotmja një periudhë si ajo e ushtarëve, kur marin urdhër "në vënd numuro"! Kështu ne s'ecim as përpara, as mbrapa. Shënojmë hapin e parë në vënd. Bile u mërzhitëm. Preferojmë të ulemi përtokë dhe të rrimë definitivisht të qetë dhe në heshtje absolute!

Kështu shpjegohet edhe agonja e shtypit. Kështu shpjegohet njëfarësoj edhe agonja shpirtërore përgjithësisht.

Të heshtim vërtet, ashtu siç këshillonte ai miku?! Ashtu siç frymëzon e tërë atmosfera psikologjike e sotme? Jo. Pikërisht saqë e ndiejmë thellë këtë gjendje, që i kuptojmë edhe shkaqet e saj, pikërisht na themi se heshtja është një farë tradhtie. Përkundrazi, duhet folë. Dhe duke shpjeguar

gjëndjen e vërtetë, duhet thënë edhe se ç’duhet thënë, edhe se ç’duhet bërë për ta ndryshuar këtë atmosferë mbytëse. Dhe duhet përsëritur këto thënie ngjersa të realizohet diçka ose ngjersa të kemi frymë na.

Jo të ikurit nga fusha e luftës, po të qëndruarit gjer në fund edhe kur duket i pashpresë fitimi, ajo është detyra e një luftëtari të mirë.

Një monument i kulturës shqiptare “Hylli i Dritës”

Vangjel Koça

Revista “Shkëndija”, korrik 1940

Kur doli “Minerva” e Nebil Çikës, këtu e nja shtatë vjet më parë, Branko Merxhani, të cilit intelektualizma shqiptare i detyrohet shumë gjëra, ngajti një problem i cili nuk kish të bënte vetëm me “Minervën”, po dhe me tërë jetën mendore shqiptare; Revista që shkon apo revista që na duhet?!

Bisedimi u kufizua vetëm në mes të Brankos nga njëra anë dhe të Nebilit e Tajar Zavalanit nga ana tjetër. Mendësia gazetareske e Nebilit dhe temperamenti letrar-gazetar i Tajarit, dy intelektualë po me prirje më tepër nga ana politike dhe praktike e ditës s’e kuptuan dot në tërë gjrësinë dhe rëndësinë e saj pikëpamjen e Brankos, i cili nisi ta konkretojë bashkë me mua në Gjirokastër me numrin e vetëm të “Neo-Shqiptarizmës” edhe vazhdoi vetë ta plotësojë në Tiranë me “Përpykjen Shqiptare”. Si parantezë e çmuar në mes të “Neo-Shqiptarizmës” e të “Përpykjes shqiptare” ka qënë, në lëmin e kulturës politike, “Illyria” e periodës së parë gjër sa e ka patur në dorë Ismet Totua.

Brankua donte një revistë që të ishte “Hylli i Dritës” i djalërisë laike shqiptare. Megjithë përkushtimin e faqes së tretë të “Demokrisë” së Gjirokastrës-për këtë faqe kjo gazetë e kryevendit të Labërisë mund të quhet pionere e lëvizjes së ideve në Shqipëri, djalëria intelektuale shqiptare vazhdonte të notonte në një kaos iderash e ndjenjash dhe rrebeshit kontigjent të ditës s’ishte e zonja ti bënte ballë me një program të caktuar iderash dhe përpykjesh. Sigurisht e donte Shqipërinë, por si kapërcente dot akoma kufinj të ndjenjës dhe të intuitës. Ç’botëkuptim, çpamje të jetës (Weltanhang) kishte djalëria shqiptare për Shqipërinë e Re? Dashurinë e zjarrtë, dashurinë romantike që si mungonte? Po kjo dashuri e vetmuar nuk mund të përbëjë një “botëkuptim”. Duhet edhe drita e mëndjes që të sistemojë idetë e të udhëheqë përpykjet. Fundi-fundit, a kishte faj kjo djalëri që s’kishte idera? Akoma edhe ajo djalëri që ishte kthyer nga Evropa

me kokën plot nga dispencat e profesorëve universitare, por me kokën bosh nga iderat? Në botën shqiptare, muhamedanë e ortodoksë po vazhdonte-dhe s'ka marrë fund akoma-myku i Anadollit ottoman dhe i bizantit grek, myk të cilin s'mund ta ç'dukte e s'mund ta ç'dukë një çerek shekulli mëvehtësie të trivaliturë shqiptare.

Në një të tillë kohë-kohë çapesh drithmarake në errësirë-në Shkodër po vetëtinë një kandil shqiptar, kandili i "Hyllit të Dritës", së fretënvet françeskanë të kuvendit të Teutës.

Ç'po bëjnë këta dishepuj të mirë të Asisiatit?

Kanë një botkuptim të tyre, botëkuptimin vërtetë katolik por shqiptar dhe oksidental kurse botkuptimi muhamedan e ortodoks bie erë Stamboll e Athinë si frymë kombëtare e qytetërimit.

Shkodra i jepte Shqipërisë dhe po i jep akoma revistën që duhet.

Në krah të "Hyllit të Dritës" mund të qëndrojnë denjësisht e me plot të drejtë, "Albania" e Faik Konicës, "Përpekja shqiptare", "Leka", "Illyria" e Ismet Totos dhe ndonjë revistë tjetër jetëshkurtër.

"Hylli i dritës" nisi të shpërndajë dritën e saj jetëdhënëse në një kohë kur Shqipëria po përpëlitej në mundimet e një shteti të sapolindur dhe në qarkun e ngushtë e të mbyllur të një kulture orjentale e ballkanike, e cila nuk shihte dot më tej nga "Muameleja" e zyrës edhe nuk e kapërcente dot kufirin e një retorike patriotike të bukur, po të zbrazët. Sa për idera, hove, frymëzime - u lamë!"

E vërteta!

"Revista Letrare", 1 maj 1944

Problemi kryesor i Shoqërisë Shqiptarë është injoranca që sundon në popull, analfebetizmi. Si shpjegohet, që sot në shekullin ku jetojmë, shumica e madhe e një populli të jetë analfabete. Ç'është bërë, që prej 1912 e tehu, sidomos në kohën e pamvarësisë, për zgjimin mendor të popollit me anën e shkollës. Janë pyetje me vënd që shqiptohen nga kushdo, e sidomos prej atyreve që kanë pak a shumë dijeni për lëvizjen mëndore të botës së jashtme.

Përgjigja e peytjes së parë që, në vet-vehte, është bërë sa herë shkak bisedash dhe polemikash për shkrime dhe botime të përkohshme qëndron, sot më tëpër së kurrë, boshti kryesorë rreth të cilit vërtitet realiteti i pozitës s'onë inferior në harrimin me botën e huaj. Dhe ky realitet që kryen detyrën

e tij kundrejt gjendjes dhe stabilitetit t'onë si Shtet, në lidhje me ç'ka munt të quhet për me sigurimin i s'ardhmes është tepër të thkesohet, sepse kuptohet vetvetiu që armë e parë mprojtëse është thesari spiritual të cilin e zotërojmë brenda kufive t'anë.

Sa për pyetjen e dytë, është e udhës të vëmë në dukje ata elementë që, në sajë të cilësive dhe pozitës së tyre shoqërore në Shtet, quhen sepse e kanë detyrë edukatorë nxitësa dhe punëtorë të lartësimit kulturorë të popullit. Dhe këta elmenta janë drejtonjëse e Shtetit, arsimetarët, intelektualët e të tjerët.

Drejtonjësit e Shtetit se njëres apo tjetrës periudhë (kjo nuk na hyn në punë sepse nuk bëjmë thjesht histori por shkruajme dhe vajtojmë një hall) duhet thënë se kanë punuar mjaft, në përshtatje me rrethanat t'one të brendshme dhe të jashtme, për përphajen e shkollës në vendin t'onë. Por, kundra dashamirësisë së tyre, një vark elemntash-personash me influencë lëndore në njërin rreth ose krahinë, e pengun mjaft përphapjen e shkollës. Këta janë protagonistët dhe viktimat kryesorë t'asaj mëndesie egoiste antishoqërore që i vuri garth arificial po dërrmues kulturës shqipëtare. T'a fshehesh të vërtetën do të i'sh një padrejtësi e pafytyrshme, kurse kjo dhe pikërisht vetëm kjo duhet të na ndalojë sheshit dhe përpara syvet realitetin e hidhur që ka brumosur për qindra vjet rresht se bashku me arsye të tjera historike, tragjedin e përgjakur të fisit t'onë.

Arsimëtarët se bashku me çdo institut tjetër arsimor të vendit sidomos me shkollën fillore qëndruan çerdhja që ndriçonjëse e moshave që u lëkundnë dhe rritnë nën përkëdheljet e dashurore të Falmurit Kuq-e-Zi. Në gjirin e saj u pikturuan me shkronjat e gjuhës shqipe kryevijat e fytyrës së amëshuar dhe stërfisnike të diturisë dhe, me nga dale, iu mbollnë shpirtit të pastër mitoror farat e para t'asaj ndjenje gjer atëherë t'errët dhe të drobitur, që formon karakterin dhe flakëron virtytin e dashurissë së mëmdheut. U desh që arësimtari të krijonte nga hiçi një kështjellë, ndërsa injoranca dhe fanatizmi, mendësia prapanike orjentale e mbështetur dhe e përkrahur nga axhikatorët dhe intrigantët, të stërvitur në të tjera kohë të historisë së Shqipërisë, ia pengun shumë veprën e tij heroike për të ringjallur në jetën kolektive cmirën dhe urrejtjen e ndasive të ndryshme antikombëtare, se në këtë mënyrë do të spekulonin më vonë mbi efektet e tyre në kurriz të solidarisë dhe të unitetit kombëtar. Mirpo guximi i pashoq dhe zelli i çeliktë që kanë karakterizuar arsimtarin në vjetët e pavarësisë për një lartësim kombëtar-shoqëror të popullit tonë, mbeten të papërlyera edhe sot tu drejtojmë mirënjohjen tonë.

Këtëj e tutje vetëm një edukim i ngulshëm, i lirë dhe çvilluar (pa

ndërhyrje, pa prapmendime, pa intriga, pa egoism, pa lëvdata hipokrite të personave të tretë plotë ferra e gjemba duhet të dallohet sin ë çdo vend tjetër të botës së qytetëruar, nga një liri dhe dashuri e sinqertë kundrejt diturisë së shëndoshë, që mund të jetë ilaçi shpëtimtarë për shumicën e madhe të popullit t'onë të varfër, bujar mendjehollë por injorant.

c) Intelektuali e të tjerët: Brenda kufivet shumë të gjerë që përcaktojnë misjonin kombtar, shoqëror, njerzorë të intelektualit shqiptar, ky pothuaj në tëresinë e tij, u tregua i denjë i emrit të vetë. Bir edhe ky i këtij vendi me anën e botës së jashtme dhe t'edukimit –studimit shkollorë, u përgatit ashtu si duhesh kundrejt popullit dhe Atdheut. U përpoq dhe përpigjet si mjek krahinor se agronom, si veteriner, si nënpunës qarku dhe si educator shkollave shtetrorë, të krijojë frymë të re në anën e shëmbëllës dhe të këshillës së tij shkencetare për ta orientuar shqiptarin në drejtimin oksidental në udhën e gjykimit të lirë dhe pozitiv të dashurisë së punës, dashurisë së solidaritetit shoqëror, të dashurisë së Athdehut. Nuk u përfill prej tij pikëpamja e pasurimit lëndor. Nuk iu ndot kasollja varfanjake, por u prek nga jetesa e tij. Bir i popullit, rrojti dhe rron midis popullit dhe i sherben për të pakësuar sa më shumë mizerjen e jetës.

Por prapë e çuan kundra tij ajo mëndesi e kalbur mbretëronjëse në kështjellën artificjale të injorancës dhe të moskorrigjimit që na la trashëgimi një epokë serviliteti, intrigash, lajkash, hipokrizish, vuajtjesh, shtypjesh morale dhe gjakderdhjesh, duke e pandehur këtë misjonin e tij si një fenomen të çuditshëm dhe mëmëmadh dhe jo siç ishte, përsëritës dhe rindërtonjës.

Veçse me të gjitha këto penegesa u bë mjaft punë në këtë drejtim. Egziston pra shkendia që duhet te udhëheqë intelektualët në përpjekjen vigane të drejtimit të jetës shqiptare në botën e shkollës d.m.th t'edukimit moral, shoqëror dhe patriotik. Le ti vemë garth çdo zëri të çjerre ose intrigimi të tërthortë që do të përdoret nga ana e botës së vejtër shqiptare për të penguar zgjimin dhe edukimin mendor të popullit t'onë. Shqipëria populli i shumëvuajtur, duhet të udhëhiqen me ndërgjegje kombëtare në një jetë të ndrshme prej asaj që ka trashëguar nga të parët tanë. Se Shqipëria do të preke kufit e çelniktë të unitetit kombëtar të sigurimit dhe të respektit të jashtëm, të mbrothësisë kombëtare, atëherë kur populli i saj, i ndershëm siç është mëndja e dhe fisnik në ndjenjë, do të jetë ay vetë mbështetja kreysore dhe ndërgjegjshme e godinës kombëtare. Jo më faktorë politik i jashtëm, jo më tolerance dhe indiferentizëm i brendshme, jo më dhelpëria dhe intriga, jo më kapadajllëku dhe tarafi, jo më fuqia e akrabollëkut dhe e titujve të fisnikërisë, jo më adhurimi i lekut dhe servilitetit, jo më lufta e djeshme

kundra intelektualit shqiptarë, asnjë tolerancë, jo më koburja por kalemi. Jo më pra, të gjithë këta faktorë prapanikë të cilët nuk do të na gdhendin shpirtin e të vëmë buzën në gaz për liri e për jetë të re mendimi dhe veprimi, Ata që në hijen çfrytëzonjëse të një botkuptimi shqiptar me karakteristika mesjetare, çiren dhe lebetiten për çdo hap të drejtë, të ndershëm oksidental që bëhet në mes tonë, le të kqyrin me gjykim gjendjen e mjeruar që vetëm injoranca antinjerzore ka mundur ta krijojë në këtë vatrë të djegur dhe të shkretuar. Patriotizmi që sot na frymëzon çdo gjë të re e të përshtatshme për vëndin tonë, na detyron tu drejtohem i atyre që drejtuan përpjekjet e para për liri, mirënjohjen tonë. Por Shqipëria, kombi dëshirojnë të ecin përpara nuk ndalen. Le të mos ia pengojmë rrugën!

Mentarët dhe rrethi shoqëror

Nebil Çika

Revista "Bleta", 1944

1. Nga fakti që në Shqipëri s'ka një grumbull mentarësh ku pjestarët të kenë të gjithë, pamje të përbashkëta, një kuptim të përbashkët përballë problemeve të mëdha të kombit tonë, mbi të Ardhmen dhe mbi qëllimet për t'u ndjekur, s'ka, pra, ide të caktuara rreth të cilave të jenë mbledhur turma njerëzish, s'ka domethënë ide udhëheqëse që të jenë si parime drejtonjëse, nga ky fakt rrjedh anarkia e opinioneve që na turbullon jetën kombtare dhe e bën njerin të mos dijë nga t'ia mbajë. Ç'po bëjnë mentarët tanë e pse nuk i përvishen punës për t'i bërë ballë kësaj gjendjeje themelisht shqetësonte?

2. Në njëmendësi (realitet) drejtonjësit e vërtetë të një Kombi janë jo administratorët dhe burokratët anonimë, por mendimet dhe besimet (croyances = credenze) që ka ai komb, domethënë janë mentarët që prodhojnë: poetët, oratorët, shkrimtarët, etj. Këta kanë jo autoritetin e xhandarit, jo fuqinë brutale, por ndikimin (influencën) e vazhdueshëm pjellor mbi shpirtërat. Mentarët tanë po i shmangen këtij misioni të lartë të drejtimit. Pse vallë?

3. Para se t'i përgjigjemi pyetjes, duhet të caktojmë se kujt i themi mentar. Ky është një njeri që punon me idetë dhe mbi idetë (shkencore, letrare, filozofike, etj.), të cilat i grumbullon në arsyttime duke i lidhur me njëra-tjetrën dhe nxjerr prej tyre ide të reja, dhe prozonon, më së fundi, në fushat e veprimtarisë së tij, shikime të përgjithshme dhe hipoteza.

4. Por ka edhe një kategori tjetër mentarësh. Këta kërkojnë, n'emër të

funksionit të tyre, të sundojnë tërësinë e ndërgjegjes mentare të vendit të tyre ose të botës: artistët, siç është një Platon, një Goethe, një Mazzini, një, Beethoven, një Shën Pal, një Hegel, etj. Për pasojë, kur mentarët merren me politikë dhe shfaqin mendime mbi nevojat më praktike dhe urgjente të shoqërisë, është e natyrshme që arsyet e tyre t'i nxjerrin nga tërësia e mendimeve shkencore dhe filozofike të kohës së tyre. Në këtë kuptim të dytë, mentari ka një vegël dhe një armë. Vegla është mendimi i tij dhe metoda e punës së tij, që i japin mundësi të ndriçojë ndërgjegjen e njeriut. Arma e tij është fuqia që ka për të mbrojtur idenë e tij mbi jetën kundra forcave dhe mbëhivë (necessiteteve) të saj. Domethënë se mentari është një fuqi dhe faktori i domosdoshëm i mbarëvajtjes së një shoqërie të shëndoshë dhe krijonjëse. Kur mentarët hiqen nga mesi, shoqëria mbetet si tufë, pa bari.

5. Për të vënë më në evidencë rolin e kësaj elite të vogël, do të kallëzoj një fjalë të Saint Simonit, i cili duke folur për elitën franceze ka thënë: “Po të qe se Franca humbiste papritmas të pesëdhjetë dijetarët e parë të saj, të pesëdhjetë artistët e parë të saj, të pesëdhjetë industrialistët e parë të saj, të pesëdhjetë lëvruarit e parë të tokës së saj, kombi do të bëhej një trup pa shpirt, do t'i ishte prerë koka. Po të qe për kundra se humbiste të gjithë personelin zyrtar të saj, nga kjo gjë nuk do të dilte për vendin veçse një dëm i vogël”.

E prandaj në regjimin e Zogut klasat drejtonjëse i urrenin mentarët që nuk ishin robëruar prej tyre dhe i luftonin dhe i mënjanonin në dëm të madh të shoqërisë dhe të mirëfunksionimit të saj. Sot nuk i mënjanon kurrkush dhe kanë mundësinë të punojnë e të prodhojnë: Numri i tyre është padyshim shumë i vogël; nuk janë më shumë se njëzet, po të marrim sidomos parasysh prodhimin mendor të vendit.

6. Tani të vijmë në çështjen pse mentarët tanë po i shmangen detyrës së tyre që është drejtimi shpirtëror i kombin. Midis arsyeve që mund të na shfaqen, më e forta duket të jetë ajo e “rrethit”. Rrethi ynë shoqëror, pjellë ndikimeve telurike (të tokës) dhe politike gjatë shekujve të errët të robërisë është tepër apatik. Apati do të thotë paaftësi për t'u impresionuar, për t'u emocionuar. Kjo paaftësi lind paaftësinë për vullnet, pasi vullneti e përfundimi i një lëvizjeje të ndërlikuar ridijimesh (sensacionesh) dhe idesh që luftojnë brenda nesh njëri me tjetrin për të marrë komandën. Kur s'ka emocion e vullnet, jeta merr kuptimin materialist të asaj, që është ta kuptosh shoqërinë njerëzore si shoqëri shtazësh: si shoqëri bletësh, bie fjala, sado ndoshta shëmbëlën nuk e zgjodha mirë, pasi Maurice Maeterlinck-u në librin e famshëm të tij me titullin Jeta e bletëve, ngul këmbë mbi frymën e

zgojit dhe shoqërinë e tyre e tregon thuasht si model urtësie. Le të themi pra, shoqëri milingonash (bubrecash). Por jeta njerëzore s' do të qe më e lartë se jeta e kafshëve po të mos ishte një përpjekje e vazhdueshme kundrejt një fryme (spiritualitet) sa më të kulluar që të jetë e mundur. Apatiku që mendoj vetëm barkun, ose "bukën e fëmijëve" siç thoshte Ismet Toto, ose gradën që ka në hierarkinë zyrtare, ky njeri i cili varet nga ata që kanë arin dhe fuqinë është mishërimi (inkarnacion) i kuptimit materialistik të jetës. Është "borgjezi i vogël" i letërsisë kohanike italiane. Veç kësaj, apatiku është një disfatist në fushën e përparimit kombëtar; ai ka një dogmë t'amshueshme për të mos bërë asgjë që nuk i shërben stomakut delikat të tij: "S' mund të bëhet gjë në këtë vend; s' të lënë të bësh gjë" - thotë sot e njëzet vjetë. Por asnjë prej apatikëve nuk u shfaq kurrë me një vepër në dorë. Por ka dhe më: apatiku është edhe mostoleronjës; ai ka një ide bie fjala, e cila nuk është veçse "opinion", d.m.th. mendim i pakontrolluar, ose ka një paragjykim, dhe ti po shfaqe një mendim të kundërt, ai ta pret mendimin me ironi e me tallje që fshehin-ose shfaqin duke nënkuptuar-akuza të ndryshme kundra teje. Por shkaku i thellë i akuzave nuk është veçse ky: pasi ai nuk punon, nuk lëviz aspak, askush nuk duhet të lëvizë e të punojë.

Por ka edhe më: një nga trajtat më vepronjëse t'apatisë që sundon rrethin tonë shoqëror dhe që pengon veprimtarinë mendore, është gogoli i "kompromentimit". Kur i shfaqta aty, shpejt një shoku se isha duke u përgatitur për të shkruar një libër mbi gjendjen tonë, ky më tha: "Ç' të duhet ty kjo punë tani? Pse të kompromentohesh kot?" Këto fjalë i kam dëgjuar shpesh. E kuptoj se ç' domethënë. Mos kompromentohesh, do të thotë t' i ikësh një përgjegjësie të ndodhshme, të kesh frikë nga kjo e të rrish duarlidhur në vendin tënd. Është d.m.th., ta mohosh vetësinë tënde, është të jesh rob, është të vesh pas një ere që mund të fryjë nesër, është një hesap egoistik dhe paralizonjës që bën për të qenë gati për çdo gjë që mund të ngjasë; është, pra, të mendosh vetëm veten tënde të shtrenjtë e të shenjtë dhe t' i ikësh detyrës që ke si pjestar i një shoqërie e pret të ndriçohet prej teje. Nga ana tjetër, të shfaqësh mendimi tënd, autentik e të singertë, nuk është sikur të firmosësh një traktat politik ose ekonomik në dëm të vendit e pra s' ka se si të të kompromentojë. Mendimi i shfaqur është si një plaçkë e ekspozuar: po të pëlqeu, e merr, e bën tenden; po s' të pëlqeu, s' e merr; nuk është një dekret të cilit do t' i bindesh me doemos.

Veç kësaj kur një shkrimtar shfaq mendime, ky shkrimtar është duke kryer funksionin, detyrën e tij si mentar. Nëse të tjerët i quajnë të gabuara mendimet e tij (them "i quajne", pse nuk e dimë se ku është e vërteta, ose e dimë se është futur thellë brenda në një pus!), atëherë këto mendime

s' bëjnë veçse t'ushqejnë e të forcojnë mendime të tjera; në këtë mënyrë, një mendim i kundërshtuar plotëson funksionin e mentarëve që janë të një mendimi tjetër. Këtu me popullin s'kemi të bëjmë: populli në vetvete, si turmë, varet nga ata që e udhëheqin, dhe bisedimi i një çështjeje u përket vetëm mentarëve kompetentë. E pra, mentarët tanë janë nën ndikimin e një rrethi që bën kërdine. Ky rreth që thyen vullnetet, që të shtrëngon të rrisht duarkryq e fatalist, që të tremb me gogolin e "kompromentimit", ka lindur tipe njerëzish të cilët për të bërë karrierë, ose për cmirë e xhelozi (zili), nuk druajnë t'ulen, në dinakërinë e tyre, gjer në përdorimin e mjeteve politike të shpifjes e të keqinterpretimit të paramenduar për të të paraqitur si njeri me "qëllime t'errta", ose, nga një ekstrem në tjetrin, si "të shitur"; ky rreth ka lindur një traditë e cila lyp që miqësia të zërë vendin e parimeve në rregullimin e punëve shtetërore dhe vendin e të gjitha vlerave të vërteta, dhe pra ka lindur hipokrizinë dhe dallkaukllekun, të cilët si përfundim kanë sjellë zënien e ofiqeve me rëndësi prej "miqve" dhe hipokritëve, në dëm t'interesit të përgjithshëm. Në mes të një rrethi të këtillë, edhe unë e di se c'më pret me rastin e këtyre mendimeve që po shfaq; i marr me mend mbiemrat me të cilat do të kërkojnë të më cilësojnë apatikët dhe "opinion" i cili, nën ndikimin e rrethit, e ka humbur toruan. Por si t'ia bëj hallit që mua m'është mbushur mendja se njeriu i pjekur, i cili dëshiron të jetë element ndërtonjës, s'mund të jetë robi i opinionit dhe s'mund të shkruajë kurrë për t'i siguruar vetes një popullorësi, pasi ndjekja e popullorësisë është sikur të pranosh të varesh nga mendimi i pakontrolluar i një turme moskompetentësh, të cilët askush do t'i linte të përziheshin individualisht në punët e tij.

Kjo varësi i thyen lidhjet e sinqeritetin e të besnikërisë (leainà). Nëse, pra, unë po e marr edhe sot pendën në dorë, këtë e bëj sepse me shtyn gaileja e së nesërme, jo vetiake, por kombtare. Dhe po shkruaj për këndonjësit, të cilët, sikundër në të shkuarën, shpirtin e tyre do t'ia hapin "kuptimit" të fjalës sime. Unë nuk dua veçse t'i ftoj këta këndonjës të mendohemi së bashku mbi problemin themelor të së ardhmes sonë si qenie kombtare, pa marrë parasysh kontigjencat e jashtme, siç janë qeveritë, sjelljet e autoriteteve, kufizime që imponon lufta, etj. Këto janë gjëra që vijnë e shkojnë dhe që s'janë veçse lëvizje në sipërfaqen e jetës së kombeve e jo në rrënjët e saj.

Aneks 2: Dokumente me informacione të vlefshme për gazetarët, botuesit dhe median shqiptare

Letra për Abetaren e parë shqipe Evetar

Naum Veqilharxhi

22 prill 1844

Më të mirën që njohu dhe kuptoi njeriu është të mësuarit... Fare lehtë mund që secili të njohë lehtësimin që ka çdo farë njerzore të mësojë diturinë mbi gjuhë të vet. Djali sado i vogël të jetë, gjithë mundimin dhe vështirësinë do ta ketë sa të mësojë shënjat e të folurit, dmth shkronjat... dhe çdo libër që të marrë në dorë e këndon dhe e kupton; dhe kur të arrijë në mësimet e larta përsëri në gjuhë të tij, shpejt merr përpara; pastaj po të njohë gjuhën e tij, mirë, shpejt e lehtë mëson çdo gjuhë të huaj. Por përsëri nuk them për ata djem, që prindërit e tyre me dëshirë i linin a i dërgonin djemtë jashtë vendit me shpenzime të mëdha, vetëm që të mësonin. Për ata s'them se nuk mësuani. Po kush e bënte atë? Vetëm kamësit e djemtë e skamëseve mbeteshin dhe mbeten sikundër thamë sipër.

Gjithë këto e të tjera, o djem duke më dalë para syve të mij, më nxitnë dhe më shtrënguanë që t'i hyj kësaj ndërmarrje dhe kësaj inisiative... vetëm që të bëj e të rrëfej detyrën që kisha dhe kam për vëndlermin tim dhe për gjuhën time të mëmës.

Se vetëm këtë të vini re gjër sot, në 500 shtëpi ja gjenden ja s'gjenden 50 veta mbarë e prapë që diç dinë të shënojnë, dhe ata mbë gjuhë të huaj. E shpresoj se më të shkuar pak vjet, në 500 shtëpi, s'them të gjenden 100 njerëz që të mos dinë në gjuhë të tyre mësim dhe ata nga kushedi nga ç'pakujdësi.

Dosja e Sigurimit të shtetit për Petro Markon

Promemorie mbi Petro Markon

Tiranë, 27.10.1946

Me ardhjen e Fultzit dhe të Anton Stevens, ky vjen për një herë në kontakt me këta dhe sipas angazhimeve të marruna fillon nga aktiviteti si agjent i amerikanëve. Si kryeradaktor i “Bashkimi” - t, amerikanët me anë të Petro Markos u informuan mbi aktivitetin që kishte treguar kjo fletore deri tani. Petro i furnizonte vazhdimisht me informata të ndryshme, ka dhënë hollësira rreth personelit që punonte aty tue i cilësuar se kush ishin më të besuar dhe kush jo. Ka dhënë biografira të personaliteteve të ndryshme. Në bazë të udhëzimeve të marruna nga Fultz-i Petro Marko desh ta bënte gazetën “Bashkimi” mjet propagande për Amerikën dhe për këtë disa herë mundi të ketë përfundime të mirë për ta. Ka nxjerë fotografi të luftës që bën ushtria amerikane, botuar artikuj nga revista amerikane, të cilat i sillte Stevensi. Ka dhënë Stevensit informata të ndryshme mbi shtypin, numurin e fletoreve që dilnin në Shqipëri, se këta drejtoreshin nga organet e pushtetit, se shtypi privat ishte i ndaluar, mbi sasinë e letrës që dispononte pushteti, çfar mungesa kishte, ç’libra të reja kanë dalë deri aherë në shtyp, mbi libra të ndryshme sovjetike nese sillleshin gratis ose me të holla.

I ka dhënë informata rreth qëndrimit politik të profesorave të shkollave të mesme. Ka njoftuar Stevensin për Karaman Yllin, i cili do të shkonte si ministër i Shqipërisë në Francë. Këtë gjë akoma nuk e dinte njeri. Përpos këtyre ky mer kontakte dhe me Stefan Peterson (Trebicka) të cilin e ka informuar mbi shumë gjëra dhe sidomos mbi shtypin dhe jetën kulturore të vendit tonë. Ka qenë njëri i besuar i Hillit aq sa ka patur raste që ka dhënë letër rekomandimi personave të ndryshëm. Ka informuar duke bërë një revolucion mbi prodhimin e qitrove në rrethin e Himarës dhe ua dërgon atyre. Ka pasur miqësi të ngushtë me Selahudin Toton. Petro Marko i ka dhënë Selaudinit artikuj të ndryshëm anglisht të maruna nga amerikanët siç qe porositur për ti përkthyer dhe pastaj i botonte në gazetë. Si njeri i besimit që ishin, Petro, Selaudini ka biseduar shumë gjëra kundër pushtetit. Aktiviteti kundërshtar i Petro Markos bënet me i dukshëm kur nxirret nga redaksia e gazetës “Bashkimi”. Atehere ky vjen në kontakt me grupin e deputetëve dhe merr pjesë në biseda të ndryshme politike qoftë në Dajti, qoftë në shtëpitë e tyre. Sidomos relacion të mirë ka pasur me Enver Sazanin, me të cilin ka biseduar shpesh herë kundër pushtetit. Në procesin e tij ky është përpjekur të mohojë aktivitetin e tij, por këto vërtetohen nga deklaratat që ka lëshuar vetë më parë, ku vë në dukje gjith aktivitetin e tij prej agjenti në shërbim të spiunazhut amerikan në Shqipëri si një nga agjentët më të besuarë të tyre...”

Ligji provizor për shtypin, miratuar nga qeveria e Xhafer Ypit

5 prill 1922

LIGJI I SHTYPIT

PJES' E PARË

N. 1) Ç' do gazetë ose e përkohshme duhet me pasë një drejtues të përgjegjshëm.

N. 2) Ç' do shqyphtar që ka mbaruar 21 vjetë dhe që zotmon gjithë të drejtat qytetnore ose nuk është dënuar me ndonjë shkak si mashtrim, çpërdorim besimi ose falsifikimi, mundet me u ba drejtues i përgjegjshëm i një gazete ose të përkohshme, por detyrohet të veprojë mbas këtij ligji. Drejtori i përgjegjshëm duhet do e mos të dijë të këndojë e të shkruaj shqyp ose atë gjuhë me të cilën do të shtypet gazeta.

N. 3) Ç' do një që kërkon të shtypë një gazetë ose të përkohëshme, duhet që të kërkojë lehtë me një lutje të posaçme nga Minis. e P. Mbrendëshme; lutja do të përmbajë pikat e poshtë shënueme.

a) Emnin e gazetës ose të përkohëshmes.

b) Vendlin ku do të shtypet.

c) Programin themelues.

d) Ditët e botimit.

e) Emnin, mbi emnin, moshën e banimit e nënshtetësisë e lulesit.

f) Emnin mbi emnin, moshën, banimin e nënshtetësisë e Drejtorit përgjegjshëm.

g) Emnin e gjuhës në të cilën do të botohet. Mbas kësaj lutjeje merrret një dftesë.

N. 4) Ç' do gazetë ose e përkohëshme që shtypet pa u paraqitë lutja e sipërthanun, ndalohet që atë çast dhe botuesi dënohet 100-1000 fr. ar gjobë nga ana e gjykatores. Në qoftë se ky faj përsëritet, dënohet me 200-2000 fr. ar ose nga 24 orë deri në një muaj burg. Në qoftë se llanda e gazetës ose e përkohëshme mbas ligjit meriton një ndeshkim ma të fort, veprohet mbas asaj. Në qoftë se përmbajtja e lutjes kundërshton me të vërtetën ose veprohet kundra përmbajtjes së lutjes, lutja quhet si e pa paraqitun dhe veprohet mbas ligjit.

N. 5) Ç' do gazetë ose e përkohëshme është pronë i të zotit; mundet që të shkojnë edhe në pronë të një tjetrit. Kur vdes i zoti i mbetet trashigimtarëve të tij dhe vazhdohet në botim nën përgjegjësin e një drejtorit të përgjegjshëm.

N. 6) Emni i një gazete ose i një të përkohëshme nuk mund të përdoret prej tjetër kuj as drejtë për drejtë dhe as me një ndryshim që t' i përgjasin asaj. Emni i një gazete ose i një përkohëshme që nuk është shtyp prej 15 vjetëve e këndeje, mundet të përdoret edhe prej tjetër kuj.

N. 7) Në qoftë se Drejtori i përgjegjshëm vdes ose me ndonji dënim të gjykatores largohet nga Drejtoria e përgjegjshme ose bahet ndonji ndryshim në përmbajtjen e lutjes që duhet të jetë e paraqitur, mbas nenet tre (fundit në 5 ditë e sipër) duhet të lajmërohet Ministria e P. Mbrëndëshme; në qoftë se vijohet në botim pa u vrejt kjo pikë, zbatohet përmbajtja e Nen. 4.

N. 8) Kryetarët e administratës, Prokurorët ose Drejtori i Shtypit kurdoherë kanë të drejtë të kontrollojnë burimet e t' ardhunave e shpenzimet e nji gazete ose të përkohëshme. Në fund të hetimeve, në qoftë se dalin në shesh që janë edhe disa burime të mshefta e të dyshimshme, që atë rast ndalohej botimi i saj. Në qoftë se ajo fuqi që e mburon e e përmban gazetën me ndihma të hollash e ka nji qëllim të msheftë për me ngatruar qetësin e vendit ose kërkon të ndryshojë formën e qeverisë ose vepron për me siguruar interesat politike t' asaj fuqije drejtori i përgjegjshëm dhe shkrimtarët e artikujve të dyshimshëm, gjykohen mbas njeve të posaçëm të ligjit ndëshkimuer.

PJES' E DYTË

N. 9) Drejtorët e përgjegjshëm për herë me të botuem fletoren, janë të detyruem me paraqitë nga nji copë tue e vërtetue me nënshkrimin e tyne:

- 1) në Min. të P. Mbrëndëshme.
- 2) në Drejtori të Shtypit.
- 3) në më të madhin nëpunës t' administratës s' atij vendi.
- 4) në Prokurori të vëndit.

Drejtorët që nuk i shtrihen këtij' rryji për çdo numër, dënohen me nga 10 fr. ari gjobë.

N. 10) Në krye ose në fund të ç' do gazete a të përkohëshme, duhet të shënohet emni i drejtorit të përgjegjshëm; përkundrazi u merret 20 fr. ar gjobë. Të pa shënuemit e emnit të drejtorit të përgjegjshëm nuk e shpëton drejtorin e asaj fletoreje nga përgjegjësia ligjore.

N. 11) Ata që shesin ose ata që përndajnë të përditëshme e sende të shtypme, mundin të përflasin vetëm emnat e shkrimtarëve a të fletorevet e të çmimeve të tyne. Të përdorunit e titullave a t' emnave të trupshëm e të thanunit e fjalëve të ndyeta që shnderojnë nji person ose nji trup edhe të bërtitunat në nji mënyrë që shkaktojnë shqetësimin e popullit është krejt i ndaluem. Kundërshtarët dënohen me 5 deri-20 fr. ari gjobë ose me 24 orë deri me një javë burg.

N. 12) Ndeshkimet ligjore që rrjedhin nga përmajtjet e fletoreve me radhë i përkasin: 1) Drejtorit të përgjegjshëm; 2) Administratorit të gazetës; 3) Shkrimtarit t' artikullit; 4) Pronarit të shtypshkronjës; 5) Atyne që shesin e përndajnë gazetën.

Pa qënë e mundun të ngrehunit e gjyqit kundra drejtorit të përgjegjshëm, nuk mundet me u ngreh gjyqi kundra atyne që mvaren prej tij. Administratori i gazetës në qoftë se nuk administrohet prej drejt të përgjegj. dhe shkruasi i artikullit për herë gjykohen si bashkë-veprues. Drejtori përgjegj. e pronari i gazetës janë të përgjegjshëm për damede që bahen dhe për shërbime që vendosen nga ana e Gjykatores.

N. 13) Kushdo që shih vehten e tij të damtuem moralisht e materialisht nga botimet e fletorevet, ka të drejtë me u drejtue në gjykatore dhe

me u ankue mbas nyjit 12, kundra atyne qe janë të përgjegjshëm, për të lypunit e shpërblimeve nuk ka nevojë me dhënë një protestë më së pari.

Gjykatorka mundet me gjykuje përmbi dëmet materiale e morale qe mund t' i ken takue ankuesit një shpërblim të arsyeshëm, veç kësaj gjykohet dhe ndëshkimi qe cakton ky ligj. Gjykesa e gjykatores do të shpallet plotësisht në numrin e parë ose në të dytën tuj fillue, prej ditës komunikimit; në mos u shtypët në këto dy numra, merret një mij (1000) fr. ar gjobë.

Gjykatorka mundet me gjykuje e mundet me vendos qe gjykesa të shpallet edhe në gazetata tjera tue u pagumun shpenzimet nga ana e fletores së ndëshkueme.

N. 14) Fletoret munden të botojnë vendimet e ç'far do këshillave ose Gjykatoreve, por nuk munden të botojnë vendimet e një gjyqit a të një komisioni zyrtarë qe ka rrjedhë mbas msheftazi. Në qoftë se botohet rrjedhja e ndonji gjyqit më së fundit duhet të botohet edhe vendimi qe nepet mbi atë çashtje; ato qe veprojnë kundra këtij ligjit dënohen me 100-400 fr. ar gjobë.

N. 15) Gjykatoret mundin të urdhënojnë ndalimin e botimit të shpjegimevet demoral zuese qe mund të bëhen më ndonji gjyq që vazhdon sheshazi. Ata qe shtypin senden e ndalueme, dënohen me 40-200 fr. ar ose 24 orë deri më një javë burg.

N. 16) Ligjet e rregulloret nuk munden të botohen para se të shpallen zyrtarisht. Ata qe veprojnë kundra këtij nyji, dënohen me 40-200 fr. ar gjobë e në u dashtë, munt të konfiskohen të gjithë aktet e shtypuna.

N. 17) Në qoftë se botohet ndonji send tue çnderue ndonji fe ose shtypen artikulla qe mund të vështijnë dasie e idhërim midis pjestarëve të fevet të ndryshme mbas neni 12 të përgjegjshmit dënohen me 6 muej deri në tre vjet burg, dhe me një gjobë 400-1000 fr. ar. Këto dy nëshkime munden të vendosen prej një herit ose u joftohet vetëm menjatë. Biseda'e shkresa ditunije e filosof ke qe bahen tue u mbështet mbi dokumenta nuk quhen çnderime.

N. 18) Në qoftë se botohen artikuj qe shtynë popullin për me bënë ndonji nga krimet qe tregohen në pjesën e dytë të ligjit ndëshkues, mbas nyjit 12 përgjegjësit dënohen si dhe kriminalet qe kanë bënë atë krim; por në qoftë se botimet e bame nuk shkaktojnë ndonji veprim, përgjegjësit dënohen me burgim të përjetëshëm.

N. 19) Ata qe marrin të holla ose profitojnë me ndonji mënyrë tjetër, dhe ata qe dëshërojnë të marrin para ose të profitojnë duke tremb me të çpallunit ose me të çpifunit e ndonji sendi qe mund të prishin nderin e ndonji njeriut, dënohen nga tre muej deri më tri vjetë burgim dhe me 200-2000 fr. ar gjobë.

N. 20) Ata qe botojnë ose çpallin lajme të rrena, të çpifuna a të falsifikueme ata qe çpallin letra a lajme të pa kenuna në emën të tjetër kuj dhe me këtë mënyrë shkaktojnë prishjen e qetësisë, dënohen me 6 muej deri më dy vjetë burg e me 100-1000 fr. ar ose dënohen me njanin prej këtyne ndëshkimeve

N. 21) Për artikulla ose për fytyra qe shtypen e qe kanë një formë jashtë moralit, mbas nyjit 12 përgjegjësit i merret 40-200 fr. ar gjobë.

N. 22) Gazetat a të përkohëshmet janë të detyrueme të shtypin: a) përgjegjet qe kanë me dhënë ata qe janë kritikuem nga ana e gazetës; b) përgënjeshttrimet qe do bëhen nga ana e qeverisë (përgjegjia duhet të mos jetë

e gjatë më tepër se dy herë nga ajo që ka shkruar fletorja). Këto përgjegje e përgënjeshtime shtypen në fletën e parë të asaj fletoreje ose në atë shtyllë që është botuar lajmi i përgënjeshtuar; për kundrazin përgjegjësit i merret 100-1000 fr. ar. gjobë.

N. 23) Të përsëriturit e fajëve të sipërthana njihen si shkak shtërngimi (Mvshedet).

N. 24) Prokurori ngref padie kundra fletoreve që botojnë sende që janë treguar në N. 18. Qeverija në qoftë se e sheh më nevojë, mundet me ndaluar botimin e fletores deri në mbarim të gënjit. Në qoftë se gënjatorja vendos pafajsiën e tij, drejtori ka të drejtë të lypë dënimin që ka takuar nga ndalimi i botimit.

N. 25) Ndeshimet që janë treguar në këtë ligjë, për fajet e shtypit, zbatohen për gazetën, të përkohëshmet, për fytyrat që shtypen në to, dhe për letra e shpallje të shtypura ose shiten, për tabllat e zadhanjet që mvarren në rrugë e në vende tjera të përgjithëshme.

PJESË E TRETË

N. 26) Të çpifunat që bëhen mbi ndonjë pikë të posaçme, dhe të shamet që shkaktojnë të fyemit ose shnderimin e një njeriu ose të një grupi quhen shnderime. Ato të shpifuna që nuk bazohen mbi ndonjë pikë të posaçme, quhen të shama.

Kritikat me nder e më logjik kurrë ndonjë herë nuk mund të quhen si një faj.

N. 27) Artikullat që botohen dhe përmbajnë fjalë të shama ose shnderime kundra personave që përfaqësojnë fuqinë e fronit mbas nyjit 12 përgjegjësi dënohet me tre muaj deri më tri vjet burg.

N. 28) Për shnderime e të shama që bahen kundra Mbretëve ose Kryetarëve të Shteteve tjera, përgjegjësit dënohet me një muaj deri në një vjet burgim.

N. 29) Të shamet e shnderimet që bahen kundra Këshillit Kombtar e kundra Gënjatoreve, Ushtriës e zyrave tjera ose kundra nëpunësive politik e të përfaqësuesave të Shteteve të huaja që ndodhen në Shqipëri, mbas nyjit 12 përgjegjësi dënohet me 15 ditë e deri më 6 muaj burgim ose më 100—1000 fr. ar. gjobë të dy ndeshkimet mund të bahen edhe të dyja për një herë. Në të shamet, ndeshkimi mund të bëhet nga një javë edhe deri në tre muaj burgim e tue marrë nga 20—200 fr. ar. gjobë; mund të zbatohet vetëm njëna prej të dyjave. Në se i shami a i shnderuem lypë edhe shpërblimin e nderit, Gënjatorja dhe përmbi këtë pikë, jep një vendim të posaçëm.

N. 30) Për të shama a shnderime që bëhen kundra kujdo që të jete nga populli mbas nyjit 12 përgjegjësi dënohet nga një javë e deri më tre muaj burgim dhe bashkarisht nga 40—500 fr. ar. gjobë, por mundet edhe me gënjue vetëm njëna prej këtyre ndeshkimeve. Për të shamet ndënohet nga një javë e deri në një muaj burg e nga 30—300 fr. ar. gjobë ose mund të gëjkohe vetëm njëna prej këtyre dy ndeshkimeve.

I shami a i shnderuem në qoftë se e sheh vehten e tij të damtuem, Gënjatorja veçanërisht vendos edhe shpërblimin e damit.

N. 31) Për të shamet e shnderimet që bëhen kundra Ministrave e anëtar-

ve të Këshillit Kombiar e kundra nëpunësive të Shtetit, zbatohet me doemos përmbajtja e nyjit 30.

E shamja ose shnderimi qi bâhet, në qoftë se i lakon detyrave të nëpun-siës tyne veprohet mbas nyjit 28. Por në qoftë se shnderimet qi bâhen kun-dra, të sipërthanunve e kundra shoqnive tregtare e financjare qi janë formue tue qitë obligacione e ju bâhen vetëm për veprat qi u takojnë nëpunësiës ty-ne tue caktue nji faj të posaçëm, dhe kjo gjâ vërtetohet dhe në rjedhje të Gjyqit. Përgjegjësit për botimet e bamuna nuk mund të dënohen.

PJESË KATËRT

N. 32) 1. Për shnderime e të shame qi bâhen kundra fuqis frontit; 2. Kundra Ministrave; 3. Parlamentit; 4. Për botime qi shkaktojnë anmiqësi ose dasi midis pjestarëvet të fevet të ndryshme; 5. Për botime qi bahen me qëllim të ndryshimit të formës qeveritare; 6. Botimet qi bâhen kundra personit moral t' ushtriës dhe për botimet qi bâhen kundra Mbretënve e Kryetarëve të Shteteve të huaj, dhe për nëpunësit diplomatik të tyne Prokurori vetiut bân gjyrimet e duhuna; për të huejt shkresa e Ministrin P. të Jashtme.

N. 33) Gjykimet qi rrjedhin nga fajet e shtypit, shikohen vetëm në Gjy-katoret e Përgj. Për të shamet e shnderimet qi bâhen kundra atyne qi nuk janë shënue ne nyji 32, shiqohen vetëm mbas nji lutje qi mund të nepet nga ana e të shamit ose të shnderimit.

N. 34) Padinat qi bâhen masi të shkojnë tre muej nga dita e botimit, nuk merren parasys.

N. 35) Në kohë mobilizacionit ose kur asht frigë luftet të botuemit e laj-meve qi i përkasin veprimeve ose veglave të mbrojtjes s' Atdheut janë të nda-lueme, dhe urdhëni i ndalimit shpallet nga ana e qeveris.

Në këtë kohë çpallen vetëm lajmet qi nep qeverija. Ata qi kundërshtojnë dënohen me 1000—4000 fr. ar. gjobë e 6 muej deri dy vjet burgim. Mund të gjykohen me njanën prej këtyne dy ndeshkimeve.

N. 36) Të përkohëshmet qi nuk merren me politik dhe kanë të bânjë vetëm me dituni e me literaturë quhen si libra e nuk hyjnë në rreth të këtij ligji.

N. 37) Gazetat ose të përkohëshmet qi shtypen në vënde të huaja mund të ndalohen nga hyrja me vendim të Këshillit Ministrues.

Ministri i P. të Mbrëndëshme mundet me urdhënue vetë ndalimin e nji numerit.

Ata qi shesin ose i përndajnë tue dit fletoren e ndalueme dënohen me 40—300 fr. ar.

N. 38) Ministrija e P. të Mbrëndëshme dhe e Drejtësiës janë të detyrue-me me zbatue kët ligjë.

Kryemistri	Ministri i P. Mbrëndëshme	Minisri i Drejtësis
<i>Xhafer Ypi (d. v.)</i>	<i>A. Zogu (d. v.)</i>	<i>H. Vrioni (d. v.)</i>

Urdhërrojme zbatimin e kësaj provizorisht.

Këshilli i naltë i Shtetit Shqiptar

Tiranë, 5-4-1722

S. Pesi (d. v.)
Refik (d. v.)

Fletorja zyrtare me ndryshimin e Ligjit të Shtypit,
pas shpalljes së monarkisë

31 janar 1931

Vjeti i X. Tiranë, e Shtunde 31 Kallnduer 1931 Nr. 8

M B R E T N I J A **S H Q I P T A R E**

Fletorja Zyrtare

Botohet prej Ministris së P. të Mbrendshme

PAJTIME: për një mot fr. ar 12 në Shqipni ; fr. ar 20/ashita	Drejtimi: Drejtorit Fletore Zyrtare T I R A N Ë	Një copë e javës fr. ar 0.25: një copë e javës së kalueme fr. ar 1.00
--	---	---

L I G J A E S H T Y P I T

Kaptina e I.

Mbi konditat e botimeve

Art. 1.

Ç' do fletore e përditëshme ose e përkohëshme duhet të ketë një drejtor përgjegjës.

Art. 2.

Drejtori Përgjegjës i ç'to fletoreje të përditëshme ose të përkohëshme ose rivisteje që do botohet në Shqipni duhet të ketë këto cilësina :

- a) Të jetë nënshietas Shqiptar.
- b) Të ketë mbaruar të paktën një liceo ose një shkollë ekuivalente me liceon dhe të ketë një praktikë prej tre vjetësh në rasë që ka mbaruar ndonjë degë universiteti, dhe pesë vjetësh në ka mbaruar vetëm liceon.

Nga kjo konditë e kohës së praktikës përjashtohen gazetat dhe revistat shkencore dhe literare.

- c) Të mos jetë i rrëzuar nga të drejtat qytetnore.
- c) Të mos jetë i dënauar me vepra immorale si për falsifikim, mashtrim, shpërdorim mbësime, vjedhje dhe çpifje.
- d) Të mos ketë një reputacion të keq dhe të mos jetë i dënauar prej gjyqit dy herë me radhë me një dënim prej gjashtë muaj e lart për fajra shtypit mbrendra një kohe dy vjetve.

Art. 3.

Kur kërkohet leja për botimin e një fletoreje ose rivisteje, Ministria e P. të Mbrendshme asht e detyruar që mbrendra një muaj nga data e paraqitjes të kërkesës t' i përgjigjet kërkuetit me vendimin e vet në se do mundet t' a botojë ose jo.

Në rastin e fundit vendimi i Ministris P. të Mbrendshme mbrendra një muaj duhet të marrë aprovimin e Këshillit Ministerial.

Art. 4.

Ai që kërkon të botojë një fletore ose revistë, si garanti për dënimet e tij eventuale duhet të depozitojë pranë një banke në Shqipni një shumë prej 5.000 fr. arit ose t' i paraqes Ministris së P. të Mbrendshme një garanti bankare për këtë sasi të hollash, garantija në fjalë mund të jepet dhe në pasuni të palujtëshme, të hipotekueme rregullisht për këtë qëllim, por në këtë rasë të fundit garancia do të jetë prej 10.000 fr. arit.

Përjashtohen nga kjo garanci revistat siantifikë dhe literare.

Art. 5.

Gjith fletoret dhe revistat që janë tuqe u botuar janë të detyruar mbrendra dy muajve nga data që hyn në fuqi kjo ligjë të konfirmohen me dispozitat e kësaj ligje.

Art. 6.

Ai që dëshiron të botojë një fletore ose revistë në Kryeqytet duhet t' i drejtoj, Ministris së P. të Mbrendshme, dhe ay që dëshiron të botojë në ndonje nga qarqet, Prefekturës së qarkut, një kërkesë me nënshkrimin e vet dhe të drejtorit përgjegjës, e cila dahet të përmbaj këto :

- a) Emni i fletores ose i rivistës,
- b) Vendi i botimit.
- c) Kohët e botimit.
- c) Karakteri i sajë.
- d) Emni e mbiemni, mosha, vendi i lindjes e i banimit dhe nënshietësija e pronarit. Kur pronari asht një shoqëni literare, politike ose tregtare, duhet

Shpallja e dekretit mbretëror
për ndryshimin e Ligjit të Shtypit
22 prill 1933

Nr. 53

DEKRET-MBRETNUER 22 Prill 1933.

Mbi nryshimin e neneve 197, 206 e 207 të Statutit Themeltar të Mbretnis

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Prill 1933, Nr. 21)

Neni 197 i Statutit Themeltar ndryshohet kështu:

«Lirija e fjalës dhe e shtypit asht e garantueme. Censura preventive nuk mund të vehet veç se me Ligjë».

Kushtet mbi rregullimin e shtypit, konfiskimin e shtypshkrimeve dhe ndjekjet ligjore mbi fajet e shtypit, caktohen me ligjë.

Vetëm shtetasit Shqiptar mund të nxjerrin gazeta në Shqipni».

Neni 206 i Statutit Themeltar ndryshohet kështu:

«Mësimi dhe edukimi i shtetasve Shqiptarë janë një e drejtë eksklusive e Shtetit. Jepen vetëm ndër Shkolla dhe institute Shtetnore shkallësh të ndryshme, si mbas Ligjës.

Arësimi filluer për gjith shtetasit Shqiptar arht i detyrueshem dhe jepet falë.

Shkollat private, të ç'do kategorije qofshin, qi kanë veprue deri sot, mbyllen.

Neni 207 i Statutit Themeltar ndryshohet kështu:

«Shkollat fetare për pregaditjen e klerit të mbajtuna prej Komuniteteve fetare Shqiptare, janë të lira dhe rregullohen me ligjë».

Z O G U I.

MBRETI I SHQIPTARËVE

D E K R E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e ndryshimit të neneve 197, 206

Dekret i Presidiumit të Kuvendit Popullor për bllokimin dhe sekuestrimin e librave, revistave, gazetave, etj., që disponohen nga tregtarët*

Tiranë, më 27 nëntor 1950

Në mbështetje të nenit 58, Nr. 6, të Kushtetutës të Republikës

Popullore të Shqipërisë.

Mbi propozimin e Qeverisë.

Presidiumi i Kuvendit Popullor

Nxjerr këtë Dekret:

Dekret Nr. 1180; 27/II/1950 Mbi bllokimin e librave, revistave, gazetave, kartolinave dhe pllakave të gramafonit të tregtarëve.

Neni 1

Të gjitha librat, revistat, gazetat, kartolinat dhe pllakat e gramafonit, të botuara, të incizuara në vend ose të hyra në Shqipëri para 29 Nëntorit 1944, që ndodhen pranë shitësve privatë (ambulantë ose stabël), me hyrjen në fuqi të këtij dekreti, konsiderohen të bllokuara.

Neni 2

Shitësit privatë (ambulantë ose stabël) që mbajnë libra, revista, gazeta, kartolina ose pllaka gramafoni që i shtrohen bllokimit simbas nenit 1, qoftë në emër të vet, qoftë në emër të të tretëve, detyrohen t'ua dorëzojnë këto komiteteve ekzekutive (zyrës së kulturës) menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij dekreti.

Neni 3

Komiteti i Arteve dhe i Kulturës ngarkohet të organizojë kontrollin e librave, revistave, gazetave, kartolinave dhe pllakave të gramafonit, të bllokuara simbas nenit 1 dhe t'u kthejë shitësve, të cilëve u janë marrë, vetëm ato që nuk kanë përmbajtje fashiste dhe reaksionare. Librat, revistat, gazetat, kartolinat dhe pllakat e gramafonit që kanë përmbajtje fashiste ose reaksionare mbahen nga Komiteti i Arteve dhe Kulturës, pa i njoftur pronarëve të tyre asnjë shpërblim.

* Beqir Meta, Afrim Krasniqi, Hasan Bello, Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit, vëllimi I, Tiranë, 2018

Raport dhe Udhëzim i Komitetit Qendror mbi krijimin dhe funksionet e Bibliotekave të Partisë

Tiranë, më 26 dhjetor 1953

I. Puna e bibliotekës me propagandistët:

1. Forma kryesore për të ndihmuar propagandistët është seminari i propagandistëve. Për seminarat punohet në bazë të një plani vjetor dhe mujor. Me propagandistët bëhet punë në mënyrë të diferencuar simbas formave të rrjetit të arsimit në parti. Kështu p.sh. kemi:

Seminare me propagandistët e shkollave politike të vitit I-rë, seminar me propagandistët e shkollave politike të vitit II, seminar me propagandistët e rretheve të ulët të studimit viti i etj. Seminari ngrihet atëherë kur nuk ka më pak se 5-6 propagandistë. Gjithashtu duhet pasur parasysh se biblioteka e partisë drejton të gjithë seminarat e propagandistëve, si të formave të partisë, rinisë e intelektualëve. Por seminarat bëhen së bashku me propagandistë të një lloj forme të partisë, rinisë e intelektualëve p.sh. me seminarat e propagandistëve të shkollave politike të vitit parë të partisë marrin pjesë propagandistët e rinisë po të kësaj forme ose p.sh. propagandistët e rretheve të ulta të vitit II të intelektualëve, marrin pjesë në seminarin e propagandistëve të rretheve të ulëta viti II të Partisë etj. Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit

IV. Puna e Bibliotekës së partisë me agjitorët

Agjitorët, një ndihmë kryesore gjejnë në bibliotekën e partisë. Biblioteka e partisë për edukimin e agjitorëve zhvillon me grupe agjitorësh nga qendra pune të ndryshme, leksione politike e ideologjike, duke ia përshtatur problemeve kryesore që ka partia për një periudhë të caktuar, për data përkujtimore etj.

Gjithashtu biblioteka e partisë zhvillon edhe leksione mbi metodën e punës me agjitorët, me qëllim të bëhen më të aftë në këtë drejtim, bën përgjithësimin e eksperiencës së agjitorëve më të mirë, ekspozon planet e bisedave të agjitorëve.

Bibliotekat e partisë, për t'ju ardhur në ndihmë agjitorëve, për (çdo) muaj përgatitin tematikën e bisedave që duhet të bëjnë agjitorët gjatë një muaji. Për çdo temë shënohet plani i temës në formën e tezave të shkurtra dhe poshtë kësaj rekomandohet literatura. Por këto tema për agjitorët nuk janë të detyrueshme por janë tema perspektive d.m.th. se agjitorin mund të shtojë ose të heqë simbas problemeve që i paraqiten atij në vendin

ku punon. Biblioteka e partisë të qarkut u dërgon tematikën bibliotekave të partisë në rrethe dhe atje ku s'ka biblioteka, seksioneve të agit-propit të rretheve dhe këta, nga kjo tematikë, zgjedhin ato që i shikojnë të nevojshme për rrethin e tyre dhe ua dërgojnë kolektivave të agitatorëve.

AQSH, Fondi 14 /AP, Viti 1953, Dosja 385, fl. 8-15

Puna politike dhe kulturele për forcimin e ndërgjegjes socialiste në masa dhe për edukimin e njeriut të ri

Puna politike dhe kulturele e partisë influencon në forcimin e ndërgjegjes socialiste në masa. Sa më me kualitet të lartë të jetë puna politike, aq më shumë forcohet ndërgjegjja e masave dhe aq më shumë masat mobilizohen për të realizuar detyrat e tyre. Në drejtimin e krijimit të masave, të ndërgjegjes në punë, ka rezultate të kënaqshme. Është mbërritur që puna të konsiderohet si një çështje nderi për çdo punonjës dhe secili përpiqet të shtojë sa më tepër rendimentin në punë, të përmirësojë teknikën dhe metodën e punës. Nga masat po dalin njerëz të rinj, të pajisur me ndërgjegje të lartë socialiste. Të tillë janë stakanovistët në vendin tonë dhe përfaqësuesit më të mirë si Xhevdet Lazja, Sali Vata etj., të cilët, duke punuar me metoda sovjetike, kanë rritur rendimentet dhe kanë përmbysur format e vjetra të punës. Karakteristikë e këtyre njerëzve dhe e gjithë sulmuesve, të stakanovistëve të vendit, është qëndrimi i ri ndaj punës, i cili gjen shprehjen më të qartë në garat socialiste, që janë bërë forca lëvizëse e shoqërisë sonë. Kjo lëvizje ka filluar të zgjerohet dhe në fshat nëpërmjet bujqve përparimtarë dhe rendimenteve të larta në kulturat bujqësore.

Gjithashtu, si konsekuencë e ngritjes së koshiençës së masave dhe e përhapjes së ideologjisë socialiste në ato, ideologjisë borgjeze, fanatizmit, prapambetjes, besimeve të kota dhe zakoneve prapanike u është ngushtuar sfera e veprimit tyre, dhe influenca e tyre në masa ka filluar të bjerë.

Neni 4

Të gjithë ata që në çdo mënyrë fshehin ose heqin nga bllokimi, librat, revistat, gazeta, kartolina ose pllaka gramafoni që i shtrohen bllokimit simbas nenit 1, si dhe ata që nuk i dorëzojnë këto në afatin e caktuar komiteteve ekzekutive, dënohen me privim të lirisë 4 muaj ose me gjobë nga 500 deri 50000 lekë dhe me konfiskimin e librave, revistave, gazetave, kartolinave ose pllakave të gramafonit të fshehura ose të pa dorëzuara.

Neni 5

Ngarkohet Komiteti i Arteve dhe i Kulturës që të japë udhëzime mbi zbatimin e këtij Dekreti.

Neni 6

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Nr. i Dekretit: 1180

**PËR PRESIDIMUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
TË SHQIPËRISË**

Sekretari

Kryetari

Sami Baholli

Dr. Omer Nishani

Kryetar i degës së Ligjeve

A. Frashëri

AQSH, Fondi 14 /AP, Viti 1950, Dosja 1, fl. 10

Aneks 3: Lista me disa prej autorëve që kanë shkruar në më tepër organe shtypi.

Mit'hat Frashëri	10 organe shtypi
Kristo Floqi.....	8
Faik Konica.....	7
Kristo Dako.....	7
Mihal Grameno.....	7
Lasgush Poradeci	7
Mehdi Frashëri	6
Vedad Kokona	6
Nonda Bulka.....	6
Tahir Zavalani.....	6
Branko Merxhani	6
Petro Marko.....	6
Sterjo Spasse	6
Nebil Çika	5
Aleks Çaçi.....	5
Don Lazër Shantoja	5
Ikbal Çika	5
Migjeni	4
Beqir Haçi	4
Aleksandër Xhuvani	4
Anton Logoreci.....	4
Karl Gurakuqi.....	4
Ernest Koliqi	4
Vangjel Koça.....	4
Fan Noli.....	3
Gjergj Fishta	3
Dhimitër Shuteriqi.....	3
Selahedin Toto.....	3
Luigj Gurakuqi.....	2
Sevasti Qiriazi Dako.....	2

Aneks 4: Lista e disa prej shtypshkronjave kryesore që shtypnin gazeta e revista në Shqipëri deri në vitin 1944.

- Shtypshkronja “Drejtësia”, Korçë, 1909
- Shtypshkronja “Korça”, Korçë 1910
- Shtypshkronja “Bashkimi i Kombit”, Manastir, 1910
- Shtypshkronja e “Zojës së Papërlyeme”, Shkodër, 1915
- Shtypshkronja “A. A. Vangjeli”, Korçë, 1922
- Shtypshkronja “Dhori Koti”, Korçë, 1922
- Shtypshkronja “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1924
- Shtypshkronja “Nikaj”, Shkodër, 1919–Tiranë, 1927
- Shtypshkronja “Gutenberg”, Tiranë, 1932
- Shtypshkronja “Elbasani”, Elbasan 1929
- Shtypshkronja “Saide”, Elbasan, 1932
- “Shtypshkronja Franceskane”, Shkodër, 1924
- Shtypshkronja “Paul Siebertz”, Vlorë, 1913
- “Shtypshkronja e Fuqivet Armate”, Tiranë, 1937
- “Shtypshkronja Teknike”, Tiranë, 1932
- Shtypshkronja “Shkodra”, Tiranë, 1933
- Shtypshkronja “Vlora”, Tiranë, 1932
- Shtypshkronja “Atdheu”, Tiranë 1944
- Shtypshkronja “Tirana”, Tiranë 1937

Aneks 5: Reklamat e para në shtypin shqiptar

Fajja e reklamës shfaqet qysh në fillimet e historisë së medias shqiptare. Në revistën “Albania” të Faik Konicës, gjejmë faqe të dedikuara me reklama tregtare që në vitin 1897. Thuajse të gjitha revistat dhe gazetat që pasuan, kishin faqe me reklama të bizneseve të pakta që ekzistonin në Shqipëri.

Me kalimin e viteve, do të përforcohej më shumë ideja e bashkëpunimit ndërmjet gazetave dhe tregtarëve përmes reklamës. Në fund të faqes dytë të revistës “Xgjimi” rezervohet një hapësirë për t’ju bërë thirrje tregtarëve shqiptarë të mbështesin botimin nëpërmjet reklamës në faqet e gazetës: “Shpirti i tregtisë është reklama”. Më poshtë publikohen disa faqe të reklamave në gazeta e revista të ndryshme.

...IV... MINERVA

Flokët ju janë thinjur, mekat.!

Po mos rini duar-lidhur: Njëezia e gjeti çarëne sidra kësoj gjëje.

Flekëve Flusia mund t'u vijë prap ngjyra që ka pasur

Mjetan që të përdorni: **UJ-KOLONJËN "LA CARMELA"**

LA CARMELA është i bërë për të shpërndarë në përpaz.

LA CARMELA i bën të hollë flokët dhe të shpërndarë.

LA CARMELA ndalon të rritet e flokëve dhe është mënyra më e mirë.

LA CARMELA bën që të shpërndarë as duart as bëhet.

LA CARMELA bën formë të depozituar dhe regjistruar në tregëtorinë e përgjithshme të shpërndarë me Nr. 4004.

Përfaqësues për në Shqipëri: **Skendo Pojani** Durrës

Kjo grua pse e ka kaq të njomë e të butë fytyrën?

Maska Veneziane

Një Zonjë ose Zonjë të qofte se ditëson, për arsyt që i vet, të duket veçanërisht të bukur dhe të përdorë produktet.

Elizabeth Arden

Krema Elizabeth Arden e pastron fytyrën dhe shduk rudhat e pikat, e freskton dhe e len të hollë lëkurën. Tënkta Elizabeth Arden e shpërndarë lëkurën dhe i jep gjallëri e shfaqin freshtësinë.

PER TË SHDOKUR PİKAT E ZEZA Përdorni: **Sashelet e Bukurisë Elizabeth Arden**

Nga ana tjetër: **Maska Veneziane e Elizabeth Arden** e ndreq fytyrën dhe i shduk irritacionet e saj. U jep gjallëri eshëve, ngjyten e shet e këthen në ngjyrë të freskët natyrore. E vet e shfaqen çallëminë e gjakut të fytyrës dhe e shfaqen lëkurën nga tokalet.

Elizabeth Arden - 25 Old Bond Street, London W2

Gjenden në:

Parfumeria **Mbrenore**

H. BERBERI & B. KRAJA RUGA 28 NENDOR

...II... MINERVA

PLAÇA ELEGANCE

NUVOTË DIMERORE

GJINALI & NIPAT

Pije e shëndetshme Me uj çesme të filtruar Pa alkool

SINALKO

U-plotësua dhe një nevojë!

Paris

Gjum të ëmhtë në shtrro të pastra Gjytha të mira të gatuar në drejtimin e dy specialisteve (talanturka e allistrang)

Gjithë pijet me mozet më të përshatura

TABELDOT të veçanë! Drejtimi i Hotel-Restaurantit "Paris" mer përshper banketa, paj i saorë, gjer në 100 vet, në loketin e vet ose njëqer shqipëri

Mbledhja e sjkës së Trandë

Hygjen shije e lirësi

Hotel, kafe restaurant

ME RUGEN E DIBRËS Me 100000

Faqe me reklama në revista dhe gazeta gjatë viteve 1913-1924

(Foto: BKSH)

MINERVA

De Stefan Shundi
1928

Prapa et. 11/11

Klientët janë të sigurtë se punët e tyre do të kryhen në mënyrën më të mirë në dobinë e plotë të tyre.

Shërbim i shpejt

Pritje e mirë

Rënaqsi, së fundi

Drejtoreshi në zyrën nënçelëse


Dr. STEFAN SHUNDI

UNIVERSITETIT TË DREJTËSISË TË ROMËS

Zonja e Zojusha!

Për të përfutur nga robat e juaja e për të pasur një veshje elegante sipas modës...

Lindëtrora: 1912



Robaqepsia, MODA'

VANGJEL LUMBËRA, BULEVA MBRETNORË, 83

MODELET E SEZONIT MË TË FUNDIT NGA PARISI

Cespe me gusto e Ledi

Në vitrinën e librarisë LUMO SKENDO këndojmë këtë lajmërim:

Fu që shkoni në këtë vitrinë: - Përfilloi nga rrasja e sotme. Tani që ranë monedhat e huaja u liruam dhe librat. - Librat, a' ka dyshim, përshpëjti do të shtrihen lloshen prapë. Bëni pra pa u vonuar. Bëni porosit. Në të vërtetë, ju them juvo: Jo vetëm për Bar-kun! po edhe Mëndfon ushqeni.

Për çdo informata bibliografike, për çdo nevojë libro dhe këndimi, u këshillojmë këndonjëvret dhe miqvet, të ven' në

Librarija LUMO SKENDO

S' ehtë një dyqan: Ehtë një shtëpi e librave; një zyrë informate arsimore.

KLISHE VULA TABELA

PËR SHËTËPINA E SHEJA DALLUËSE ME RE TËNÇ-EMAIL (Tirana) (shkëllyer)

ETJ.

PREGATITEN N'ATELIERIN FOTOCINOGRAFIK

NEXHDET A. KOSTURI

TIRANË

E PËRFAQËSUEME:

Në Durrës: **Stefan Tali**

Në Shkodër: **Vlazon Koceli**

Në Gjinokastër: **Alizon Emiri**

Në Elbasan: **Libraria Shkampa**

Në Berat: **Geqi Vruho**

Bëni ekonominë më të madhe, duke blerë:

SENDET SHKOLLORE FURNIZIMET E ZYRAVE LIBRAT GAZETAT REVISTAT

NË

ARGUS

TIRANË

Kërkoni katalogun GRATIS Dërgohen porosi kudo në Shqipëri

Nga viset prodhohjese më të përmëndura i' Atidheut

ULLIRI VAJI VERA
DJATHI BAKIA ETJ.

SHUTEN MË PAKIC' E SHUMICË DHE MË ÇMIME TË ARSYESHME VETËM TEK

MAHMUT TOTA & SHOKU

(Tek Pasi kundruell Bashkisë)



FIERA del LEVANTE (PANAIRI I LINDJES)

PREJ 6 DERI 21 SHTATOR

ZBRITJA TË VEÇANTË UDHETIMI 50%

ZYRA ELEKTROTEKNIKE

R. STERMASI

MERR PËRSIPËR:

*Instalacione Centralesh
Drilo - Fuqije - Rrull-pritëse
Zile dhe Radio*

TIRANË - Rruga Koço Kotta

Dr. KRISTIDHI mjek specialist i Syve, rruga Hoxha Tahsin, atër-Postës



Bulevard' i Shënt Gjergjit

Bojtere Amerikane

Për Zonja dhe Zotërinj

Qendër zbukurimi

VELL. V. ZALLEMI

Parfumerie: Kollonjë të mirë 4 fr. ar oka.

MINERVA



Sinalco!

NE VERË
VETËM SINALCO
PA ALKOL
MË UJ TË FILTRUAR



Në tualitin e përditëshëm të një
femme qi don të mbetet
gjithmonë e freskët dhe e ré,
SAPUNI VENUS
është i pazevendsueshëm.

ARS



G. Çani
Robaqenës
KORÇË

Qepim roba
në gjith form-
mat me mje-
shhtëri të rallë

Kemi dhe gjith
kalitet
e kazmireve

EMBELTORE "YLLI"
GURI V. LUBONIA
Rruga e Mitropollit No. 22

Në embleterën "YLLI" gëzohen
gjitë embleterat, si: Turta,
Bakllava "Orientale"

Konfiteria
Pagjitë të mirë



**Duhet & cigare shites
OSMAN FEJZI**

Kemi shumë lloj duhanit dhe
cigaret me omni të kënaqshme.
Blotaje çdo lloj kafë për 2
korona okën me mashina të sis-
temi modern amerikane; gjith
shtu shesim dhe kafë të bijtur
për 19 korona okën.

Keto ditë na vëllë v'fijmë dotimë
hapë të mirë
Çmimi i tyre mëjor i lart.
Merr burroni njëdit i' l'adretit

Këlbaza shërchet vetëm me "Distol"
Shërimi është i sigurt dhe i shpejtë
SHITET NE Farmacine "Shendetit"

POLYFOTO PER HERË TË PARË
NË SHQIPTARI

SHUMË FOTOGRAFI NË **FOTO-STUDIO MAZREKU**
FOZA TË NDRYSHME TIRANË - Rruga e Çajit No. 10 - TIRANË

Dr. FERDINAND BUNGO

Mjek i spitalit
specjalizim për ob-
stetrikë e ginekologji

Pret vizitë
çdo ditë prej
orës 10-18

RREGUA DE KADAUNA (Pakull në krahinën Muzinë)

DOKTOR RONGA

Në transferim klinikë dhe vet për sëmundje
YENERIKE DHE LËKURE

Grupi MARRËTORE Nr. 102 - TIRANË

Pret: prej orës 8.30 deris 13
prej orës 16.30 deris 20

SMUNDJE TË BRENDESHME
GRASH DHE FEMIJESH

DOKTORESHA KATERINA MENZER BALDINI

Mjekse patologje e Spitalit Civil

Rr. Muzinë Tëputur 102 TIRANË

Dr. SPIRO ÇIPI

FATHOLOG
KONSULTIMË SPECIALE
PËR SËMUNDJE NËVROSE
DHE MENTALE

Pret çdo ditë në ballkonin e rr. RREGUA DALLË 89 - Tel. nr. 8

E PARË SHOQNI SHQIPTARE PUBLICITETI

S. P. A. S.

Shoqni Publiciteti Artistik Shqiptar

TIRANË - Rr. CARNARVON 15 (për ballë ish Kafë Sovajës)
Telefon 214 - Kutija Postare 96

Shoqëria e shtetshme "STOHU" Tiranë

MINERVA

TWO GREAT NEW TRUCKS BY REO



Esportuesi preferues, për misionin njerëzish dhe plagë, kështu, ka misionin e detyrës së tij. Në këtë REO, sepse janë të shpejta — durueshëm shumë — me pajisje të gjëra — një koha të gjatë — janë ekonomikë — janë të lirë.

Për këto cilësira dhe për cilësitë e ra'istia, firma REO ka shumë kliente.

Fillojnë nga 4 tonellata gjë në 4-6 tonellata.

“FLYING CLOUD” REO

Duke fabrikuar dhe shitur 30 vjet reut automobil, teknika e firmës REO arriti të bëjë një automobilonë të automobilave — të

si të **Flying Cloud** — me manxhel automatik l'vojës. Mijëra njera që ngjajnë automobilonë, kanë vleratuar në ndërtimi automobilin e sajës së

të përparimit në i trejshëm i taktikës së automobilave në 1934. Vaj këtyre REO ka të gjitha cilësitë dhe komoditetet që i jep koha.

PËRFAQËSUESIT I PËRQJITISHËM PËR SHQIPTARËT: **VASIL PAPPA - Sarandë - Durrës**

Dr. DHIMITER PRAPOPULLI

MJEK-PATHOLOG
MË EKSPERIENCË TË GJATË

FRANON VIZITA PËRJ OHËS: 10 - 12 PARA DREKË DHE 3 - 5 MESA DREKË

Bregu VELLA MBRETNORE (Pranë Shng Shkollës) - Durrës

SHITËR PËR SHITYPISHTORINËN „TIRANA“ NË TIRANË, BREGUA SHKOLLË PASHË ZOGU 104

MINERVA

‘Parisiana’

SAPUN FRANCEZ



*Qualitet i lartë
Ërë e këndëshme*

SAPUN SHUM I MIRË - ÇMIM EKONOMIK - GJËNDËT KUDD

Një pudrë e re ...



L. T. PIVER ju prezanton pudrën **MAYTË**, kreacionin i fundit. *Qualiteti i lartë i saj i ka siguruar famën të përbalshme.* 22 22 22

Me erë të lehtë që bashkohet me odë parfume. 22 22 22 22

ÇMIM EKONOMIK

PËRFAQËSUESIT I PËRQJITISHËM PËR SHQIPTARËT:
SHKALLI RUGI, Tiranë

Përfaqëson për: Durrës-Tiranë: **TONIN SHIROKA**
Për Shkodër: **JAK KRAJA**

MINERVA

KUJTIMET MË TË MIRA RUHEN ME NJE APARAT “Voigtlander”

dhe me filmat:

- VOHGLÄNDER • 23:
- PERUTZ •
- NIKOSIA •

Si dhe dykë dhuruar:

- Një dykë «PELIKAN», «PARKER»
- «AURORA», «FABER» etc
- Një kuti cigaretes «AROUS»
- Një kuti letrash-shkrimi «LUKS»
- Një album H. Bekur
- Një kuti bojës pikturë «SCHMINKE»
- Një saktë tavolinë
- Një album fotografije dhe
- ÇDO SEND PËR 2 YRA



Me një **SPILLANT** - teknologjia e sajës, sepse me një e pasqyrore që shfaq, rrethvorbës ka mundësi të vlerësuar për një detyrë. Një kuti bojës dhe një album normal 6 x 6. Me adresën të parë 1-1-1-1.

Pr. nr. 29-



• **PERKHO** - 4.5 x 6
Eashtë një aparat i vogël dhe i lehtë dhe praktik. Me film 127 x 170 mm. Pjesë të reja - Çmimi i 4.2
Çmimi Pr. nr. 72-



• **BESSA** - 6.9
Aparat me shkallë në 12 matës të Durrës-Mirësi. Pr. nr. 65-
Pranë 10-11 Pr. nr. 65-


LIBRA REVISTA GAZETA ALBUME MODË

NGA TËRË ANET E BOTËS

ABONAMENTE DHE POROSITJE ME ÇMIMET ORIGINALE, SHËRIM I POSATSHËM, DËKË DËRGUAR POROSITJA NË GJITHË QYTETET DHE KATUNDET E SHQIPËRIË 22 22 22

KËRKONI HOLLËSHRA «GRATIS» DHE DREJTOHUNI ME BESIMIN MË TË MATH NË
LIBRARIJA “ARGUS”
TIRANË, RUGA MBRETNORE, 14 (PRANË PALLATIT MBRETNORË)

SHOQËRI DETARE AMERIKANE



UNITED STATES LINES

GAQI M. OPARI

AGJENT I PËRQJITISHËM PËR NË SHOQËRI TIRANË

Vapore ekspres për Amerikë & Kanada
NISJET PREJ HAVRE

Mahnattan	12 Mars
President Harding	19 "
Washington	26 "
President Roosevelt	2 Prill

Çmimet e Klasës së tretë prej Durrës New York doll. 110

PËR INFORMATA ADRESOHUNI TE AGJENTAT

Korçë:	Erlind Opari & Bije	Përmes:	Dhimo Hotova
•••	Nano Limoni	Berat:	Llambi Tavanihi
Ersekë:	Mihal P. Prodani	Sarandë:	Koço Qendro
Gjipekastër:	Xhimo Godella	Tepelenë:	Thodhos Leska
Durrës:	Lipo Spiro		
Gjergjeat:	Vasil Liel		

Shërb. dhe Libraria Dhori Kufi, Korçë

Aneks 6. Lista e organeve të shtypit gjatë viteve 1848 - 1944 (Rendiur sipas vitit I të botimit)

Titulli i botimit	Viti I bot.	Viti i fundit	Periodike	Botues	Kryeredaktor/drejtor	Lloji	Nr. Faqe	Vendi
L'ALBANESE D'ITALIA	1848	1848	2 herë në javë	Girolamo de Rada E COMP.	Girolamo de Rada E COMP.	gazetë politiko-kulturore-letrare	4	Napoli, Itali
FIAMURI ARBËRIT - LA BANDIERA	1883	1887	permuajshme		Girolamo de Rada	gazete periodike mujore	12	Cosenza, Itali
DRITA	1884	1884	mujore	Pandeli Sotiri	Pandeli Sotiri	Fletore mësimi e përhershme (Periodik letrar)	16	Kostandi-nopojë
ARBRI RI	1887	1887	permuajshme		Giuseppe Schiro	revistë kulturore e letrare në gjuhën shqipe dhe italisht		Palermo, Itali
ELCIJA I ZEMERS T'JEZU KRISCTIT	1891	1913	permuajshme	Kolegji i Jezuitëve		e përkohshme mujore fetare (katolike)	52-392	Shkodër
ALBANIA	1896	1909	permuajshme / përdyjavshme	Faik Konica	Faik Konica	Folklor, Linguistike, Literaturë, Histori, Lajme	28	Bruksel, Londër
ILI I ARBRESHVET	1896	1897	permuajshme		Antonio Argondizze	kulturore, shoqërore, letrare, folklorike, gjuhësore	18	Cosenza, Itali
KALENDARI KOMBIAR	1897	1928	vjetore	Shoqëria "Dëshirë" Sofje		kronologji të përbotshme dhe shqiptare	56-225	Sofje, Selanik, Tiranë
L'ALBANIA LETTERARIA = SHQIPËRIA LETRARE	1897	1897	përdyjavshme		Francesco Cicero	revistë e përdyjavshme në gjuhën italiane	20	Kalabri, Itali

(LA) NAZIONE ALBANESE	1897	1923	2 herë në muaj		Anselmo Lorecchio	buletin politik, letrar e kulturor në gjuhën italiane, rralë shqip	20	Pallagorio (Catanzaro), Itali
KALENDAR SCCYP	1898	1898		Kleri Katolik		kalendari i festave fetare të tri besimeve, kronika	36	Shkodër
ALBANIA E VOGËL	1899	1903	përdyjavshme	Faik Konica	Faik Konica	lajme nga bota	8	Bruksel, Londër
MIKU BESTAAR - HAANNAMIA PER SENNE	1899	1899		Kisha Katolike		kalendar fetar		Milano, Itali
KALENDAR I MALEVE	1900	1901	vjetore	Faik Konica	Faik Konica	festat festare dhe kulturore, kronika, këshilla bujqësore, etj	36-158	Bruksel
ALBANIA - ROMA	1901	1901				italisht, arabisht	24	Romë, Itali
TOSKA	1901	1901	përmuajshme	Milo Duçi	Jashar Erebara	gazetë informuese	12	Beograd, Misir
DRITA SOFIE	1901	1908	përdyjavshme	Shahin Kolonja	Shahin Kolonja	gazetë politiko-letrare	4	Sofie
BESA	1904	1905	permuajshme	Thoma Abrami	Milo Duçi	revistë politike, shoqërore, kulturore, letrare etj., në gjuhët shqip, frëngjisht, turqisht dhe greqisht	30	Kajro
FLAMURI I SHQIPERIS = LA BANDIERA ALBANESE	1904	1904	2 herë në muaj		Giuseppe Schirò	revistë politike, shoqërore, letrare, kronika	12 deri 40	Napoli, Itali

LAIMTARI I SHCYPENIES = L' ARALDO D' ALBANIA	1904	1905		Kryekomiteti Dretare	Conte Vladany (pseud. i Gaspër Jakova).	revistë politike, shoqërore, kulturore, letrare, historike, arkeologjike etj., në gjuhën shqipe dhe italisht	12	Romë, Itali
PRO ALBANIA = PRO SHQPËRIA	1904	1904	1		Gius. D. Ciarra	revistë e ilustruar letrare në gjuhën italiane me një përkthim në shqip	8	Itali
SHCYPRTARI	1904	1906	vjetore			kalendare per vete 1904 : përmban lëndë letrare e kulturore, didaktike, gazmore etj. si dhe lajme e kronika të kohës dhe kalendarin fetar	200	Napoli, Itali
LA QUESTIONE ALBANESE = ÇËSHITJA SHQIPTARE	1905	1905	përmuajshme		Orazio Irianni	revistë e përmuajshme politike, shoqërore, kulturore, letrare etj. në gjuhët italisht, pjesërisht edhe shqip		Buenos Aires
KOMBI	1906		javore	Sotir Petssi	Sotir Pettsi	gazetë politike letrare	4	Boston USA
LEGA ALBANESE = LIDHJA SHQIPTARE	1907	1907			Orazio Iriani	udhërrëfyes i lëvizjes kombëtare shqiptare : e përkohshme politike, shoqërore e kulturore në gjuhën italiane		Buenos Aires
KORÇA	1908		javore	Sami be Pojani	Thanas V. Floqi	gazetë politike, letrare, trrtegtare	4	Korçe
DITURJA	1909	1929	permuajshme		Lumo Skëndo	revistë kulturore, letrare e shkencore	44	Tiranë, Bukuresht, Selanik

KALENDARI KORÇA	1909	1931	vjetore	Mihal S. Xoxe & Jani Kremro		festat fetare ortodokse dhe lëndë të ndryshme kulturore, shoqërore, letrare, kronika të kohës	20-314	Korçë
VIATA ALBANO - ROMANA = VIE ALBANO - ROUMAINE SCIENTIFIQUE = JETA SHQIPTARE - RUMUNE	1909	1910	përmuajshme		Dr. Shunda	përmuajshme politike, shoqërore e shkencore në gjuhët rumanisht, frëngjisht e pjesërisht edhe shqip	25	Konstancë (Rumani).
DIELLI	1909	1939	Javore/ditore	The albanian society "Besen" / Vatra	Faik be' Konitza, Kristaq E. Floqi, Andon Frashëri, R. Xh. Gurrazezi	gazetë politiko - kulturore, organ i Shqipëtarëve Nacionalistë	4	Boston USA
GLASUL ALBANIEI = ZËRI I SHQIPËRISË	1910	1910			C. Podrescu	revistë politike, letrare dhe shkencore në gjuhën rumune	18	Bukuresht
KALENDAAR I PJESËSHEM	1910	1910		Kleri Katolik		kalendari katolik për muajin janar 1910	32	Shkodër
LAHUT' E MALISIS	1910	1910		Shoqnia e Djeleumisë Shqiptare Manastir	Hristo D. Qirias	revistë politike, letrare, kulturore, historike, folklor e lajme të kohës, në gjuhën shqipe	20	Manastir
(L)' ALBANIA NELL'ORA DEL RISORGIMENTO	1910	1910			Oreste Buono	Shqipëria në orën e rilindjes : revistë politike dhe letrare në gjuhën italiane dhe shqipe	12	Sicili, Itali

SHQYPEJA E SHQYPIENIS	1910		dy herë në muaj	Josif Bageri	Josif Bageri	gazetë politike, kulturore, letrare	4	Sofie
LIBRI I PERVJETSHËM SHQIPTARI	1911	1911		Zyra e fletës "Shqipëtarë"	Hilë Mosi	vjetar në gjuhën shqipe, përmban festat fetare (kalendarët) dhe lëndë kulturore, shkencore, letrare e shoqërore me ilustrim	195	Stamboll
TRUMBETAE KRUEJËS	1911	1911			Faik Konica	shqip anglisht	4	Sant Louis Missouri, USA
DRITA MANASTIR	1911	1912	e përjavëshme /2 herë në javë	Mustafa Hilmi Leskoviku, Ali Panariti	Mustafa Hilmi Leskoviku, Ali Panariti	gazetë politiko-letrare	4	Manastir
KALENDARI I VJETËS	1912	1927	vjetore	Vepra Pijore		festat fetare dhe lëndë kulturore, letrare, historike, fetare, kronologjike, ngjarje, kuriozitetet etj	72-116	Shkodër
ZEGTHI	1912					Revistë satirike dhe humoristike		
HYLLI I DRITËS	1913	1944	permuajshme	Kisha Katolike	Gjergj Fishta	fetare, kulturore, filozofike, juridike, letrare, shoqërore, gjuhësore, folkloristike, lajmet kohës	56-98	Shkodër
PERLINDJ'E SHQYPIENIS	1913	1914	2 herë në javë		D. Beratti	Organ për të mprojtur të drejtat kombëtare. Del dyë herë në javë në Vlonë		Vlorë

ANEKS 6. LISTA E ORGANEVE TË SHTYPIT GJATË VITEVE 1848-1944

XGJIMI	1913	1914	përmuajshme	Dhori G. Kotti	Mihal S. Xoxe	revistë politike dhe shoqërore me ilustrimë në gjuhën shqipe	28-64	Korçë
ZËNI I SHNA NDOUT	1913	1944	përmuajshme	Kisha Katolike	Marjan Prela, Andon Harapi, Vinçenc Prenushi etj.	fetare dhe kulturale e klerit katolik	20	Shkodër
ALBANIEN	1914	1914	përmuajshme		Alexandre Salkind	revistë e përmuajshme politike, shoqërore, historike, etnografike		Vienë
DRITA E POPULLIT	1914	1914	2 herë në muaj		Mustafa Qulli	politike dhe shoqërore	20	Shkodër
